



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në subjektin Bashkia Përmet

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Auditim Financiar dhe Përputhshmërie

Tiranë, 2025

PËRMBAJTJA		Faqe
I.	PËRMLEDHJE EKZEKUTIVE	3-3
1	Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	3-3
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-5
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6-8
II.	HYRJA	8-8
1	Objektivat dhe qëllimi	9-9
2	Identifikimi i çështjes	9-9
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9-10
4	Përgjegjësitë e audituesve	10-11
5	Kriteret e Vlerësimit	11-12
6	Standartet e auditimit	12-12
7	Metodat e auditimit	12-13
8	Dokumentimi i auditimit	13-13
III.	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	14-14
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	14-15
2	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	15-15
2.1.1	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.	15-32
2.1.2	Mbi auditimin e brendshëm.	32-34
2.2.1	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit për vitin 2024.	34-80
2.2.6	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2024.	80-98
2.3	Mbi planifikimin dhe zbatimin e procedurave të prokurimit publik.	98-135
2.4	Mbi zbatimin e kontaktave të Punimeve	135-148
2.4.4	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës Publike	148-155
2.5	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.	155-163
2.6	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore.	163-166
2.7	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	167-196
2.8	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	196-196
IV.	REKOMANDIME	196-221

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Bashkia Përmet, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të Bashkisë Përmet për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

b. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Përmet. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme: Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
- Auditim mbi Burimi i krijimit i të ardhurave.
- Auditim mbi Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2024.
- Auditim mbi planifikimin, dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike. (Aseteve dhe pyje kullota) të transferuara sipas VKM.
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të Territorit.
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV.
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

c. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar transaksionet e likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme.

d. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

1. Mbi Prokurimet publike: Nga auditimi i 10 (dhjetë) procedurave të përzgjedhura për auditim për periudhën 01.01.2023 -31.12.2024 , me vlerë totale të fondit limit 320,032,598 lekë pa TVSH dhe vlerë totale të kontratave 269,460,736 lekë pa TVSH, u konstatua se, janë aplikuar kritere të paargumentuara. Nga auditimi i 10 (dhjetë) të përzgjedhura për auditim u konstatua se në një (3) raste për vlerën 28,300,285 lekë nga Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar Fondin Limit. Në 7 procedura nga 10 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 325,436,368 lekë pa TVSH dhe vlerë totale të kontratave 279,303,576 lekë pa TVSH, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Përmet.

1.1. Mbi zbatimin e kontratave:

Nga auditimi i zbatimit të kontratave në 6 objekte, rezultoi dëm ekonomik në vlerën 2,639,733 lekë pa TVSH, si rezultat i diferencave në volume pune.

2. Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të Territorit.

- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe deklaratave paraprake, u konstatua se në 5 raste, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Në të gjitha rastet janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu në 1 rast u konstatua se leja e ndërtimit nuk respekton përcaktimet ligjore në lidhje me përmbajtjen e dokumentit të lejes së ndërtimit.

3. Mbi procedurat e dhënies me qira dhe likuidimin e kontratave të lidhura.

Gjatë periudhës nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, rezulton se janë aktive gjithsej 52 kontrata për dhënien me qira të aseteve në administrim të Bashkisë Përmet. Referuar këtyre kontratave, konstatohet se Bashkia Përmet nuk disponon titull pronësie për pasuritë e dhëna me qira, gjë që cenon sigurinë juridike të administrimit dhe dhënies në përdorim të aseteve publike. Gjithashtu, Bashkia Përmet ka në administrim 22 apartamente të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave, të cilat i janë dorëzuar për qëllime privatizimi. Sipas vendimeve përkatëse, Bashkia ka detyrimin të lidhë kontrata shitjeje me rezervë me subjektet përfituese nga privatizimi. Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se janë lidhur kontrata me 18 prej këtyre subjekteve, ndërsa 4 kontrata mbeten ende të pakonkluduara.

Në lidhje me detyrimet financiare, deri më datë 31.12.2024 rezulton se:

-Vlera e detyrimeve të papaguara nga kontratat e qirasë është 1,641,667 lekë;

-Vlera e detyrimeve të papaguara nga këstet e kontratave të shitjes me rezervë është 343,261 lekë.

4. Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV.

Nga auditimi i veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme përgjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2024, u konstatua se:

-Në Bashkinë Përmet funksioni i kontrollit të territorit, kryhet nga zyra e kontrollit dhe mbrojtjes së territorit në varësi të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Pra nuk është krijuar Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, në varësi direkte nga organi ekzekutiv i bashkisë (pra Kryetari të Bashkisë Përmet);-Numri i punonjësve në zyrën e kontrollit, nuk është në përputhje me përcaktimet e kuadrit rregullator, pasi nga 3 punonjës minimalisht që duhet të ketë kjo strukturë, në fakt është vetëm 1(një) punonjës, si dhe nga niveli drejtues i Bashkisë Përmet nuk janë marrë masa për plotësimin e kësaj strukture dhe ushtrimin e funksionit të inspektimit në përputhje me përcaktimet në kuadrin rregullator të fushës;

-Në strukturën e zyrës së kontrollit nuk ka punonjës me formimin profesional të fushës, si inxhinier

5. Mbi të ardhurat:

Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve nga taksat dhe tarifatat vendore që kanë ndaj Bashkisë Përmet, u konstatua se deri në datën 31.12.2023, borxhi tatimor ka qenë 51,105,727 lekë për 17,584 debitorë. Vlera debitore e krijuar gjatë vitit 2024 ka qenë 9,976,242 lekë. Në total detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive deri në datën 31.12.2024, janë 59,851,624 lekë. Në këtë vlerë debitore nuk është përfshirë vlera prej 33,616,134 lekë nga debitorët familjarë nga ish komunat lista e debitorëve e së cilës nuk është verifikuar nga Njësitë Administrative respective por është kontabilizuar si dhe vlera 240,000 lekë nga IMT e cila është e kontabilizuar.

f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

1. Kryetari i Bashkisë Përmet të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të

vendosë kritere të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e kontratës.

-Kryetari i Bashkisë të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

-Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë të gjithë masat e nevojshme për trajnimin e zyrtarëve që përfshihen në procedurat e prokurimit, me qëllim shmangien e mangësive lidhur me dokumentimin dhe argumentimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike, dokumentimin e kërkesave të sektorëve dhe drejtorive për mallra/punë/shërbime për përllogaritjen e fondit limit.

-Titullari i Bashkisë Përmet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës 1,241,795 lekë përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "S." SHPK, për punime të pa kryera, parashikuar në kontratën me nr. 107 prot., datë 11.01.2023 me objekt "Rehabilitimi i kanalit ujitës Piskovë", Bashkia Përmet.

2.Kryetari i Bashkisë Përmet të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e kontratave të qirasë, me qëllim ndjekjen e gjithë procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e aseteve në total në vlerën 1,641,667 lekë, si dhe për pagesat e kësteve të kontratave të shitjes nga procesi i privatizimit në total në vlerën 343,261 lekë.

3.Nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit të Teritorit, Bashkia Përmet, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi dhe çertifikata përdorimi:

- Të kërkojnë ngarkimin e plotë të dokumentacionit të detyrueshëm gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi, siç janë: licenca për ushtrimin e aktivitetit, polica e sigurimit e përgjegjësisë profesionale, çertifikata e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për hartuesit e projekteve ndërtimore, etj.;

- Të sigurojë plotësimin e saktë dhe të plotë të dokumentit të lejes së ndërtimit;

4.Nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit të Teritorit, Bashkia Përmet, të merren të gjitha masat për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi, mendimin e Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Informacioni që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën.

5.Kryetari i Bashkisë Përmet në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masat e nevojshme për: -Krijimin dhe funksionimin e strukturës së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit në nivel Inspektorati dhe jo si zyrë kontrolli, për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara. - Rekrutimin në stafin e IMTV të punonjësve me formimin profesional të fushës, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.

6. Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria Financës dhe e buxhetit, Sektori i të Ardhurave vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e borxhit tatimor në shumën progresive 97,956,740 lekë për 7858+ debitorë. 7.Drejtoria e Ekonomike dhe e të Ardhurave, të hartojë një plan masash periodik dhe vjetor për të siguruar vjeljen e taksave dhe tarifave vendore brenda afateve të miratuara me VKB si për familjarët dhe për biznesin, me qëllim parandalimin e krijimit të debitorëve të rinj.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

I. Opinioni mbi Pasqyrat Financiare:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të Bashkisë Përmet për vitin ushtrimor 01.01.2024 - 31.12.2024, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Përmet janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë të shprehura në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e *një opinionin "të modifikuar, me rezervë"*.

Baza për opinionin e modifikuar me rezervë:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 është: për shpenzimet 10,891 mijë lekë dhe për të ardhurat 5,326 mijë lekë.

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë parregullsitë në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2024, si më poshtë:

-Llog. 468 "Debitorë të ndryshëm", paraqitet në shumën 92,232,291 lekë dhe është nënvlerësuar për shumën 5,724,449 lekë;

-Llogaritë e klasës 20 "AAJM"/llog. 202 "Studime e projekte" paraqitet në shumën 20,194,217 lekë. U konstatua se nga ana e DFB nuk janë marrë masat që për nëntë projektet e hershme nga ish komunat në shumën totale 7,302,172 lekë, të sigurohet informacioni i nevojshëm dokumentar, për të kaluar vlerën e tyre në llogaritë përkatëse të klasës 21 AAM: llog. 212 apo llog. 213. tek investimi respektiv;

-Në llog. 210, llog. 211, llog. 212 dhe llog. 213 nuk janë përfshirë asetet e transferuara me VKM për Bashkinë Përmet, pasi procedurat për pajisjen e tyre me titull pronësie janë të papërfunduara nga ASHK dhe nuk është bërë rivlerësimi i atyre të pajisura me titull pronësie. U konstatua se këto asete janë të pa kontabilizuara;

-Vlera e amortizimit në llog. 209 & 219 "Amortizimi i AAGJM & AAJM" në vlerën 64,881,828 lekë, rezulton se nuk është llogaritur për çdo aktiv, por në grup, duke mos patur kështu informacion

mbi aktivet që e kanë vlerën e mbetur të papërfillshme ose zero;

-Llog. 26 “ pjesëmarrje në kapitalin e vet” paraqitet në vlerën 216,752,570 lekë. Kësaj vlere nuk i është shtuar vlere e investimit të kryer prej 583,299,150.92 lekë, pasi punimet përfunduan mbas transferimit kapital të UK Përmet tek UK Rajonale Gjirokastër.

-Llog. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” përfshin katër projekte të përfunduar në vlerën totale 1,528,145 lekë, për të cilët nuk është marrë asnjë masë për zhblokimin e garancisë.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë.

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit Bashkia Përmet me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës. Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Përmet, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar për përputhshmërinë.

Baza për dhënien e opinionit të modifikuar/kualifikuar:

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Përmet, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e opinionit të modifikuar.

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomalitë e konstatuara, si më poshtë:

-Nga auditimi u konstatua se, në 7 (shtatë) procedura prokurimi nga 10 (dhjetë) të përzgjedhura u konstatua se, janë aplikuar kritere të paargumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet.

-Nga auditimi i 10 (dhjetë) procedurave të prokurimit u konstatua se, në (3) raste, nga Njësia e Prokurimit nuk është argumentuar përllogaritja e fondit limit për 2 (dy) procedurat me objekt blerje karburanti dhe 1 (një) procedurë me objekt Blerje ushqimesh për kopshtin /konviktin/çerdhen për vitin 2023.

-Në 7 procedura nga 10 të audituara, , u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësisimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Përmet,

-Nga auditimi i procedurës me objekt prokurimi “Blerje ushqimesh për kopshtin /konviktin/çerdhen për vitin 2023”, është konstatuar mos zbatim i kushteve të kontratës me nr. 584 prot., datë 20.02.2023, gjithashtu është konstatuar se, marrja në dorëzim e mallrave është kryer jo në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

-Nga auditimi i zbatimit të kontratave në 6 objekte, rezultoi dëm ekonomik në vlerën 2,639,733 lekë pa TVSH, si rezultat i diferencave në volume pune.

-Nga auditimi lidhur me taksat dhe tarifat vendore, dhe të ardhurave nga qiradhënia, detyrimi tatimor progresiv nga bizneset, familjet dhe kontratat e qirasë rezultoi, në vlerën 99,598,407 lekë. Nga auditimi i veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtime të paligjshme përgjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2024, u konstatua se:

-Numri i punonjësve në zyrën e kontrollit, nuk është në përputhje me përcaktimet e kuadrit rregullator, pasi nga 3 punonjës minimalisht që duhet të ketë kjo strukturë, në fakt është vetëm 1

(një) punonjës dhe nga niveli drejtues i Bashkisë Përmet nuk janë marrë masa për plotësimin e kësaj strukture dhe ushtrimin e funksionit të inspektimit në përputhje me përcaktimet në kuadrin rregullator të fushës

-Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe deklaratave paraprake, u konstatua se në 5 (pesë) raste, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Në të gjitha rastet janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu në 1 (një) rast u konstatua se, leja e ndërtimit nuk respekton përcaktimet ligjore në lidhje me përmbajtjen e dokumentit të lejes së ndërtimit.

-Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në 5 (pesë) raste nuk është kërkuar ose respektuar mendimi i të gjithë autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Lejet e ndërtimit janë miratuar në heshtje, pa marrë mendim nga DV ASHK.

-Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se, në 2 (dy) raste, objekti i miratuar nuk respekton kondicionet urbane, siç janë respektimi i numrit të kateve dhe distanca nga kufiri i pronës. Gjithashtu në 1 (një) rast u konstatua se, parcelat të cilat janë vendosur në funksion të zhvillimit të objektit, nuk kanë lidhje fizike me njëra-tjetrën.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr.323/1 prot., datë 10.03.2025 i ndryshuar “Auditim Financiar dhe Përputhshmërie në Bashkinë Përmet”, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 10.03.2025 – 09.05.2025, në subjektin Bashkia Përmet për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2024 – 31.12.2024, u krye “Auditim Financiar” dhe nga 01.01.2023 – 31.12.2024 “Përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. S.D, Përgjegjës grupi;
2. S. J, Auditues;
3. H. A, Auditues;
4. S. M Auditues;

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Auditimi i Përputhshmërisë në Bashkinë Përmet kishte si objektiva kryesore: - Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij; - Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315); - Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Përmet është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të

rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

2. Identifikimi i çështjes.

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi baza të riskut, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjëseve të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Përmet, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Përmet.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Kryetari i Bashkisë Përmet (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Përmet, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Përmet në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Përmet është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH-së kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Përmet është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Përmet. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";
- Ligji 162/2020, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*";
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e*

Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- Ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe ransferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendor”
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njërive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vleravetë zbatueshme për legalizim;
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”
 - Rregullore e brendshme “Mbi procedurat e auditimit në KLSH”;
 - Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;
 - Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
 - Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;
- Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimi.

6. Standardet e auditimit

ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH-së.

7. Metodatat e auditimit

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

Konfirmim nga të tretët. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj. Verifikimi i transaksioneve - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

Intervistimi - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

Raporte dhe informacione - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi Akt-Konstatimet e mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Raport Auditimi.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

Etika dhe pavarësia;

Kontrolli i cilësisë;

Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre;

Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar;

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme;

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël;

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura;

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion;

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës:

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë;

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet;

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar;

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara;

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese:

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit;

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë;

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese;

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Auditimi në subjektin “Bashkia Përmet”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave. Bashkia Përmet është e organizuar dhe funksionon në bazë Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”. Profili i Bashkisë Përmet: Përmeti kufizohet në veri me Bashkinë Skrapar, në lindje me Bashkinë Përmet, në perëndim me Bashkinë Libohovë dhe Këlcyrë. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Përmetit. Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 10,614 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 20.301 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 601.95 km² me një densitet prej 33.72 banorë/km².

1. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

1.Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

1.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Bazuar në Misionin e Vetëqeverisjes Vendore “ për të siguruar qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve” nëpërmjet: zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të Bashkisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative; për të rritur cilësinë e jetës si dhe shtuar aktivitetet për t’i shërbyer popullsisë së Bashkisë Përmet”¹; referuar dhe Ligjit nr.

¹ Misioni dhe Vizioni përbëjnë dhe hapin 2 të ciklit të MFK sipas Manualit të MFK miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe përditësuar me atë nr. 108/2016. I ndryshuar me urdhërin nr.4. datë 26.01.2024 të Ministrit të financave.

10296 dt. 08.07.2010, kreu III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, neni 19, Bashkia Përmet, për çdo vit ka përgatitur “Deklaratën dhe Pyetësorin e Vetëvlerësimit” dhe i ka dërguar në MFE/ Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar/ Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit. Më poshtë po i analizojmë në mënyrë të detajuar, duke përcaktuar mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxherial dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrave, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Referuar nenit 20 të Ligjit nr. 10296 “Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli”, titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Nga auditimi u konstatua se, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, Kreu II, neni 8, pika 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit”; neni 9 pika 4/a “Përgjegjshmëria menaxheriale e Nëpunësit Autorizues”, në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4,2,10/a “Roli i nëpunësit autorizues të njësisë”, rezulton se me Vendimin nr. 3 datë 10.06.2020², janë hartuar/miratuara: “Plan i Përgjithshëm Vendor” - [PPV] me Fokus Strategjia e Zhvillimit Vendor, Analiza & Vlerësimi Territorit, Parashikimet e Planit, Vlerësimi Strategjik Mjedisor, Materiali hartografik si dhe “Rregullore e Planit Vendor”, të cilët hartohen si bashkëpunim i Bashkisë me KKT³ dhe miratohen me VKB Përmet; Gjithashtu Bashkia Përmet me VKB Nr.19 datë 29.04.2020 “Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të territorit dhe projekteve strategjike të zhvillimit të Bashkisë Përmet”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, ka hartuar dhe miratuara Strategjinë e Zhvillimit Vendor - [SZHV], ku paraqiten synimet kryesore për çdo fushë përgjegjësie dhe identifikohen veprimet që njësia duhet të ndërmarrë për realizimin e tyre, duke parashikuar edhe kostot përkatëse, kjo në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” Kreu VI, neni 32 pika 2/a,b,c.

[PPV] përmban: objektivat strategjike dhe rregullat e zhvillimit me instrumentet për zbatueshmërinë e tyre për periudhën 2020 e në vazhdim; për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të territorit, respektim dhe mbrojtje të tokës me vlera natyrore, bujqësore, kulturore, të krijojnë vende pune, të nxisin zhvillimin ekonomik dhe me përdorimin e kujdesshëm të instrumenteve financiare, të sigurojnë të ardhura të drejtpërdrejta dhe përfitime për projekte investimi publik në nivel vendor.

Tabela nr. 1

Qarku	Qendra e Bashkisë Përmet	Njësitë Administrative	Numri i fshatrave	Numri i popullsisë
Gjirokastrë	Përmet	Qyteti Përmet	-	20,301
		NJA Çarçovë	9	
		NJA Frashër	8	
		NJA Petran	15	
		NJA Qendër Piskovë	17	

Punoi: Grupi i Auditimit

² <https://planifikimi.gov.al/index.php?id=732>

³ Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) emëruar sipas VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017

1.1. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

a. Bashkia Përmet ushtron funksionet e veta me Rregulloren e Brendshme “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe procedurat për zbatimin e kompetencave vendore në administratën dhe njësitë administrative të Bashkisë Përmet”, hartimi dhe miratimi i të cilës është mbështetur në zbatimin e Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9 pika 1/1 germa ‘b’, Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak [VKB] të çdo viti respektiv “Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të bashkisë dhe njërive administrative” si dhe Vendimit të Kryetarit nr. 21 datë 16.01.2024 me nr. 151 prot., datë 16.01.2024 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Përmet dhe të Njësive Administrative”, Rregullore e miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 103 datë 11.03.2024 dhe nr. 750 prot., datë 11.03.2024 i ndryshuar dhe i përket Strukturës Organizative miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 21 datë 16.01.2024 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Përmet dhe të Njësive Administrative ” i ndryshuar.

Për periudhën nën auditim, ndryshimet në strukturën organizative të miratuara me VKB janë konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, si dhe këto janë pasqyruar në *Rregulloren e brendshme të njësisë*.

b. Mbi respektimin e etikës nga punonjësit e institucionit, Bashkia Përmet ka hartuar “Kodin e Etikës së Bashkisë Përmet” dhe miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 104 datë 11.03.2024 me nr. 751 prot., datë 11.03.2024, konform Ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1/1 germa “b”, VKM nr. 306 datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil;

c. Me Urdhër të Kryetarit nr. 44/1 datë 15.04.2024 dhe me nr. prot., 751/1 datë 15.04.2024 është hartuar dhe miratuar “Rregulloren e Posaçme për Parandalimin e konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, në zbatim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1/1 germa ‘b’, neni 46; Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar; Kjo Rregullore përcakton rastet e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike dhe ka si qëllim parandalimin e tyre.

“Kodi i Etikës” dhe “ Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesit” përcaktojnë rregullat e sjelljes së nëpunësve të administratës publike, sipas standardeve të kërkuara, i ndihmon ata për arritjen e këtyre standardeve si dhe vë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë nëpunësi i administratës publike. Kjo ndikon në mbarëvajtjen e funksionimit të institucionit, duke mos lejuar cenimin e aktivitetit të tij në çdo aspekt.


d. Lista (Harta) e Proceseve/Manuali i Procedurave të punës. Pamja e përgjithshme e procesit përmban një vështrim të përgjithshëm të aktiviteteve dhe procedurave që parashikojnë mënyrën e realizimit të proceseve të veçanta, sikurse dhe dokumentacionin që përdoret gjatë ecurisë së tyre. Ajo garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit, që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit; shkresat/ formularët tip si dhe disa Seksione të tjera plotësuese të tyre (procedurave).

Konstatim: Bashkia Përmet ka hartuar një draft “Manuali i proceseve për menaxhimin e aktiveve vendore”. Nga auditimi rezulton se deri tani nuk janë hartuar manuale për të gjitha proceset që kryhen sipas drejtorive/sectorëve të bashkisë, në moszbatim të Ligjit nr. 10296 /2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 dhe Manualin e ri me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108/2016 Kapitulli III pika 3.3.

1.2 Politikat menaxheriale dhe stili i Punës

Punësimi në Bashkinë Përmet bëhet në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 243/2015 i ndryshuar me VKM nr. 746/2018 Kreu I pika 1,2. Kjo procedurë rregullohet nga vet Strukturat e Bashkisë Përmet: punësimi sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM nr. 243/2015 i ndryshuar Kreu II;

- Komiteti i Përherëshëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr. 243/2015 i ndryshuar ;
- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pika e,ë,f,g të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.



Skema e procedurës së punësimit në NJVQV.

Për vitin 2024 [KPP] në Bashkinë Përmet është ngritur me Urdhrin e Kryetarit nr. 37/2 datë 27.12.2023 me nr. 281/2 prot., datë 27.12.2023, i cili përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë:
Tabela nr. 2

Nr	Emër Mbiemër	Statusi	Pozicioni në strukturë
1	D.D	Kryetar	Sekretar i Përgjithshëm
2	E.K	Anëtar	Dr. DFBBNJ
3	K.ç	-/-	Specialiste përgjegjëse për BNJ
4	E.H	-/-	Specialist Dega e Thesarit Përmet
5	M.B	-/-	Përgjegjës i Degës së Thesarit Përmet

Burimi: Bashkia Përmet

KPP është konform VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr. 746/2018, Kreu III pika 2,3.

- Strukturat përgjegjëse të çdo bashkie hartojnë në fillim të çdo viti “Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil dhe miratimin e numrit të aplikantëve jashtë shërbimit civil” në zbatim të Ligjit nr. 152/2015 “Për nëpunësin civil” neni 18, VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, të atyre me Kontratë Pune konform Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKB “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Përmet”. Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil hartohet mbi nevojat

e institucionit për personel për vitin e ri ushtrimor dhe përmban: numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës vakante të hapura për konkurrim, klasifikimin e tyre për çdo kategori dhe klasë, vendin e publikimit. Për vitin 2024 është miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vendimin nr. 40 datë 30.01.2024 dhe me nr. 305 prot., datë 30.01.2024. Publikimi i vendeve vakante nga ana e Bashkisë Përmet bëhet në faqen zyrtare të saj, në Portalin Kombëtar të Punësimit të AKPA si dhe në stendat për njoftime publike të Institucionit, konform kjo VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar Kreu II pika 6.

Konstatim: Nga Bashkia Përmet për pozicionet me Kod Pune (pa afat apo provizorë), nuk bëhet shpallja në AKPA, por vetëm në stendat e Bashkisë dhe në faqen zyrtare të saj, në mospërmbushje të kërkesave të Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 19 pika 1, 2;

- Përshkrimin e punës të çdo pozicioni si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët, duhet të jenë të përshkruara në Formularin e Përshkrimit të Pozicionit të Punës. Ato janë pjesë e rëndësishme e politikave dhe praktikave që lidhen me burimet njerëzore. Si të tilla *Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit*. Për këto arsye kriteret duhet të jenë pjesë në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, neni “përshkrimet e punës” si dhe e dosjes së personelit. [DFB/BNJ] nga ana e saj pasi harton planin vjetor të punësimit, ndjek procedurën nga shpallja e njoftimit deri në përfundimin e saj, praktikë e cila në përfundim bëhet pjesë e dosjes së personelit; Kjo procedurë realizohet në zbatim të përcaktimit ligjorë në fuqi, Ligjin nr. 152/2015 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar.

Konstatohet se praktika e plotë e punësimit e kandidatëve të kualifikuar, nga shpallja e pozicionit deri në emërimin e tij, nuk është bërë pjesë e dosjes së personelit.

- Me Urdhrin nr. 194/1 datë 20.09.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm “Për ngritjen e Komitetit të Vlerësimit, në kuadër të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil të Bashkisë Përmet”, është ngritur Komiteti i Vlerësimit me këtë përbërje:

Tabela nr. 3

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni ne strukturë	Statusi
1	E.M	Përgjegjës sektori Financë/buxhet	Kryetar
2	A.P	Drejtor i Përfshirjes Sociale	anëtar
3	P.M	Përgjegjës Sektori juridik dhe Burimet njerëzore	-//-

Komiteti i Vlerësimit ka përcaktuar në strukturën organizative 58 pozicione pune pjesë të shërbimit civil, të cilat janë përcaktuar qartë në strukturën organizative të miratuar nga Kryetari i Bashkisë nr. 345/1 datë 02.10.2024;

Me shkresën nr. 2592 prot., datë 07.10.2024 Sekretari i Përgjithshëm ka njoftuar gjithë punonjësit mbi nisjen e procesit të ristrukturimit të institucionit / Bashkia Përmet;

Me shkresën nr. 2422 prot., datë 23.09.2024 “Kërkesë për rivlerësimin e përshkrimeve të punës”, është kërkuar nga çdo drejtori e sektor risjhikimin e përshkrimeve të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil;

Me shkresën nr. 2562 prot., datë 08.10.2024 është përcjellë informacioni mbi përshkrimet e punës të përditësuara për çdo pozicion të strukturës me shërbimin civil.

Konstatim: Nga strukturat përgjegjëse, Sekretar i Përgjithshëm dhe sektori i burimeve njerëzore nuk është kërkuar rishikim i përshkrimeve të punës dhe për pozicionet me Kod Pune.

- Të punësuarit gjatë vitit 2024 në Bashkinë Përmet pasqyrohen si në tabelën më poshtë:

Numri i të punësuarve viti 2024	Niveli arsimor	
	I lartë	I mesëm
36	11	25

Në Bashkinë Përmet struktura organizative ka pësuar ndryshime, të cilat janë miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë, pasqyruar edhe në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të saj. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve mbështetëse si struktura përgjegjëse për personelin, harton çdo fillim viti Planin Vjetor të pranimit në shërbimin civil për Bashkinë Përmet, mbështetur në nevojat që pasqyrohen në Strukturat organizative të çdo viti, të miratuara nga Kryetari i Bashkisë me emërtimet e pozicioneve përkatëse. Për vitin 2024 me Vendimin nr. 40 datë 30.01.2024 dhe me nr. 305 prot., datë 30.01.2024. Vendimet janë konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

Kategoria e pozicionit	E mesme drejtuese	2	II b
Numri	Ekzekutive	5	IV a /IV b
Punonjës me Kod Pune	Nuk ka informacion		
Punonjës provizor	Nuk ka informacion		

Konstatim: Në Planin vjetor të punësimit, duhet të përfshihen edhe ato pozicione vakante që i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune si dhe nevojat e Bashkisë për punonjës provizor.

- Struktura organizative e Bashkisë Përmet për dy vitet 2023 dhe 2024 ka këtë kompozim:

Nr	Viti	Numri drejtorive	Numri sektorëve	Numri i punonjësve
1	2023	3	23	315
2	2024	5	23	316

Burimi: Bashkia Përmet

Shpërndarja e pozicioneve në strukturën organizative për vitet 2023 e 2024 sipas ligjit që rregullon marrëdhëniet e punës, pasqyrohet si më poshtë:

Tabela nr. 4

Niveli pozicionit	Status i Nëpunësit Civil		Vende vakante		Kodi i Punës		Funksion politik	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024		
Kategori e lartë	1	1	-	-	0	0	1	1
E mesme drejtuese	4	5	1	1	0	0	1	3
E ulët drejtuese	8	8	2	2	13	13	5	5
Ekzekutive	19	23	6	6	256	236	-	-
Totali	32	37	9	9	269	249	7	9

Burimi: Bashkia Përmet

- Nga informacioni shkresor i vënë në dispozicion, rezultoi se numri i largimeve të punonjësve për arsye të ndryshme në Bashkinë Përmet ka qenë i konsiderueshëm, prej 31 punonjësish.

Një pasqyrim më i detajuar i numrit me arsyen e largimeve, jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 5


Nr	Arsyeja e lirimit të vendeve	2024	Punësimi 2024
1	KMCAP	1	
2	Pension	11	
3	Largim me dëshirë/dorëheqje	15	
4	Shkurtime/ristrukturime	-	
5	Zgjidhje Kontrate/përfundim	-	
6	Largim për mosparaqitje në punë/ shkelje të përsëritura	-	
7	Ndërruar jete	1	
8	Refuzim të vendit të punës	-	
9	Leje Lindje	3	
TOTALI		31	36

Burimi: Bashkia Përmet

Numri i përgjithshëm i punonjësve në Bashkinë Përmet, referuar strukturave organizative të miratuara në planifikim për vitin 2024 është 316 punonjës dhe për vitin 2023 është 315 punonjës.

1.3 Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Përmet funksionon me një Strukturë që bazohet në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”. Nga auditimi rezulton se Strukturat Organizative nuk shoqërohen edhe me Organigramën përkatëse për tu miratuar nga Këshilli Bashkiak, por janë miratuar pa to:



Skemë e thjeshtuar e strukturës së NJVQV

A. Organi Përfaqësues i Bashkisë - Këshilli Bashkiak

B. Organi Ekzekutiv i Bashkisë - Kryetari i Bashkisë

Për periudhën 01.01.2024- 31.12.2024 që ne auditojmë, struktura organizative e Bashkisë Përmet ka pësuar ndryshime nga ajo e mëparshme, të cilat miratohen me Vendim të Kryetarit të Bashkisë. Këto ndryshime kanë qenë kryesisht në riorganizimin e njësive të strukturës. Një pasqyrim të kompozimit të Strukturës organizative të Bashkisë Përmet paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Viti	VKB / Vendim Kryetari	Njësi Administrative	Drejtori	Sektor	Punonjëssipas strukturës
2023	Vendim Kr. nr.13 datë. 10.01.2023	4	3	23	315
2024	Vendim Kr. nr. 21 datë 16.01.2024	4	5	23	316

Burimi: Bashkia Përmet

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar edhe në tabelën e mësipërme rezulton se në vitin 2024 ka patur rikompozim të strukturës organizative me krijimin e drejtorive të reja dhe lëvizje të punonjësve brenda të njëjtës drejtori por në sektorë apo nga një drejtori në tjetrën, ndryshime të cilat janë pasqyruar në rregulloren e Brendshme të Bashkisë Përmet;

- Ndërsa shpërndarja e punonjësve në strukturën organizative sipas njësive përbërëse të saj, pasqyrohen si më poshtë në tabelë:

Tabela nr. 6

STRUKTURA		2024	
		PLAN	FAKT
1	Administrata e Bashkisë	300	292
2	NJA Piskovë	3	3
3	NJA Frasher	4	4
4	NJA Çarshovë	4	4
5	NJA Petran	5	5
VENDE VAKANTE		9	
TOTALI		316	308

Burimi: Bashkia Përmet

Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2024 nuk ka të punësuar sezonalë;

Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Përmet nuk ka planifikuar në strukturën organizative dhe nuk ka punësuar punonjës në pozicione të ndryshme nga “grupi i veçantë”, në të cilin përfshihen 15 kategori punëkërkesish të disavantazuar në tregun e punës: persona me aftësi të kufizuara, jetimë, kryefamiljare, të komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptianë etj) si personel administrativ dhe jo vetëm, në moszbatim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar neni 5; Ligjit nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligjit nr. 15/2019 dt. 13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”;

Nga Bashkia Përmet nuk janë planifikuar në strukturë pozicione për statusin “ekselent”, në moszbatim të VKM nr. 586 datë 30.08.2019 “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekxelencës në institucionet e administratës shtetërore”.

- Nga auditimi i strukturave organizative që ka kompozuar Bashkia Përmet me të cilat ka ushtruar funksionet e veta konform kompetencave që i jep ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” dhe pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën Aneks MFK/1 dhe në tabelën Aneks MFK/2 u konstatua se, ka shërbime të cilat nuk mbulohen me njësi përkatëse në strukturë, por me pozicione të veçanta të inkuadruara në struktura me aktivitete të ngjajshëm procedural, duke riskuar mungesën e ofrimit të tyre për komunitetin: “shërbimi parësor shëndetësor” i funksionit “infrastruktura dhe shërbimet publike”⁴ dhe funksioni “Mjedisi”⁵ të cilët nuk kanë njësi në strukturën organizative, por vetëm numër të kufizuar specialistësh (nga 1) përgjegjës për këto shërbime të përfshirë në Sektorin e Emergjencave Civile; shërbimi “kundërvajtjet administrative/mbrojtja e territorit”⁶ ka vetëm një specialist përgjegjës/Inspektor për mbrojtjen e territorit i përfshirë në Strukturën e Policisë Bashkiake. Duke iu referuar fokusit turistik të përcaktuar si prioritar në këtë bashki, mungesa e një strukture të veçantë për mjedisin, ka cenuar efektivitetin e aktivitetit turistik dhe zhvillimit të tij.

1.4 Përcaktimi i përgjegjësive

Në Bashkinë Përmet ndarja e detyrave, kompetencave dhe përgjegjësive janë përcaktuar qartë në Rregulloren e brendshme funksionale të Bashkisë, miratuar me vendim të Kryetarit nr. 103/1 datë 11.03.2024 me nr. 750/1 prot., datë 11.03.2024 i ndryshuar⁷;

Rezultoni se në Bashkinë Përmet nuk ka procedura të delegimit të detyrave.

1.5 Aftësitë profesionale të punonjësve.

-a Për të audituar *dosjet e personelit*, përzgjedhëm kryesisht dosjet e të punësuarve në vitin 2024 në aparatit e bashkisë dhe në Njësitë Administrative për kategoritë: ngritje në detyrë, pranimit në shërbimin civil, me Kod pune; si dhe dosjet e punonjësve të larguar nga Bashkia Përmet. Emërimet/largimet i janë nënshtruar, Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”. Rezultoi se, dosjet përgjithësisht përmbanin dokumentet bazë të punonjësit, por u konstatua se, për punonjësit që i janë nënshtruar procedurave “lëvizje paralele” apo “ngritje në detyrë” nuk është krijuar praktikë e plotë (fashikull) e veçantë e

⁴ Vetëm për mirëmbajtjen e infrastrukturës shëndetsore dhe garantimin e ofrimit të shërbimit për komunitetin

⁵ Në zbatim të ligjit nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”; Ligji nr. 9587/2006 “mbrojtja e diversitetit” i ndryshuar; Ligji nr. 9774/2007 “Për vlerësimin dhe mbrojtjen nga zhurmat në mjedis” etj

⁶ Në zbatim të Ligjit nr. 107/2014, datë 26.3.2001 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”

⁷ Rregullore e re e miratuar i përket strukture së re të miratuar me Vendimin nr. 345/1 datë 02.10.2024, e cila vijon të jetë funksionale deri më tani.

dokumente të përditësuara të punonjësit për pozicionin e ri, si pjesë përbërëse e dosjes kryesore të personelit;

- Në dosjet e punonjësve të larguar nga puna mungonte procesverbali i dorëzimit të bazës materiale, mangësi e cila u konstatua edhe në Urdhrin e Kryetarit me objekt “lirim nga marrëdhëniet e punës”, në të cilin në kërkesat për zbatim duhej të renditej edhe dorëzimi i bazës materiale;

- Dosjet e të punësuarve në pozicionin “shofer” në Bashkinë Përmet:

Nga verifikimi i dosjeve të personelit të punësuar në pozicionin “shofer” dhe informacionit të pasqyruar në tabelën MFK/3 u konstatua mungesë të dokumentacionit bazë si dhe mospërditësim i domosdoshëm i dokumentit “raport i aftësisë për punë/mjekësor”, Çertifikatës familjare, dokumentit arsimor ose dokument alternativ në të njëjtën vlerë ligjore, libreza e punës etj., në kundërshtim me VKM nr. 117/2014 datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” i ndryshuar me VKM nr. 833/2020 datë 28.10.2020, kreu I/pika 3 ku citohet “.Dosja e personelit është individuale dhe përmban të dhëna të karakterit teknik, profesional, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë, si dhe të dhëna të tjera, sipas lidhjeve 1 e 2, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse të tij.” dhe pika 4 ku citohet “.Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në çdo institucion përgjigjet për mbajtjen dhe sistemin e dosjeve të personelit për çdo të punësuar.”, kreu IV/pika 2 etj.

- b Mbi trajnimin e punonjësve në Bashkinë Përmet.

Tabela nr. 7

Trajtime të Buxhetuara/Parashikuara			Trajtime të realizuara në 2024		
Nr. i trajnimeve	Kosto totale	Nr i personelit pjesmarrës	Nr. i trajnimeve	Kosto totale	Nr i personelit pjesmarrës
133	2,932,000	176	124	2,736,204	164

Burimi: Bashkia Përmet.

Stafi administrativ ka zhvilluar trajnime sipas programeve të detyrueshëm ofruar nga ASPA pjesë e procedurës për përfitim të statusit të nëpunësit civil dhe jo vetëm. Nga auditimi rezultoi se, nga Bashkia Përmet, struktura përgjegjëse e saj [SJBNI] çdo vit ka hartuar Planin vjetor të trajnimeve për punonjësit e saj, dhe për vitin 2024 është miratuar nga Kryetari i Bashkisë me nr. 3016/1 prot., datë 10.11.2023; trajnimet e punonjësve realizohen nga programet që ofron ASPA dhe jo vetëm, duke patur kështu një orientim mbi rëndësinë në përzgjedhjen e atyre temave që lidhen ngushtë me proceset e punës të përditshmërisë; me qëllim njohja nga ana e tyre me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Manualin për MFK. Referuar tabelës së planifikimit vjetor të trajnimeve si dhe tabelës nr. 7 dhe tabelës MFK/4 të temave dhe punonjësve pjesëmarrës në trajnimet e realizuara gjatë vitit 2024, konstatohet se:

- Numri i punonjësve pjesëmarrës në trajnime është i kufizuar;

- Temat e përzgjedhura për trajnime nuk janë gjithëpërfshirëse, ku bie në sy mungesa e njohjes së gjithë stafit me Ligjin nr. 10296/2010 "për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, dhe Manualin përkatës mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, si dhe me Udhëzimin nr. 30/2011 mbi “Menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar.

Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësive kuptohen dhe arrihen nga punonjësit.

Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për:

- Caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune;
- Verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës;
- Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta;
- Futjen e programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre;
- Kryerjen e analizave periodike për njohuritë dhe aftësitë e kërkuara për çdo pozicion pune dhe mbështetur në këto analiza, hartimin e planeve periodike për trajnimin e punonjësve;
- Zhvillimin e profesionalizmit menaxherial nëpërmjet trajnimeve dhe marrjes në konsideratë të aftësive menaxhuese gjatë procesit.

c. Komisioneri i Mbikqyrjes së Shërbimit Civil (KMSHC) nëpërmjet Autorizimit me nr. 868 prot., datë 15.11.2024 në referim dhe zbatim të Vendimit nr. 9 datë 30.01.2024, ka filluar mbikqyrjen e orientuar lidhur me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (bashki) për vitin 2024. Grupi i punës i miratuar i KMSHC-së, në mbyllje të inspektimit në datën 13.12.2024 ka lënë një Akt Konstatim me nr. 3317 prot., datë 13.12.2024.

- Drejtimit ku është orientuar procesi i inspektimit të Grupit të punës (pikat e programit), që janë:
-Akti për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit, në kuadër të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil, si dhe nëse përbërja e tij është në përputhje me aktin nënligjor që rregullon këtë proces;

-Nëse janë njoftuar subjektet që përfshihen në zbatim të këtij kuadri ligjor;

-Diskutim dhe ofrim i asistencës teknike lidhur me institutin e pezullimit dhe lirimit nga shërbimi civil, sipas planit vjetor të Komisionerit për vitin 2024.

- Konstatimet/konkluzionet:

-Në lidhje me pikën e parë, ka rezultuar e zbatuar konform kuadrit ligjor procedural;

-Në lidhje me pikën e dytë ka rezultuar e zbatuar konform kuadrit ligjor procedural.

-Grupi i punës ka ofruar asistencë teknike në zbatim të pikës 3 të programit.

3.1.1 Parimet E Mjedisit Të Kontrollit:

Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritetin dhe vlerat etike;

Parimi 2 - Titullari / Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje;

Parimi 3 - Titullari / Njësia Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë;

Parimi 4 - Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave;

Parimi 5 - Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale;

2. Menaxhimi i Riskut

Në Bashkinë Përmet nëpërmjet Urdhrit të Kryetarit nr. 41/1 datë 30.01.2024 dhe me nr. 306/1 prot., datë 30.01.2024, “Për menaxhimin dhe koordinimin e riskut në Bashkinë Përmet”, gjithë njësitë e strukturës organizative të bashkisë, janë angazhuar për zbatimin e tij. Ky urdhër përmban 9 pika dhe konsiston në përcaktimin e risqeve, strukturat përgjegjëse për menaxhimin e tyre si dhe

masat konkrete për parandalimin apo minimizimin e risqeve. Rezultati i zbatimit të tij është si më poshtë vijon:

2.1 Regjistri i Riskut: Grupi i auditimit lidhur me menaxhimin e riskut, kërkoi t'i vihet në dispozicion Regjistri i riskut, ku jepet një pasqyrim i identifikimit të risqeve të çdo njësie të strukturës dhe masat që duhen marrë për parandalimin apo minimizimin e pasojave në Bashkinë Përmet. Bashkia Përmet ka hartuar për vitet 2023 Regjistrin e Riskut, në të cilin është bërë i mundur identifikimi i risqeve që vijnë nga burime të brendshme dhe atyre që vijnë nga burime të jashtme, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

Regjistri i Riskut është i bazuar në analizën e riskut të çdo drejtorie dhe ka si *Synim* “Planifikimin dhe Përdorimin me efikasitet, efikasitet dhe transparencë të fondeve buxhetore në përputhje me misionin e Bashkisë, për arritjen e objektivave”. Ky regjistër përmban përshkrimin e risqeve për çdo drejtori/sector, nivelin e risqeve, kontrollat ekzistuese, veprimet e ndërmarra për të adresuar risqet, zotëruesi i riskut si dhe situatën e riskut pas detyrës së fundit, si dhe mënyrën apo rrugëzgjdhjen e situatës në rastin e ndodhjes apo konstatimit të dukurisë. Për vitin 2024 nuk është përditësuar Regjistri i riskut, duke rezultuar për mungesë analize të risqeve të ndodhura në vitin 2023 dhe raportin mbi masat e marra nga strukturat përkatëse për menaxhimin e tij, të cilat pasqyrohen në Regjistrin e riskut të vitit pasardhës.

Konstatim: Në Bashkinë Përmet, Regjistri i Riskut të vitit 2023 nuk është miratuar nga Titullari i njësisë, si dhe nuk është përditësuar për vitin 2024, në moszbatim të Ligjit 10296 dt. 08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 dt. 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të Riskut në njësitë publike”. Bashkia Përmet ka ngritur *Grupin e Menaxhimit Strategjik [GMS]* me Urdhrin e Kryetarit nr. 41 datë 30.01.2024 me nr. 306 prot., datë 30.01.2024 “Për krijimin e GMS”. Për arsye të mosndryshimit të menaxherëve të njësisë publike, GMS i ngritur me Vendimin e Kryetarit të vitit 2024 ka qenë i vlefshëm gjatë vitit 2024.

Tabela nr. 8

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Statusi në GMS
1	A.H	Kryetar i Bashkisë	Kryetar
2	F.H	N/Kryetar	Koordinator MFK/ Koordinator Risku
3	A.M	N/Kryetar	Anëtare
4	D.D	Sekretar i Përgjithshëm	-/-
5	E.K	Dr. Financës	NZ/Sekretar
6	M.K	Përgjegjës SPUSHP	Anëtar
7	F.L	Përgjegjës MZSH	-/-
8	A.P	Drejtor i Shërb. sociale	-/-
9	L.K	Përgjegjës i KRS	-/-

Burimi: Bashkia Përmet

Nga auditimi rezultoi se GMS ka realizuar takime sipas grafikut të hartuar dhe miratuar me nr. Si dhe ka hartuar dhe miratuar planin e punës dhe grafikun e takimeve për përgatitjen e PBA -së 2024-2026 dhe Projekt Planit vjetor 2024 të Buxhetit, me Vendimin nr. 99 datë 18.12.2023;

Tabela nr.9

GMS	Plani dhe grafiku i takimeve	Proces verbalet e takimeve
	Vendim nr. 99 datë 18.12.2023	datë 25.03.2024
	.	datë 24.04.2024
	.	datë 06.06.2024
	.	datë 02.09.2024
	.	datë 19.11.2024
	2	5

Burimi: Bashkia Përmet/Punoi: Grupi i Auditimit

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të paraqitur në tabelë, rezultoi se GMS ka zhvilluar takime të dokumentuara të aktivitetit të tij, por u konstatua se, nuk ka plan vjetor pune dhe grafik takimesh, ku bën përjashtim kalendari për përgatitjen e PBA, rrjedhimisht as raporte vjetore të aktivitetit të tij, të përcaktuara në Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manualin e MFK Kap. II/2.2.6 ku citohet: */GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të garantojë se komponentët e MFK-së dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësisë. GMS duhet të zhvillojë aktivitetet e mëposhtme:*

- Të nxisë realizimin e objektivave dhe qëllimeve strategjike të njësisë;
- Të garantojë se brenda njësisë ekziston një kuadër i përshtatshëm dhe efektiv i MFK, që siguron vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve;
- Të kuptojë se si njësia realizon objektivat e MFK;
- Të rishikojë procesin e menaxhimit të riskut;
- Të garantojë se drejtuesit dhe punonjësit e njësisë janë të pajisur me aftësitë dhe udhëzimet e nevojshme për të vënë në zbatim kontrole të brendshme efektive dhe për të menaxhuar risqet;
- Të shqyrtojë nëse mjedisi i kontrollit dhe procedurat mund t’i përmbushin objektivat e tyre;
- Të vendosë standardet dhe vlerat e njësisë;
- Të verifikojë raportet e audituesve mbi MFK dhe përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore;
- Të përcaktojë nëse janë raportuar dobësi materiale, kushte të tjera të raportueshme, apo gjetje të tjera;
- Të rishikojë përmirësimet e sugjeruara për MFK si dhe të ndjekë në vazhdimësi korrigjimin e dobësive në kontrollin e brendshëm;
- Të verifikojë deklaratën e titullarit të njësisë mbi sistemin e kontrollit të brendshëm;
- Të udhëheqë dhe të mbikqyrë procesin e ndryshimit, që shton kapacitetin e njësisë për të punuar me rezultate të larta”; Si dhe / “Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të mbledhet të paktën katër herë në vit. Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t’i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë”.

Nr	Viti	Nr. Anëtarëve GMS	EMP	Nr. i Programeve	Nr. Anëtarëve EMP
1	2023	9	6	6	12
2	2024				

Punoi: Grupi i auditimit

Konstatim: GMS/Bashkia Përmet si çdo vit ka hartuar planin e punës dhe grafikun e takimeve për përgatitjen e PBA dhe buxhetin e vitit pasardhës, duke e kufizuar aktivitetin e GMS vetëm për përgatitjen e buxheteve të njësisë. Kjo ka ardhur si rezultat i mos pasjes mjaftueshëm të njohurive rreth rolit të GMS, pasi edhe pse në takimet e planifikuara të GMS mbi PBA janë diskutuar edhe problematika të tjera të konstatuara në aktivitetin e përditshëm të strukturave përbërëse të Bashkisë, nuk kanë qenë mjaftueshëm aq sa për të mos realizuar takime sipas një plani të miratuar vjetor. rolin dhe aktivitetin e GMS në shërbim të Njësisë publike, si dhe mos përpilimit të raportit vjetor mbi aktivitetin e tij, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Kap II neni 8, pika 8/b; nenit 27 pika 1,2; dhe “Manualin e Menaxhimit financiar dhe kontrollin” miratuar nga Ministri MFE me nr. 8980 /2010 dhe ai i ri me nr. 108/2016 Kap II pika 2.2.6.

2.2 Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet (në këtë rast) nga Koordinator i Riskut, duhet t'u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.

Duhet theksuar se në procesin e miratimit të planeve vjetore të punës, duhet të merren parasysh risqet më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu e rëndësishme është që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike. Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Njësitë e Strukturës organizative të Bashkisë Përmet dhe GMS, kanë hartuar Strategjinë e Menaxhimit të Riskut.

Lidhur me asetet e Bashkisë Përmet, janë në fazën e miratimit të *draft* "Manualit të Proceseve për menaxhimin e aktiveve vendore"

Nga auditimi u konstatua se, në Bashkinë Përmet nuk është miratuar nga Kryetari "Strategjia e menaxhimit të riskut", në moszbatim të Ligjit nr. 10296/2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar dhe Manualit të MFK, Kap. III, paragrafi 3.2.

2.3 Gjurmët e Auditimit janë një instrument mbështetës për menaxhimin e njësisë. Gjurmët e Auditimit përfshijnë operacione të cilat nisin dhe përfundojnë brenda një strukture organizative, por që mund të përshkojnë gjatë rrugës së tyre, disa struktura organizative, dhe madje disa njësi. Gjurma e Auditimit informon mbi: Përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit; Gjurmimin e operacionit prej fillimit në fund; Të gjithë dokumentet që janë marrë ose janë gjeneruar gjatë procesit; Aktivitetet e rëndësishme të kontrollit, që garantojnë ecurinë e duhur të operacionit; Kush e merr një vendim të caktuar gjatë ecurisë së operacionit; Sistemet e IT-së që mbështesin operacionin; Kush mban përgjegjësinë finale për procesin – veçanërisht në rastet kur në kryerjen e një operacioni marrin pjesë disa njësi organizative.

Nga sa më sipër nga ana e Bashkisë Përmet, grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion Gjurmët e Auditimit, kjo pasi Titullari i Bashkisë në cilësinë e NA, nuk ka miratuar gjurmët e auditimit.

Konstatim: Nga auditimi rezulton se, gjurmët standarde të auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari i njësisë, si një dokument *i unifikuar* për të gjitha proceset e Bashkisë Përmet, në kundërshtim kjo me ligjin nr. 10296/2010 i ndryshuar, neni 16 pika 2; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit" kapitulli V; Udhëzimit nr. 30 dt. 27.12.2011 i ndryshuar, neni 121 e122.⁸ Parimi 6 - Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva;

Parimi 7 - Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave;

Parimi 8 - Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtime;

Parimi 9 - Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm;

2.4 Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme ku në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.

⁸ Lënë rekomandim edhe në Raportin e vlerësimit të cilësisë nga DPKBFPRE/MF

Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhet të jenë: Të përshtatshme; Efektive nga pikëpamja e kostos; Të gjithanshme; Të dokumentuara qartë etj. Për këtë çdo Njësi Publike dhe NJVQV duhet të hartojë dhe miratojë Planin e Kontrollit të Brendshëm (periodik apo vjetor), si një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen; gjithashtu ndihmon në monitorimin e detyrave që menaxherët e njësisë i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre.

Konstatim: Nga Bashkia Përmet nuk është hartuar/miratuara një Plan i Kontrollit të Brendshëm periodik apo vjetor, kjo në moszbatim të nenit 22, pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, “Manualit për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” Kapitulli III pika 3.3.⁹

- Lidhur me Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Sistemeve IT, nga specialisti IT i Bashkisë Përmet, u vu në dispozicion ky informacion si më poshtë:

-Nga specialisti IT çdo vit paraqiten në Drejtorinë e financës kërkesat buxhetore mbi nevojat institucionale për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe pajisjet IT.

Kështu për vitin 2024, kërkesat buxhetore janë si më poshtë:

Tabela nr. 10/në lekë

Shpenzime Operative	Plan	Fakt	
Mirembajtje pajisjesh informatike	120,000	0	
Nëntotali I	120,000	0	
Shpenzime për Investime			
Pajisje Informatike	317,000	183,480	
Pajisje informatike nga projektet(me skeme te plote thesari)	270,000	244,000	
Nëntotali II	587,000	427,480	
Pajisje te tjera nga projekte (me skeme te pjesshme thesari)	816,462	682,242	
Nëntotali III	816,462	682,242	
Totali (I+II+III)	1,523,462	1,109,722	413,740

Burimi: Bashkia Përmet

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën Aneks MFK/5, rezultoi se në Bashkinë Përmet nga GMS nuk është bërë analizë e mirëfilltë mbi nevojat e atyre strukturave të njësisë për programe të avancuara, me qëllim rritjen e efektivitetit të shërbimeve, si në rastin e administrimit dhe menaxhimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore etj.

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe komunikimi mbi implementimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT, konstatua se:

1. Bashkia Përmet nuk ka ende një organizim të mirëfilltë për sistemet IT, që do të thotë nuk ka Dhomë serverash të ndërtuar sipas standardeve të përcaktuara në aktet ligjore dhe rregulloret përkatëse të miratuara nga AKSHI;
2. Nuk ka miratuara Rregulloren “Për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit të Bashkisë Përmet”; Pajisjet IT në bashki janë në linja direkte dhe jo të mirëorganizuar apo të dedikuara dhe mirëmbahen sipas nevojës, jo në bazë të një rregulloreje;
3. Specialisti i Dixhitalizimit të të dhënave pjesë e Drejtorisë së Projekteve të huaja, Integritet Evropian, Performancës dhe Dixhitalizimit të të dhënave, nuk ka monitoruar procedurat e *back up* mujor automatik apo manual, por ruajtja e tyre bëhet nga vet përdoruesit e sistemeve dhe programeve IT në USB (universal serial bus). Specialisti IT ndjek problematikat e çdo sektori në funksionimin e pajisjeve IT si dhe sistemeve që përdoren.
4. Nuk ka hartuar Planin Vjetor të punës për vitin 2024;

⁹ Lënë rekomandim edhe në Raportin e vlerësimit të cilësisë nga DPKBFPRF/MF

5. Ka bërë raportim mujor mbi punën e kryer referuar kalendarit të detyrave mujore të përcjella nga Drejtori;

6. Gjatë viti 2024 Specialisti IT nuk ka qenë i planifikuar dhe nuk ka marrë pjesë në trajnime specifike të fushës, organizuar nga ASPA etj.;

7. Mungon dokumentacioni mbi procedurat e veprimeve në sistem, regjistër për dokumentimin e problematikave të tyre etj., ku mundësohet gjurma e auditimit të aktivitetit dhe efica e tyre; në zbatim të VKM nr. 710/2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”; “Rregullore për ndërtimin e dhomës së serverave” hartuar nga AKSHI/2008;

1.3.3 PARIMET E AKTIVITETEVE TË KONTROLLIT

Parimi 10 - Përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit;

Parimi 11 - Zgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë;

Parimi 12 - Vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe procedurave;

3. Veprimtaritë e Kontrollit

Veprimtaritë e Kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme ku në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.

Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhet të jenë: Të përshtatshme; Efektive nga pikëpamja e kostos; Të gjithanshme; Të dokumentuara qartë etj.

- Në Bashkinë Përmet për realizimin e objektivave me efikasitet, ekzistojnë dhe përdoren manuale për proceset kryesore operacionale dhe financiare, të cilët specifikojnë qarkullimin e dokumentacionit:

Tabela nr. 11

Nr.	Sektorët	Manualet që përdoren
1	Sektori i Financës	» Manuali i Klasifikimit të llogarive » Manuali i pasqyrave financiare
2	Drejtorja e Shërbimit Urban dhe Shërbimeve Publike	» Manuali teknik i punimeve të ndërtimit në fuqi, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015” Për miratimin e manualeve teknike të punimeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave të tyre.
3	Njësia e Prokurimit	» Manuali mbi prokurimin elektronik në SPE të blerjeve me vlerë të vogël » Manuali mbi përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE)

Veprimtaritë e kontrollit, përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

Lloji i Kontrollit që zbatohet në Bashkinë Përmet është ai parandalues, ndërsa kontrollet pas faktit realizohen çdo vit *vetëm nga KLSH*, pasi Bashkia Përmet nuk ka NJAB të vetin etj., pra jo nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit;

a. Kontrollat në shqyrtimin e dokumentacionit që nënshkruhet, praktika e saj dhe verifikohet saktësia e materialit;

b. Ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person (NA-NZ);

c. Të gjitha angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA&NZ (sistemi i dy firmave);

d. Çdo dalje e Aktiveve afatgjata autorizohet dhe monitorohet nga NA; kontroll i dokumenteve të inventarëve, regjistrave financiarë, librat e kontabilitetit etj.

e. *Nuk ka* rregullore për Sistemet IT të cilat nuk iu janë vënë në dispozicion çdo përdoruesi;

f. Parashikuar procedura të qarta mbi komunikimin e shkresave brenda dhe jashtë Bashkisë: hyrja, trajtimi, mbajtja e dokumentacionit lidhur me depozitimin e protokollimit, komunikimin shkresor dhe elektronik;

g. Komunikimi dhe trajtimi urdhrave të brendshëm dhe udhëzimeve përshtatur sipas përgjegjësi individuale të çdo pozicioni;

h. Institucioni ka parashikuar politika të ruajtjes së dokumenteve, nuk ka një plan masash për trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin gjatë punës;

i. Bashkia Përmet ka hartuar dhe është në fazë shqyrtimi për miratim nga Titullari në cilësinë e NA, Manualin e proceseve për menaxhimin e aktiveve vendore”. Ky dokument është një kombinim i “Manualit të proceseve të punës” dhe Rregullores për menaxhimin e aktiveve të Bashkisë, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik.

j.1 Bashkia Përmet me Urdhër e Kryetarit nr. 31 datë 23.01.2024 dhe nr. 226 prot., datë 23.01.2024, ka miratuar “Ngritjen e strukturës përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Bashkinë Përmet” të përbërë nga 3 anëtarë: Sekretar i përgjithshëm në cilësinë e përgjegjësit të njësisë [NJSMS];

- Kjo njësi ka hartuar Rregulloren “Për hetimin administrativ të sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga njësia e sinjalizimit” dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Përmet me nr. 979/1 datë 28.04.2020, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, neni 13 pika 10;

2. NJSMS nuk ka hartuar Rregullore “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja nga njësia e sinjalizimit” shoqëruar me regjistrin, formulari tip I dhe tip II, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” neni 19 pika 8;

- Për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, grupit të auditimit iu vu në dispozicion raporti vjetor i dërguar në ILDKPKI me nr. 106 prot., datë 14.01.2025 për vitin 2024, i cili rezulton pa raste sinjalizimi të brendshëm, për pasojë dhe asnjë rast për mbrojtje të sinjalizuesit; Deri më 31.12.2024 në bashkinë Përmet nuk ka patur raste informacioni nga njësia e sinjalizimit dhe e mbrojtjes së sinjalizuesit;

k.1. Me Urdhër e Kryetarit nr. 30 datë 23.01.2024 dhe me nr. 225 prot., datë 23.01.2024 “Për ngritjen e strukturës përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave”, është ngritur kjo strukturë e përbërë nga 3 anëtarë (e njëjtë me NJSMS).

2. Kjo strukturë nuk ka hartuar “Rregulloren e Parandalimit të konfliktit të intereseve”;

- Për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, grupit të auditimit iu vu në dispozicion raporti vjetor i dërguar në ILDKPKI me nr. 105 prot., datë 14.01.2025 për vitin 2024, i cili rezulton pa raste konflikti interesi në procedurat e realizuara në punë publike, mallra e shërbime gjatë vitit 2024; Deri më 31.12.2024 në Bashkinë Përmet nuk ka patur raste informacioni/denoncimi nga komuniteti, grupe interesi apo media për raste të konfliktit të interesit;

m. Bashkia Përmet ka faqen e saj zyrtare në ëeb me adresë <https://.bashkiapërmet.gov.al/> dhe pasaportën e Bashkisë në Portalin Porta Vendore me adresë <https://portavendore.al/bashkia-përmet/pasaporta-e-bashkisë-përmet>, të cilat përdorin një lidhje të sigurt (connectionsecurity) HTTPS (HyperTextTransferProtocolSecure), që do të thotë se serveri i faqes së internetit përdor një certifikatë sigurie, për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletuesit e ndryshëm;

4. Informacioni dhe Komunikimi

Drejtuesit e institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e Menaxhimit financiar dhe të kontrollit; si dhe gjatë vitit 2024 nuk kanë kryer trajnime mbi Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të organizuar nga ASPA. Mungesa e realizimit të takimeve të GMS dhe e trajnimeve të stafit për njohjen dhe zbatimin e ligjit “Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ka riskuar harmonizimin në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e detyrave gjatë procedurave apo proceseve brenda sektorëve/drejtorive si

dhe ndërmjet sektorëve/drejtorive me drejtorinë ligjore, me qëllim ruajtjen e komunikimit ndërmjet njësisë brenda strukturës së Bashkisë, Bashkisë me njësitë Administrative dhe Bashkisë me institucione të tjera publike dhe jo vetëm. Informacioni shkëmbehet në nivel Horizontal dhe Vertikal. Bashkia Përmet disponon një Rregullore të Brendshme hartuar dhe miratuar mbështetur strukturës organizative me të cilën funksionon bashkia sipas VKB-ve përkatëse.

a. Në Bashkinë Përmet me Urdhrin e Kryetarit nr. 272/1 datë 15.11.2022, është caktuar *Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Transparencës* konform Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 15, 16 dhe Ligjit nr. 119/2014 “Për Informimin Publik”. Koordinatori për Informim ka përpiluar raporte periodike 6 mujore dhe i ka përcjellë te titullari. Pra një detyrim i vërtetë i Koordinatorit është se ai krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve sipas shkronja b, pika 2 e nenit 10. Çdo informacion dhe njoftim publikohen në ËEB-in e Bashkisë Përmet. Me Urdhrin nr. 323 datë 10.10.2023 dhe me nr. 2699 prot., datë 10.10.2023 është caktuar *Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik* në Bashkinë Përmet, konform ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 15, 16; ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

Mos hartimi dhe mos miratimi i Manualit të Procedurave dhe i Gjurmëve të Auditimit të unifikuar të njësisë, pavarësisht përditësimit të Rregullores së brendshme referuar strukturës organizative të miratuar me ndryshime, riskon të pasurit e një komunikimi jo shumë efektiv e harmonik, si dhe paqartësi në ndarjen e detyrave dhe monitorimin e zbatimit të tyre;

b. Buxheti diskutohet në të gjitha nivelet e Institucionit (edhe me njësitë Administrative);

c. Zhvillohen analiza vjetore të arritjeve të objektivave të Bashkisë Përmet;

d. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve mbështetëse, është përgjegjës për komunikimin me Subjektet kryesore të jashtme (ka korrespondencë shkresore zyrtare dhe elektronike sipas rastit) si dhe e çdo dokumenti administrativ (operacional e financiar) në institucion; ajo përzgjedh formën e komunikimit (shkresor të protokolluar apo elektronik) sipas rastit. Duhet të aplikohet rregullisht komunikimi elektronik ose shkresor (komunikim i brendshëm), për të evituar komunikimin verbal me qëllim forcimin e gjurmës së auditimit;

e. Çdo muaj bëhet akt rakodimi me Degën e Thesarit dhe raportimi i bëhet Titullarit të Bashkisë (NA);

f. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për çdo problem apo paqartësi, në rrugë shkresore të protokolluar, rrallëherë në rrugë elektronike dhe verbale.

3.4.3 Parimet E Informacionit Dhe Komunikimit

Parimi 13 - Marrja, gjenerimi dhe përdorimi i informacionit përkatës cilësor;

Parimi 14 - Komunikimi i brendshëm;

Parimi 15 - Komunikimi i jashtëm;

5. Monitorimi

Mos hartimi i gjurmëve të auditimit dhe mos përditësimi i rregullores së brendshme, ka sjellë një proces monitorimi jo efektiv, pasqyruar kjo: në aktivitetin e kufizuar të GMS dhe rrjedhimisht në hartimin e raporteve vjetore vetëm për përgatitjen e PBA; të mungesës së NJAB; të mungesës së dokumentimit të raporteve periodike të menaxherëve të nivelit të ulët dhe të mesëm mbi ecurinë dhe realizimin e produkteve të njësisë publike (bashkisë), si dhe identifikimin e fushave të cilat nuk janë realizuar në masën e pritshme, duke analizuar dhe shkaqet përkatëse. Ky raportim bëhet nga personi përgjegjës i çdo drejtorie tek eprori dhe eprorët ia përcjellin titullarit, në cilësinë e NA dhe Kryetarit të GMS. Raportimi mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë, përmban

informacione dhe evidenca të ndryshme, ku bazohet dhe Raporti 4, 8 mujor dhe vjetor i monitorimit, i cili i dërgohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ky Raportim bëhet në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 68 /2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, nenit 65 të ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” e të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22/2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dërgohet në Këshillin Bashkiak dhe MFE: Për vitin 2024 mbi Raportimin e zbatimit të buxhetit për 4, 8 dhe 12 mujorin (janar-prill); Raportet për në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të sistemeve të kontrollit të cilat përmbajnë: Pyetësin e Vetëvlerësimit, Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Regjistrin e Menaxhimit të Riskut, Raporti për Funksionimin e Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm, Plani i Veprimit për MFK; Gjithashtu nga ana e Bashkisë Përmet raportohet çdo vit te Agjencia Kombëtare e Mjedisit/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në zbatim të Ligjit nr. 10431/2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar, Ligjit nr. 10463/2011 “Për Menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar si dhe VKM nr. 687/2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”.

Çdo akt administrativ i Bashkisë Përmet publikohet në faqen zyrtare të saj konform kjo Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” Kreu VI, neni 15 dhe Programit të Transparencës konform ligjit nr. 119/2014 “Për informimin publik”.

Duke analizuar me kujdes të gjitha procedurat që ndiqen në funksion të arritjes së objektivave të Bashkisë, konstatojmë se baza rregullatore mbi të cilën mbështetet aktiviteti funksional i saj, është e paplotë për rrugët që duhen ndjekur në konturimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit, duke e parë si sistem dinamik (të jetë koherent me çdo akt ligjor apo nënligjor që miratohet). Kjo arrihet duke forcuar aktivitetin e GMS, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie dhe atë të koordinatorit të MFK dhe të Riskut, njohjen e stafit me Ligjin nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualin MFK, si dhe plotësimin të kuadrit rregullator të njësisë, në zbatim të Ligjit nr. 10296 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Manualit MFK, Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të riskut”, Udhëzimit nr. 21 datë 25.10.2016 “Për Njësiet Zbatues të të gjitha niveleve”; me qëllim që të mund të kontrollojnë, të konstatojnë dhe të sistemojnë në kohë reale edhe parregullsinë më të vogël të procedurave të përditshme, duke minimizuar riskun e kthimit të tyre në fenomen.

3.5.3 Parimet E Monitorimit

Parimi 16 - Përzgjedhja, zhvillimi dhe kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme dhe/ose të veçanta

Parimi 17 - Vlerësimi dhe komunikimi i mangësive

1.2. Mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.

1. Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm sipas përcaktimeve në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për Miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”;

Në zbatim të Programit të Auditimit dhe Rregullores së brendshme të KLSH mbështetur në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, pas një komunikimi verbal iu drejtua në rrugë elektronike Njësiet Zbatues [NZ] për një informacion të detajuar mbi arsyet e mosekzistencës së NJAB në Bashkinë Përmet.

1. Referuar Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” neni 3/a, Bashkia Përmet është subjekt i këtij ligji;

2. Bashkia Përmet deri në 31.12.2024 (deri në 23.04.2025) nuk ka ngritur në strukturën e saj organizative NJAB, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” neni 10, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” pika 18 a dhe pika 6;

Me Vendimin e Kryetarit nr. 13 datë 10.01.2023 me nr. 92 prot., datë 10.01.2023 e ndryshuar, është miratuar struktura organizative e Bashkisë Përmet për vitin 2023, në të cilën është bërë pjesë e saj edhe pozicioni i “specialistit të AB”;

Me Vendimin e Kryetarit nr. 21 datë 16.01.2024 me nr. 151 prot., datë 16.01.2024 e ndryshuar, është miratuar struktura organizative e Bashkisë Përmet për vitin 2024, në të cilën është ribërë pjesë e saj edhe pozicioni i “specialistit të AB”;

3. Nga Sektori i Burimeve njerëzore çdo vit është shpallur njoftimi për vendin vakant të specialistit [AB]: për vitin 2023 me nr. 464 prot., datë 08.02.2023 dhe për vitin 2024 me nr. 3079 prot., datë 18.11.2024, konform ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin civil” i ndryshuar, neni 22 dhe neni 25; VKM nr. 243/2015 i ndryshuar kreu II, IV dhe VIII;

4. Referuar rolit të GMS në Bashkinë Përmet përcaktuar qartë në Ligjin nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, dhe Manualin MFK miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108/2016 datë 17.11.2016, pika 1.2.6 i paraqesim si më poshtë vijon:
“GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të garantojë se komponentët e MFK-së dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësisë. GMS duhet të zhvillojë aktivitetet e mëposhtme:

- Të nxisë realizimin e objektivave dhe qëllimeve strategjike të njësisë;
- Të garantojë se brenda njësisë ekziston një kuadër i përshtatshëm dhe efektiv i MFK, që siguron vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve;
- Të kuptojë se si njësia realizon objektivat e MFK;
- Të rishikojë procesin e menaxhimit të riskut;
- Të garantojë se drejtuesit dhe punonjësit e njësisë janë të pajisur me aftësitë dhe udhëzimet e nevojshme për të vënë në zbatim kontrole të brendshme efektive dhe për të menaxhuar risqet;
- Të shqyrtojë nëse mjedisi i kontrollit dhe procedurat mund t'i përmbushin objektivat e tyre;
- Të vendosë standardet dhe vlerat e njësisë;
- Të verifikojë raportet e audituesve mbi MFK dhe përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore;
- Të përcaktojë nëse janë raportuar dobësi materiale, kushte të tjera të raportueshme, apo gjetje të tjera;
- Të rishikojë përmirësimet e sugjeruara për MFK si dhe të ndjekë në vazhdimësi korrigjimin e dobësive në kontrollin e brendshëm;
- Të verifikojë deklaratën e titullarit të njësisë mbi sistemin e kontrollit të brendshëm;
- Të udhëheqë dhe të mbikqyrë procesin e ndryshimit, që shton kapacitetin e njësisë për të punuar me rezultate të larta.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se në takimet e GMS të realizuara gjatë vitit 2024, është ngritur vazhdimisht mungesa e NJAB dhe pasojat që ajo sjell mbi aktivitetin e Bashkisë Përmet;¹⁰

¹⁰ Vërtetuar edhe në Proces verbalin e mbajtur në takimin e GMS dt. 24.04.2024

5. Analiza vjetore e vitit 2022 e përcjellë edhe në takimin me Ministrin e Shtetit për pushtetin vendor në turin “Dialogu vendor”, përfshin si problematikë mungesën e NJAB në Bashkinë Përmet si dhe arsytet që kanë çuar në pamundësinë e krijimit të kësaj strukture: kërkesa ligjore, mungesa e burimeve njerëzore të çertifikuara dhe trajtimi me pagë jo dinjitoze nuk ka nxitur interes për këtë pozicion;

6. Gjithashtu kjo problematikë është përcjellë edhe gjatë trajnimit 3 ditor me temë “Analiza Financiare, auditimi i pasqyrave financiare dhe roli i tyre në rritjen e transparencës dhe cilësisë në së vendimmarrjes në njësitë publike” zhvilluar nga ekipi i projektit “Financat lokale” i Drejtorisë së Kontrollit të brendshëm dhe Raportimi financiar mbështetur nga SECO dhe në bashkëpunim me MF. Currikula e programit i drejtohet drejtuesve financiar dhe audituesve të brendshëm të njërive vendore.

Drejtores e Finances dhe Buxhetit ka përcjellë problematikën e pamundësisë së krijimit të NJAB, përpjekjeve pa rezultat për bashkëpunim me Bashkinë Këlcyrë dhe Bashkinë Tepelenë (që kanë të njëjtin problem). Në këto kushte i është kërkuar që një zgjidhje të ofrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Kontrollit të Bëndshëm Financiar Publik dhe Raportimit Financiar [DPKBFPRF] në MF.

7. MF me anë të shkresës nr. 1584/2 prot., datë 16.02.2024 të DPKBFPRF/Drejtores e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit [DHMFKK], ka dërguar Raportin e “Vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2023 në Bashkinë Përmet”.

Janë përcjellë gjithsej 8 Rekomandime, ku bie në sy mungesa e konstatimit të NJAB;

Referuar Ligjit të MFK dhe Manualit MFK paragrafi 2.2.10 i tij përmban rolin dhe detyrat e NJAB si aktor kyç që sistemi i MFK të funksionojë me efektivitet në Njësinë publike.

Aktiviteti i AB në sektorin publik duhet:

- të ndihmojë që ministritë dhe njësitë e tjera të sektorit publik të mbajnë përgjegjësi para publikut duke vlerësuar dhe matur pajtueshmërinë me ligjet në fuqi dhe rregulloret, kontrollet, efikasitetin, ekonominë dhe efektivitetin e operacioneve;

- ofrojë garanci objektive për organizmat mbikqyrës lidhur me besueshmërinë dhe saktësinë e raporteve financiare dhe atyre të performancës, që dorëzohen nga ana e titullarit/ NA;

- ndihmojë drejtuesit e sektorit publik të përmbushin qëllimet dhe objektivat e tyre duke përmirësuar sistemet dhe shërbimet organizative;

- shmangë mashtrimin, shpërdorimin dhe abuzimin;

- ndihmojë punonjësit të përmirësojnë në përgjithësi mënyrën e punës së tyre dhe t’u nënshtrohen kontrolleve të vendosura;

- identifikimin dhe vlerësimin e risqeve domethënëse dhe dhënien e kontributit në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të riskut (bazuar në rregjistrin e riskut të hartuar nga menaxhimi);

- vlerësimin e kontrolleve/masave që janë vendosur nga menaxhimi, që kanë si pikësynim adresimin e risqeve;

- inkurajimin e kontrolleve efektive dhe eficiente dhe nxitjen e përmirësimit të vazhdueshëm në këtë drejtim;

- vlerësimin dhe theksimin e proceseve që garantojnë besueshmërinë dhe integritetin e informacionit financiar dhe atij operacional;

- rekomandimin e shtimit të kontrolleve, të cilat asistojnë procesin e qeverisjes duke:

- Nxitur etikën dhe vlerat e përshtatshme brenda njësisë;

- Nxitur menaxhimin efektiv të punës së njësisë dhe përgjegjshmërinë e saj;

- Komunikuar në mënyrë efektive risqet dhe kontrollet në zona të caktuara të veprimtarisë së njësive.

Konkluzion: Bashkia Përmet e ushtron aktivitetin e saj në mungesë të NJAB. Me gjithë përpjekjet e bëra nga ana e saj dhe transmetimin e problematikës edhe te strukturat e qeverisjes qendrore që ndjekin dhe vlerësojnë cilësinë e aktivitetit të NJAB të çdo institucioni qendror dhe vendor, konkretisht Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Kontrollit të Bendshëm Financiar Publik dhe Raportimit Financiar [DPKBFPRF]/[DHMFKK] në MF, deri tani nuk është marrë asnjë masë nga ana e tyre për ta mundur auditimin e brendshëm në Bashkinë Përmet në mënyra alternative, por efektive.

2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

-Struktura organizative e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për vitin 2024 Bashkia Përmet:

Tabela 1

Nr	Emërtimi i pozicionit në strukturë	Emër Mbiemër	Formimi arsimor	Numri i punonjësve/Periudha e ushtrimit të detyrës
Drejtoria e financës dhe buxhetit				
1	Drejtor	E.K	Financë/Kontabilitet	31.10.2019
2	Përgjegjës Sektor Finance	E.M	Ekonomi agrare	03.08.2015
3	Specialiste finance	V.N	Financë	29.09.2021
4	Specialiste finance	K.G	Financë	17.02.2011
5	Llogaritar	K.K	I mesëm	01.08.2015
Numri total i punonjësve në strukturë DFB			5	

Burimi: DFB/Bashkia Përmet

2.1. Programimi PBA-së 2024-2026 dhe programimi i buxhetit vjetor për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024:

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2024-2026, rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) me Urdhrin nr. 17 datë 12.01.2023 me nr. 110 prot., datë 12.01.2023 dhe të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve [EMP] me Urdhrin e Kryetarit nr. 41/4 datë 24.04.2023 ; VKB nr. 97 datë 18.12.2023 “Mbi miratimin e PBA 2024-2026” ku është përfshirë dhe Plani vjetor i buxhetit 2024; shkresa nr. 83 prot., datë 11.01.2024 dërguar Degës së Thesarit Përmet për regjistrimin e buxhetit të vitit 2024 të miratuar. Rezulton se të gjitha aktet e mësipërme janë verifikuar për ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me nr. 1080/1 datë 08.01.2024.

Një shpërndarje e programeve buxhetore për vitin 2024 sipas funksioneve/nënfunksioneve që NJVQV/Bashkitë janë përgjegjëse për ushtrimin e tyre të atribuar nga Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pasqyrohen në tabelën nr. 1/Aneksin B1.

Nga analiza e informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, pasqyruar dhe në Aneksin B1, rezultoi se, nga 20 programe buxhetore të miratuara nga MF për përgatitjen e PBA 2024-2026 nga DFB /Bashkia Përmet janë planifikuar për buxhetim vetëm 14 programe; dhe ka funksione/nënfunksione të cilat nuk kanë asnjë program buxhetimi, si: F- “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike” (neni 23): “Transportin publik vendor” dhe “Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të kujdesit të shëndeti publik”; F- “në fushën e mbrojtjes së mjedisit” (neni 26); N/f- “Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi” etj; N/f-“Transporti publik”, :turizmi” etj,. Çdo funksion i përcaktuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” përfshihet në një program të caktuar buxhetor të përcaktuar në Udhëzimin nr. 7 datë 25.05.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes

Vendore” shtojca 1. Pra vihet re se nuk ka një harmonizim të planifikimit buxhetor të atyre nënfunksiioneve që edhe pse u përkasin funksioneve të ndryshme, me një studim dhe analizë profesionale do të mbështesnin apo plotësonin njëra tjetrën, me qëllim realizimin në tërësi të shërbimeve ndaj komunitetit në territorin që mbulon bashkia Përmet.

Programimi i shpenzimeve në PBA 2024-2026 dhe i detajuar për çdo program, sipas PBA (shpërndarja e fondeve sipas programeve), është paraqitur në tabelën nr. 2.1 dhe nr.2.2/Aneksin B/2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në mënyrë të përmbledhur, informacioni pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.2/Në mijë lekë

Përmbledhëse informacionit të tabelave nr.2.1 dhe nr. 2.2									
Planifikimi buxhetor i shpenzimeve sipas çdo viti në PBA 2023-2025/2024-2026									
Nr.	Kodet e programeve	Shpenzimet Viti 2023		Shpenzimet Viti 2024		Shpenzimet Viti 2025		Shpenzimet Viti 2026	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
				x		x		x	
TOTALI (I) PBA 2023-2025		1,993,152	100	896,573	100	864,459	100		
Diferenca			(-)1,096,579		(-)32,114		-		
TOTALI (II) PBA 2024-2026				344,790	100	333,037	100	340,491	100
Diferenca					(-)11,753		7,454		
Diferenca (II-I)/trendi			-	(-)551,783		(-)531,422			-

Burimi: DFB/Bashkia Përmet/Punoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelën 2 (përmbledhëse) dhe në Aneksin B2, rezulton se:

- Në PBA 2023-2025 dhe 2024-2026, planifikimi i fondeve në buxhet në total ka ardhur në rënie nga viti në vit: me (-) 1,096,579 mijë lekë nga 2023 në vitin 2024 në PBA 2023-2025 dhe me (-) 32,114 mijë lekë nga viti 2024 në vitin 2025 në PBA 2023-2025; me (-) 11,753 mijë lekë nga viti 2024 në vitin 2025 në PBA 2024-2026;

Për 2 vitet vijuese është në të njëjtat vlera;

- Për vitin 2024 në PBA 2023-2025 është parashikuar në vlerën 896,573 mijë lekë dhe në PBA 2024-2026 në vlerën 344,790 mijë lekë, ose (-) 551,783 mijë lekë më pak;

Për vitin 2025 në PBA 2023-2025 është parashikuar në vlerën 864,459 mijë lekë dhe në PBA 2024-2026 në vlerën 333,037 mijë ose (-) 531,422 mijë lekë më pak;

- Nga 15 programet e buxhetuara në PBA 2024-2026 të grupuara në 6 programe, rezulton se programi C135 vjen në rënie nga viti në vit; ndërsa 5 programet e tjera janë planifikuar me vlera në rritje të cilat kanë diktuar dhe trendin e vlerës totale të çdo viti të PBA 2024-2026;

- PBA 2024-2026 ka një program më tepër [6140] se PBA 2023-2025.

▪ Ndërsa programet buxhetore e përzgjedhura në Bashkinë Përmet për buxhetin e vitit 2024 si viti i parë në PBA 2024-2026, krahasuar me programet e miratuara nga MF për tu patur në konsideratë nga NJVQV gjatë përgatitjes së PBA 2024-2026, pasqyrohen në tabelën nr. 3 si më poshtë:

Tabela nr. 3/Në mijë lekë

Udhëzimi nr. 7 datë 25.02.2022			Kodi buxhetuar	Kodi i ri	Emërtimi i Programit Buxhetor	Viti 2024		Diferenca
Funksioni	N/ Funksioni	Kodi Programit				Plan	Fakt	
1	011	01110	01110	AA135	Planifikim, Menaxhim, Administrim	83,468	75,558	(-)7,910
3	031	03140	03140	AE135	Shërbimet e Policisë Vendore	36,134	29,262	(-)6,872
	032	03280	03280		MZSH			
4	041	04130			Mbështetje për zhvillim ekonomik			
	042	04220			Shërbimet bujqësore/inspektimi /siguria ushqimore/mbrojtja konsumatore			
		04240	04240	AB135	Menaxhim infrastrukture Kullim-Ujitja	214,562	141,761	(-)72,801
		04260	04260		Administrim Pyje-Kullota			

	045	04520	04520		Mirëmbajtje Rruge e trotuare			
		04570			Transporti Publik			
	049	04980	04980	AF135	Fond kontigjence, Fond rezervë	4,520	3,016	(-)1,504
5	051	05100	05100		Menaxhim Mbetje Urbane			
	061	06140	06140	AB135	Planifikimi urban vendor			
6	062	06260	06260		Shërbime Publike			
	063	06370			Furnizim me ujë dhe kanalizime			
7	072	07220			Shërbimet e kujdesit parësor			
	081	08130	08130	AD135	Sport dhe argëtim, turizëm;	93,180	63,014	(-)30,166
8	082	08220	08220		Shërbime kulturore			
	091	09120	09120		Arsimi bazë/parashkollor			
9	092	09230	09230	AC135	Arsimi i Mesem	89,015	67,825	(-)21,190
	104	10430	10430		Paaftësi/ Kujdesi Social/ndihma ekonomike			
10	106	10661			Strehimi Social/ Qendra ditore per femijet me aftesi ndryshe			
	109	10910			Mbrojtje Civile e Emergjencia			
22 Programe			15	7		520,915	380,436	(-)140,479

Burimi: Bashkia Përmet/Punoi: Grupi i auditimit

Programet afatmesme janë hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligjin nr. 57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008”, Ligjin nr. 9652/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Udhëzimin e MF nr. 7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së buxhetit”, Udhëzimin e MF nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimi plotësues i MF nr. 2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, Udhëzimin plotësues nr.6/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, Udhëzimin nr. 7 datë 25.05.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” shtojca 1, Udhëzimi MF nr. 6 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026” si dhe UMFE nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar me UMFE nr. 3 datë 16.01.2021, UMF nr. 6 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026”¹¹ dhe VKB nr. 75 datë 30.10.2023 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë e Përmet për vitin 2024”. Është marrë në konsideratë Instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme).

Konstatim: Nga verifikimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelën 2, në tabelën 3 dhe në tabelën 4 të funksioneve të bashkisë dhe 20 programeve buxhetore të caktuara në udhëzimet e MF për PBA 2024-2026, rezultoi se: programet [04130], [04220], [04570], [07220], [10910] nuk janë marrë në konsideratë nga Bashkia Përmet për të parashikuar fonde në buxhet, në moszbatim të Udhëzimit nr. 7 datë 25.05.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive

¹¹ Bashkia Përmet është në grupin e 9 bashkive pilot, të cilat do e plotësojnë instrumentin e Planifikimit Financiar sipas metodologjisë së re të përcaktuar në shtojcën 5 të Udhëzimit

të Vetëqeverisjes Vendore” shtojca 1 dhe Udhëzimit nr. 6 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026” shtojca 4.

- Programe që kanë parashikuar fonde për zërin “investime” në PBA 2024-2026 dhe në Planin Vjetor 2024, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.4/në lekë

Kodi i ri	Kodi standard	Emërtimi	Vlera në mijë lekë		Kodi standard	Kodi i ri
			Plan	Fakt		
AA135	01110	Planifikim e menaxhim	4,517			
AC135	09120	Arsimi parashkollor/arsimi bazë	15,735		09120	AC135
		Kujdesi social				
	09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm			09230	
AE135	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	4,886		03280	AE135
AB135	04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	155,435		04260	AB135
	04240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit			04240	
	05100	Menaxhim i mbetjeve			05100	
AD135	08130	Sport dhe argëtim	67,593		08130	AD135

Burimi: DFB/Bashkia Përmet/Punoi:Grupi i auditimit

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën 4, rezulton se nga 6 programe buxhetore, 5 prej tyre kanë planifikuar fonde për zërin “investime”.

- Ndarja e shpenzimeve sipas zërave buxhetorë parashikuar në PBA 2024-2026, është paraqitur në tabelën 3/Aneksin B/3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në Aneksin B/3, rezulton se:

- Nga planifikimi i fondeve në PBA 2024-2026, zëri "paga" ka vlerën më të lartë për të 3 vitet, në diferenca të vogla vlere nga viti në vit, është në masën 53% në vitin 2024, 54.9% në vitin 2025 e 53.5% në vitin 2026 ndaj totalit të buxhetit respektiv;

-Zëri "shpenzime operative", parashikuar në vlerë në rënie nga viti në vit, 93,822 mijë lekë në vitin 2024 ose në masën 27.2%, në vlerën 86,371 mijë lekë në vitin 2025 ose në masën 25.9% dhe në vlerën 84,013 mijë lekë në vitin 2026 ose në masën 24.7% ndaj totalit të buxhetit respektiv;

-Zëri “investime” parashikuar për vitin 2024 në vlerën 28.28 mijë lekë ose 8.2% e buxhetit total, për vitin 2025 është në vlerën 24,084 mijë lekë ose 7.2% dhe për vitin 2026 në vlerën 34,227 mijë lekë ose 10% ndaj totalit të buxhetit;

-Zëri “Rezervat” vjen në rritje dhe parashikuar në vitin 2024 në vlerën 3,681 mijë lekë ose 1.1% ndaj buxhetit total, për vitin 2025 në vlerën 3,700 mijë lekë ose 1.1% e totalit të buxhetit dhe në vitin 2026 prej 3,800 mijë lekë ose 1.1% të totalit të buxhetit.

Tabela nr.5/në mijë lekë

Emërtimi i shpenzimit	Viti Plan	2024 Fakt	Diferenca	%
600	294,912	269,634	(-) 25,278	91.4
601	50,036	45,045	(-) 4,991	90
602	167,622	141,144	(-) 26,478	84.2
604	5,505	743	(-) 4,762	13.5
230-231	196,930	133,200	(-) 63,730	67.6
606	12,437	11,602	(-) 835	93.3
Mj. në ruajtje 466	44,963	44,963	0	100

Burimi: DFB/Bashkia Përmet

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave në tabelën 5, rezulton se:

- Realizimin më të lartë e ka llog.606 “Transferime për Buxhetet familjare dhe Individë” në masën 93.3%; dhe llog.601 “paga” në masën 91.4%;

- Ndërsa mosrealizimin më të lartë e ka llog 230-231 “investimet” në masën 67.6%.

- Sipas PBA 2023-2025 dhe PBA 2024-2026 tendenca e të ardhurave paraqitet Aneks B/4, ku nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në të rezulton se:

- Të “ardhurat e veta” janë planifikuar me vlera në rritje nga viti në vit; për vitin 2024 janë në vlerën 59,117 mijë lekë por me një vlerë 4,851 mijë më shumë se viti paraardhës 2023;

- “Nga transferat” për vitin 2024 janë planifikuar në vlerën totale 244,857 mijë lekë dhe 34,438 mijë lekë më shumë se në vitin 2023;

- Për vitin 2026 të ardhurat për të 2 kategoritë janë parashikuar në rritje krahasuar me vitet paraardhëse nisur kjo nga trendi i realizimit të të ardhurave, me 565 mijë lekë dhe 22,345 mijë lekë më shumë krahasuar vetëm me vitin paraardhës 2024;

Paketa fiskale për vitin 2024 është miratuar me VKB nr. 75, datë 30.10.2023.

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave, rezulton se planifikimi bëhet mbi nevojat reale të Bashkisë. Grupi i auditimit duke analizuar këtë fakt, arrin në konkluzionin se diferencat mes planifikimit të të ardhurave me realizimit faktik të tyre, ka ardhur si rezultat i mungesës së një analize të mirëfilltë të realizimit apo mosrealizimit të çdo takse e tarife vendore.

- Nga auditimi rezultoi se Bashkia Përmet për PBA 2024-2026 dhe Projekt buxhetin e vitit 2024, ka zhvilluar takime konsultative me grupet e interesit në komunitet, konform Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; ndërsa prezantimi i PBA 2024-2026 dhe Projekt buxheti vjetor 2024 nga ana e Bashkisë Përmet është publikuar në faqen Zyrtare të Bashkisë në formatin e përshtatur për publikun.

Tabela nr. 6

Datat e konsultimeve publike	PBA 2024-2026	P.Buxheti 2024
		12.10.2023
	12.10.2023	
	14.10.2023	
	25.10.2023	
	25.10.2023	
	25.10.2023	
Numri i takimeve	6	

Burimi: DFB/Bashkia Përmet

Procesi konsultativ me komunitetin është realizuar nëpërmjet njoftimit zyrtar në stenda, ëeb-in e Bashkisë, rrjetet sociale etj., me anë të të cilave njoftohet komuniteti mbi takimin, objektin, platformën dhe adresën/linkun etj., vërtetuar kjo nga proces verbalet e mbajtura në secilin takim, konform kuadrit ligjor në fuqi: Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” Kreu IV, neni 11-20;

- Buxhetet janë hartuar mbi bazën e nevojave të njëjësive shpenzuese: 3 njësitë e varësisë, njësitë administrative, drejtori/sectorë të aparatit të Bashkisë Përmet, drejtorive të shkollave, kopshteve, etj, vërtetuar kjo nga kërkesat e dokumentuara;

- Hartimi i PBA 2023-2025 rezulton të ketë kaluar të gjitha fazat e përgatitjes, konform kuadrit ligjor;

Tabela nr.7/ Në mijë lekë

Bashkia Përmet	PBA 2024-2026	Plani Buxhetit 2024
		VKB Nr. 70 dt.29.09.2023
	Vlera	
	577,341	

Punoi: Grupi i auditimit.

- PBA 2024-2026 dhe Buxheti vjetor për vitin 2024 kanë pësuar këto ndryshime dhe janë miratuar në Këshillin Bashkiak si më poshtë:

Tabela nr. 8

Ndryshimet në buxhetin e vitit 2024		
Nr.	PBA 2024-2026	P. Buxheti 2024
1	Nr.70 dt.29.09.2023	VKB Nr. 97 datë 18.12.2023
2		VKB Nr. 09 datë 30.01.2024
3		VKB Nr. 19 datë 06.03.2024

4		VKB nr. 20 datë 06.03.2024
5		VKB nr. 21 datë 06.03.2024
6		VKB nr. 30 datë 30.04.2024
7		VKB nr. 33 datë 30.04.2024
8		VKB nr. 49 datë 01.07.2024
9		V.Kr nr. 220 datë 02.07.2024
10		VKB nr. 53 datë 31.07.2024
11		VKB nr. 62 datë 18.08.2024
12		VKB nr. 76 datë 25.09.2024
13		VKB nr. 80 datë 23.01.2024
14		VKB nr. 83 datë 05.11.2024
15		VKB nr. 85 datë 05.11.2024
16		VKB nr. 89 datë 05.11.2024
17		VKB nr. 90 datë 05.11.2024
18		VKB nr. 91 datë 05.11.2024
19		VKB nr. 93 datë 14.11.2024
20		V.Kr. nr. 418 datë 15.11.2024
	1	20

Burimi: DFB/ Bashkia Përmet

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit në tabelën nr. 8, rezulton se buxheti vjetor 2024 ka pësuar 19 ndryshime: 12 ndryshime janë miratuar me VKB dhe 2 ndryshime me Vendim të titullarit të njësisë. Për këto ndryshime, është zbatuar kuadri ligjor në fuqi për buxhetin.

- Një informacion i detajuar mbi vlerën e fondeve të transferuara, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 9/Në lekë

Buxheti fillestar 2024		Ndryshimet në Buxhet gjatë vitit 2024					
Vlerë	Art. Nr. datë	PROGRAMI	Shtesa /art	shuma	Pakësuar/art	shuma	
577,341	VKB nr.09 dt.30.01.2024	AF135/Kap 01	602	462,000	609	462,000	
	VKB nr.19 dt.06.02.2024	AF135/Kap 01	606	154,136	609	154,136	
	VKB nr. 20 dt 06.03.2024	AF135/Kap 01	606	601,428	609	601,428	
	VKB nr. 21 dt 06.04.2024	TIT 4980/Kap 05	606	100,000	609	100,000	
	VKB nr.30 dt. 30.04.2024	AC135/Kap 06	Te Ardhurat	2,980,000	Shpenzimet 602 231	2,980,000	
	VKB nr.33 dt. 30.04.2024	AF135/Kap 05	606	180,000	609	180,000	
	VKB nr.49 dt. 01.07.2024	AF135/Kap 05	606	80,000	609	80,000	
	Vendim Kr. Nr.220 dt. 02.07.2024	AA135/Kap 05	602/V111AAH	532,000	602/V111AAD	532,000	
	VKB NR. 53 dt.31.07.2024	AA135/Kap 01				602-609/V111AAD	200,000
		AB135/Kap 01	231/V426AAC	816,024	816,024	602-609/V426AAC	816,024
		AB135/Kap 05	231/P452AAM	390,000	390,000	602-609/V452AAB	390,000
		AB135/Kap 01	231/P424XXX	185,236	185,236	602-609/V424AAB	317,752
		AB135/Kap 02	231/P424XXX	132,516	132,516		
		AC135/Kap 05				602-609/V912AAD	200,000
	AC135/Kap 01	600-601/V912AAA		2,895,442			
		600-601/V043AAA		2,048,475			
		602-609/V043AAD		2,151,525			
	AE135/Kap 01	600-601/V328AAB	1,409,639				
	AF135/Kap 01	602-609/V494AAA	200,000				
	Kap 05	609/V494AAA	200,000				
	VKB nr. 62 dt. 18.08.2024	AD135/Kap 01	602-V822AAD	500,000	500,000	604/V822AAD	500,000
	VKB nr. 76 dt. 25.09.2024	AF135/Kap 05	606/V494AAA	306,000	306,000	609/V494AAA	306,000
	VKB nr 80 dt. 23.10.2024	AA135/Kap 01				602/V111AAD	100,000
		AD135/Kap 01	604/V913AAB	100,000			
	VKB nr. 83 dt. 15.11.2024	AE135/Kap 01	600-601/V314AAB	332,000			
		AE136/Kap 01	600-601/V328AAB	330,000			
		AA135/Kap 01	600-601/V111AAA	1,900,000			
602/V111AAB			1,837,750				
602/V111AAG			949,320				
602/V111AAH	200,000						

	AB135/Kap 01	600-601/V626AAA	800,000			
		602/V626AAH	400,000			
	AD135/Kap 01	600-601/V822AAA	150,000			
	AD135/Kap 02	602/V822AAD	1,020,000			
	AC135/Kap 01	601/V923AAA	20,000	600/V923AAA	20,000	
	AE135/Kap 01	601/V328AAB	130,000	602/V328AAC	130,000	
		600/V328AAB	750,000	231/P328AAA	750,000	
	AC135/Kap 01	602/V043AAF	100,000	602/V043AAF	100,000	
	AD135/Kap 01	602/V822AAD	120,000	604/V822AAD	120,000	
	VKB nr.85 dt. 05.11.2024	AF135/Kap 05 Kap 01	606/V494AAA	14,000	609/V494AAA	14,000
			606/V494AAA	10,000	609/V494AAA	10,000
	VKB nr. 89 dt. 05.11.2024	AF135/Kap 01	606	329,400		329,400
	VKB nr. 90 dt. 05.11.2024	AF135/Kap 05	606/V494AAA	80,000	609/V494AAA	80,000
	VKB nr. 91 dt. 05.11.2024	AF135Kap 05	606/V494AAA	40,000	609/V494AAA	40,000
Kap 01		606/V494AAA	60,000	609/V494AAA	60,000	
VKB nr. 93 dt. 14.11.2024	AD135/Kap 01	231/P813AAC	11,119,273			
Vendim Kr. Nr. 418 dt. 15.11.2024	AC135/Kap 02	602/V0432AAD	444,000	604/V0432AAD	444,000	
	AB135/Kap 01	231/V510AAC	180,000	231/V510AAC	180,000	

Burimi:DFB/Bashkia Përmet/Punoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, *rezultoi* se:

a. Bashkia Përmet ka hartuar “Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit vjetor” për Bashkinë Përmet dhe njësisive administrative për vitin 2024 dhe miratuar me VKB nr. 99 datë 18.12.2023, në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 33;

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në Këshillin e Njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor.(është paraqitur për miratim së bashku me PBA 2024-2026);

b. PBA 2024-2026 miratuar me VKB nr. 70 datë 29.09.2023 dhe Plani vjetor i buxhetit për vitin 2024, janë; Buxheti fillestar i miratuar për vitin 2024 me VKB Nr. 97 datë 18.12.2023, ka pësuar 20 ndryshime, të cilat janë miratuar sipas VKB për shtesa/pakësime apo përdorim fondesh të trashëguara nga viti paraardhës 2023 për tu përdorur në buxhetin e vitit 2024 etj.

Ndryshimet e propozuara dhe të miratuara në buxhetin e bashkisë për vitin 2024 me Vendim të Këshillit Bashkiak, kanë pasqyruar lëvizjet në buxhet sipas kodeve të programit, kapitullit, artikullit e vlerës, të cilat janë shoqëruar edhe me relacionet përkatëse, konform Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 26,27,28 e 29; neni 44 paragrafi për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe neni 47;

c. Vendimeve të Këshillit Bashkiak për miratimin e PBA 2024-2026 dhe Planit vjetor 2024 dhe ndryshimeve të bëra, iu janë bashkëngjitur relacionet përkatëse, në të cilat janë dhënë argumentet e nevojshme ku mbështeten këto ndryshime.

Rezulton se, VKB-të nuk janë rregjistruar në librin e protokollit të Bashkisë Përmet, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “për arkivat” i ndryshuar, “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”; Vendimi nr. 4 datë 19.06.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.

d. VKB-të për PBA/ Buxhetin vjetor dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit ushtrimor, janë konfirmuar për ligjshmëri nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, si dhe janë dërguar në Degën e Thesarit Gjirokastrë.

- Planifikimet fillestare sipas PBA-së dhe planit vjetor 2024, pasqyrohen në tabelën nr. 5/ Aneksi B5.

Referuar të dhënave të pasqyruara në Aneksin B5, konstatohet se, Bashkia Përmet ka planifikuar në PBA 2024-2026 që me të ardhurat e veta të mbulojë 25.8% të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2024. Ndërkohë që nga tabela rezulton se, të ardhurat e veta të trashëguara nga viti paraardhës 2023 janë 3,556 mijë lekë. Të ardhurat e veta në total për vitin 2024 janë 88,201 mijë lekë ose në masën 11.4% të planit vjetor të miratuar.

Referuar Akt Rakordimit me Degën e Thesarit “mbi të ardhurën e trashëguar” mbajtur në datën 23.01.2025 dhe të dhënave të pasqyruara në Aneks B5 dhe në Aneks B6, rezulton se, shpenzimet me burim të “ardhurat e veta” nga taksat e tarifave vendore për vitin 2024 janë planifikuar në vlerën totale 88,201 mijë lekë dhe janë shpenzuar në vlerën 42,598 mijë lekë ose në masën 48.3% e tyre; Nga fondet e “pakushtëzuara” janë planifikuar 242,329 mijë lekë dhe shpenzuar 204,617 mijë lekë ose në masën 84.4% e tyre; nga fondet “specifike e sektoriale” janë planifikuar 190,386 mijë lekë dhe shpenzuar 133,221 mijë lekë ose në masën 70% e tyre; si dhe nga fondet "e kushtëzuara" janë planifikuar 188,830 mijë dhe shpenzuar 162,717 mijë lekë ose në masën 86.2% e tyre.

- Gjithashtu nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, rezulton se të ardhurat për shpenzime të planifikuara në vitin 2024 bashkë me ato të trashëguara nga viti paraardhës 2023, janë 777,866 mijë lekë.

Ndërsa buxheti fillestar për vitin 2024 është planifikuar në vlerën e 577,341 mijë lekë, me fondet e trashëguara nga viti 2023 prej 142,324 mijë lekë (nga të ardhurat e veta & transfertat e pakushtëzuar + tr.specifike e sektoriale) dhe transfertat shtesë nga granti arrin në vlerën progresive e 777,865 mijë lekë. Krahasuar me planin fillestar buxheti vjetor progresiv i planifikuar është 200,524 mijë lekë më shumë se ai fillestar dhe realizimi i tij është në vlerën e 544,544 mijë lekë. Planifikimi i Buxheteve të Bashkisë Përmet për vitin 2024 është bërë në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” pika 4 dhe 5, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015, germa “dh” të nenit 32, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe UMFE nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, Udhëzimit MF nr. 6 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026” si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkiak Përmet.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo vit buxhetor.

Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2024, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Planifikimi i buxhetit është bërë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njëjësive vendore. Janë zbatuar kriteret në çeljen e buxhetit, është bërë detajimi i planit fillestar bazuar në kompetencat që i lejon ligji për lëvizjet në buxhet.

- Struktura organizative për vitin 2024, është miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 13, datë 10.01.2024, Konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1080/1 prot., datë 08.01.2024. Informacion i detajuar mbi numrin e punonjësve pasqyrohet në Aneksi B/8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Struktura organizative dhe niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 21, datë 16.01.2024 i ndryshuar, në zbatim të VKM nr. 113, datë 01.03.2023, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, VKM nr. 175 datë 08.03.20217 i ndryshuar, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi

pagë të punonjësve mësimorë në Arsimin Parauniversitar”, VKM nr. 350 datë 19.04.2017 i ndryshuar, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendim nr. 165 dt. 02.03.2016, për grupin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksioneve” dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me nr. 900/1 prot., datë 08.01.2024.

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës. Informacioni i detajuar mbi planifikimin, çeljet dhe ndryshimet e bëra gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 në buxhetin e vitit 2024 të miratuar, janë pasqyruar më lart në tabelën 2 dhe tabelën 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga analiza e vlerave të pasqyruara në *Aneks B/6* dhe informacionit në *tabelën 1, tabelën 2 dhe tabelën 3*, rezulton se ka diferenca në programe të ndryshme buxhetore, ku veç atyre programeve për të cilat Bashkia Përmet nuk mund të bëjë planifikim të saktë të fondeve që do të shpenzohen (investime të reja gjatë vitit buxhetor me fonde të Ministrisë së linjës/FZHR), ka programe si: 04570- “Transporti publik”, 04130- “Mbështetje e zhvillimit ekonomik”, 07220- “Kujdesi Parësor Shëndetsor”, 036-“Marrëdhëniet në komunitet”, 056- “Ndërgjegjësimi mjedisor”, 062/1 “programe zhvillimi”, rezultojnë të jenë programe pa fonde buxhetore apo me fonde të papërfillshme; gjë për të cilat tregon se Bashkia Përmet nuk ka pritshmëri për alokim të fondeve shtesë.

Diferencat e vlerave të PBA-ve në gjykimin e grupit të auditimit tregojnë jo vetëm për planifikim jo të studiuar të fondeve buxhetore në PBA, por edhe paqartësi në përcaktimin dhe vlerësimin e programeve prioritare si dhe mungesë harmonizimi ndërmjet atyre programeve që i përkasin të njëjtit funksion apo funksioneve të ndryshme, por që mbështesin apo plotësojnë njëri - tjetrin, të cilat lidhen ngushtësisht me planin strategjik dhe politikat institucionale

Bashkia Përmet nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh për t’i kushtuar rëndësi programeve 052 “Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve”, 056-“Ndërgjegjësimi mjedisor” si programe që lidhen ngushtë me 051-“Menaxhimi i mbetjeve”; 036-“Marrëdhëniet në komunitet”, etj, të cilat nuk janë vlerësuar si programe prioritare nga Bashkia Përmet. Kështu mungesa e planifikimit të fondeve apo planifikim me fonde të papërfillshme nga ana e Bashkisë, tregon për një shërbim ku është cënuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj që i ofron komunitetit, të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 23-30.

- Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime) të cilat janë pasqyruar në mënyrë të detajuar në tabelat nr. 8, tabelën nr.9 dhe Aneks B/7. Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga

programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të Këshillit Bashkiak, të pasqyruara në tabelat respektive.

Për hartimin e projekt buxhetit vjetor 2024, janë marrë në konsideratë kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës dhe drejtpërdrejtë kërkesat buxhetore sipas nevojave të çdo njësie të strukturës së bashkisë, konform nenit 40 pika 3/ç të ligjit nr. 67/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi gjithashtu, se është bërë analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj; gjatë vitit 2024 është bërë raportimi periodik shkresor 4, 8 dhe 12-mujor (zyrtar shkresor dhe elektronik) i realizimit të buxhetit në MF.

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuar sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Ky informacion paraqitet i detajuar në Aneks B/9 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitin 2024 rezultoi se PBA 2024-2026 të jetë realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë periudhës nën auditim, buxheti i Bashkisë Përmet ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

Nga auditimi rezultoi se Kryetari i Bashkisë ka raportuar në Këshillin Bashkiak për gjendjen ekonomiko-financiare të vitit të mbyllur ushtrimor 2023 dhe 2024, në zbatim të neneve 11, 64 të ligjit nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 44.

Për sa më sipër, një informacion i përmbledhur pasqyrohet në tabelën nr. 10 dhe i detajuar pasqyrohet në Aneks B9. Në tabelën e mëposhtme nuk janë përfshirë shpenzimet me fonde nga transfertat e kushtëzuar.

Tabela nr. 10/në mijë lekë

Bashkia Përmet. Vetëm me të ardhurat e veta vendore + transfertat e pakushtëzuar. Viti 2024									
Art	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	% e realizimit
		Fakti i vitit para ardhës Viti 2023	PBA Plan Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024 (sipas VKB .)	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2024	Çelja në thesar	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	
Totali (korrente + kapitale)		364,124	577,341	513,220	520,913	386,243	380,436	5,807	98.5


Burimi:DFB/Bashkia Përmet/Punoi: Grupi i auditimit

2.3 Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë bazuar në nivelin e fondeve të çelura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me akt rakordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Gjirokastrë si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Përmet, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar të vitit, të miratuar me Vendim të KB ose të diktuar nga transfertat

e deleguar nga pushteti qendror. Për rishikimet e buxhetit dhe rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, rezulton se është respektuar disiplina buxhetore, si në planifikim ashtu edhe në realizim.

Grafiku i Buxhetit Bashkia Përmet



-Realizimit i treguesve të buxhetit për vitin 2024 referuar akt-rakordimeve me thesarin, paraqitet në Aneksi B10/Tabela 10, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Referuar të dhënave të pasqyruara në Aneks B/10, rezulton se për vitin 2024 niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varion në masën nga 46% deri në 97.5%; konstatohet se, llog. 606 “transferime për buxhetet familjare dhe individuale” ka realizimin më të lartë në masën 97.5% dhe llog.230-231 “investimet” ka mosrealizimin më të lartë në masën 46%.

Tabela nr. 11/në mijë lekë

Artikulli	2023			2024			
	Plan	Fakt	Dif.	Plan	Fakt	Dif.	
Totali	516,812	362,381	154,431	520,915	380,436	140,479	
Diferenca plan (2024-2023)	4,103						
Diferenca fakt (2024-2023)	18,055						
Trendi i realizimit vjetor	70.1%			73%			Dif.2.9%

Nga informacioni i pasqyruar në Aneks B/10 dhe Aneks B/11 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në mënyrë të përmbledhur në tabelën nr.11, rezulton se:

- Niveli i planifikimit buxhetor vjen në rritje nga viti 2023 në vitin 2024 me një diferencë prej 4,103 mijë lekë;

- Niveli i realizimit (ndaj planit) në total dhe për çdo zë buxhetor vjen në rritje nga viti 2023 në vitin 2024, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Përmet dhe se realizimi faktik nuk i përgjigjet në çdo rast zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara;

- Referuar vlerave të mosrealizimit të buxhetit në tërësi dhe për çdo zë buxhetor, rezulton se ka ardhur në rënie nga viti 2023 në vitin 2024 me 18,055 mijë lekë;

Realizimin më të lartë e ka llog.606 me trendin e përmirësimit 96.9 %, dhe mosrealizimin me trendin e përkeqësuar e ka llog.604 me 156 %.

▪ **Sipas burimeve të financimit:**

Për përdorimin e të ardhurave treguesit e buxhetit për vitin 2024, sipas burimeve të financimit: transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, të ardhura të veta, janë planifikuar si në tabelën 12. ë Aneksit B/12, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Sipas burimeve të financimit: transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, të ardhura të veta, treguesit e buxhetit në mënyrë të përmbledhur janë planifikuar si më poshtë:

Tabela nr. 12/në lekë

Nr.	Emërtimi	Totali	Burimi i financimit					% të ardhura të veta ndaj totalit për zë	% të ardhura të veta ndaj totalit për lloj
			Transferta pakushtëzuara	Transferta e specifike/sectoriale	Të Ardhura të veta	Transferta e kushtëzuar	Transferta te huaja		
TOTALI		777,865	242,328	190,384	88,201	186,703	70,249	11.3	100
në %		100	31,2	24,5	11,3	24	9		

Burimi: DFB/Bashkia Përmet

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacionit të pasqyruar në Aneks B/12, rezulton se:

- Vlera e buxhetit progresiv në total për vitin 2024 është 777,865 mijë lekë, ku peshën më të madhe e kanë fondet nga “transferta e pakushtëzuar” në vlerën 242,328 mijë lekë ose në masën 31.2% të vlerës totale; dhe më të ulët fondet nga “të ardhurat e veta” në vlerën 88,201 mijë lekë ose në masën 11.3% të vlerës;

- Nga fondet me burim financimi “të ardhurat e veta” peshën më të madhe e zënë “investimet” në vlerën 52,472 mijë lekë ose në masën 16.9% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 59.5% ndaj vlerës totale të fondeve me burim “të ardhurat e veta”;

Vlerën 16,590 mijë lekë e kanë zëri “shpenzimet operative” ose në masën 16% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 18.8% ndaj vlerës totale të fondeve me burim “të ardhurat e veta”; “Pagat” janë në vlerën 13.500 mijë lekë dhe zënë 6.3% të vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 15.3% ndaj vlerës totale të fondeve me burim “të ardhurat e veta”;

Peshën më të vogël në buxhet e ka zëri Trans.Buxh.Familjare/individ në vlerën 2,700 mijë lekë ose në masën 2.8% të vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 3.1% ndaj vlerës totale të fondeve me burim “të ardhurat e veta”;

- Sipas burimeve të financimit: transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, të ardhura të veta, treguesit e buxhetit në mënyrë të përmbledhur janë realizuar si më poshtë:

Tabela nr. 13./në lekë

Nr	Emërtimi	Totali	Burimi i financimit					% nga të ardhurat e veta ndaj totalit	% të ardhura të veta ndaj totalit për lloj
			Transferta pakushtëzuara	Transferta e specifike/sectoriale	Të Ardhura të veta	Transferta e kushtëzuar	Transferta te huaja		
TOTALI		544,544	204,619	133,221	42,596	162,718	1,390	7.8	100
në %		100	37,6	24,5	7,8	29,8	0,3		

Burimi: Bashkia Përmet

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacionit të pasqyruar në Aneks B/13 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, rezulton se:

- Vlera e shpenzimeve faktike në total për vitin 2024 është 544,544 mijë lekë, ku peshën më të madhe e kanë fondet nga “transferta e pakushtëzuar” në vlerën 204,619 mijë lekë ose në masën

37.6% të vlerës totale dhe në vlerën më të ulët janë shpenzimet nga “të ardhurat e veta” në vlerën 42,596 mijë lekë ose në masën 7.8% të vlerës totale;

- Nga fondet e shpenzuara me burim financimi “të ardhurat e veta” peshën më të madhe e zënë “shpenzimet operative” në vlerën 14,535 mijë lekë ose në masën 21.8% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 34.1% ndaj vlerës totale të fondeve me burim “të ardhurat e veta”; Në vlerën 13,331 mijë lekë e ka zëri “paga” ose në masën 6.6% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 31.3% ndaj vlerës totale të fondeve me burim “të ardhurat e veta”;

“Investimet” janë në vlerën 9,837 mijë lekë dhe zënë 6.9% të vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 23.1% ndaj vlerës totale të fondeve me burim “të ardhurat e veta”;

Peshën më të vogël e ka zëri “Trans.Buxhet. Familjare e individ” në vlerën 1,992 mijë lekë ose në masën 21.1% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 4.7% ndaj vlerës totale të fondeve me burim “të ardhurat e veta”; “Transferta korrente të brendshme” në vlerën 2,901 mijë lekë ose në masën 38.7% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 6.8% ndaj vlerës totale të fondeve me burim “të ardhurat e veta”;

▪ **Realizimi faktik i buxheteve sipas periudhave ushtrimore**

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në Aneks B/10 dhe Aneks B/11, rezulton se realizimi i Buxhetit është: për vitin 2023 është 558,570 mijë lekë; për vitin 2024 buxheti faktik është në vlerën e 544,544 mijë lekë ose (-)14,026 mijë lekë më pak se viti 2023; dhe se buxheti i planifikuar i vitit 2024 është 777,865 mijë lekë ose (-)10,173 mijë lekë më pak se ai i vitit 2023; gjithashtu trendi i shpenzimeve ka ardhur në rënie si në planifikim ashtu edhe në realizimin e tyre.

Tabela nr. 14/në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2023	Viti 2024	Diferenca	Trendi i mosrealizimit
1	Shpenzimet e planifikuara	788,038	777,865	-10,173	↘
2	Shpenzimet faktike	558,570	544,544	-14,026	↘
	Diferenca	(-)229,468	(-)233,321		

Burimi: Bashkia Përmet/Punoi: Grupi i auditimit

Nga analiza e informacionit të pasqyruar në Aneks B/11 dhe Aneks B/12, tabelën nr. 11 dhe tabelën nr.12, u konstatua se, ka diferenca të dukshme midis treguesve në hartimin e planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre, kështu nga të ardhurat të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2023 dhe 2024 të ketë mosrealizime, vlera e të cilit vjen me trend në rritje dhe në mënyrë të përmbledhur paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr. 15/në mijë lekë

Emërtimi	2023		2024		Diferenca ndaj faktit (I)	Diferenca ndaj planit (II)	Trendi i mosrealizimit (I)
	Fakt	Plan	Fakt	Fakt			
Shpenzime	558,570	777,865	544,544		-14,026	-10,173	↘
Të Ardhura	67,604	88,201	42,598		-25,006	-45,603	↘

Burimi: Bashkia Përmet/Punoi: Grupi i auditimit

- Nga auditimi rezultoi se: Bashkia Përmet nuk ka patur financime të huaja për vitin 2024;
- Bashkia Përmet nuk ka aplikuar për kredi në vitin 2024;
- Bashkia Përmet nuk ka patur subvencione nga shteti;
- Bashkia Përmet ka patur donacione për vitin 2024.

▪ Një pasqyrim i përmbledhur mbi të ardhurat dhe shpenzimet faktike të 2 viteve të fundit në tabelën e mëposhtme, rezulton se, vlera e të ardhurave ka trend në rënie nga viti në vit, ndërsa vlera e shpenzimeve ka trend në rritje.

Tabela nr. 16/në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2023	Viti 2024	Trendi
1	Të ardhurat faktike	67,604	42,598	
2	Shpenzimet faktike	558,570	544,544	

Burimi: DFB/Bashkia Përmet

Miratimi i buxhetit faktik:

Bashkia Përmet ka miratuar Raportin vjetor të monitorimit dhe realizimit të buxhetit faktik për vitin 2023, në zbatim të Ligjit nr. 139 /2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 44; ndërsa për vitin u mbyllur ushtrimor 2024 është brenda afatit ligjor.

Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak:

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 22 dt.30.07.2018 “Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, rezulton se nga DFB/Bashkia Përmet janë bërë raportimet 4, 8 dhe 12-mujore në MF sipas formateve të miratuara:

- Realizimi i buxhetit për periudhën 4-mujore Janar – prill 2024, VKB nr.40, datë 07.06.2024. Shkresa për MF nr.1435/1prot,datë 25.06.2024.
- Realizimi i buxhetit për periudhën 8-mujore Janar–Gusht 2024, VKB nr.69, datë 25.09.2024. Shkresa për MF nr.2594 prot,datë 07.10.2024.
- Realizimi i buxhetit për periudhën 12-mujore Janar–Dhjetor 2024, VKB nr.16, datë 18.02.2025. Shkresa për MF nr. 639 prot.,datë 05.03.2025.

Rezulton se raportimet janë dërguar në MF në rrugë elektronike nga adresa zyrtare institucionale dhe ajo postare brenda afatit ligjor.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion Raportet e Monitorimit të buxhetit të vitit 2024 janë miratuar në Këshillin Bashkiak dhe janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës:

Me miratimin e buxheteve parashikohen dhe Fondi Rezervë [FR], Fondi i kontigjencës [FK], Fondi i Emergjencës [FE] dhe Mbrojtja civile [MC] (nga AKMC), vlerat e planifikimit dhe përdorimit të tyre pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 17/Në mijë lekë

Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	
Fond Rezervë	1,400	1,397	
Fond Emergjence	2,681	462	
Fond Kontigjence	-	-	
Mbrojtja Civile	4,816	1,744	
Totali	10,642	3,603	Dif. 7,039

Burimi: DFB/Bashkia Përmet

Përdorimi i këtyre fondeve është realizuar me miratimin e Këshillit Bashkiak.

Me VKB nr. 47 datë 20.12.2023 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026” u **konstatua** se, në buxhetin vjetor të vitit 2024 vlera e planifikuar e [FR] është në vlerën totale 1,400 mijë lekë ose në masën 1.8% të vlerës totale të buxhetit fillestar të miratuar, ndërsa për [FK] rezulton të mos jetë planifikuar fond, në kundërshtim me ligjin nr. 9936/2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” ku përcaktohet se këto fonde [FR] dhe [FK] llogariten deri në masën 3% të buxhetit pa transfertat e kushtëzuara.

Fondi i Emergjencës është planifikuar në vlerën 4,847 mijë lekë dhe përfaqëson fondet që bashkia planifikon nga të ardhurat e veta në rastet e fatkeqësive natyrore, të cilat për vitin 2024 nuk janë shpenzuar;

Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile:

Referuar kritereve të përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e këtij fondi, nga ana e tyre, Pushteti Vendor/Bashkitë kanë për detyrim të miratojnë a) strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë; b) vlerësimin vendor të riskut; c) planin vendor të emergjencave civile; ç) planin e zhvillimit urban, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

Nga sa më lart, nga auditimi rezulton se, Bashkia Përmet për vitin 2024 fondin për mbrojtjen civile [FMC&FE] e ka planifikuar në vlerën totale 5,167 mijë lekë nga të cilat: [FMC] në vlerën 4,816 mijë lekë dhe [FE] në vlerën 2,681 mijë lekë, nga i cili janë shpenzuar 1,744 mijë lekë dhe vlera deferenca prej 2,219 mijë lekë është trashëguar për vitin pasardhës 2025. Në total fondet për emergjencat civile për vitin 2024 janë planifikuar në vlerën 7,497 mijë lekë dhe përdorur 2,206 mijë lekë. Në arsyetimin tonë kjo tregon për shpërndarje racionale në përdorimin e tij sipas hallkave të procesit, duke i kushtuar më shumë rëndësi masave paraprake për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore.

Fondi që bashkitë duhet të kenë është në masën 4% të shpenzimeve buxhetore të fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 65/1.

Realizimi i Investimeve:

Planifikimi dhe realizimi i investimeve për vitin 2024 për Bashkinë Përmet, me burim "financimi nga të ardhurat e veta" [AV] dhe "transferta e pakushtëzuara" [TP], pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Tabela nr.18/ në mijë lekë

230-231	2023		2024		
	Fakt	Plan	Fakt	Diferenca ndaj planifikimit	Diferenca ndaj faktit
	90,444	88,969	29,836	(-)59,133	(-)60,608

Burimi: DFB/Bashkia Përmet

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën 18, rezulton se për vitin 2024 realizimi i buxhetit ndaj planifikimit është me (-) 59,133 mijë lekë më pak ose në masën 33.5% dhe se vlera e realizimit të tij në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 është me (-) 60,608 mijë lekë më pak ose kjo vlerë përbën 33% të vlerës së realizimit faktik të vitit 2023;

- Duke iu referuar të dhënave në tabelën nr. 19, një pasqyrim i përmbledhur i të dhënave për zërin “investime”, pasqyrohen si më poshtë vijon:

Tabela nr. 19/në mijë lekë

230-231	Burimet e Financimit	Viti 2024		%
		Plan	Fakt	
		Të ardhurat e veta	88,201	
Transferta specifike/sectoriale	86,650	44,560	51.4	
Transferta e pakushtëzuar	36,497	19,999	54.8	
Transferta e kushtëzuar	85,815	67,326	78.5	
Transferta e huaj	48,960	998	2	
Totali	310,394	142,720	67.8	

Burimi: Bashkia Përmet

Nga informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 19, rezulton se nga të ardhurat e veta zëri “investime” është realizuar në masën 48.3%, nga transferta specifike/sectoriale në masën 51.4%, nga transferta

e pakushtëzuar në masën 54.8%, nga transferta e kushtëzuar në masën 78.5% dhe nga transferta e huaj në masën 2%.

Një informacion i detajuar i investimeve para dhe gjatë vitit 2024 sipas burimeve të financimit, paraqitet në Aneks B14 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga informacioni i pasqyruar në Aneksin B14, rezulton se:

Investime me burim nga buxheti i shtetit/ministri linje janë 5 projekte investimi në vlerën totale 257,588 mijë lekë, nga të cilët deri në 31.12.2024 janë përfunduar 2 në vlerën e paguar 52,871 mijë lekë dhe 3 të tjera janë në proces në vlerën e mbetur prej 109,394 mijë lekë;

Investime me burim nga të ardhurat e veta/bashkia janë 5 projekte në vlerën totale të planifikuara 155,578 mijë lekë, të cilat janë paguar në vlerë të plotë.

- Duke iu referuar të dhënave në tabelën 19, një pasqyrim i përmbledhur i të dhënave për zërin “investime”, pasqyrohen si më poshtë vijon:

Tabela nr. 19/në lekë

230-231	Burimet e Financimit	Viti 2024		%
		Plan	Fakt	
	Të ardhurat e veta	57,629,744	16,156,474	28
	Transferta specifike/sectoriale	3,216,423	-	0
	Transferta e pakushtëzuar	136,083,811	117,043,802	86
	Totali	196,929,978	133,200,276	67.6

Burimi: Bashkia Përmet

Nga informacioni i pasqyruar në tabelën, rezulton se nga të ardhurat e veta zëri “investime” është realizuar në masën 48.3%, nga transferta specifike/sectoriale në masën 51.4%, nga transferta e pakushtëzuar në masën 54.8%, nga transferta e kushtëzuar në masën 78.5% dhe nga transferta e huaj në masën 2%.

Konkluzion: Mosrealizimi i buxhetit në arsyetimin e grupit të auditimit, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin e viteve paraardhëse, pavarësisht faktit që të ardhurat veçanërisht të ardhurat e veta, kanë ardhur në rritje nga viti në vit, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, Ligji nr. 67 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 36, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre në vitet paraardhëse.

-Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Përsa i përket situatës së pandemisë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se Bashkia Përmet gjatë vitit 2024 nuk ka patur fonde të planifikuara dhe rrjedhimisht as të shpenzuara për nevoja specifike të situatës.

2.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si Ministrinë e linjës etj.).

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet duhet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës (progresive). Me fondet e vitit buxhetor ushtrimor apo me fondet e trashëguara, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të pa likuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballduara me fondet e veta, ndërsa për investimet

e financuara nga Ministritë e linjës apo FZHR dhe nga fondet e vet Bashkisë Përmet, është raportuar se në mbyllje të vitit 2024 nuk ka detyrime të prapambetura.

Në PBA 2024-2026 dhe Planin vjetor 2024, Bashkia Përmet nuk ka planifikuar fonde me qëllim mos lënien jashtë buxhetimit të programit “likujdimi i detyrimeve të prapambetura”.

▪ Situata e detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhëse në buxhetet respektive për vitin 2024, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

Tabela nr. 20/Në lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2023	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2024	Total detyrime	Shlyerja gjate vitit 2024	Mbetja në fund të vitit 2024
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministritë e linjës		9,296,664	9,296,664	9,296,664	0
b. Investime nga Bashkia	13,195,555	3,437,752	16,633,307	16,633,307	0
Nëntotali II	13,195,555	12,734,416	25,929,971	25,929,971	0
Të tjera ...	2,200,102		2,200,102	2,200,102	0
Investime	15,395,657	12,734,416	28,130,073	28,130,073	0
Mallra dhe shërbime	2,346,886	248,300	2,595,186	248,300	2,346,886
Vendime gjyqësore	12,376,606	973,792	13,350,398	13,048,310	302,088
Të tjera ...					0
Nëntotali II	14,723,492	1,222,092	15,945,584	13,296,610	2,648,974
Totali	30,119,149	13,956,508	44,075,657	41,426,683	2,648,974

Burimi: DFB/Bashkia Përmet

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelën nr.20, rezulton se:

- Për zërin "investime" viti 2023 është mbyllur me vlerën totale të detyrimit të prapambetur prej 13,195,555 lekë, të cilat në masën 100% janë detyrime për investime nga fondet e Bashkisë; Gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime të reja në vlerën totale 12,734,416 lekë, të cilat janë të ndara 9,296,664 lekë nga investimet e ministrisë së linjës dhe 3,437,752 lekë nga investimet e Bashkisë, duke e çuar vlerën totale të detyrimeve të prapambetura në shumën 25,929,971 lekë; Gjatë vitit 2024 janë shlyer në total 25,929,971 lekë për detyrimet e prapambetura progresive për “investimet” ose në masën 100%;

Me mbylljen e vitit ushtrimor 2024, rezulton se, vlera e mbetur e detyrimeve të prapambetura në total për zërin "investime" është në vlerën 0 lekë.

- Për zërin shpenzime /"mallra e shërbime" (përmbledhëse) viti 2023 është mbyllur me vlerën e detyrimit të prapambetur në total prej 14,723,492 lekë, që përbëhet nga: 2,346,886 lekë për “mallra e shërbime” ose në masën 16% dhe 12,376,606 lekë për “vendime gjyqësore”ose në masën 84%; Gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 1,222,092 lekë, duke e çuar vlerën totale progresive të detyrimit për këtë grup në 15,945,584 lekë;

Tabela nr. 21./ në lekë

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emerimi i detyrimit te prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2023	Vlera e planifikuar për likujdim në planin e buxhetit 2024 për detyrimet e prapambetura	Vlera e paguar gjatë vitit 2024 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2024 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2024)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2024 (situata më 31.12.2024)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetura a më 31.12.2024
1	2	3	4	5	6=3-5	7	8=6+7
I. Detyrime që kanë si burim financimi të ardhurat e veta							
4864100	Detyrime për vendime gjyqësore	12,376,606		13,048,310	302,088	973,792	302,088
4864200	Detyrime për shërbime	2,346,886		248,300	2,346,886	248,300	2,346,886
4864300	Detyrime për mirembajtje						
4864400	Detyrime për investime	15,395,657 (2,200,102+13,195,555)		16,633,307		3,437,752	0
4864400	Detyrime për nga Ministrinë e Linjes (specifiko FZHR etj...)						
4865600	Detyrime për mallra						
4864900	Detyrime të tjera						

	Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta	30,119,149		29,929,917	2,648,974	4,659,844	2,648,974
II. Detyrime te prapambetura nga granti (FZHR etj) (Ministritë e linjës)							
4864400	Detyrime për Investime nga Ministritë e Linjës (Min. e Mbrojtjes)			9,296,664		9,296,664	
4864100	Detyrime për vendime gjyqësore (Min. e Brendshme per punonjes te GJ.Civile) shpërblim lindje						
	Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi Grantin						
Detyrime ne total nga të ardhurat e veta + granti		30,119,149		39,226,581	2,648,974	13,956,508	2,648,974

Burimi: DFB/Bashkia Përmet

Përveç sa u sqarua më lartë, nga informacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezulton gjithashtu se detyrimi prej 2,648,974 lekë nuk është likuiduar për arsyet e mëposhtme:

- Vlera prej 2,346,886 lekë detyrim ndaj FSHU (OSHEE) për të cilin është në proces gjyqësor, sipas kërkesë padisë nr.2545 datë 26.08.2022;

- Detyrimi prej 302,088 lekë i kontabilizuar në favour të B.C t sipas Vendimit nr.3854 datë 28.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është rrëzuar, por ende nuk ka një vendim të formës së prerë nga Gjykata e Apelit Tiranë¹²;

- Gjatë vitit 2024 me anë të VKB nr. 121 datë 18.12.2024 është marrë vendim për shuarjen e detyrimit në vlerën 2,200,102 lekë "Projektim i Qendrës së Qytetit" me palë kreditore "TEC CONSULT", për të cilën nuk ka pasur faturë dhe ky detyrim ishte kontabilizuar gabim.

Informacion i përmbledhur mbi detyrimet nga Vendimet gjyqësore si në tabelat e mëposhtme:

Tabela nr. 22/në lekë

Vendime gjyqësore për të larguarit nga puna							
Numri Kreditorëve	Gjendja e palikujduara 31/12/2023	Vendime gjyqësore të ardhura gjatë vitit 2024		Likuiduar gjatë vitit 2024		Nr. i Kreditorëve	Vlera e mbetur datë 31.12.2024
		Nr i vendimeve	Vlera e vendimit	Nr. Kreditor	Vlera e kreditit		
9	5,396,829	2		10	2,846,150	0	0
Totali	9	5,396,829	2	774,080	10	2,846,150	0

Burimi: DFB/Bashkia Përmet

Tabela nr. 23/në lekë

Vendime gjyqësore për çështje të ndryshme							
Numri Kreitorëve	Gjendja e palikujduara 31/12/2023	Vendime gjyqësore të ardhura gjatë vitit 2024		Likuiduar gjatë vitit 2024		Nr. I Kreditorëve	Vlera e mbetur datë 31.12.2024
		Nr i vendimeve	Vlera e vendimit	Nr. Kreditor	Vlera e kreditit		
3	10,304,536	2		3	10,450,460	1	302,088
Totali	3	10,304,536	2	448,012	3	10,450,460	1

Burimi: DFB/Bashkia Përmet

Konkluzion: Bashkia Përmet ka detyrime të prapambetura në mbyllje të vitit 2023 në vlerën totale progresive prej 30,119,149 lekë, të cilat janë me burim financimi nga fondet e veta ose në masën 100% të vlerës totale progresive të detyrimeve;

Në mbyllje të vitit 2024 detyrimet e prapambetura janë në vlerën totale progresive 2,648,974 lekë, të cilat janë me burim financimi nga fondet e veta ose në masën 100% të vlerës totale progresive të detyrimeve;

Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave edhe në rrugë elektronike.

Raportimi në MF është bërë sipas udhëzimit nr. 2 datë 20.01.2020 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020", pika 106, ku citohet:

“Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara që **jo më vonë se data 10 Prill 2020** për remujorin e parë, **10 Korrik 2020 për tremujorin e dytë**, **10 Tetor 2020 për tremujorin e tretë** dhe **30 Janar 2021 për tremujorin e katërt**, të dërgojnë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë informacionin me shkrim dhe në rrugë elektronike për detyrimet e prapambetura sipas Shtojcës 5, “Raportimi periodik për detyrimet e prapambetura” bashkëlidhur këtij udhëzimi.”¹³

Raportimi në Degën e Thesarit është bërë sipas udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

Konkluzion: Bashkia Përmet ka detyrime të mbartura nga vitit i mbyllur ushtrimor 2024 për tu likuiduar në vitin 2025 në shumën totale 2,648,974 lekë, të ndara si më poshtë vijon:

- Bashkia Përmet nuk ka detyrime të mbartura nga viti 2024 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2025 për “investime” nga ministritë e linjës;

- Nuk ka detyrime të mbartura nga viti 2024 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2025 për “Investime” nga të ardhurat e veta;

- Ka detyrime të mbartura nga viti 2024 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2025 për “mallra e shërbime” në shumën 2,346,886 lekë;

- Ka detyrime për Vendime gjyqësore për dëmshpërblim, në shumën 302,088 lekë.

Programimi i fondeve për faturat e pa likuiduara në fund të periudhave ushtrimore:

Nga auditimi i PBA 2024-2026 plani vjetor 2024, referuar edhe tabelës së programeve buxhetore të planifikuara, rezultoi se nuk është planifikuar veçmas fondi në programin 04960 “planifikim për detyrimet e prapambetura”. Nga auditimi i likuiditeteve dhe informacionit të pasqyruar në tabelën nr.25, rezulton se kanë lindur detyrime të reja gjatë vitit 2024 në shumën 13,956,508 lekë, krahas vlerës së trashëguar nga viti 2023 në shumën totale progresive 30,119,149 lekë për “investime” dhe “mallra e shërbime”. Gjatë vitit 2024 janë paguar 41,426,683 lekë duke e mbyllur vitin 2024 me një vlerë të detyrimit progresiv prej 2,648,974 lekë. Bashkia Përmet ka dërguar rregullisht në MF “Raportet e vetëvlerësimit financiar dhe treguesit fiskal”: me shkresën nr. 1435 prot., datë 31.05.2024 për periudhën janar-prill 2024; me shkresën nr. 2594 prot., datë 07.10.2024 për periudhën janar-gusht 2024 dhe me shkresën nr. 639 prot., datë 05.03.2024 për vitin 2024. Situata e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit ushtrimor 2024 dhe klasifikimi i bashkisë mbi shkallën e vështiorësisë financiare sipas raportit vjetor të monitorimit dorëzuar në MF me nr. 639 prot., datë 05.03.2025, është si në tabelat më poshtë:

Tabela nr. 24/në lekë

Nr.	E M E R T I M I	Vlera për periudhën e raportimit (Fakt progresiv)		Vlera e Buxhetit vjetor (Plan i rishikuar) 2024
		2024	31 Dhjetor	
1	Të ardhurat e Pushtetit Vendor	54,891,000		58,153,000
1	Taksat e veta vendore	12,974,000		16,255,000
a.	Taksa mbi pasurinë	10,899,000		12,645,000
b.	Biznesi i vogel	153,000		0
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	1,331,000		3,200,000
d.	Taksa të tjera vendore	591,000		410,000
2	Të ardhura jotatimore	31,756,000		33,670,000
a.	Tarifat e shërbimeve publike	20,330,000		19,740,000
b.	Tarifa administrative	554,000		619,000
c.	Të tjera jo tatimore	10,872,000		13,311,000
3	Taksa të ndara	10,161,000		8,228,000
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	97,000		250,000
b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	6,283,000		4,637,000
c.	Renta minerare			
d.	Tatim mbi të ardhurat personale	3,781,000		3,341,000
e.	Të tjera			

¹³ Në raportimet e bëra respektohet viti ushtrimor në të cilin realizohen shpenzimet vjetore të planifikuara në PBA

II	Shpenzime te Buxhetit Vendor	380,436,250	520,913,936
I	Shpenzime Korrente	306,040,250	345,294,936
a.	Paga dhe fond i veçantë për paga	197,100,000	209,122,000
b.	Kontributi për Sigurime Shoqërore	32,457,000	34,106,000
d.	Shpenzime Operative	65,832,250	86,531,936
e.	Të tjera korrente	10,651,000	15,535,000
2	Shpenzime Kapitale	74,396,000	175,619,000
3	Burimet e Financimit	380,436,250	520,915,936
a.	Të ardhurat e veta vendore	42,598,132	88,201,347
b.	Transferta e pakushtëzuar	204,617,134	242,328,756
c.	Transferta specifike/transferta e pakushtëzuar sektoriale	133,220,984	190,385,833
d.	Të ardhurat e pa-planifikuara (jashtë limit)		
f.	Financimi i huaj		
g.	Huamarria Vendore Vjetore		

Burimi: Bashkia Përmet.

Ndërsa niveli i vështirësisë financiare i Bashkisë Përmet është në tabelën 25, si më poshtë:

Tabela nr.25/Në lekë

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	2,648,974		0.7
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore	302,088		
4864200	Det.Prap. Sherbime			
4864201	D.P.EneriElektirke	2,346,886		
4864300	Det.Prap.Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime			
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronësime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	Totali (I+II)	2,648,974	380,436,250	0.7

Ndërsa për ministrinë e linjës vlera e detyrimit të prapambetur, e raportuar në Raportin e monitorimit në MF nga bashkia Përmet është në tabelën 26, si më poshtë vijon:

Tabela nr. 26/Në lekë

Detyrime Pushteti qendror	Llogaria ekonomike	Vlera
Ministri linje 06	4864400	-
Ministri linje 16	4864903	-
Ministri linje 11	4864400	-
Totali		0

Tabela nr. 27

Rasti i vështirësisë ku ndodhet njësia e vetëqeverisjes vendore 2024				
Situata	Probleme financiare	Vështirësi financiare	Vështirësi serioze financiare	Paaftësi paguese
Normale e gjendjes fiannciare	Stoku detyrimeve/Shpenzime > 15%	Stoku detyrimeve/Shpenzime > 25%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 80%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 130%
0.7% normale				

Nga informacioni i pasqyruar në tabelën 27 dhe i raportuar në MFE, rezulton se Bashkia Përmet paraqet një situatë normale të vështirësisë financiare.

Nr.	Bashkia Permet	Detyrimi i mbetur deri në dhjetor 2024	Shuma e parashikuar për shlyerje përgjatë tre viteve			Tabela nr. 28	
			Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Diferencë (Fakt-Plan)	Shënime
	Bashkia Permet	2,648,974	2,648,974	0	0	0	

Nga dokumentet e pagesave të bankës u kërkuar dhe u verifikuan disa Urdhër Shpenzime. Nga auditimi rezultoi se dokumentacioni justifikues bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit, ishte i plotë. Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave, të cilat referuar edhe të dhënave të MF, rubrika “Detyrimet e prapambetura”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura, janë paraqitur në Tabelat 20/21/22 23; Në mënyrë të detajuar paraqiten në Aneks B 15 në kapitullin Aneks.

2.6. Burimi i krijimit i të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave . Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dizpozitat ligjore në fuqi si dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Në zbatim të pikës II.2.6 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.75 datë 30.10.2023 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024”;
- Vendimi nr. 61 datë 16.01.2024 me nr. 151 prot., datë 16.01.2024 “Për miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Përmet” i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 97.prot., datë 18.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm PBA 2024-2026” dhe buxhetin e vitit 2024.
- Konfirmimet për përputhshmëri ligjore nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë;
- Dokumentacioni i Sektorit të taksave dhe tarifave vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga Programi Excel i mbajtjes së sistemit të taksave;
- Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, për taksat dhe tarifatat vendore;
- Pasqyrat financiare për vitin 2024.
- Miratimet e buxheteve në lidhje me planifikimin e të ardhurave për vitin 2024;
- Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimin faktik të të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacioni në lidhje me agjentët tatimorë, rakordimet me ta, me thesarin, etj.;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Sektori i të Ardhurave Vendore/tatim-taksave.
- Struktura/t organizative e miratuar gjatë periudhës 01.01.2024-31.12.2024;
- Rregullore e brendshme institucionale e miratuar;

Bashkia Përmet - Viti 2024						
Qarku	Qendra e Bashkisë	Nr	NJAdministrative	Fshatrat Nr.	Nr. Banorë	Klasifikimi taksapagues
Gjirokastrë	Përmet	1	Përmet	-	20301	418 BV
		2	Çarçovë	9		58 BM
		3	Frashër	8		21 Insituc
		4	Petran	15		6102 Familje
		5	Qendër Piskovë	17		
Totali		5		49		6599

Punoi: Grupi i auditimit

2.6/1 Burimi i Krijimit të të Ardhurave

Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me Vendimin nr. 61 datë 16.01.2024 me nr. 151 prot., datë 16.01.2024 “Për miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Përmet” i ndryshuar. Me VKB nr. 75 datë 30.10.2023 është miratuar Paketa Fiskale 2024 dhe konfirmuar për përputhshmëri ligjore nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me nr. 931/1 prot., datë 13.11.2023 dhe nr. 2962/1 prot.(i bashkisë), datë 13.11.2023, konform përcaktimeve në kuadrin ligjor.

Si njësi përbërëse e strukturës organizative të Bashkisë Përmet është edhe struktura e të Ardhurave Vendore e organizuar në nivel Drejtorie/DFBTT/Spektori i Tatim Taksave, i cili është konfiguruar si në tabelën e mëposhtme (tabela 1). Ky sektor në aktivitetin e tij për arkëtimin e disa prej llojeve të të ardhurave, bashkëpunon edhe me sektorë të tjerë pranë bashkisë, si: Drejtoria e Planifikimit Territorit dhe Urbanistikës [DPTU], MZSH, Policia Bashkiake [PB], Spektori i Aseteve [SA] etj, ku roli i këtyre sektorëve është hartimi i autorizimit për arkëtim, ndërsa roli i sektorit të taksave dhe tarifave vendore është hartimi i faturës për arkëtim dhe gjobat e vendosura, dokument i cili i shërben taksapaguesve për kryerjen e pagesës, duke vijuar me ndjekjen e arkëtimit/marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e pagesave/detyrimeve të krijuara.

Tabela nr. 1

Spektori i Tatim Taksa Vendore – viti 2024					
Nr.	Emër Mbiemer	Pozicioni në strukturë	Profili Arsikor	Niveli	Periudha në pozicionin e punës
1	D.M	Përgjegjës	Administrim biznesi	Lartë	21.09.2022 e në vijim
2	R.K	Spec. Tatim-taksa	Administrim public	-/-	01.12.2021 e në vijim
3	O.H	-/-	Financë-kontabilitet	-/-	20.10.2022 e në vijim
4	P.DH	-/-	Financë-kontabilitet	-/-	06.03.2024 e në vijim
5	A.S	-/- NJA Piskovë	Mësuesi	-/-	01.11.2019 e në vijim
6	J.L	-/-	Mësuesi	-/-	17.05.2022 e në vijim
7	M.S	-/- NJA Petran	Agronomi e përgjithshme	-/-	01.05.2007 e në vijim
8	S.G	-/-	Mësuesi	-/-	01.05.2022 e në vijim
9	J.M	-/- NJA Çarshovë	Mësuesi	-/-	01.11.2021 e në vijim
10	F.K	-/-	Veterinari	-/-	01.02.2009 e në vijim
11	A.Z	-/- NJA Frashër	I përgjithshëm	I mesëm	27.02.2020 e në vijim

Burimi: Bashkia Përmet/Punoi: Grupi i auditimit

- Spektori i Tatimeve dhe Taksave Vendore/ Bashkia Përmet, për vitin 2024 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore.

Veç Spektorit të tatimeve dhe taksave vendore, në Bashkinë Përmet janë të angazhuara edhe struktura të tjera për faturimin dhe/ose mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, të mituara me VKB e Paketës Fiskale 2024, sipas specifikave si më poshtë vijon:

Tabela nr. 2

Struktura	Lloji i të ardhurës
	Taksa e pronës
Spektori i Tatimeve dhe Taksave Vendore dhe tregje/Asetet	Taksat dhe tarifave vendore për biznesin dhe familjarët
Drejtoria e Urbanistikës	Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale
	Taksën e ndikimit në infrastrukturë për leje ndërtimi
	Certifikatë përdorimi etj
Spektori i Bujqësisë,	Qira e tokës Bujqësore
	Taksa nga Toka bujqësore
Specialist i IMTV	Gjoha për ndërtime pa leje etj
MZSH	Tarifa sherbimesh
Policia Bashkiake	Gjoha kundërvajtjeje

Burimi: Bashkia Përmet/ Punoi: Grupi i auditimit

Në fillim të çdo viti Sektori i Tatim Taksave bën raportimin vjetor mbi analizën e të ardhurave vjetore të bashkisë, i cili është pjesë e Raportit vjetor të Monitorimit dhe e Raportit të buxhetit që prezantohet në Këshillin Bashkiak.

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në Aneks TA/1 rezulton se:

- Bashkia Përmet në paketën fiskale 2024 me VKB ka miratuar 8 gruptaksash dhe 12 gruptarifash; 28 lloje Gjobash dhe 4 lloje TA jotatimore;

- Afati fundor i pagesës së taksave dhe tarifave të vitit ushtrimor për biznesin dhe për familjarët nuk është e përcaktuar në paketën fiskale të vitit 2024 të miratuar¹⁴.

- STTV Bashkia Përmet informacionin tatimor e përpunon në paketën *Microsoft Office 2013* - programi *Excel*. Mungesa e një sistemi IT bashkëkohor vetëm për të ardhurat vendore, sjellë vështirësi në administrimin e informacionit tatimor nga ana e STTV, për të gjitha subjektet tatimpaguese të biznesit të vogël edhe të biznesit të madh, klasifikimi sipas kategorisë së detyrimit, interesat, rregjistrimin e gjobave dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit.

- Rezulton se nga ana e STTV çdo fillim viti me Urdhër të Kryetarit bëhen verifikime në terren, lidhur me veprimtarinë e subjekteve që ushtrojnë biznes mbi hapësirën e lejuar publike, tabelën apo reklamën për të cilat paguan edhe tarifë të detyrueshme vjetore, shpërndan fletë njoftimet mbi detyrimet etj.,

Për vitin 2024 me Urdhrin nr. 451 datë 29.12.2023 dhe Urdhrin nr. 3479 prot., date 29.12.2023 është ngritur komisioni “Për evidentimin dhe verifikimin e bizneseve” i përbërë nga 2 grupe pune si më poshtë vijon:

Nr	Grupi I		Grupi II	
	Emër Mbiemër	Pozicioni	Emër Mbiemër	Pozicioni në strukturë
1	D.M	Përgjegjës STT	R.K	Specialist tatim -taksa
2	Xh.S	Polic bashkiak	Shkëlqim Dyrmishi	Polic bashkiak
3	V.C	Polic bashkiak	Majlinda Kote	Polic bashkiak

Burimi: Bashkia Përmet.

- Me Urdhër të Kryetarit nr. 415 datë 13.11.2024 dhe me nr. 3016 prot., date 13.11.2024 është ngritur komisioni “Për verifikimin e pasurive të paluajtshme , të llojit “ndërtesë” dhe “truall”, me përbërje sin ë tabelën e mëposhtme:

Nr	Emër Mbiemër	Statusi	Pozicioni në strukturë
1	A.B	Kryetar	Specialist topograf deri në shtator 2024 Specialist asetesh nga tetori 2024 e në vijim
2	R.K	anëtar	Specialist tatim -taksa
3	Dh.P	anëtar	Specialist asetesh

Burimi: Bashkia Përmet.

Për rastet e konstatimit të ndryshimeve mbahet akt konstatime/verifikime dhe përditëson dokumentacionin e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore, rillogarit vlerën e tarifës/taksës së re dhe klasifikimin në nivel tjetër detyrimesh. Kjo praktikë realizohet nga STTV. Për vitin 2024 nuk ka raste rivlerësimi tatimor.

2.6/2 Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

“Paketa fiskale 2024” është miratuar me VKB nr. 75 datë 30.10.2023 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me nr. 931/1 prot., datë 13.11.2023 dhe me nr. 2962/1 prot., (bashkisë) datë 13.11.2023, konform kuadrit ligjor në fuqi. Nga të dhënat e pasqyrës përmbledhëse Aneks TA/2, rezulton se për vitin 2023 të ardhurat nga taksat dhe tarifat (pa përfshirë grantin e qeverisë dhe sponsorizimet) janë realizuar në vlerën 62,590 mijë lekë ose në masën 86.6%; për vitin 2024 janë

¹⁴ E konstatuar edhe nga grupi i mëparshëm i auditimit, për të cilin është lënë dhe rekomandim

realizuar në vlerën 55,503 mijë lekë ose në masën 95.5%. Konstatohet se, nga viti 2023 në vitin 2024 ka patur një rënie të të ardhurave prej (-) 7,087 mijë lekë ose me 11.3%, ku me përjashtim të të ardhurave personale [TAP] që kanë rritje me 523 mijë lekë, kategoritë e tjera kanë ardhur me rënie: të ardhurat nga “taksat vendore” me (-)2,474 mijë lekë; të ardhurat nga “tarifat vendore” me (-) 517 mijë lekë.

- Nga analiza e të dhënave e cila pasqyrohet Aneks TA/2, në kapitullin Aneks rezulton se:
- Për vitin 2024, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 58,153 mijë lekë ose 14,164 mijë lekë më pak se të vitit 2023 dhe janë realizuar në vlerën 55,503 mijë lekë ose 7,087 mijë lekë më pak se viti 2023 dhe 2,650 mijë lekë më pak se planifikimi i tyre në vitin 2024; Realizimi i të ardhurave total për vitin 2023 është në masën 97.3%; ndërsa për vitin 2024 është në masën 99.6%;

-Analizë e planifikimit të të ardhurave dhe e realizimit të tyre për vitin 2024

Nga informacioni i pasqyruar në tabelë, vërehet se, në disa lloje taksash/tarifash ka realizim më shumë se planifikimi, për arsye se gjatë vitit janë arkëtuar edhe detyrime për taksa/tarifa të prapambetura, si edhe në raste të caktuara për disa lloje taksash/tarifash nuk është planifikuar vlerë për t'u arkëtuar, megjithëse gjatë vitit kanë ndodhur arkëtime.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelën përmbledhëse rezulton si mëposhtë vijon:

- TNI për vitin 2024 është parashikuar në vlerën 3200 mijë lekë dhe është realizuar 1331 mijë lekë ose 42% e vlerës së planifikimit, me (-) 1862 mijë lekë më pak se në vitin 2023 ose prej (-) 58%;
- Taksë e ndërtesës është parashikuar në shumën 9,880 mijë lekë dhe është vjelë 7,418 mijë lekë ose në masën 75% të saj, por vlera e saj ka ardhur në rënie prej (-) 1,833 mijë lekë më pak se në vitin 2023 ose me (-)19%;
- Taksa e tokës bujqësore është parashikuar në vlerën 1,825 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 1,980 mijë lekë ose në masën 108%, krahasuar me vitin 2023 ka një rritje prej 16 mijë lekë ose me 0.1%;
- Taksë trualli është parashikuar në vlerën 940 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 1501 mijë lekë ose në masën 160 %, me një rritje të ardhurash prej 388 mijë lekë nga viti 2023 ose prej 31%;
- Taksë tabele është parashikuar në vlerën 300 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 301 mijë lekë ose në masën 100%, krahasuar me vitin 2023 rezulton në rënie në vlerën prej (-)79 mijë lekë ose (-) 28%;
- Taksë e mjeteve në qarkullim është parashikuar në vlerën 4637 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 6282 mijë lekë ose në masën 135%, krahasuar me vitin 2023 është rritur me 634 mijë lekë më shumë ose me 10.1%;
- Taksë fjetje në hotel për vitin 2024 është planifikuar 110 mijë lekë dhe është vjelë 289 mijë lekë, krahasuar me vitin 2023 është rritur me 181 mijë lekë më shumë ose me 62.6%;
- Taksë e kalimit të pronësisë për vitin 2024 është planifikuar 250 mijë lekë dhe është vjelë 415 mijë lekë ose në masën 166%, krahasuar me vitin 2023 ka një rritje prej 214 mijë lekë ose 51%;
- Të ardhura nga tarifa e pastrimit për vitin 2023 janë planifikuar 13,220 mijë lekë dhe janë realizuar 14,284 mijë lekë ose në masën 108%, krahasuar me vitin 2023 ka në rënie të realizimit të të ardhurave prej (-) 519 mijë lekë ose me (-)3.5%;
- Tarifë për hapësirat publike për vitin 2024 është planifikuar 850 mijë lekë dhe realizuar 1,178 mijë lekë ose në masën 139%, krahasuar me vitin 2023 ka rritje prej 620 mijë lekë ose 52.6%;

- Tarifë leje transporti dhe autorizime për vitin 2024 është planifikuar 1,800 mijë lekë dhe realizuar 1,094 mijë lekë ose në masën 61%, krahasuar me vitin 2023 është rritur prej 839 mijë lekë ose 76.6%;
- Tarifë mirëmbajtje kanale vaditës për vitin 2024 është planifikuar 370 mijë lekë dhe realizuar 252 mijë lekë ose në masën 68%, krahasuar me vitin 2023 është rritur me 120 mijë lekë ose me 47.6%;
- Tarifë urbanistike për vitin 2024 është planifikuar 1,000 mijë lekë dhe është realizuar 1,112 mijë lekë ose në masën 111%, krahasuar me vitin 2023 ka ardhur në rënie prej (-) 909 mijë lekë ose me (-)44.9%;
- Të ardhura nga tarifa e ndriçimit janë planifikuar 4,550 mijë lekë dhe janë realizuar 4,037 mijë lekë ose 89%, krahasuar me vitin 2023 ka një rënie prej (-) 322 mijë lekë ose me (-) 7.4%;
- Tarifë e gjelbërimit për vitin 2024 është planifikuar 1,970 mijë lekë dhe realizuar 1,955 mijë lekë ose në masën 99%, krahasuar me vitin 2023 ka rënie me (-)155 mijë lekë ose me (-) 6%;
- Tarifë për lëndët drusore për vitin 2024 është planifikuar 810 mijë lekë dhe realizuar 589 mijë lekë ose në masën 73%, krahasuar me vitin 2023 ka rënie me (-) 23 mijë lekë ose (-) 3.8%;
- Tarifë kullotë bagëti për vitin 2024 është planifikuar 1,230 mijë lekë dhe realizuar 1130 mijë lekë ose në masën 92%, krahasuar me vitin 2023 ka rënie me (-) 148 mijë lekë ose (-) 11.6%;
- Tarifë shërbimesh MZSH është planifikuar 250 mijë lekë dhe realizuar 45 mijë lekë ose në masën 18%, krahasuar me vitin 2023 ka rënie prej (-) 57 mijë lekë ose me (-)55.9%;
- Të ardhura nga qira për troje janë planifikuar 5,370 mijë lekë dhe janë realizuar 2,818 mijë lekë ose në masën 52%, krahasuar me vitin 2023 ka një rënie të ardhurave prej (-)3,209 mijë lekë ose me (-)53.2%;
- Të ardhura nga pagesat kopshte & çerdhe janë planifikuar 1,500 mijë lekë dhe realizuar 1830 mijë lekë ose në masën 122%, krahasuar me vitin 2023 ka rënë me (-) 510 mijë lekë ose me (-) 21.8%;
- Të ardhura nga sponsora, dhurata& garanci janë realizuar 1,767 mijë lekë ose 1,000 mijë lekë më shumë se viti 2023 ose rritur me 56.6%;
- Të ardhura të tjera për vitin 2024 janë planifikuar 500 mijë lekë dhe realizuar 299 mijë lekë ose në masën 80%, krahasuar me vitin 2023 ka rënie me (-) 900 mijë lekë ose me 69.3%;
- Tarifë parkimi për vitin 2024 është planifikuar 250 mijë lekë dhe realizuar 60 mijë lekë ose 24%, krahasuar me vitin 2023 ka rritje me 7 mijë lekë ose me 11.7%.

Mungesa e një analize të mirëfilltë për të ardhurat e mosrealizuara në vitin 2023, ka sjellë mungesën e planifikimit të tyre ose planifikimin në vlera jo reale të pastuduara mbi të ardhurat e realizuara ndaj pritshmërisë për vitin pasardhës (objekt auditimi) 2024.

- Gjithashtu, nga auditimi rezulton se, procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore realizohet jo vetëm në analizën e të dhënave dhe trendi i realizimit të të ardhurave nga vitet paraardhëse, por edhe nga kërkesat që STTV dhe SFB iu ka përcjellë për informacion njësisive të strukturës së Bashkisë që sigurojnë të ardhura, për të grumbulluar një informacion sipas, realizimit të të ardhurave të 2 viteve të fundit për hartimin e paketës fiskale për vitin 2023.

Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstatoi që, metodologjia e përdorur nga Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë. Veprime këto në kundërshtim me Rregulloren e brendshme të miratuar me Vendimin nr. 103/1 datë 11.03.2024, neni 25- "*detyrat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit të*

sektorit të tatimeve, tregje dhe asetëve” dhe “detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të tatime, tregje e asetëve”.

➤ **Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:**

Konstatohet se në Rregulloren e brendshme të institucionit të miratuar, në strukturën e STTV apo në atë të SF, nuk është caktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me agjentët tatimorë, si dhe krijimin e një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët.

1. Për Taksa vjetore e mjeteve të përdorura, mblidhet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor/DRSHTRR Përmet”, për llogari të Bashkisë Përmet. Akt rakordimi me DPSHTRR realizohet vetëm nëpërmjet Degës së Thesarit Përmet, referuar dhe në zbatim të ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “*Për taksat kombëtare*”, të ndryshuar dhe në mbështetje të gjurmës “b”, të pikës 2, në nenin 25 “*Të ardhurat nga taksat e ndara*” të ligjit nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njërive përkatëse i kalojnë 25% e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura.

2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, mblidhet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria Rajonale e Tatimeve (DRT) Korçë”. Në zbatim të ligjit nr. 181 datë 28.12.2016 “*Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”*” i ndryshuar dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32 datë 31.12.2013 “*Për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël*” Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore ku biznesi i tatueshëm është i vendosur, Administrata Tatimore Qendrore, brenda datës 10 të muajit pasardhës, bën transferimin e të ardhurave nga ky tatim. Në Bashkinë Përmet rakordimet bëhen nga Sektori i Financës dhe buxhetit. Me ndryshimet në kuadrin ligjor Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin nuk vilet, shfuqizuar me Ligjin nr. 29/2023, datë 30.03.2023.

3. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mblidhet nga Agjenti Tatimor “Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” (ZVRPP) tani ASHK Vendore. ASHK Vendore ka patur bashkëpunim me STTV/Bashkinë Përmet, për dërgim informacioni mbi numrin e kalimeve të pronësisë, vlerën totale të tyre me qëllim rakordimin e vlerës së derdhur nëpërmjet Degës së Thesarit Përmet me vlerën e përlllogaritur. Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” të ndryshuar, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme tani ASHK Rajonale, janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë si komision 3% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë jo me vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria.

Nga auditimi rezulton se deri në 31.12.2024 rakordimet me DPSHTRR dhe ASHK Vendore, nuk janë kryer sipas formateve të miratuara nga MFE. në pajtueshmëri me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, Neni 117, UMF Nr. 26, datë 04.09.2008 “*Për Taksat Kombëtare*”, i ndryshuar, Formularët e akt-rakordimeve.

4. Grupi i auditimit verifikoi në Regjistrin e lejeve minerare aktive të AKBN-së (Agjencia Kombëtare e Burimeve Nayrore) dhe rezultoi se janë dhënë leje shfrytëzimi minerar në territorin e Bashkisë Përmet si më poshtë vijon:

Tabela nr. 3

Lejet Minerare aktive – Bashkia Përmet								
Nr. rregj istrin	Nr. leje	Data QKR	Emri Subjektit	Nipt-i		Vendburimi	Lloji i minerarit	Sip /km ²
174	1127/I	08.01.2008	C.F.F. shpk	K.....I	Objekti Lipe		Ranor pllakor	0.3060
269	1470/I	20.05.2010	R.	J.....E	Prane fshatit Lipa, komuna Petran		Gëlqeror pllakor	0.0150
280	1491/I	18.08.2010	F	K.....M	Dhembel, Kelcyre, Permet (prane ish fabrikes se rrushit)		Gëlqeror pllakor	0.0705
335	1607	18.01.2013	K	J.....I	Perroi i Shen Gjonit, Mbrezhdan, Permet		Ranor silicor	0.0096
379	1710	30.05.2014	F	K.....M	Objekti Argova		Ranor Silicor	0.1000

Burimi: Bashkia Përmet.

Nga auditimi *rezulton* se:

- Në territorin e Bashkisë Përmet janë dhënë tre leje minerare¹⁵, të cilat janë aktive;
- Nga Bashkia Përmet rezulton se, nuk bëhen rakordimet mujore për vjeljen e rentës minerare me DPD dhe DPT, por informacioni mbi arkëtimet e saj merret nëpërmjet Degës së Thesarit.

Për vitin 2024 nuk ka të ardhura nga renta minerare.

Nga ana e Bashkisë Përmet janë dërguar shkresa me objekt "kërkesë për informacion" konkretisht: me shkresën nr. 2066 prot., datë 14.08.2024 dërguar DRT Gjirokastrë dhe DRD Tre Urat Përmet, me qëllim rakordimin mes institucioneve referuar kuadrin ligjor në fuqi, për vjeljen e rentës minerare. Deri më tani nga institucionet nuk ka asnjë përgjigje.

Lidhur me këtë problematikë nuk është vënë në dijeni MIE.

5. Për vjeljen e detyrimeve të familjarëve (taksa e ndërtesës, ndriçim, gjelbërim, pastrim) *rezulton se*, Bashkia Përmet ka lidhur marrëveshje me UK-sha për të luajtur rolin e agentit tatimor, në zbatim të ligjit nr. 9632/2006 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar.

➤ Detyrimet e familjarëve

- Njoftimet e bëra për familjarët, masat e marra dhe masat shtrënguese

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën e Sektorit të Taksave dhe Tarifave dhe Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifave vendore për abonentët familjarë.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë, në lidhje me taksat dhe tarifave vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj, por edhe në stendat e bashkisë apo Njësitë Administrative.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë në rrugë zyrtare me anë të shërbimit postar, por edhe dorazi nëpërmjet punonjësve të terrenit, me qëllim njoftimin e taksapaguesve për të paguar në kohë detyrimin. Për vjeljen e detyrimeve të familjarëve (taksa e ndërtesës, ndriçim, pastrim) Bashkia Përmet ka lidhur marrëveshje me UK sha për të luajtur rolin e agentit tatimor. Përjashtim bën vetëm NJA Frashër që nuk ka ujësjellës dhe vjelja e taksave bëhet nga inspektorëi i taksave.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, në çdo rast kërkohet vërtetimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër kjo nuk është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga komuniteti, pasi janë bërë njoftimet në bankat e nivelit të dytë.

15 Subjekti "FLO-TO-NE" i përket Bashkisë Këlcyrë me ndarjen e re territoriale

- Pasqyra e *familjeve të regjistruara si tatimpagues* në territorin e Bashkisë Përmet për vitin 2024 dhe detyrimi vjetor, pasqyrohet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 4

Nr	Bashkia Permet	Nr Familje	Vlera
1	Qyteti Përmet	2,815	10,360,741
2	NJA Petran	1,373	2,714,542
3	NJA Frasher	66	163,598
4	NJA Çarshove	1,155	2,805,198
5	NJA Piskove	1,719	2,943,894
	Totali	7,128	18,987,973

Burimi: STTV/Bashkia Përmet

- Situata e *debitorëve familjarë për vitin 2024*, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 5

Nr	Bashkia Permet	Nr Familje	Vlera
1	Qyteti Përmet	356	635,318
2	NJA Petran	805	1,389,714
3	NJA Frasher	30	87,799
4	NJA Çarshove	265	735,697
5	NJA Piskove	419	1,255,892
	Totali	1875	4,104,420

Burimi: STTV/Bashkia Përmet

Meqënëse taksat dhe tarifat vendore vilen nga UK Sha, për shkak të mënyrën së mbledhjes së tyre në grup, deri më tani nga ana e UK sha dhe specialistëve të taksave akt rakordimi mujor bëhet po në grup dhe jo i klasifikuar sipas llojit të taksës që paguhet nga abonentët në sportelet e UK sha. Nga analiza e informacionit të pasqyruar në tabelën nr.4 dhe në tabelën , rezulton se:

- numrin më të lartë të abonentëve e ka qyteti Përmet me 2815 taksapagues në vlerën vjetore të detyrimit 10,360,741 lekë dhe numrin më të vogël të taksapaguesve e ka NJA Frasher me 66 në vlerën vjetore të detyrimit 163,598;

- Numrin më të lartë të debitorëve e ka NJA Petran me 805 në vlerën e debisë 1,389,714 lekë dhe numrin më të vogël të debitorëve e ka NJA Frashër me 30 në vlerën e debisë 87,799 lekë.

Vlera totale prej 4,104,420 lekë e 1875 debitorëve familjarë, nuk është kontabilizuar.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar.

-Taksa e tokës bujqësore

Bashkia Përmet ka tokë bujqësore të ndarë me Ligjin 7503 /1991 datë 19.07.1991 “Për tokën” i ndryshuar, sipas regjistrave kadastralë të së cilës rezulton si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.6/Në lekë

Nr.	Njësitë Administrative	Nr. Familjeve	Vlera vjetore taksës për token bujqësore
1	Frasher	97	131,000
2	Petran	1,604	1,327,000
3	Piskove	763	1,141,000
4	Çarshove	762	1,002,000
	Totali	3,226	3,601,000

Burimi: Bashkia Përmet.

Nga informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 6 rezulton se numrin më të lartë të familjeve me tokë bujqësore e ka NJA Petran me 1604 familje dhe vlerën totale vjetore të taksës 1,327,000 dhe numrin më ulët e ka NJA Frasher me 97 familje dhe vlerën totale vjetore të taksës 131,000 lekë.

Më poshtë janë paraqitur të përmbledhura vlera debitoare e biznesit, familjarëve dhe institucioneve për taksat dhe tarifatat vendore si më poshtë vijon:

Tabela nr. 7/në lekë

Përshkrimi	Nr	Vlera e borxhit progresive deri më 31.12.2023	Arkëtuar nga detyrimi prapambet 2023	Borxhi i krijuar gjatë vitit 2024	Vlera e borxhit progresive deri më 31.12.2024
Debitorë biznes i madh	12	3,976,683	110,838	1,054,962	4,920,807
Debitorë biznes i vogël	121	17,534,367	673,489	2,900,733	19,761,611
Nëntotali I	133	21,511,050	784,327	3,955,695	24,682,418
Institucione	6	921,000	0	598,500	1,519,500
Nëntotali II	6	921,000	0	598,500	1,519,500
Debitorë taksa e ndërtesës familje	4876	5,492,937	0	475,546	5,968,483
Debitorët taksat familje (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim.)		6,108,717	0	1,949,280	8,057,997
Debitorët taksa e tokës bujqësore	2971	12,038,566	397,844	1,679,594	13,320,316
Debitorët taksa e ndikimit në infrast.	27	1,480,494	48,174		1,432,320
Debitorët nga qiratë		1,952,963	0	1,317,627	3,270,590
Debitorë nga hidrokarburet		1,600,000	0	0	1,600,000
Nëntotali III		28,673,677	446,018	5,422,047	33,649,706
Total Borxhi tatimor (I+II+III)		51,105,727	1,230,345	9,976,242	59,851,624

Burimi: STTV/Bashkia Përmet

Nga Informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 7, rezulton se:

- Vlera progresive e debisë për kategorinë “biznes” deri në 31.12.2024 është 24,682,418 lekë ose 3,171,368 lekë më shumë se në 31.12.2023;
- Vlera progressive e debisë për “kategorinë institucione” deri në 31.12.2024 është 1,519,500 lekë ose 598,500 lekë më shumë se në 31.12.2023;
- lera progresive e borxhit tatimor deri në 31.12.2024 për kategorinë “familjare” është 32,049,706 lekë ose 4,976,029 lekë më shumë se në datën 31.12.2023”;
- vlera progresive e detyrimit për subjektet që tregëtojnë “hidrokarbure” deri në 31.12.2024 është 1,600,000 lekë e njëjtë me vlerën e 31.12.2023;
- vlera progresive e detyrimit nga kontratat e qirave deri në 31.12.2024 është 3,270,590 lekë ose 1,317,627 lekë më shumë se në 31.12.2023;

➤ Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:

- Situata mbi numrin e bizneseve të vogla e të mëdha, regjistruar për herë të parë, çregjistruar apo pezulluar (për bizneset me aktivitet sezonal) për vitin 2024 në Bashkinë Përmet, është si mëposhtë:

Tabela nr.8

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja në fund të vitit
1	Biznesi i Madh	2024	70	1	3	68
2	Biznesi i Vogël	2024	366	78	26	418
3	Institucione	2024	23			23
(1+2)	Gjithsej	2024	436	79	29	486

Burimi: SSTV/Bashkia Përmet

- Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelën nr. 8, rezulton se Bashkia Përmet e ka mbyllur vitin 2023 me **436** biznese aktive në total, prej të cilëve: 70 BM, 366 BV dhe 23 Institucione;
- Janë **79** regjistrime të reja, nga të cilat **1** regjistrim i ri klasifikuar si BM dhe **78** klasifikuar si BV;
- Kanë mbyllur aktivitetin **29** subjekte, nga të i cilat **3** janë BM dhe **26** janë BV;
- Bashkia Përmet në fund të vitit 2024 ka në total **486** biznese aktive ose 50 biznese më shumë se në mbyllje të vitit 2023.

Pra rezulton se numri total i subjekteve që ushtrojnë aktivitet privat, paraqitet me rritje nga viti 2023 në vitin 2024 me një numër prej 50 biznesesh.

- Subjekte fizike që kanë mbyllur aktivitetin dhe janë debitorë deri në mbyllje të vitit 2024 në Bashkinë Përmet janë si më poshtë vijon:

Tabela nr. 9/Në lekë

Nr	Subjekti	Statusi	Data	Afati	Detyrimet	Penaliteti
1	I.H	Pezulluar	14.06.2024	Pa afat	NUK KA	NUK KA
2	AC	-//-	25.01.2024	-//-	-/--	
3	EJ	-//-	17.01.2024	-//-	-/--	
4	AK	-//-	30.01.2024	-//-	-//-	
5	NSH	-//	30.01.2024	-//-	-//-	
6	I.TH	-//-	16.05.2024	-//-	46,850	7,168
7	ES	-//-	06.12.2024	-//-	-//-	
8	EK	-//-	04.12.2024	-//-	-*//-	
1	AM	Çregjistruar	10.01.2024	-		
2	AS	-//-	12.02.2024	-		
3	AB	-//-	19.11.2024	-		
4	ZHL	-//-	13.11.2024	-		
5	KDH	-//-	14.10.2024	-		
6	AP	-//-	27.08.2024	-		
7	YM	-//-	23.07.2024	-		
8	GL	-//-	09.07.2024	-	50,904	7,789
9	FK	-//-	22.05.2024	-		
10	E.TH.	-//	27.03.2024	-		
11	EM	-//-	27.02.2024	-		
12	KP	-//-	31.01.2024	-		
13	AH	-//-	29.01.2024	-		
14	FK	-//-	24.01.2024	-		

Burimi: STTV/Bashkia Përmet

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 9, rezulton se, kanë mbyllur aktivitetin me pezullim pa afat 8 subjekte dhe janë çregjistruar 14 subjekte, nga të cilët konstatohet se, kanë përfunduar procedurën në QKB pa marrë konfirmim nga Bashkia Përmet mbi detyrime 2 subjekte: Irma Thomollari me “pezullim” për vlerën e debisë 54,018 lekë dhe G.L me “çregjistrim” për vlerën e debisë 1315/1 prot., date 58,693 lekë.

- Për subjektin “G. L” procedura e çregjistrimit është kryer 3 muaj më vonë nga marrja e njoftimit mbi detyrimet e papaguara ndaj Bashkisë Përmet;

- për subjektin “I. Th” nga QKB shkresa për konfirmim është nisur 1 ditë më vonë nga mbyllja e procedurës dhe në Bashkinë Përmet ka mbërritur pas 5 ditësh;

Bashkia Përmet nga ana e vet ka dërguar shkresat nr. 1318/1 prot., date 22.05.2024 dhe nr. 1792/1 prot., date 17.07.2024 në QKB dhe personave debitorë, ku ka shprehur kundërshti të dokumentuar ndaj procedurave të ndjekura nga QKB, në kundërshtim me kërkesat ligjore në fuqi.

Nga ana e STTV në bashkëpunim me Policinë Bashkiake janë bërë verifikime në terren subjekteve që kanë “pezulluar” apo “çregjistruar” aktivitetin, për të cilat në çdo rast janë mbajtur Procesverbale dhe nënshkruar nga 2 inspektorët e STTV dhe 1 i policisë bashkiake.

Nga verifikimi i tyre rezulton se nuk ka asnjë rast të kundërligjshëm.

Rezulton se nga ana e STTV dhe QKB për periudhën 2024 e në vijim ka një bashkëpunim për mos veprim pezullimi pa vërtetimin e lëshuar nga ana STTV Bashkia Përmet.

Tabela nr. 10

Subjekte të pezulluara gjatë vitit 2023	9
Subjekte të çregjistruara gjatë vitit 2023	12
Subjekte të pezulluara gjatë vitit 2024	8
Subjekte të çregjistruara gjatë vitit 2024	14

Nga informacioni i pasqyruar edhe në tabelën nr. 12, rezulton se numri i aktiviteteve të pezulluara ka ardhur në rënie nga viti 2023 në vitin 2024 me 1 subjekt, ndërsa numri i aktiviteteve të çregjistruara ka ardhur në rritje nga viti 2023 në vitin 2024 me 2 subjekte.

2.6/3 Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor 2024

➤ Debitorët sipas kategorive të tyre.

1. Biznesi dhe Institucionet

Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, ecuria e debitorëve përgjatë vitit 2023, për tarifën e shërbimit, ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, etj, në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë.

Tabela nr.11/në lekë

Përshkrimi	Nr	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2023	Paguar nga debia e prapambetur	Borxhi krijuar gjatë vitit 2024	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2024
Debitorë biznes i madh BM	12	3,976,683	110,838	1,054,962	4,920,807
Debitorë biznes i vogël BV	121	17,534,367	673,489	2,900,733	19,761,611
Nëntotali I	133	21,511,050	784,327	3,955,695	23,682,418
Institucione	6	921,000	0	598,500	1,519,500
Total Borxhi tatimor subjekte	139	22,432,050	784,327	4,554,195	2,201,918

Burimi: STTV/Bashkia Përmet

Nga informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 11, konstatohet se:

a. deri në 31.12.2023 vlera totale e debisë për kategorinë biznes është 21.115.050 lekë për 133 debitorë, ku peshën më të madhe e zë debia e biznesit të vogël [BV] me 17,534,367 lekë për 121 debitorë ose 81.5% dhe në vlerë më të vogël debia e biznesit të madh [BM] me 3,976,683 lekë për 12 debitorë ose 18.5%;

- gjatë vitit 2024 janë arkëtuar për këtë kategori 784,327 lekë nga debia progresive e mbartuar nga viti 2023, ku peshën më madhe e zë arkëtimi nga [BV] në vlerën 673,489 lekë ose 85.9% dhe BM në vlerën 110,838 lekë ose në masën 14.1%;

- gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime të reja nga mos arkëtimi në kohë i taksave dhe tarifave debia në vlerën 3,955,695 lekë, ku peshën më të madhe e [BV] me 2,900,733 lekë ose në masën 73.3% të debisë për këtë kategori dhe 1,054,962 lekë nga [BM] ose në masën 26.7%;

- deri në 31.12.2024 debia progresive për kategorinë biznes është në vlerën 24,682,418 lekë, ku peshën më të madhe e zë BV me 19,761,611 lekë ose 80% të debisë totale dhe 4,920,809 lekë nga BM ose në masën 20%;

b. deri në 31.12.2023 vlera e debisë për kategorinë institucione është 921,000 lekë për 6 institucione;

- gjatë vitit 2024 nuk janë bërë arkëtime nga këto institucione me qëllim zvogëlimin e debisë së akumuluar;

- gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime të reja nga mosarkëtimi në kohë i taksat dhe tarifave në vlerën 598,500 lekë;

- deri në 31.12.2024 vlera totale e debisë progresive për kategorinë institucione është 1,519,500 lekë;

- Për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, nga bizneset, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifa Vendore, janë dërguar fletë njoftimet mbi detyrimet për subjektet debitorë; për debitorët është dërguar shkresa për bllokimin e llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë me nr. 179 prot., datë 07.02.2023; shkresa nr. 180 prot., datë 07.02.2023 në DPSHTRR për masë bllokimi mjeteve të transportit.

Pra rezulton se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2024, ka marrë masa vetëm lidhur me “Njoftim dhe kërkesë për pagesë debie” dhe “Bllokim i llogarive bankare”, nëpërmjet Urdhrit të Kryetarit nr. 307 datë 09.09.2024 (1) dhe Urdhrit nr. 416 datë 13.11.2024 “Për mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore” (2), ku janë ngritur 2 grupe pune, me përbërje si më poshtë:

[1]

Nr	Grupi I		Grupi II	
	Emër Mbiemër	Pozicioni	Emër Mbiemër	Pozicioni
1	D.M	Kryetar grupi/Përgjegjës STT	O.H	Kryetar grupi/
2	SHD	Anëtar/	Arben Vezuli	Anëtar/
3	VC	Anëtar/	Xhulio Sanxhaku	Anëtar/

[2]

Nr	Grupi I		Grupi II	
	Emër Mbiemër	Pozicioni	Emër Mbiemër	Pozicioni
1	D.M	Kryetar grupi/Përgjegjës STT	Edjon Maliqi	Kryetar grupi/
2	SHD	Anëtar/	Majlinda Kote	Anëtar/
3	VC	Anëtar/	O.H	Anëtar/

Si rezultat i masave të marra është bërë i mundur arkëtimi nga borxhi në vlerën 784,327 lekë. Duke iu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se, për më tej nuk është vazhduar në marrjen e masave të tjera shtrënguese si: bllokimi i aktivitetit të biznesit, sekuestron e mallrave të debitorëve etj, deri në kallëzim penal.

-Veprime apo mosveprime në kundërshtim me Neni 76, neni 114, i Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar;

-Pikat 1, 2 në nenin 4, neni 9, pikat 1 dhe 2 në nenin 20, pika 1 në nenin 22, neni 22/5, nenin 24, shkronjën “c” të pikës 3 në nenin 27, neni 34 dhe neni 35 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

-Pikën 1.3 në pikën 1 në nenin 9, pikën 2 në nenin 27, neni 35, neni 64 në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar;

Shkronjën “a” të nenit 5, pikën 2. ë nenit 7, pikën 1 të nenit 12, nenin 14, neni 40, pikën 2. ë nenit 42 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

-VKB nr. 75 prot., datë 30.10.2023.

Një klasifikim i llojit të aktiviteteve referuar klasifikimit të subjekteve bashkë me detyrimin vjetor /debinë për vitin 2023, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 12/në lekë

LLOJI I SUBJEKTTIT	NUMRI	LLOJI I AKTIVITETIT	MATURIMI VJETOR 2024	DEBI NË FUND 2024
BIZNESI I MADH	4	Fasoneri	960,612	-
	6	Firme Ndertimi	690,160	140,100
	4	Karburante	435,240	
	20	TVSH	1,867,035	370,140
	5	Ushqimore	307,074	62,100
	2	Fondacion	131,096	
	2	Banka	501,785	
	1	Treg Private	67,760	
	2	Shoqeri Transporti	339,437	166,000
	7	Tregeti dhe Sherbime	855,167	83,411
	2	Hotele	362,179	148,850
	2	Farmaci	86,175	43,994
	1	Prodhim	413,367	
	BIZNESI I VOGËL	27	Artizane	471,182
43		Industriale	1,271,003	253,064
35		Prodhim	1,584,273	244,713
17		Profesione te Lira	460,103	52,395
83		Sherbime	2,763,860	834,745
49		Guest House	1,303,901	296,063
23		Transport	460,112	74,040
81		Ushqim Social	2,467,531	491,336
42		Ushqimore	1,065,605	392,452
2		Vendore	83,046	-

	16	Ndertese	350,738	57,240
INSTITUCION	23	Institucione	2,076,024	596,718
TOTALI	499		21,374,465	4,554,195

Burimi: STTV/Bashkia Përmet

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën nr.12, rezulton se aktivitetet sipas llojit që ushtrohen në territorin e Bashkisë Përmet, janë parashikuar dhe miratuar në Paketën Fiskale të vitit 2024.

-Gjendja e subjekteve debitoare e shpërndarë sipas vitit të krijimit deri në fund të vitit 2024, është si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 13/në lekë

Nr. Subj. debitor	Vlera e debisë sipas viteve të krijimit										Totali
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	
104	↘	↘	↘	↗	↗	↗	↘	↘	↘	↗	383
Vlera e debisë	2,313,920	1,385,939	849,311	1,480,762	2,109,637	3,526,360	3,097,024	3,503,645	3,381,125	4,554,195	26,201,918
Kamata	345,719	208,186	128,494	222,658	329,465	463,444	580,347	711,058	562,818	696,792	4,248,982
Vlera totale e debisë	2,659,639	1,594,115	977,805	1,703,420	2,439,102	3,989,804	3,677,371	4,214,703	3,943,943	5,250,987	30,450,900
Trendi i debisë		↘	↘	↗	↗	↗	↘	↗	↘	↗	
Diferenca		-1,065,524	-616,310	725,615	735,682	1,550,702	-312,433	537,332	-270,760	1,307,044	

Burimi: STTV/Bashkia Përmet

Nga analiza e të dhënave të pasqyruara në tabelën 13, rezulton se:

- Numri më i lartë i debitorëve është në vitin 2020 me 134 debitorë në vlerën totale të debisë 3,989,804 lekë;
- Numri më i vogël i debitorëve është në vitin 2017 me 38 debitorë në vlerën totale të debisë 977,805 lekë;
- Ndërsa vlera më e lartë e debisë është regjistruar për vitin 2024 me 5,250,987 lekë;

Një klasifikim i debitorëve të biznesit, sipas riskut të shlyerjes së detyrimit të mbartur është si më poshtë vijon:

Debitorë pa shpresë arkëtimi janë 191 subjekte dhe në vlerën e debisë 13,805,893 lekë;
 Debitorë nga 3 deri në 5 vjet janë 83 subjekte dhe në vlerën e debisë 7,298,204 lekë;
 Debitorë nga 2 deri në 3 vjet janë 88 subjekte dhe në vlerën e debisë 5,097,821 lekë;

Nga verifikimi i dosjeve të subjekteve debitoare, rezultoi se, nga ana e STTV është bërë verifikimi në sistemin e QKB mbi statusin e tyre dhe ekstraktet e QKB-së janë bërë pjesë e dosjes.

Gjithashtu konstatohet se:

1. Në Bashkinë Përmet janë zhvilluar takime të GMS ku trajtohen problematikat për (pa)mundësinë e vjeljes së detyrimeve të debitorëve problematikë, por rezulton se këto takime nuk janë dokumentuar; si dhe nga mungesa e një analize të mirëfilltë nga ana e strukturave përgjegjëse (GMS dhe DFBTT), nuk është hartuar një plan masash konkrete për arkëtimin e tyre.
2. Mungesa e Aplikimit të penalteteve me shkresa për bllokimin e asetëve rregjistruar në ASHK;
3. Njoftimi i subjekteve debitoare dhe familjare kryhet nëpërmjet punonjësve të mblledhjes së taksave në terren verbalisht dhe shkresë-njoftimeve, si edhe me njoftimet në stendat e bashkisë dhe në qendrat e NJA.
 - Subjekte me më shumë se 1 aktivitet në të njëjtin territor dhe me një Nipt:

Tabela nr. 14

Nr	Subjektet qe ushtrojnë dy aktivitete ne nje seli		NIPT-i
	Emri I subjektit		
1	AD		
2	R.19		
3	SK		
4	VN		

5		VB	
6		MM	
7		AG	
8		MH	
9		RTH	
10		RN	
11		AM	

Burimi: Bashkia Përmet

Nga auditimi i dokumentacionit dhe analiza e informacioneve, u konstatua se, në Bashkinë Përmet rezultojnë 11 subjekte të cilat ushtrojnë më shumë se një aktivitet në territorin e tyre me të njëjtin Nipt dhe paguajnë detyrimet ndaj bashkisë vetëm për një aktivitet, në kundërshtim me kuadrin ligjor/nënligjor për taksat dhe tarifatat në Republikën e Shqipërisë.

- Nisur nga kushtet specifike të komunitetit që përbën këtë bashki, nga ana e STTV na u komunikua se vështirësia e vjeljes së taksave dhe arkëtimi i detyrimeve të prapambetura vjen nga fakti se popullata është një pjesë emigratore dhe një pjesë jo rezidentë.

- Për institucionet debitorë është dërguar urdhër bllokimi në bankat e nivelit të dytë, për shlyerje të detyrimeve që ato kanë ndaj Bashkisë Përmet.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se, nga struktura tatimore e Bashkisë Përmet, për asnjë nga subjektet, që janë debitorë në vite, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar kallëzim penal, bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se:

“Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3., ku përcaktohet se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:
1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.”

Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

2. Debitorët familjar: Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për tarifën e shërbimit: gjelbërim¹⁶, pastrim, ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, TNI si dhe nga qiraja.

Tabela nr. 15/në lekë

Përshkrimi		Nr	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2023	Nr	Paguar 2024 nga debia progresive	Nr	Borxhi i krijuar gjatë vitit 2024	Nr	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2024
Debitorë taksa e ndërtesës familje	T ak s	4,876	5,492,937		0		475,546		5,968,483
Debitorët taksat familje /truall			6,108,717				1,949,280		8,057,997

¹⁶ Vetëm në qytet

Debitorët taksat familje /pastrim									
Debitorët taksat familje /ndriçim									
Debitorët taksa e tokës bujqësore		2,971	12,038,566		397,844		1,679,594		13,320,316
Nëntotali			23,640,220		397,844	1875	4,104,420	1875	27,346,796
Debitorët TNI	TA, jo	61	1,480,494	1	48,174	0	0	60	1,432,320
Debitorët nga qiratë	Tatimor		1,952,963				1,317,627		3,270,590
Numri total i debitorëve			3,433,457		48,174		1,317,627		4,702,910
Karburante			1,600,000						1,600,000
Total Borxhi tatimor për familje			27,073,677		446,018		5,422,047		32,049,706

Burimi: STTV/Bashkia Përmet.

a. Deri në 31.12.2023 vlera e debisë për kategorinë familjarë është në vlerën totale 23,640,220 lekë, ku peshën më të madhe e zënë: debia nga taksa e “tokës bujqësore” në vlerën 12,038,566 lekë për 2971 familje debitore ose në masën 44.5% të vlerës totale; debia për taksa “familjarë [truall, pastrim, gjelbërim, ndriçim]” në vlerën 6,108,717 lekë ose në masën 22.6%; debia për taksën “ndërtesa familjare” në vlerën 5,492,937 lekë për 4876 debitorë familjar ose në masën 20.3%;

- gjatë vitit 2024 janë arkëtuar 446,018 lekë nga debia e trashëguar e vitit 2023 ose në masën 1.7 % të debisë totale të kategorisë “familjare”, ku 397,844 lekë janë arkëtuar nga taksa e “tokës bujqësore” ose në masën 3.3% të debisë së vet dhe 89.2% të vlerës së arkëtuar për kategorinë familjare;

- gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime të reja në vlerën totale 5,422,047 lekë, ku 1,949,280 lekë nga mospagesa e taksave “familjare [truall, pastrim, gjelbërim, ndriçim]”; 1,679,594 lekë nga taksa e “tokës bujqësore”; dhe 475,546 lekë nga taksa e “ndërtesës”;

- deri në 31.12.2024 vlera totale e debisë progresive për kategorinë taksa familjare është 27,346,796 lekë ose 4,706,576 lekë më shumë se në datën 31.12.2023; peshën më të madhe të debisë e zë taksa e “tokës bujqësore” me 13,320,316 lekë ose 48.7% të totalit të debisë progresive të kësaj kategorie; taksat familjare “[truall, pastrim, gjelbërim, ndriçim]” në vlerën 8,057,997 lekë ose 1,949,280 lekë më shumë se në 31.12.2023 dhe në masën 29.5% të totalit të debisë për këtë kategori dhe taksë “ndërtesa” në vlerën 5,968,483 lekë ose 475,546 lekë më shumë se në 31.12.2023 dhe në masën 21.8% të debisë totale progresive të kësaj kategorie.

b. deri në 31.12.2023 vlera e debisë për kategorinë jotatimore është 3,433,457 lekë ku peshën më të madhe e zë debia nga “qiratë” në vlerën 1,952,963 lekë ose në masën 56.9% e vlerës totale të kësaj kategorie dhe “TNI” nga legalizimet në vlerën 1,480,494 lekë për 27 debitorë ose në masën 5.4% të vlerës totale të debisë për këtë kategori; debia nga “qiratë” në vlerën 1,952,963 lekë ose në masën 7.2% të vlerës totale të debisë për kategorinë “familjare”;

- gjatë vitit 2024 janë arkëtuar 48,174 lekë nga debia e TNI ose 3.3% e debisë së vet dhe 10.2% e vlerës së arkëtuar;

- gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime të reja në vlerën totale 1,317,627 lekë nga “qiratë”;

- deri në 31.12.2024 vlera totale e debisë progressive për kategorinë jotatimore është 4,702,910 lekë ose 1,269,453 lekë më shumë se në 31.12.2023; peshën më të madhe e zë debia nga “qiratë” në vlerën 3,270,590 lekë ose në masën 69.5% të totalit të debisë për këtë kategori dhe TNI në vlerën 1,432,320 lekë ose 48,174 lekë më pak se në 31.12.2023 ose në masën 30.5% të totalit të debisë për këtë kategori;

▪ Një analizë e detajuar e debisë progresive nga viti i krijimit deri në fund të vitit 2024 për Bashkinë Përmet dhe Njësitë Administrative, *rezulton* se, me bashkimin e ish komunave në vitin 2015, debia progresive e taksa e tarifave vendore është e kontabilizuar;

Pas viti 2015 me lidhjen e marëveshjes me UK Përmet Sha, nuk është ndjekur rigorozisht numri i debitorëve dhe klasifikimi i debisë sipas cdo lloj takse e tarife, por vetëm vlera debitoare në total. Ndaj dhe vlera e debisë pas vitit 2015 nuk është kontabilizuar.

Për sa më lart mosveprimet janë në kundërshtim me VKB- nr. 75 prot., datë 30.10.2023 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Përmet, penalitetet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2023".

Familje debitoare për taksën e tokës bujqësore.

Referuar *tabelës nr. 17*, rezulton se, vlera debitoare progresive për taksën e tokës bujqësore, është nga **12,038,566 lekë** në mbyllje të vitit 2023, në **13,718,160 lekë** në mbyllje të vitit 2024, me *një vlerë të debisë në rritje prej 1,679,594 lekë*. Theksojmë se, sipërfaqja e mësipërme e tokës bujqësore të taksuar, është bërë mbi bazën e regjistrave kadastrale. Nga ana e administratorëve të njësisve nuk janë bërë riverifikime në terren me qëllim sigurimin e të dhënave të sakta dhe krijimin/përditësimin e kadastrës vendore të tokës bujqësore. Mangësi konstatohen edhe në organizimin e strukturave për ndjekjen e kësaj takse, mos përditësimi i regjistrave të familjeve fermere që disponojnë toke si dhe niveli i ulët i realizimit të taksës së tokës bujqësore, duke u evidentuar një numri të madh i familjeve debitoare në vlera të konsiderueshme debitoare. Regjistrat nuk janë të përditësuar sipas ndryshimeve të bëra vit pas viti në kadastër për tokat në disponim dhe përdorim. Njoftim detyrimet për të gjithë fermerët e evidentuar në regjistra, bëhen në kohë, por emigrimi i tyre, ka sjellë vonesa dhe është shfrytëzuar rasti kur fermerët janë paraqitur pranë Bashkisë për shërbime të ndryshme dhe shërbimi i kërkuar është ofruar pasi iu janë prerë faturat dhe janë bërë arkëtimet.

Tabela nr.16/në lekë

Nr.	Njësitë Administrative	Nr. Familjeve debitoare viti 2024	Vlera e debisë viti 2024
1	Frasher	30	42,895
2	Petran	221	452,765
3	Piskove	364	872,769
4	Çarshove	174	311,165
	Totali	789	1,679,594

Burimi: Bashkia Përmet

Konstatim: Gjatë vitit 2024 numri i familjeve debitoare nga mospagimi i taksës së tokës bujqësore është 789 debitorë në vlerën totale të debisë 1,679,597 lekë; numrin më të lartë të debitorëve e ka NJA Piskovë në vlerën e debisë 872,769 lekë dhe numrin më të vogël të debitorëve e ka NJA Frasher në vlerën e debisë 42,895 lekë. NJA Piskovë falë specialistit të taksave ka mundur të përditësojë regjistrin e debitorëve dhe të ulë vlerën e debisë, duke rritur arkëtimet në buxhetin e Bashkisë Përmet.

Tabela nr. 17/në lekë

Nr	Njësitë Administrative	Nr. Familje 31.12.2023	Vlera debitoare 31.12.2023	Nr. Familje viti 2024	Vlera e debisë vetëm viti 2024	Nr. Familjeve 31.12.2024	Vlera debi progresive 31.12.2024
1	Frasher	32	169,524	30	42,895		212,419
2	Petran	785	4,162,203	221	452,765		4,614,968
3	Piskove	366	3,775,833	364	872,769		4,648,602
4	Çarshove	168	3,931,006	174	311,165		4,242,171
	Totali	1,351	12,038,566	789	1,679,594		13,718,160

Burimi: Bashkia Përmet

Konstatim: Nga informacioni i pasqyruar në *tabelën nr. 17*, rezulton se vlera progresive e debisë në fund të vitit 2024 është 132,718,160 lekë krahasuar me vitin 2023 ka rritje të debisë me një vlerë prej *1,679,594 lekë*;

NJA Piskovë ka vlerën debitoare progresive më të lartë prej 4,648,602 lekë dhe NJA Frashër ka vlerën më të vogël të debisë progresive prej 212,419 lekë;

Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr. 75 prot., datë 30.10.2023, Për miratimin e paketës fiskale 2024.

-Sipas bonitetit sipërfaqja e tokës bujqësore në territorin e bashkisë Përmet pasqyrohet e klasifikuar si në tabelën mëposhtë:

Tabela nr.18/nëlekë

Kategoria e Tokës	Sipërfaqe e tokës bujqësore në ha					Lekë ha/vit sipas VKB	Pritshmëria në lekë	Plani vjetor 2024	Arkëtuar 2024
	Sipërfaqe Total	Frasher	Petran	Piskove	Çarshove				
Kategoria e IV	-					-			
Kategoria e V	3,601	131	1,327	1,141	1,002	1,000		1,825 ha	1,980 ha
Kategoria e VI	-					1,000			
Kategoria e VII-X	-					1,000			
TOTALI	3,601	131	1,327	1,141	1,002		3,601,000	1,825,000	
Arkëtuar/lekë									1,980,000

Burimi: SB/Bashkia Përmet

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 6 dhe tabelën nr. 18, konstatohet se, në territorin e Bashkisë Përmet janë shpërndarë 3,601 ha tokë bujqësore për 3226 familje që sipas bonitetit klasifikohet “kategoria V”; referuar tarifave të miratuara me VKB në paketën fiskale të vitit 2024, pritshmëria e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore për vitin 2024 duhet të jetë 3,601,000 lekë, por nisur nga mundësia e arkëtimeve sipas vitit të mëparshëm 2023, është planifikuar 1,825,000 lekë ose 1,776,000 lekë më pak se pritshmëria dhe 155,000 lekë më shumë se realizimi faktik i vitit 2024. Duhet theksuar fakti që edhe pse vlera e taksës për vitin 2024 është modeste, vlera totale progressive në mbyllje të vitit 2024 është më e lartë se ajo në mbyllje të vitit 2023 prej 1,679,594 lekë.

➤ **Detyrimet nga qiratë e sipërfaqeve pyjore/tokave bujqësore**

Nga Sektori i Bujqësisë, është marrë ky informacion lidhur me sipërfaqet e tokës bujqësore në pronësi të ndarë me Ligjin 7501 /1991 i ndryshuar, si më poshtë:

Tabela nr. 19

Njësi Administrative/Institucion	Sipërfaqja në ha			
	Të ndara	Të ndara		Të pandara
		Me origjinë nga ish.Koop.bujqësore	Me origjinë nga ish.Nb. bujqësore	
Bashkia Përmet	3,601	3,324	277	

Burimi: SB/Bashkia Përmet

-Tokat bujqësore të Bashkisë Përmet sipas ndarjes (llojit) pasqyrohen si më poshtë:

Tabela nr. 20

Nr	Emërtimi i asetit	Sip. në ha
1	Pyje	10771.01
2	Kullotë	7033.69
3	Toka joproductive	110.41
4	Shkëmbore e ujore	482.52
5	Djerrë	20.46
6	Bimësi Pyjore	-
7	Sipërfaqe boshe	15
Totali		18,433.09

Burimi: SB/Bashkia Përmet

Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Bujqësisë [SB], rezulton se, ky sektor ka dërguar çdo vit në Këshillin e Qarkut Gjirokastrë, informacionin mbi treguesit kadastral të përditësuar për ndryshimet në nivel vendor të fondit pyjor e kullësor, sipas formularëve të miratuar Formular 1, 2, 3 dhe 4.

- Tokë bujqësore e pandarë e dhënë me qira:

Tabela nr. 21/në lekë

Nr	Emertesa	Afati i Kontratës	Data e pagesës	Vlera e Kontrates	Detyrimi	Paguar	Debia
1	Kontratë qeraje për pasuri të patundshme Shoqëria “GI Sh.p.k”	07.11.2018-07.11.2053		48,360	48,360		48,360
2	Kontratë për dhënie me qera të tokës bujqësore të pandarë, AD	12.04.2022 – Afat 99 vjeçar		11,607	11,607		11,607
3	Kontratë qeraje e tokës bujqësore, të pandarë RM	03.09.2021 Afat 99 vjeçar	12.09.2024	31,756	31,756	31,756	-
4	Kontratë qeraje e tokës bujqësore, të pandarë KM	03.09.2021 – Afat 99 vjeçar	12.09.2024	69,836	69,836	69,836	-
5	XHK	Mars 2010-Afat 40 vjet	Viti 2024	700	700	700	-
6	IC	Shtator 2010-afat 40vjet	Viti 2023-2024	450	900	0	900
7	OTH	Shtator 2010-afat 40vjet	Viti 2023-2024	650	1,300	0	1,300
8	PJ	Shkurt 2011-afat 40 vjet	Viti 2024	750	750	750	750
9	FI	Prill 2011	Viti 2024	4,000	4,000	4,000	-
10	XHK	Prill 2011	Viti 2024	450	450	450	-
11	JD	Prill 2012	Viti 2024	230	230	230	-
12	EK	Prill 2012	Viti 2024	320	320	320	-
13	OTH	Prill 2013	Viti 2023-2024	3,600	7,200	0	7,200
14	ND	Prill 2013	Viti 2024	4,800	4,800	4,800	-
15	Kontratë qeraje për pasuri të patundshme LK	18.07.2018 Afat 99-vjet	23.09.2024	80,822	80,822	80,822	-
16	Kontratë qeraje për pasuri të patundshme LK	18.07.2018 Afat 35-vjet	23.09.2024	3,412	3,412	3,412	-
Shuma Totale		16 kontrata		261,743	264,843	196,376	70,117

Burimi: Bashkia Përmet

Nga informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 21, rezulton se janë lidhur 16 kontrata për dhënie me qira të tokës bujqësore, me afat 1 dhe 2 vjeçar në vlerën totale të detyrimit 264,843 lekë, nga e cila janë arkëtuar 196,376 lekë për 10 kontrata dhe ka mbetur vlerë debitore prej 70,117 lekë për 6 kontrata: një kontratë 1 vjeçare, tre kontrata 2 vjeçare dhe dy kontrata 99 vjeçare.

▪ Tabela e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore në Bashkinë Përmet për vitin 2023.

Bashkia Përmet ka sipërfaqe pyjore në pronësi sipas VKM-së nr. 398 datë 13.05.2020 “Për disa ndryshime në VKM-në nr.433 datë 08.05.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve e kullotave publike”;

- Nga auditimi dhe analiza e të dhënave të pasqyruara në Aneks TA/3.1 dhe Aneks TA/3.2, rezultoi se gjatë vitit 2024 janë lidhur në total 27 kontrata ose 4 kontrata më pak se në vitin 2023, nga të cilat janë 26 kontrata për kullota verore për afatin 01.06.2024-31.10.2024 dhe 1 kontratë për kullotë dimërore për afatin 01.11.2024-30.04.2025, vlera totale e të cilave është 1,130,400 lekë.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale, objekt legalizimi.

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga zyra e vendore e ASHK Përmet, u auditua i gjithë dokumentacioni për periudhën e vitit 2024, i paraqitur nga Sektori i Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit.

Në Bashkinë Përmet deri në 31.12.2024, disponohen shkresat përcjellëse dhe listat me emrat përkatës që ju janë miratuar Lejet e Legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Përmet. Nga ZVASHK, janë dërguar informacioni dokumentar për çdo person që ka ndërtuar objekt banimi apo social ekonomik në territorin e Bashkisë Përmet. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, rezulton se Bashkia Përmet, nuk ka detyrime të prapambetura të trashëguara ndër vite për TNI.

Në vijim paraqiten pasqyra e personave të cilët janë pajisur me Leje Legalizimi, sipërfaqet ndërtimore sipas objekteve, funksioni, vendndodhja e objektit, sipërfaqja e objektit, detyrimi sipas personave që duhet të paguanin, për periudhën e vitit 2024 dhe statusi.

Tabela përmbledhëse - Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) për legalizimin e objekteve informale deri në 31.12.2024, pasqyrohet në Aneks TA/4

Vlera debitore nga TNI është kontabilizuar nga DFB/SF në pasqyrat financiare të njësisë.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në vitin 2024 nga ASHK Rajonale Gjyrokastër janë legalizuar me pagesë të plotë të TNI-së 5 familje, si më poshtë vijon:

Tabela nr. 22

Shkresa me ASHK		Vlera e paguar e TNI/lekë		Destinacioni
Nr Prot	Data	Viti 2024		
118	15.01.2024	3,775		ekonomike
163	17.01.2024	18,205		banimi
799	18.03.2024	3,497		banimi
2224/1	16.09.2024	5,365		ekonomike
3414	23.12.2024	13,025		banimi
5		43,867		

Burimi: SUMT/Bashkia Përmet/Punoi: Grupi i auditimit

Nga informacioni i pasqyruar në tabelën nr.22 rezulton se, gjatë vitit 2024 nuk ka debitorë për TNI të përfituesve nga leje legalizimi ndaj Bashkinë Përmet.

Tabela nr. 23

Debitor TNI deri në 31.12.2024	Subjekte	
	Nr	Vlera
Progresive deri në 31.12.2023	60	1,432,320
Krijuar vetëm në vitin 2024	0	0
Progresive deri në 31.12.2024	60	1,432,320

Burimi: SUMT/Bashkia Përmet

Nga auditimi dhe informacioni i vënë në dispozicion rezulton se debitorët e TNI nga leje legalizimi janë krijuar në periudhën para vitit 2023. Rezulton se nga Drejtoria e Urbanistikës nuk është bërë një analizë e mirëfilltë dhe nuk është hartuar një plan masash për arkëtimin e vlerës debitore nga TNI e akumuluar prej shumë vitesh.

▪ Lidhur me lejet e ndërtimit të dhëna nga SUMT/Bashkia Përmet, rezulton se në vitin 2024 janë dhënë 7 leje, të cilat kanë paguar TNI brenda afatve ligjore. Një informacion i detajuar pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 24

Lejet e dhëna nga SUMT/Bashkia Përmet në vitin 2024								
Lloji i lejes	Emërtimi i objektit	Zhvilluesi	Preventivi (lekë)	Vlera e TNI-së (lekë)	Nr. vendimi, datë, nr. prot;	Data e miratimit	Sip. totale ndërtimi (m ²)	Shënime mbi kontributin ndaj fondit publik për strehim social
Leje ndërtimi rikonstruksion	Pallati i sportit	Bashkia Përmet		0	559/4 datë 17.05.2024			
Leje ndërtimi ≠ projekti	Rikonstruksion objekti/ mbingritje kati	xx	7,494,418	212,120	2306/6 datë 05.07.2024		144.00	
Leje ndërtimi rikonstruksion	Banesë individuale	xx	1,734,008.8	82,020	1100/6 datë 28.08.2024		83.00	
Leje ndërtimi rikonstruksion	Rikonstruksion me ≠ funksioni	xx	20,132,219	807,089	2058/6 datë 23.05.2024		751.80	
Leje ndërtimi rikonstruksion	Shkolla "Meleq Gosnishti"	Bashkia Përmet		0	2441/4 datë 01.10.2024			
Leje ndërtimi obj. I ri	Bujtinë /obj. 2 kate	xx	21,087,764	958,800	27328/5 datë 18.10.2024		644.50	
Leje ndërtimi rikonstruksion	Ndryshim destinacioni nga njesi ne banesë	xx	563,167	46,835	237/6 datë 25.10.2024		42.45	

Burimi: SUMT/Bashkia Përmet

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 24, rezulton se gjatë viti 2024 janë aplikuar për leje ndërtimi gjithsej 17 kërkesa, nga të cilat:

- janë miratuar në total 7 leje ndërtimi me vlerë totale të TNI prej 2,106,864 lekë;
- janë refuzuar 10 kërkesa.
- Të Ardhura nga privatizimi i banesave sociale.

Tabela nr.25 /në lekë

bashkia përmet /zona kadastrale 2917											
nr	emër mbiemër	vlera e privatizimit	kësti mujor +interesi	pagesa viti 2023			pagesa viti 2024			vlera e debisë 2023+2024	vlera e debisë 31.12.2024
				paguar	detyrimi vjetor	dif	paguar	detyrimi vjetor	dif		
1	VH	1,638,738	6,745.98	45,217	45,218.8	-2	86,386	80,951.8	5,432	5,432	1,507,135
2	VM	1,482,676	6,818.74	122,736	81,825	40,911	81,824	81,824.9	40,910	40,910	1,278,116
3	ID	1,524,061	7,009.07	28,000	21,027	6,973	84,000	84,108.8	6,864	6,864	1,412,061
4	BD	1,497,655	6,887.63	13,800	82,652	-68,852	75,900	82,651.6	-75,603	-75,603	1,407,955
5	arqile dhimitri	872,758	4,013.76	16,000	20,069	-4,069	40,000	48,165.1	-12,234	-12,234	816,758
6	YR	1,699,676	7,816.71	0	93,801	-93,801	0	93,800.5	-187,601	-187,601	1,699,676
7	LC	1,699,676	blerje e menjeheresh me	1,716,672	0	0	0	0	0	0	-16,996
8	QN	1,030,258	4,738.10	0	56,857	-56,857	0	56,857.2	-113,714	-113,714	1,030,258
9	PS	1,418,040	6,541.29	0	39,248	-39,248	400,130	78,495.5	282,387	282,387	1,017,910
shuma i		12,863,538	6,745.98	1,942,425			768,240				10,152,873
1	AD	1,518,207	blerje e menjeheresh me	1,518,207	0	0	0	0	0	0	0
2	SHC	1,817,801	8,359.96	0	100,320	-100,320	0	100,319.5	-100,320	-100,320	0
3	AN	1,607,801	7,394.19	73,945	88,730	-14,785	111,000	88,730.3	22,270	7,484	1,817,801
4	FD	1,552,857	7,159.21	28,640	28,637	3	85,920	85,910.5	9	13	1,422,856
5	THK	1,447,021	6,654.77	119,789	79,857	39,932	79,800	79,857.2	-57	39,875	1,438,297
6	KH	1,607,801	7,394.19	321,600	88,730	232,870	0	88,730.3	-88,730	144,139	1,247,432
7	SGJ	1,686,897	7,757.94	0	93,095	-93,095	0	93,095.3	-93,095	-93,095	1,286,201
8	HM	1,686,897	7,757.94	337,380	93,095	244,285	337,380	93,095.3	244,285	488,569	1,686,897
9	IC	1,530,808	7,040.10	28,160	84,481	-56,321	126,730	84,481.2	42,249	-14,072	1,012,137
10	BD	1,686,897	7,757.94	93,093	93,095	-2	93,093	93,095.3	-2	-5	1,375,918
11	LB	1,686,897	7,757.94	31,032	77,579	-46,547	85,338	93,095.3	-7,757	-54,305	1,500,711
12	KB	1,686,897	7,757.94	7,700	93,095	-85,395	15,515	93,095.3	-77,580	-77,580	1,570,527
13	NC	1,704,397	7,838.42	39,076	94,061	-54,985	125,116	94,061.0	31,055	-23,930	1,663,682
shuma ii		21,221,178	90,630.54	2,598,622			1,059,892				17,562,664
totali (i+ii)		34,084,716	141,201.82	4,541,047	1,455,473.59	3,085,573.41	1,828,132	1,694,421.8	133,710.2		27,715,537

Burimi: Bashkia Përmet

Nga informacioni dokumentar dhe i pasqyruar në tabelën 25 rezulton se, me procedurë privatizimi deri në 31.12.2024 i janë nënshtruar në total 22 banesa në vlerën totale të privatizimit 34,084,716 lekë, nga të cilat për 2 banesa është likuiduar vlera në masë të plotë menjëherë në vlerë totale 3,234,879 lekë dhe për 20 banesat e tjera janë lidhur kontrata për likuidimin e tyre me këste mujore; Gjatë vitit 2023 janë paguar 4,541,047 lekë ose 3,085,573.41 lekë më shumë se vlera totale e detyrimit total vjetor dhe në vitin 2024 janë paguar 1,828,132 lekë ose 133,710 lekë më shumë se vlera totale e detyrimit vjetor.

- nga banesat me kontratë në vitin 2023 janë paguar 1,306,168 lekë ose 149,305.59 lekë më pak se detyrimi vjetor dhe në vitin 2024 janë paguar 1,828,132 lekë ose 133,710 lekë më shumë se vlera totale e detyrimit vjetor;

- Vlera totale e privatizimit të 22 banesave ka qenë 34,084,716 lekë, nga e cila vlera totale e mbetur pas likuidimit të menjëhershëm të 2 banesave është 30,849,837 lekë, ndërsa vlera e mbetur për tu paguar deri në likuidim të plotë është 27,715,537 lekë ose 15,595 lekë më shumë se vlera e mbetur që duhej të ishte sipas kushteve të kontratës.

Nga ana e strukturave përgjegjëse nuk rezulton të jenë marrë masa shtrënguese për të respektuar kushtet e kontratës në vlerën e plotë dhe në afat të pagesave mujore.

- **Tarifa e pastrim, gjelbërim, ndriçim etj (sipas rastit), për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike.**

Nga auditimi lidhur me tarifën e pastrim, ndriçimit, gjelbërim etj, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike, rezultoi se gjatë viti 2024 kanë kryer punime me procedurë prokurimi. Informacioni i detajuar pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.26/Në lekë

Nr	Subjekt i	NIPT	Vl.kont. (pa TVSH)	Afati i i kontratës	Lloji i taksave dhe tarifave vendore						
					Taksë mjedisi	Kamat vonese	Tarifë Pastr.	Tarifë Nd.rrug	Tarifë Gjelb.	Paguar	Debitor
1	L. V	K.....	39,991,152	15.01.2024-15.01.2025			113,100	7,000	20,000	140,100	0
2	Z.	L.....O	98,407,650.48	01.10.2024-01.04.2025			33,700	2,330	6,660	46,690	0
3	2.	K.....M	38,695,735	20.10.2023-20.06.2024			52,676	3,260	9,315	65,251	0
4	A.	J.....O	7,926,814	21.11.2023-21.02.2024		1,151	15,493	958	2,739	20,341	0
Totali					0		214,969	13,548	38,714	272,382	0
					540,764						

Burimi: Bashkia Përmet

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe informacionit në tabelën nr. 26, rezulton se gjatë vitit 2024 janë 4 OE që kanë fituar procedurat e prokurimit për 4 punë publike me fondet e Bashkisë Përmet dhe se kanë paguar detyrimin mbi taksat vendore në vlerën totale 540,764 lekë.

➤ **Tarifa për vizitë në muze**

Referuar Paketës Fiskale 2024 tarifat e miratuara për vizitorët në Qendrën Kulturore Multifunkionale “Odise Paskali”, e cila është e organizuar në pavione të veçanta me: “Vëllezërit Frashëri”, "Odise Paskali", Arkeologjik dhe ai Etnografik, janë miratuar 2 vlera të ndryshme të tarifës për 2 kategori vizitorësh: vizitorë dhe nxënës shkolle/studentë.

Tabela nr.27/në lekë

Viti 2023			
Kategori vizitorësh	Tarifa sipas VKB (lekë)	Nr	Vlera arkëtuar
Vizitorë	100		
Nxënës/studentë	50		
Totali I			0
Dhënie me qira salla e konferencave	15,000	1	15,000
Totali II			15,000

Burimi: Bashkia Përmet

Nga auditimi rezulton se, për vitin 2024 nga 4 pavionet (muzet) e qytetit nuk ka patur të ardhura në buxhetin e Bashkisë.

Nga komunikimi verbal me subjektin, grupit të auditimit iu përcoll ky informacion: “Deri tani është numër shumë vogël i vizitorëve që frekuentojnë muzetë, dhe ky grup vizitorësh përbëhet nga nxënësit e shkollave të cilëve në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore, iu është bërë pjesë e programit mësimor “vizitë në muzetë e qytetit”. Grupi i auditimit duke analizuar situatën, arriti në konkluzionin se mungesa e të ardhurave nga muzetë ka ardhur si rezultat i mungesës së publikimit të informacionit dhe promovimit të tyre nga strukturat përkatëse të bashkisë, për të cilët mjetet dhe mënyrat në kohën e sotme të teknologjisë janë të shumta dhe të larmishme.

- Në ambientet e QKM “Odise Paskali” ndodhet salla e konferencave, i vetmi objekt nga i cili sigurohen të ardhura nga dhënia me qira për aktivitete të ndryshme. Gjatë vitit 2024 ka patur vetëm një aktivitet nga subjekti “Partnerët për Shqipërinë” nga dhënia me qira e së cilës është arkëtuar në buxhetin e bashkisë vlera prej 15,000 lekë.

➤ **Tarifa për lundrimin në lumin**

Bashkia Përmet ka parashikuar në Paketat fiskale të miratuara, shfrytëzimin e resurseve natyrore për promovimin e tyre me qëllim rritjen e të ardhurave për buxhetin e bashkisë, duke vendosur tarifa modeste.

Me anë të VKM nr.155 datë 13.03.2023 Lumi Vjosa është shpallur Park Kombëtar ,Kategoria II. Administrimi i këtij parku bëhet nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM).

Me VKB nr.75 datë 30.10.2023 është miratuar Paketa Fiskale për nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024, në pikën “E” të së cilës është miratuar zëri :

[Tarifë për mbajtje dhe përdorim të mjeteve të lundrimit dhe objekteve të tjera të lundrimit]:

-Për person_____	100 lekë /person
-Për pajisje_____	200 lekë /pajisje

Sipas Ligjit nr.21/2024 datë 22.02.2024 ka ndryshuar ligjin nr.81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” sipas të cilit AKZM menaxhon këtë zonë dhe tarifon subjektet mbështetur në Udhëzimin nr.01 datë 10.02.2021 “Për rregullat e Përdorimit dhe gëzimit të Shërbimeve që ofron Zona e Mbrojtur Mjedisore dhe pagimin e çmimeve për to”, Bashkia Përmet që mirëmban këtë park, nuk është përfshirë në përfitimet financiare që sigurohen nga aktiviteti që ushtrojnë subjekte të ndryshme të pajisura me leje/licenca dhe kontratave të lidhura nga AKZM.

Tabela nr. 28

Subjektet që ushtrojnë aktivitete turistike apo argëtuese në burimet ujore					
Nr.	EMRI I SUBJEKTIT	NIPT-I	ADMINISTRATORI	VEPRIMTARIA	VENDODHJA
1	EC	L...G	EIET	Rafting,Sherbime te ndryshme turistike	Petran ,Qilarisht Rruga Nacionale Permet-Tre urat
2	VA	M....O	EN	Organizim guidash per Rafting ne Lumine E Vjoses,Turizem lumor dhe malor	Rruga Kongresi Permetit Lagjia e Re
3	PDT	M....M	JP	Aktivite te ne fushen e turizmit, organizimi i udhetimeve turistike.	Permet. Shetitorja Mentor Xhemali
4	VR	M....P	IT	Aktivite te Rafting	Gjirokaster Permet PERMET Rruga NB Permet
5	RVAC	M....D	AE	Organizim guidash per rafting ne lumin e Vjoses, turizem lumor dhe malor. Shitje te produkteve te veta turistike	Gjirokaster Permet Rruga e Korçes Permet
6	AR	L.....M	AS	Rafting, Kajak dhe Kanoë, Hidrospeed, Kanionim dhe Kacavjerrje. Eksplorim me motorra uji si ne dete dhe ne lumenj.	Berat Berat BERAT Lagjia" Mangalem".
7	R	L9.....H	RSH	Rafting. Shetitje me bicikle. Ture me xhip. Sherbime turistike. Aktivite te ne fushen e turizmit.	Gjirokaster PERMET, me vendodhje ne qytetin e Permetit.
8	R.L	M4.....K	MN	Guest House ,Rafting	Permet

Burimi: Bashkia Përmet

Referuar Ligjit nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” i ndryshuar, referuar nenit 16 pika 3/ç, ku citohet “Në këtë zonë mund të ushtrohen veprimtari të lejuara të përcaktuara në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur, si dhe ato të parashikuara në nenin 33 të këtij ligji, që sigurojnë krijimin e mundësive shpirtërore, shkencore, edukative, çlodhëse të vizitorëve, në përputhje me kërkesat mjedisore, kulturore, por vetëm pasi të pajisen me miratimin e institucioneve shtetërore, që synojnë: dhënie e kontributit në ekonominë vendase nëpërmjet veprimtarive të turizmit/agroturizmit. etj.,”

Nenit 33 “ Veprimtaritë e lejuara në zonat e mbrojtura”; nenit 40 “Bashkitë”; nenit 66 “Inspektimi” pika 4/e; nga auditimi rezulton se pavarësisht faktit që Bashkitë kanë një rol kyç jo vetëm për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e zonave të mbrojtura, por edhe në veprimtarinë e AKZM në këto zona (në Parkun Kombëtar të Vjosës), deri tani Bashkia Përmet nuk është përfshirë në përfitimet financiare që AKZM siguron nga aktiviteti i këtyre 8 subjekteve. Duke mos kontribuar qoftë edhe në vlerat modeste të tarifave të miratuara me VKB.

III.Burimi i krijimit të të ardhurave jotatimore

➤ **Lista e aseteve të dhëna me qira/Kontratat**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacionit të pasqyruar në tabelën Aneks TA/5, rezulton se:

- Janë lidhur gjithsej 26 kontrata, nga të cilat: 3 në vitin 2010; 3 në vitin 2011; 2 në vitin 2012; 2 në vitin 2013; 8 në vitin 2018; 2 në vitin 2019; 1 në vitin 2020; 2 në vitin 2021 dhe 3 në vitin 2022;
- Në vitet 2014, 2015, 2016, 2017, 2023 dhe 2024 nga Bashkia Përmet nuk ka kontrata të lidhura;
- Për vitin 2024 vërtetohet nga shkresa nr. 1790/1 prot., datë 31.07.2024 dhe shkresa nr. 3468/1 prot., 08.01.2025;
- **Konstatohet** se Subjekti “K. ” sh.p.k vijon të mbetet debitor problematik¹⁷, pasi masat e marra nga Bashkia Përmet kanë qenë të vonuara dhe joefektive, si rezultat i moszbatimit të kërkesave që dikton kuadri ligjor dhe kushtet e marrëveshjes së lidhur, në kohën dhe në masën e duhur nga Zyra Juridike e bashkisë.
- **Konstatohet** se gjatë viti 2024 nuk janë paguar detyrimet për “qiratë” nga 9 subjekte në vlerën totale të detyrimit vjetor prej 1,317,627 lekë dhe deri në 31.12.2024 debia totale progresive është në vlerën 3,270,590 lekë.

➤ **Debitor nga gjoba të vendosura nga Policia Bashkiake.**

Nga auditimi, rezulton se gjatë vitit 2024 Policia Bashkiake nuk ka regjistruar gjoba për kundërvajtje administrative në territorin e Bashkisë Përmet.

➤ **Nga gjobat e IMTV**

Nga auditimi dhe relacioni i inspektorit të IMTV Bashkia Përmet, rezulton se gjatë vitit 2024 nuk ka gjeneruar të ardhura nga gjobat nga sektori i IMTV-së.

➤ **Nga aktiviteti i MZSH**

Nga auditimi dhe relacioni i përgjegjës të MZSH-së Bashkia Përmet, rezulton se gjatë vitit 2024 çshtë ky informacion i raportuar në Drejtoria e PMBZSH-Së, Sektorti i PMNZSH-së Qarkut Gjirokastrë.

Tabela nr. 29/në lekë

Nr	Emër Mbiemër	Shërbimi	Pagesa	Vlera /në lekë
1	LG	Akt teknik	Raif.Bank dt. 21.02.2024	5,000
2	BB	-//-	dt. 23.02.2024	5,000
3	ET	-//-	dt. 11.11.2024	5,000
4	Qendra Shëndetsore Frasher-Piskovë	-//-	Tira Bank dt. 02.10.2024	5,000
5	PY	Leje ndërtimi	Raif Bank dt. 15.04.2024	5,000
6	IP	-//-	Tira Bank dt. 01.08.2024	5,000
7	EXH	-//-	Raif Bank dt. 21.11.2024	5,000
8	AN	Miratim PMZSH Pajisje me Çsz	Tira Bank dt. 09.05.2024	5,000 5,000
Llog. ekonomike	7113011	Totali	9 shërbime	45,000

Burimi: *STTV dhe MZSH/Bashkia Përmet*

➤ **Shlyerja e detyrimeve të prapambetura/ me këste**

Bashkia Përmet referuar kuadrit ligjor në fuqi, ka aplikuar lidhjen e marrëveshjeve me debitorët për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura prej tyre, në favor të buxhetit të Bashkisë Përmet. Një informacion i detajuar në tabelën më poshtë:

Tabela nr.30/Në lekë

¹⁷ Problematikë e konstatuar edhe në auditimin e mëparshëm dhe përcjellë me rekomandim në RPA. Trajtuar gjerësisht në pikën nr. 8 "Zbatimi i rekomandimeve"

Marrëveshjet e lidhura dhe ato aktive gjatë vitit 2024							
Nr.	Akt-marrëveshja	Subjekti	Detyrimi total	Pagesa deri në 50%	Detyrimi në marrëveshje	Shuma e paguar	Shuma e mbetur 31.12.2024
1	Nr.1. Dt 21.04.2024	VB	213,329	82,450	Pagese me 2 keste(20.04.2024-25.10.2024)	213,329	0
2	Nr.2. Dt 20.05.2024	FXH	30,540	30,540	Pagese vjetore brenda 15.08.2024	30,540	0
3	Nr.3. Dt 04.06.2024	KS	35,494	9,397	Pagese me dy keste(05.06.2024-05.10.2024)	35,494	0
4	Nr.4. Dt 05.06.2024	JC	26,097	26,097	Pagese vjetore brenda dates 10.11.2024	26,097	0
5	Nr.5. Dt 05.06.2024	AM	30,864	30,864	Pagese vjetore brenda dates 15.08.2024	30,864	0
6	Nr.6. Dt 11.06.2024	KB	17,964	17,964	Pagese brenda datës 25.07.2024	17,964	0
7	Nr.7. Dt 17.07.2024	ED	16,200	16,200	Pagesa brenda datës 25.09.2024	16,200	0
8	Nr.8. Dt 19.07.2024	BK	23,100	23,100	Pagese brenda datës 25.10.2024	23,100	0
Totali			393,588	236,612	8	393,588	0

Burimi: Bashkia Përmet

Gjatë vitit 2024 Bashkia Përmet ka lidhur 8 akt marrëveshje për likuidimin e detyrimeve progresive nga taksat e tarifave vendore. Rezulton se deri në 31.12.2024 detyrimi prej 393,588 lekë është likuiduar plotësisht nga debitorët, sipas kushteve të Akt Marrëveshjes.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Përmet mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

-Ligj nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar

-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017;

-VKM nr. 212, datë 16.3.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)”

-VKB për miratimin e paketave fiskale për vitin 2024, përkatësisht VKB nr.75, datë 30.10.2023, në të cilat është përcaktuar tarifa e licencimit, si dhe sektori përgjegjës për lëshimin e licencës, faturës së arkëtimit;

Pasqyra e subjekteve që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë në Bashkisë Përmet në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 31/në lekë

Nr	Emer Mbiemer	NIPT	Adresa	Autorizim fillon-mbaron	Niveli I tarifës sipas VKM nr 344	Pagesa deri ne vitin 31.12.2023	Pagesa gjate vitit 2024	Detyrime per tu paguar
1	"S G"	K...V	PERMET; Rruga e Varrezave te Deshmoreve ,Ish Kompleksi Gjajica, Pike karburanti, Zona Kadastrale 2917, Nr.Pasurie 18/22	30,04,20218 - 29,04,2023	1,000,000	200,000	-	800,000
2	"K" shpk	J...P	PERMET; Rruga Kelcyre-Permet, Km 1, Zona Kadastrale 2131, Ndertese 1-kateshe me nr. pasurie 269/41(Pike karburanti)	06,08,2020 - 05,08,2025	1,000,000	1,000,000	-	-
3	O	J.....I	Pikë Karburanti, Përmet. Pasuria Nr.17/3, Zona Kadastrale 2917. Rruga Përmet-Korce, ish karburanti Roselia”shpk	01,06,2021 - 31,05,2026	1,000,000	1,000,000	-	-

4	"G."	K....IT	Pikë Karburanti, pranë Zonës së ish parkut, aksi Këlcyrë - Përmet, krahu i djathtë në hyrje të Qytetit të Përmetit, Pasuria me Numër 3/18, Zona Kad 2917"	06.01.2022 - 05.01.2027	1,000,000	-	600,000	400,000
5	A & CO shpk	L....P	PERMET; 11 Lagjja e re, rruga Kongresi i Permetit, objekt privat 2-katesh me nr pasurie 23/175, zona kadastr 2917	14.09.2022 - 13.09.2027	1,000,000	200,000	400,000	400,000
Totali					5,000,000	2,400,000	1,000,000	1,600,000

Burimi: Bashkia Përmet

Nga informacioni i evidencave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe pasqyruar në tabelën nr. 31, rezulton se, në Bashkinë Përmet ushtrojnë aktivitetin 5 subjekte, të cilët janë pajisur me Autorizim 5 vjeçar. Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 30, rezulton se nga 5 subjekte aktive, 1 subjekt ("S. G") i ka mbaruar afati i autorizimit në vitin 2023 dhe nga vlera totale prej 1,000,000 lekë ka për të paguar dhe 800,000 lekë ose 80% të vlerës totale¹⁸; 2 subjekte e kanë likjuar në masë të plotë detyrimin ndonëse janë brenda afatit të autorizimit; 2 subjekte kanë për të paguar deri në përfundim të afatit të autorizimit shumën 400,000 lekë secili ose 40 % të detyrimit total.

IV. Përjashtimet nga Taksat dhe Tarifat/Kategoritë sociale përfituese

Tabela nr. 32/Në lekë

Perjashtimet nga Taksat dhe tarifet Vendore 2024												
Nr	Kategoria sociale	Tarife Pastrimi		Tarife Ndricimi		Tarife Gjellberimi		Takse Ndertese		Totali		
		Nr	Vlere	Nr	Vlere	Nr	Vlere	Nr	Vlere	Nr. person	Nr. Pers/ lloj	Vlerë
1	Pensioniste te vetem	129	309,600	129	103,200	129	25,800	129	24,531	129	516	463,131
2	Invalide paafesia	32	76,800	32	256,00	32	6,400	32	14,264	32	128	123,064
3	Pensioniste çift	75	0	75	0	75	0	75	20,110	75	300	20,110
4	Pensioniste çift me te ardhura nen 30,000 leke	3	7,200	3	2,400	3	600	3	4,181	3	12	14,381
Totali		164	393,600	164	131,200	164	32,800	239	63,085	239	956	620,685

Burimi: STTV/Bashkia Përmet

Në Paketën Fiskale 2024, janë parashkuar nga STTV dhe miratuar me VKB nr. 75 datë 30.10.2023 edhe disa kategori sociale për tre lloj taksash: Taksë Ndertese, Tarifë ndricimi dhe tarifë pastrimi, të cilat në mënyrë të detajuar pasqyrohen në tabelën e mësipërme. Nga informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 32 rezulton se për 4 kategoritë sociale përfituese janë në total 239 persona për katër lloj tarifash ose 956 taksapagues përfitues në vlerën 620,685 lekë.

STTV ka evidencë të hartuar mbi vlerën e vjelë të tyre dhe vlerën e plotë të taksave që duhej të arkëtohej në rast se nuk do përfshihej në paketën e lehtësisë fiskale.

➤ Komisioni i Apelit Administrativ

Bashkia Përmet ka ngritur Komisionin e Hetimit Tatimor [KHT] me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 41/1 datë 30.01.2024 dhe me nr. 306/2 prot., datë 30.01.2024, në zbatim të Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 7 i tij;

KHT për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 është i përbërë si më poshtë vijon:

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni në strukturë	Formimi profesional/arsimor
1	F.H	N/Kryetar i Bashkisë	Kryetar Komisioni/juridik
2	E.K	Dr. Buxhet -Financë	Anëtar/financë -kontabilitet
3	D.M	Përgjegjës STTV	-/- / administrim biznesi

¹⁸ Trajtuar gjerësisht në rekomandimin e lënë në RPA të auditimit të mëparshëm

4	P.M	Përgjegjës i SJBNI deri më shtator 2024 / Specialist jurist nga tetori 2024 e në vijim	-/- / juridik
5	A.B	specialist topograf deri në shtator 2024 / specialist aseteve nga tetori 2024 e në vijim	-/- / matematikë

Burimi: Bashkia Përmet

- Nga ana e komisionit janë ndjekur hapat proceduralë për zgjedhjen e kryetarit të komisionit me procesverbalin e dates 30.01.2024;

- Nëpërmjet Urdhrit të Kryetarit nr. 41/3 datë 31.01.2024 dhe me nr. 306/3 prot., date 31.01.2024 është caktuar z. O.H sekretar organizativ i KHT;

Nga auditimi *rezulton se* gjatë vitit 2024, nuk ka patur raste të ankimeve nga subjekte apo familjarë, lidhur me detyrimet tatimore ndaj Bashkisë Përmet.

3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

▪ Hartimi i pasqyrave financiare për vitin 2024

Bashkia Përmet për vitin ushtrimor 2023 ka plotësuar pasqyrat financiare të vetat sipas formateve nga 1-8 për çdo njësi përbërëse të aparati i bashkisë të cilat i ka dorëzuar në Degën e Thesarit Përmet me nr. 1041 prot., datë 21.03.2025 dhe konfirmuar në datën 25.03.2025.

Pasqyrat e llogaridhënies vjetore kanë të plotësuara pasqyrat si vijon:

Format 1 - Pasqyra e Pozicionit Financiar,

Format 2 - Pasqyra e Performancës Financiare,

Format 3 - Pasqyra e Flukseve Monetare,

Format 4 - Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivitet Neto/Fondet Neto,

Format 5 – Pyetëtori dhe Shënime Shpjeguese,

Format 6 - Pasqyra Investimet dhe Burimet e Financimit,

Format 7/a - Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata me kosto historike,

Format 7/b – Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata me vlera neto,

Format 8 - Pasqyra Numri i Punonjësve dhe Fondi i Pagave.

Veprimet janë mbartur nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Përgatitja e të dhënave për pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2024 janë bërë duke kryer paraprakisht manualisht regjistrimin në mënyrë kronologjike sipas natyrës të të gjitha veprimeve financiare të realizuara gjatë secilit vit ushtrimor; kontabiliteti mbahet në regjistra manual dhe pjesërisht në programin Microsoft Excel;

▪ Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare	Administrata me NJA	Data e miratimit në Degën e Thesarit Përmet
Bashkia Përmet Nr. 1041 prot., datë 21.03.2025	Bashkia Përmet	Dorëzuar/Datë 21.03.2025 Miratuar/Datë 25.03.2025

Rezulton se Pasqyrat financiare të Bashkisë Përmet janë përgatitur nga sektori i financës dhe janë nënshkruar nga NA dhe NZ; janë dërguar në Degën e Thesarit Përmet për vitin ushtrimor 2024 me shkresën nr. 1041prot., datë 21.03.2025 dhe miratuar datë 21.05.2025 nga Dega e Thesarit Përmet, *brenda afatit ligjor*;

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin ushtrimor 2024 rezulton verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë të ekstrakteve të bankës (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe

në total, mujor e vjetor, rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditar i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve. **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi, u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të vërtetuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike, deri në mbyllje të ushtrimit të mëparshëm;

Nëse informacioni kontabël mundëson në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazim i lëvizjes së ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Bashkisë Përmet

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e informacionit bazë dhe justifikues;

- Në këtë njësi publike, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale dhe më pak informatike në programin "Microsoft Excel";

- Përditësimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletëkontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrjedaljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, aktmarrëveshjet etj.

Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si: faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar, Pohimet mbi saktësinë e përgatitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të njësisë për aktivitetin ekonomik –financiar të vitit 2024. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Sektori i Financës. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatuan se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 148,388,051 lekë.

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktiviteti neto janë të barabarta me Aktivitet-Pasivitet

	<u>Viti 2023</u>	<u>Viti 2024</u>
Aktivitet	1,564,629,616 lekë	1,516,729,679 lekë
Pasivitet	164,961,954 lekë	141,270,665 lekë
Aktivitet neto	1,399,667,662 lekë	1,375,459,014 lekë

▪ Aktivitet afatshkurtra

Aktivitet afatshkurtra më datë 31.12.2024 paraqiten në vlerën 313,433,880 lekë dhe përbëhen nga:
 Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 129,524,917 lekë;
 Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 62,519,908 lekë;
 Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 121,389,055 lekë lekë;
 Të tjera aktive afatshkurtra në shumën 0 lekë.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” sipas bilancit në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën e 129,524,917 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në shumën 148,388,051 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” të Formatit nr. 3 “Pasqyra e Flukseve Monetare”(cash-floë), që sipas metodës direkte. përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca
				(2023-2022)
531	Mjete monetare në arkë	0	0	0
512	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	129,524,917	148,388,051	-18,863,134
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akredeitiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizjone zhvlerësimi	0	0	0
Totali		129,524,917	148,388,051	-18,863,134

Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 129,524,917 lekë, përbëhet nga: të ardhura dhe transfertat e pakushtezuar që trashëgoohen llogaria 85 (Kredi) në vlerën 109,643,307, si dhe gjendja e llogarisë 466 në shumën 19,881,610 nga e cila: “pulla” në vlerën 9,000 lekë dhe “Mjetet në ruajtje” në vlerën 19,872,610 lekë që përbën 5% garanci kontrate. Pra llog. 520 kuadron me shumën e llog. 85 “rezultati i veprimtarisë ushtrimore” dhe llog.466 “kreditorë për mjete në ruajtje”.

Janë rakorduar me Degën e Thesarit Përmet, mbartjet e të ardhurave dhe transfertave të vitit 2024 si mëposhtë:

1- Kap.1-Trasfertë e pakushtëzuar viti 2024 e papërdorur 91,171,969.40 lekë;

2-Kap.5-Të ardhurat e veta viti 2023 e papërdorur 17,117,190.63 lekë;

3-Kap.6 - Të papërdorura 402,913 lekë;

4- Kap.2 - 951,233.95 lekë

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 109,643,306.98 lekë fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2025 dhe kuadrojnë me vlerën e llog.85 “rezultat i veprimtarisë ushtrimore”. Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca
				(2024-2023)
31	Materiale	12,042,889	9,003,335	3,039,554
32	Objekte inventari/Inventar imët	50,477,019	48,335,518	2,141,501
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri	0	0	0
37	Gjendje te pambritura ose pranë të treteve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provigjone për zhvlerësim e inventarit(-)	0	0	0
Totali		62,519,908	57,338,853	5,181,055

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar Përmet në 31.12.2024 paraqitet në vlerën 62,519,908 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në shumën 12,042,889 lekë dhe nga llogaria kontabel 32 “Objekte/inventari imët” në shumën 50,477,019 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit, vlerë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 5,181,055 lekë.

Llogaria 312 “Materiale”, në fillim të vitit 2024 ka vlerën 9,003,335 lekë dhe në mbyllje të vitit ka vlerën 12,042,889 lekë, është shtuar me vlerën 3,039,554 lekë, për vlerën e materialeve të blera gjatë vitit 2024 gjendje në magazinë. Lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë	Diferenca
Gjendja në 01.01.2024	9,003,335	3,039,554
Hyrje gjatë vitit 2024	3,039,554	
Dalje nga magazina gjatë vitit 2024	-	
Gjendja në 31.12.2024	12,042,889	

Llogaria 327 “Objekte inventari”, në fund të vitit 2023 ka vlerën 48,335,518 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 50,477,019 lekë, është shtuar në vlerën 2,141,501 lekë, për vlerën e inventarit të imët hyrje gjatë vitit 2024. Kjo vlerë përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë	Diferenca
Gjendja në 01.01.2024	48,335,518	2,141,501
Hyrje gjatë vitit 2024	2,141,501	
Dalje nga magazina gjatë vitit 2024	-	
Gjendja në 31.12.2024	50,477,019	

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve, llog 63 evidentuar në pasqyrën e performancës financiare. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”. Titullari ka nxjerrë Urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit për inventarizimin fizik dhe vlerësimin paraprak të aktiveve që klasifikohen të dëmtuara etj¹⁹

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”&“Të tjera aktive afatshkurtra” pasqyrohen në Aneks PF/1

- **“Llogari të arkëtueshme”** për vitin 2024 është në shumën 121,389,055 lekë dhe në vitin 2023 është 106,089,009 lekë me një diferencë prej 15,300,046 lekë. Kjo shtesë ka ardhur si rezultat i rritjes së vlerës së llog. 468 “debitorë të ndryshëm” me shumën 4,391,527 lekë për mospagesa ndaj kreditorëve dhe rritjes së llog. 4342 “të tjera operacione me shtetin (debitor)” me shumën 10,908,519 lekë;

- **“Të tjera aktive afatshkurtra”** për vitin 2024 paraqitet pa vlerë dhe për vitin 2023 është në shumën 41,480,074 lekë që përfaqëson llog. 486 "shpenzime të periudhave të ardhme".

Llog. 466 “kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 17,031,885 lekë dhe në vitin 2024 në vlerën 19,881,610 lekë, me një diferencë në rritje prej 2,849,725 lekë. Llog 466 përbëhet nga ngaranci 5% e investimeve të pasqyruara në tabelë dhe vlera e pullave.

Është konfirmuar nga Dega e Thesarit Përmet me SFB rakordimi i llog.466 dhe analiza e saj është si më poshtë:

Në lekë

Numri i investimeve	Gjendje deri më 31.12.2023	Shtesa 2024	Pakesime nga 2023 në 2024	Gjendje 31.12.2024	Numri
25	17,031,885	5,913,458	3,063,733	19,881,610	26
(5% + pulla)					

Analiza e detajuar e llog.466 “kreditorë për mjete në ruajtje” pasqyrohet në tabelën Aneks PF/2.

Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet në vitin 2024 në shumën 3,868,762 lekë dhe në vitin 2023 nuk është paraqitur vlerë. Shuma prej 3,868,762 lekë është e përbërë nga: vlera e pretenduar nga OSHEE prej 2,346,886 lekë si detyrim i papaguar në periudha të hershme 2007-2011 për të cilën Bashkia Përmet është në proces gjyqësor, vlera 302088 lekë ndaj shtetasit B.Ç. dhe 1,219,788 lekë ndaj një projekti²⁰.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në fund të vitit 2023 është 87,840,764 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 92,232,291 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë	Debitor në numër
Gjendja në 01.01.2024	87,840,764	
Shtesa gjatë vitit 2024	5,250,987	
Pakësime gjatë vitit 2024	859,460	
Gjendja në 31.12.2024	92,232,291	

Llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” ka si kundërparti llog.4341 "operacione me shtetin (detyrime)" dhe kuadron me llog. 470 “të ardhura për tu marrë” në vlerën 92,232,291 lekë. Nga analiza rezulton se vlera e kësaj llogarie ka ardhur në rritje me 4,391,527 lekë në vlerë, për arsye të mospagesave të taksa e tarifa vendore nga biznese e nga familjarë²¹. Shuma e detyrimeve debitohet në llog. 468 “debitorë të ndryshëm” dhe kreditohet në llog. 4341 “të tjera operacione me shtetin (kreditor)”.

Në lekë

¹⁹ Trajtuar gjerësisht në nënpikën 3.4 ‘procedura e inventarizimit të aktiveve’

²⁰ Trajtuar gjerësisht tek “Detyrimet e prapambetura” dhe tek “Zbatim i rekomandimeve”

²¹ Në mënyrë të detajuar te pika 2.6 e programit, rubrika e debitorëve

Nr	EMERTIMI	viti 2023	Shtesa 2024	Pagesa 2024	viti 2024
1	Permeti	25,732,538			25,732,538
2	Nj Ad Piskove	614,384			614,384
3	Nj Ad Petran	6,051,085			6,051,085
4	Nj Ad frasher	1,091,158			1,091,158
5	Nj Ad Carcove	126,969			126,969
	SHUMA I	33,616,134			33,616,134
6	Aluizmi	1,480,494		48,174	1,432,320
7	Taksat	26,011,199	5,250,987	811,286	30,450,900
8	Debitor ujesjellesi 2024	26,492,937			26,492,937
9	Gjobe IMT	240,000			240,000
	SHUMA II	54,224,630	5,250,987	859,460	58,616,157
	SHUMA TOTALE (I+II)	87,840,764	5,250,987	859,460	92,232,291

Burimi: SFB/Bashkia Përmet

Në tabelën e mësipërme në grupin “taksa” është përfshirë vlera debitore e subjekteve të krijuara nga viti 2015 e deri në 31.12.2024. Konstatohet se, nga SFB gjatë vitit 2024 nuk është shtruar për diskutim në takimet e GMS, mbi hartimin e një plani për të mundësuar arkëtimin e shumës progresive të periudhës deri në 31.12.2024 prej 30,450,900 lekë për 383 subjekte debitor në buxhetin e bashkisë.

1	Detyrim nga diferenca e taksa e tarifa fam,iljare				853,859
2	Detyrim nga kontratat e qirasë				3,270,590
3	Detyrim nga licencat e Karburanteve				1,600,000
Llog.468	Shuma III				5,724,449

Nga auditimi i dokumentacionit mbi borxhin tatimor²² dhe informacionit të pasqyruar në tabelë, u konstatua se shuma e llogarisë 468 “debitorë të ndryshëm është nëvlerësuar me 5,724,449 lekë, pasi informacioni i ardhur në Sektorin e financës për borxhin tatimor dhe numrin e tatimpaguesve që janë debitorë ndaj Bashkisë Përmet, nuk ka qenë i plotë dhe si pasojë vlera 5,724,449 lekë nuk rezulton e kontabilizuar.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 18,248,245 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 29,156,764 lekë dhe kuadron me llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, si dhe me shumën e llogarive të pagueshme në pasiv si në tabelë:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408	0
Detyrime personelit llog 42	18,993,686
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	995,328
Sigurime shoqërore llog.435	4,653,227
Sigurime shëndetësore llog.436	645,761
Organizma të tjerë shtetërorë	
Kreditorë të ndryshëm llog.467	3,868,762
Totali	29,156,764

Nga analiza e llog.4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” rezulton e kuadruar me shumën e llogarive të pagueshme (pa përfshirë vlerën e llog.466) dhe me vlerën e llog. 7206 ”Financim i pritshëm nga buxheti”.

• **Llogaritë e Marrëdhënive me shtetin**

Në marrëdhëniet e institucioneve me shtetin përdoren dy llogari specifike dhe karakteristike për sektorin publik buxhetor.

- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”

- Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”.

²² Trajtuar gjerësisht në nënpikën 2.6 të programit “burimi i krijimit të të ardhurave”

Llog. 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabile në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë:

a) Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi:

Debitohen llogaritë respektive të klasës 6 “Shpenzime sipas natyrës”;
Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42,43,40,e të tjera).

b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi:

Debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”;
Kreditohet llogaria 7206 ”Financim i pritshëm nga buxheti”.

c) Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës bëhet veprimi:

Debitohen llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4);
Kreditohet llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”.

d) Paralel me veprimin e mësipërm artikullohet veprimi tjetër:

Debitohet llogaria 476” Të ardhura të caktuara për tu përdorur”;
Kreditohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”.

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të viteve 2023 paraqitet në shumën 41,840,074 lekë dhe në 2024 në pasqyrat financiare vjetore paraqitet pa vlerë, referuar Udhëzimit të MFE nr. 5 datë 21.02.2022 i ndryshuar datë 16.03.2022. Nga auditimi dhe dokumentacioni raportues nga ana e DFB Bashkia Përmet në MFE me nr. 1077 prot., datë 23.02.2024, rezulton se: vlera e llog. 486 është 811,918 lekë që përbën detyrimet e prapambetura që bashkia u ka të tretëve për investime e shërbime etj.

Kjo llogari përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Vlera e kësaj llogarie, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera, por të pa financuara në vitin ushtrimor. Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2023, është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2019 i ndryshuar, pika 42 ku cilësohet: "Të gjitha Njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, “shërbime” apo “investime” të kryera, por të pa financuara".

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. Aktivet afatgjata

Objektivat e auditimit janë që të sigurohemi se: Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet e subjektit janë të plota dhe korrekte.

Në Formatin 1 “Pozicioni Financiar”, “Aktivet afatgjata” paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e Ilog.231). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,210,973,629 lekë dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën 1,203,295,799 lekë, që përbëhet nga shuma 20,194,217 lekë të AAJM dhe shuma 966,349,012 lekë të AAM;

Nr. Reference Llogarije	EMERTIMI	Gjendje ne Fillim vit te vitit	Shtesa gjate vitit ushtrimo, Kosto Historike					Pakesime gjate vitit , Kosto Historike				Gjendja mbyllje te ushtrimit
			Blerje e krijuar me pagese	Shtesa pa pagese		Levizje brenda aktiveve	Gjithe sej	Shitje	Nx.jasht perdor	Pakesime te Tjera	Gjithe sej	
				Jashte sistemit	Brenda sistemit							

b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
20	I. AAGJ/JM	16,186,082	6,436,047		0	0	6,436,047	0	0	0	2,427,912	20,194,217
21- 28	II. AAGJ/JM	978,034,977	141,820,456	356,340	0	0	142,176,796	0	0	91,408,845	91,408,845	966,349,012
	TOTALI (I+ II)	1,210,973,629	148,256,503	356,340	0	0	148,612,843	0	0	91,408,845	156,290,673	1,203,295,799

Burimi: Bashkia Përmet0

Analiza e secilës llogari të klasës 20 dhe 21 pasqyrohet në Aneks PF/4.

Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, për vitin 2023 janë në shumën 16,186,082 lekë dhe për vitin 2024 janë 20,194,217 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (kosto historike), paraqitet e analizuar si vijon:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2024	16,186,082
Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	6,436,047,
Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
Gjendja në 31.12.2024 (D)	20,194,217

Në Formatin 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (vlera neto), llog.202 “studime e kërkime” paraqitet si më poshtë:

Emërtimi i Aktivit Llog. 202	Gjendja më 31.12.2023	Shtesa gjate vitit 2024	Pakësime gjatë vitit 2024	Amortiz. Akum.	Gjendja më 31.12.2024
Studime e projektme	16,186,082	6,436,047	2,427,912	9,803,291	20,194,217

Konstatim: Nga Bashkia Përmet nuk është bërë analizë e mirëfilltë e llog. 202 “studime e kërkime” për verifikimin e situatës së projekteve të hershme me qëllim transferimin e vlerës së tyre në llogaritë respektive të klasës 21 “AAM”.

Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale” në Formatin 1 (Aktivi i bilancit), paraqiten me vlerën neto për vitin ushtrimor 2024 në vlerën 966,349,012 lekë; në vitin paraardhës 2023 vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 978,034,977 lekë, me një pakësim të AAM-ve me (-) 11,685,965 lekë.

Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet: nga shtimi i llog.211 “Pyje e plantacione” me 766,000 lekë, shtim i llog. 212 “ndërtesa e konstruksione” me 56,669,933 lekë; pakësim i llog. 213 “rrugë, rrjete, vepra ujore” me (-) 59,319,673 lekë; pakësim i llog, 214 “instalime,makineri e pajisje” në shumën (-) 1,449,227 lekë; pakësim i llog. 215 me (-)7,498,080 lekë dhe lëvizjeve në llog.218 me shtime me dhe pa pagesë jashte sistemit në shumën totale 5,582,998 lekë.

21	2.Aktive Afatgjata materiale	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca
210	Toka, Troje, Terrene	9,544,588	9,544,588	0
211	Pyje, Plantacione	1,921,860	1,155,860	766,000
212	Ndertesat e Konstruksione	779,949,052	698,144,128	56,669,933
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,457,307,172	1,497,523,257	-59,319,673
214	Instalime teknike, makineri e paisje	58,272,515	51,208,011	-1,449,227
215	Mjete Transporti	58,998,843	58,998,843	-7,498,080
216	Rezerva Shtetore			
217	Kafshe pune e prodhimi			
218	Inventar ekonomik	46,119,915	44,771,307	-854,918
24	Aktive afatgjata te demtuara			
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata			
	TOTALI AAM	966,349,012	978,034,977	-11,685,965

Sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (kosto historike) paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 978,034,977 lekë dhe në fund të vitit 2024 në vlerën 966,349,012 lekë.

Llog.210 “Toka, troje, terrene” paraqitet në mbyllje të viteve 2023 e 2024 në vlerën 9,544,588 lekë; si dhe në Formatin 7/a e 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” paraqitet në të njëjtën vlerë. Kjo llogari ka inventar fizik por nuk ka inventar kontabël.

nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 210	Gjendja 31.12.2023	Shtesa dhe pakësime gjatë vitit 2024		Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2024
1	Toka, troje, terrene	9,544,588	0	0	-	9,544,588

Llog. 211 “Pyje, plantacione” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në shumën 1,155,860 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,921,860 lekë dhe kuadron me llog.211 në Formatin 7/a e 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata”. Analiza e llog.211 “Pyje, plantacione” si më poshtë:

nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 211	Gjendja 31.12.2021	Shtesa dhe pakësime gjatë vitit 2022		Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2022
1	Pyje, Plantacione	1,155,860	766,000	0	-	1,921,860

Llog.212 “Ndërtesa Konstruksione” në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 502,699,820 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 559,369,753 lekë, me një shtim prej 56,669,933 lekë. Ndërsa në Formatin 7/a “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (kosto historike) paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 698,144,128 lekë dhe në fund të vitit 2024 në vlerën 779,949,052 lekë, me një vlerë të shtuar në shumën 81,804,924 lekë që përfaqëson vlerën e investimeve të përfunduara;

Në Formatin 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (vlera neto) 559,369,753 lekë; Diferenca 56,669,933 lekë përfaqëson vlerën e shtesës duke zbritur vlerën e amortizimit (81,804,924-25,134,991). Llog.212 në pasqyrën F1 kuadron me llog.212 në pasqyrën F7/a e F7/b. Analiza e llog.212 si më poshtë:

nr	Emërtimi i Aktiveve – llog.212	Gjendja 31.12.2023	Shtesa dhe pakësime gjatë vitit 2024		Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2024
1	Ndërtime e Konstruksione	502,699,820	81,804,924	-5,134,991	220,579,299	559,369,753

Në regjistrin e inventarit të llog.212 “Ndërtesa Konstruksione”, nga verifikimi rezulton se objektet inventare të regjistruara në këtë llogari, janë konform klasifikimit të Nomenklaturës së llogarive kontabël.

Hyrjet e AAGJ dokumentohen:

- Për blerjet, ku si dokumenta shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme).
- Për hyrjet në cilësinë e kontributeve në natyrë të kapitalit/fondeve, ku si dokument shërben akt-marrëveshja dhe akti i marrjes në dorëzim të aktivitetit.
- Për prodhimin nga vetë njësia, ku si dokument shërben situacioni përfundimtar dhe akti i marrjes në dorëzim.
- Për rivlerësimet, si dokument shërbejnë aktet ligjore ose nënligjore që autorizojnë një gjë të tillë dhe pasqyrat përkatëse të llogaritjeve.

Llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën neto të saj 382,071,756 lekë dhe në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën neto 322,752,083 lekë me një pakësim në vlerën (-) 59,319,673 lekë; Ndërsa në Formatin 7/a “Gjendja dhe Ndryshimet e

Aktiveve Afatgjata” (kosto historike) paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,497,523,257 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,457,307,172 lekë, ku diferenca prej 59,319,673 lekë përbëhet nga vlera e investimeve të bëra në vitin 2024, vlera e pakësimeve dhe e amortizimeve; Në Formatin 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (vlera neto) paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 382,071,756 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 322,752,083 lekë; Diferenca 59,319,673 lekë përfaqëson shtesën duke zbritur pakësimet dhe vlerën e amortizimit (51,192,760-91,408,845-(-)19103,588). Analiza e llog. 213 është si më poshtë:

nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 213	Gjendja 31.12.2023	Shtesa dhe pakësime gjatë vitit 2024		Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2024
1	Rrugë, rrjete, vepra ujore	382,071,756	51,192,760	91,408,845	1,134,555,089	322,752,083

Në regjistrin e inventarit të llog.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, nga verifikimi rezulton se objektet inventare të regjistruara në këtë llogari, janë konform klasifikimit të Nomenklaturës së llogarive kontabël.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 34,054,924 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 32,605,697 lekë me një diferencë prej (-) 1,449,227 lekë; Ndërsa në formatin 7/a paraqitet në vlerën bruto në mbyllje të vitit 2023 prej 51,208,011 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 58,272,515 lekë. Diferenca përfaqëson vlerën e aktiveve të shtuara nga blerje me pagesë. Analiza e gjendjes së llog. 214 me ndryshimet nga viti 2023 në 2024 paraqitet si vijon:

nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 214	Gjendja 31.12.2023	Shtesa dhe pakësim gjatë vitit 2024		Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2024
1	Instalime teknike, makineri, pajisje	34,054,924	7,064,504	0	25,666,818	32,605,697

Në regjistrin e inventarit të llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje”, nga verifikimi rezulton se objektet inventare të regjistruara në këtë llogari, janë konform klasifikimit të Nomenklaturës së llogarive kontabël.

Llogaria 215 “Mjete transporti”. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Përmet më datë 31.12.2023 në shumën 37,490,401 lekë dhe në 31.12.2023 në shumën 29,992,321 lekë, ku diferenca (-) 7,498,080 lekë (rënie) është vlera e amortizimit vjetor. Ndërsa në formatin 7/a lëvizjet e llogarisë janë si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë		Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2024		58,998,843
Shtesa gjatë vitit 2024 (D)		0
Pakësime gjatë vitit 2024 (K)		0
Gjendja në 31.12.2024 (D)		58,998,843

Bashkia Përmet ka në pronësi të saj 24 mjete në vlerën kontabël 58,998,843 lekë dhe në gjendje aktive 17 mjete transporti në vlerën totale 48,635,483 lekë.

Në pasqyrën Format 7/a llog.215 “Mjete transporti” gjatë vitit 2024 është si në tabelë:

Nr.	Emërtimi i Aktiveve - llog. 215	Gjendja 31.12.2023	Shtesa dhe pakësim Gjatë vitit 2024		Amortizim akumuluar	Gjendja 31.12.2024
1	Mjete transporti	58,998,843	0	0	29,006,522	

Llogaria 218 “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga Bashkia Përmet. Sipas pasqyrave financiare Format 1 dhe Format 7/a, gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2023 paraqitet në vlerën 44,771,307 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën

46,119,915 lekë me një diferencë (shtim) në vlerën 1,348,608 lekë, e cila përbëhet: nga blerjet në shumën 992,268 lekë dhe sistemime në shumën 356,340 lekë; me amortizim vjetor prej (-) 2,203,526 lekë. Lëvizjet në llog. 218 sipas Formatit 7/a janë si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	44,771,307
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	1,348,608
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
Gjendja në 31.12.2023 (D)	46,119,915

- Nga analiza e llog. 218 “inventar ekonomik” rezulton se, kategoria “pajisje kompjuterike” nuk është ndare si nënkategori më vete [2186], duke mos pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj për të saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit. Por nga verifikimi i analizës së llogarisë dhe rregjistrit të inventareve rezultoi se llogaritja e amortizimit për pajisjet kompjuterike është llogaritur saktë prej 25% të vlerës së mbetur.

Në pasqyrën Format 7/b llog. 218 inventar ekonomik pasqyrohet si më poshtë:

nr	Emërtimi i Aktiveve - llog. 218	Gjendja 31.12.2023	Shtesa gjatë vitit 2024	Pakësime gjatë vitit 2024	Amortizim akumuluar	Gjendja 31.12.2024
1	Inventar ekonomik	11,017,628	992,268	0	35,957,205	10,162,710

Referuar Pasqyrës F7/b vlera neto e AAM në fund të vitit 2023 është 11,01,6287 lekë dhe në fund të vitit 2024 është 10,162,710 lekë, shtesa përbën vlerën e blerjeve prej 992,268 lekë për mobilimin e qendrës së të moshuarve dhe krevate për kopshte e çerdhe dhe

Kontabilizimi i vitit 2024 për blerjet e kryera gjatë vitit pasqyrohen në Aneks PF/5

Tabela përmbledhëse për llog. 214, llog. 215 dhe llog. 218 pasqyrohet në Aneks PF/4.

Llog 209 & 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM është llogaritur sipas koeficientit të amortizimit dhe është në vlerën 64,881,828 lekë, për amortizimin vjetor të AQT-ve viti 2024, pasqyruar kjo në Aneks PF/3 .

Nga auditimi i analizës së llogarive të klasës 2 (për AAGJM) në regjistrin e aktiveve *u konstatua se* amortizimi *nuk është* llogaritur për çdo aktiv, por në grup, duke mos patur kështu informacion mbi aktivet që e kanë vlerën e mbetur të papërfillshme ose zero dhe si rrjedhojë as të paturin nën kontroll të nevojës për rivlerësimin e atyre që janë në gjendje pune, në kundërshtim me Udhëzimit nr. 30/2011 “Menaxhimi i aktiveve në njësitë publike” Kreu II pika 23/d.

- Në llog. 210, llog.211, llog. 212 dhe llog.213 *nuk janë përfshirë* asetet e transferuara me VKM për Bashkinë Përmet, pasi procedurat për pajisjen e tyre me titull pronësie janë të papërfunduara nga ASHK. Rezultoni se këto asete janë të pa kontabilizuara.

25-26 Aktive Afatgjata Financiare në pasqyrat fianciare pasqyrohet në vlerën zero dhe përbëhet nga:

Llog. 25 “huadhënie e nënhuadhënie” në vlerën zero;

Llog.26 “ pjesëmarrje në kapitalin e vet” e cila paraqitet në vlerën 216,752,570 lekë.

Bashkia Përmet referuar Ekstraktit të QKB -së është aksionere me 7.65% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër” Sha me Nipt- M23329601L, ose me 7650 aksione me vlerë nominale 100 lekë/copa. Kjo vlerë është përcaktuar referuar Marrëveshjes “Për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjiellës Kanalizime [SKPUK]” mes 7 Bashkive të Qarkut Gjirokastër dhe MIE, me nr. Prot., 2298 datë 22.07.2022 për Bashkinë Përmet. Bashkia Përmet me anë të shkresës nr. 2071 prot., datë 14.08.2024 i është kërkuar për interpretim Sektorit juridik të AKUK referuar gjetjes së grupit të auditimit të KLSH-së në RPA-

në e fundit. Nga ana e AKUK për këtë shkresë nuk është kthyer asnjë përgjigje; Me anë të shkresës nr. 87 prot., datë 13.01.2025 i është ridërguar shkresa për interpretim dhe përcaktim të saktë të vlerës së aksioneve që Bashkia Përmet ka në UKR Gjirokastër, drejtuar AKUK-së dhe Shoqërisë Rajonale “Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër” Sha. Me shkresën nr.109/1 datë 21.03.2025 UKR Gjirokastër ka kthyer përgjigje ku theksohet fakti se është në proces vlerësimi i kapitalit të secilës bashki dhe raportit ndaj kapitalit në total, pa anashkaluar 51% e MIE. Nga DFB i është kërkuar AUK situacioni përfundimtar i punimeve të kryera në Ujësjiellësin Përmet (pas vitit 2019), i cili në periudhën e transferimit të UK Përmet dhe krijimit të UKR Gjirokastër ishte në proces, ende i papërfunduar. Me përfundimin e tij nga ana e autoritetit kontraktor nuk ishte vënë në dijeni Bashkia Përmet. Me rrugë elektronike në datën 03.04.2025 është dërguar Situacioni dhe është regjistruar në Bashki me nr. 1134 prot., datë 03.04.2025. DFB në llog. 26 "pjesëmarrje në kapitalin e vet" të pasqyrave kontabël ka regjistruar vlerën e certifikuar të Shoqërisë audituese ‘H A’ Shpk me eksperte kontabël H.M të miratuar në prill të vitit 2019, në Raportin e së cilës vlerësohet se kapitali i Shoqërisë UK Përmet Sha është në vlerën 216,752,570 lekë dhe zotërohet në masë të plotë 100% nga aksioneri Bashkia Përmet.

Për sa më lart, nga ana e DFB nuk është reflektuar në llog. 26 të pasqyrave financiare të vitit 2024, vlerën e ndryshuar e situacionit dhe ajo e rekomanduar²³.

Pasqyra statistikore nr. 7/b “Aket afatgjata me vlerë neto”

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të llogaritura nga Bashkia Përmet, janë si më poshtë:

*ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje	5%
*inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi)	20%
*për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi)	25%
*për mjetet e transportit	20%
*për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare)	15%

Llogaria 230 dhe 231 "Investime" për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2023, paraqiten në shumën 0 lekë dhe për vitin 2024 në shumën 0 lekë.

Nr.	Emertimi i Llog	Gjendja fillim viti 2023	Debi	Kredi	Gjendja me 31.12.2024	Diferenca
1	Aktive Afatgjata jomateriale	0			0	
2	Aktive Afatgjata materiale					
Totali						

Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten si më poshtë:

Nr. reshti	Nr Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Teprica ne Fillim te Vitit	Transaksionet e vitit		Teprica ne Fund
				Debi	Kredi	
a	b	c	d	e	f	g
1	I.	SHPENZIMET PER INVESTIME	0	148,612,843	148,612,843	
2	230	Shpenzime per Aktive Afatgjata jo materiale		6,436,047	6,436,047	
3	231	Shpenzime per Aktive Afatgjata materiale		142,176,796	142,176,796	
4	25,26	Shpenzime per Aktive Afatgjata Financiare	0	0	0	0
5	25	Huadhenie dhe nenhuadhenie		0	0	
6	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet				

²³ Trajtuar në auditimin e mëparshëm dhe është lënë rekomandimi 17.1 në RPA.

7	II.	BURIMET PER INVESTIME		148,612,843	148,612,843	
29	III.	BALANCA (II-I)	0	0	0	0
30		(Burimet per Investime minus Shpenzimet per Investime)				

Investimet e kryera gjate vitit 2024 që janë në proces referuar Udhëzimit të MFE nr. 8 dt.09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, veprimet kontabël ndjekin keto hapa: me çeljen e fondeve - debitohet llog. 520 dhe kreditohet llog. 476; me konstatimin e shpenzimit - debitohet llog. 231 dhe kreditohet llog. 404; në momentin e pagesave- debitohet llog. 404 dhe kreditohet llog. 520; në fund te vitit ushtrimor për fondet e përdorura për investimet në proces debitohet llog. 476 dhe kreditohen llog. 720 dhe llog. 4342 për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues; me perfundimin e investimit te konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimin total të vlerës së kontratës bëhet kapitalizimi i aktivitet në debi të llog. 21 (përcaktohet artikulli kontabël) dhe kredi të llog. 231; me kapitalizimin e aktivitet - debitohet llog. 476 dhe kreditohet llog. 105; kreditohet llog. 1011 dhe debitohet llog.105. Pra të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre dhe detyrimet të evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e ndodhjes si shpenzim pavarësisht nga data e pagesës. Në mënyrë analitike aktivitet afatgjata materiale në proces paraqiten në Aneks.

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme dhe paraqesin detyrimet deri më 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2024	Viti 2023	Diferenca/ ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to		41,840,074	-41,840,074
42	Detyrime ndaj personelit	18,993,686	13,165,611	5,828,075
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	995,328	708,161	287,167
435	Sigurime shoqërore	4,653,227	3,850,421	802,806
436	Sigurime shëndetësore	645,761	524,052	121,709
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	19,881,610	17,032,871	2,848,739
467	Kreditorë të ndryshëm	3,868,762		3,868,762
4341	Të tjera operacione me shtetin (detyrime)			
	Gjendja në fund të periudhës	49,038,374	77,121,190	-28,082,816
	Të tjera pasive afatshkurtra	92,232,291	87,840,764	4,391,527
470	Te ardhura per t'u marrë	92,232,291	87,840,764	4,391,527
C	FONDI NETO/FONDET (A-B)	1,375,459,014	1,399,667,662	-24,208,648
D	FONDI I KONSOLIDUAR	1,375,459,014	1,399,667,662	-24,208,648
101	Teprica/deficiti i akumuluar	1,265,815,707	1,268,312,482	2,496,775
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	109,643,307	131,355,180	-21,711,873
E	TOTALI I PASIVIT (B+C)	1,516,729,679	1,564,629,616	-47,899,937

-Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2023 është 41,840,074 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është 0 lekë me një diferencë (-)41,840,074 lekë; ndërsa gjendja e llog. 401-408 paraqet faturat e palikuiduara ndaj të tretëve nga Bashkia Përmet deri më 31.12.2024.

-Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura nga Bashkia Përmet, paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 13,165,611 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024

në vlerën 18,993,686 lekë me një diferencë (shtim) në vlerën 5,828,075 lekë. Vlera e llog.42 përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

-Llogaria 431, “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, paraqitet në vitin 2023 në vlerën 708,161 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 995,328 lekë me një diferencë (shtim) prej 287,167 lekë; vlera e llog. 431 përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor dhe e paguar në Janar të vitit pasardhës. Vlera rakordon me vlerën sipas listëpagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2024 për detyrimet tatimi mbi pagën.

-Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe **llogaria 436** “Sigurime shëndetësore” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 3,850,421 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 4,653,227 lekë për sig. Shoq; në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 524,052 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 645,761 lekë dhe përbën vlerën e papaguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhet në muajin janar të vitit pasardhës. Rezulton se llogaritë janë plotësuar në vlera të sakta dhe se ka informacion analitik për çdo llogari.

Nr.	Pagat Dhjetor 2023	Paga	Sigurime	Tatimi mbi page
1	Punonjësit e Bashkisë në total	18,993,686	5,298,988	995,328

-Llog. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 17,032,871 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 19,881,610 lekë, gjendje e cila përfaqëson vlerën e garancisë 5% kontrate dhe pulla, të cilat rakordojnë me Akt rakordimin me Degën e Thesarit Përmet datë 23.01.2025.

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, përfshin faturat e palikuiduara si detyrime ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera, por të papaguara për mungesë fondesh.

Lëvizjet e llogarisë 467	
Gjendja në 01.01.2024	
Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	
Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	
Gjendja në 31.12.2024	3,868,762

-Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit”, paraqitet me tepricë kreditore në vlerën 109,643,307 lekë në mbyllje të vitit 2024 dhe në vlerën 131,355,180 lekë në mbyllje të vitit 2023 me një diferencë (pakësim) në vlerën -21,711,873 lekë; dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Vlera e saj është e barabartë me diferencën e të ardhurave me shpenzimet, që Bashkia Përmet trashëgon për t'u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me Degën e thesarit Përmet mbi fondet që trashëgohen dhe kuadron me llog. 85 “teprica ose deficieti i periudhës” në pasqyrën format 2 “performanca financiare”.

Pasqyra Format 2 “Performanca financiare” dhe analiza e llogarive të të “Ardhurat” dhe “Shpenzimet”

Kjo pasqyrë ka rubrikën A – Të Ardhurat dhe Rubrikën B- Shpenzimet.

Nga pasqyra në *Aneks PF/ 6.1* rezulton se rubrika e të “Ardhurave” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 514,647,978 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 516,648,118 lekë me një diferencë (shtim) në shumën 2,000,140 lekë që tregon për përmirësim të vjeljes së taksave e tarifave. Analiza e llogarive të të Ardhurave paraqitet si më poshtë vijon:

- Llog. 70 “të ardhura nga taksa e tatime” paraqitet në bilanc të vitit 2023 në vlerën 29,805,548 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 26,330,811 lekë, e cila kuadron me akt rakordimin me thesarin; llog. 70 përbëhet nga:

Llog. 700 “Tatim mbi të ardhurat” në shumën 5,203,752 lekë, që përfshin nënlog. 7000 “Tatim mbi të ardhurat personale” në shumën 5,050,164 lekë dhe nënlog. “Tatim mbi fitimin” në shumën 153,588 lekë;

Llog. 702 "Tatim mbi pasurinë" paraqitet në bilanc të vitit 2024 në vlerën 9,387,512 lekë dhe përfshin nënlog. 7020 "Tatim mbi pasurinë e paluajtshme" në shumën 9,069,742 lekë dhe nënlog. 7021 "Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme" paraqitet në vlerën 317,770 lekë;

Llog. 703 "Tatime mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit" paraqitet në shumën 11,739,547 lekë dhe përfaqëson taksën e pastrimit, ndriçimit, ndërtesës, zënie hapësire publike, etj;

Konstatim: të ardhurat nga gjocat dhe kamatvonesat duhet të pasqyrohen në llogarinë përkatëse
llog. 709 "gjoca e kamatvonesa", për të patur një pasqyrim të drejtë dhe të saktë të vlerave për secilën llogari kontabël. Kjo ka sjellë që llog. 709 të jetë nënvlerësuar;

- **Llog. 71** "të ardhurat jotatimore" paraqitet në bilanc të vitit 2024 në vlerën 22,890,226 lekë, e cila kuadron me akt rakordimin me thesarin;

-**Llog. 710** "të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia" paraqitet në vlerën 3,243,476 lekë dhe përfshin vlerën e nënlog. 7109 "të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia" dhe përbëhet qiraja e asetëve;

-**Llog. 711** "shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare" në vlerën 19,646,750 lekë, që përbëhet nga: nënlog. 7110 "Tarifa administrative dhe rregullatore" në vlerën e 15,610,596 lekë; nënlog. 7111 "të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh" në vlerën 1,905,444 lekë; nënlog. 7113 "të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve" në vlerën 1,999,610 lekë; nënlog. 7115 "gjoca, kamatvonesa dhe zhdëmtime" në vlerën 131,100 lekë;

- **Llog. 72** "Grante korrente" në bilancin e vitit 2024 paraqitet në shumën 462,246,026 lekë dhe përbëhet nga:

-**llog. 720** "Grant korrent i brendshëm" paraqitet në vitin 2024 në shumën 462,246,026 lekë në të cilën përfshihen:

nënlog. 7200 "Nga buxheti për NJQP (qendrore)" në vlerën 343,897,651 lekë;

nënlog. 7204 "Pjesëmarrje në institucione në tatime nacionale" në vlerën 6,282,438 lekë;

nënlog. 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" në vlerën 109,643,307 lekë, e cila kuadron me shumën e gjendjes së llog. 4342 "operacione me shtetin (të drejta)";

nënlog 7207 "sponsorizime të brendshme (nga të tretë)" në vlerën 72,422,630 lekë;

- **Të Ardhura të tjera** në pasqyrat e bilancit të vitit 2024 paraqitet në shumën 0 lekë;

Llog. 73 "Ndryshim i gjendjes së inventarit të produkteve" paraqitet në shumën 5,181,055 lekë. Të Ardhurat rakordojnë me Seksionin e Të Ardhurave në Degën e Thesarit Përmet.

Rubrika B -SHPENZIMET

Referuar të dhënave në pasqyrën *Aneks PF/6.2*, kategoria "Shpenzimet" për vitin 2023 paraqitet në shumën 383,292,798 lekë dhe në vitin 2024 paraqitet në shumën 407,004,811 lekë, analiza e llogarive paraqiten si më poshtë vijon:

- **Llog. 600** "paga dhe përfitime e punonjësve" paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 201,003,503 lekë, dhe rakordon me akt rakordimin me thesarin; vlera e kësaj llogarie përbëhet nga:

Nënlog. 6001 "paga personeli i përhershëm" në shumën 200,248,809 lekë;

Nënlog. 6003 "shpërbime" në shumën 754,694 lekë;

- **Llog. 601** "kontribute të sigurimeve" në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 33,109,763 lekë ku rezulton e pasqyruar vetëm në llogarinë/nënlog. 6010 "kontribut i sigurimeve shoqërore" dhe nënlog. 6011 "kontribut i sigurimeve shëndetsore" nuk pasqyrojnë vlerën e kontributit.

- **Llog. 602** "blerje mallra e shërbime" në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 66,553,964 lekë dhe përbëhet nga vlerat e llogarive si më poshtë:

nënlog. 6020 "materiale zyre të përgjithshme" në vlerën 1,245,385 lekë;

nënlllog. 6021 “materiale dhe shërbime speciale” në vlerën 6,958,358 lekë;
 nënlllog. 6022 “shërbime nga të tretë” në vlerën 12,264,764 lekë;
 nënlllog. 6023 “shpenzime transporti” në vlerën 16,718,446 lekë;
 nënlllog. 6024 “shpenzime udhëtimi” në vlerën 4,800,324 lekë;
 nënlllog. 6025 “shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” në vlerën 2,192,160 lekë;
 nënlllog. 6026 “shpenzime për qiramarrje” në vlerën 0 lekë;
 nënlllog. 6027 “Shpenzime për detyrime për kompensime legale” në vlerën 11,488,491 lekë;
 nënlllog. 6029 “shpenzime të tjera operative” në vlerën 10,877,036 lekë.

- **“Transferime korente”** në pasqyrat financiare të bilancit të vitit 2024 paraqiten në vlerën 101,156,526 lekë, dhe përbëhet nga:
 - **Llog. 604** “Transferime korrente të brendshme” paraqitet në shumën 7,495,954 lekë dhe përfshin nënlllog. 6040 “Transferime korente në nivele të tjera të qeverisë” në shumën 200,000 lekë dhe nënlllog. “Transferime korente të organizatave jo fitimprurëse” në shumën 7,295,954 lekë;
 - **Llog. 606** “transferime për buxhete familjare e individë” që përfshin nënlllog. 6061 “transferime paguara nga Inst. Tjera e Org. Pushteti. Vendor” në shumën 93,660,572 lekë, për pagesat për PAK, Ndihmë ekonomike, Ndihmë raste emergjente e të ndryshme, ndihmë për fatkeqësi natyrore, etj,
 - **Llog. 63** “ndryshimi i gjendjes së inventarit” në vlerën 5,181,055 lekë, e cila kuadron me diferencën e klasës 3 të formatit 1 të bilancit;
 - **Llog. 85** “teprica ose deficit i periudhës (rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor)” është në vlerën 109,643,307 lekë dhe përbëhet nga fondet e përdorura të cilat trashëgohen për tu përdorur në vitin 2025. Kjo vlerë rakordon me diferencën mes të ardhurave dhe shpenzimeve dhe kuadron me llog.85 të formatit 1 të bilancit..
 - **Formati 5** “shënime shpjeguese” është plotësuar sipas formatit të miratuar;
 - **Formati 8** “numri i punonjësve dhe fondi i pagave” është plotësuar saktë, duke dhënë një pasqyrim të plotë të shpërndarjes së fondit të pagave sipas kërkesave të formatit në Aneks PF7 Tek Formatit 8 i bilancit Fondi i pagave gjithsej është i barabartë me llog 6001 Paga personeli të Formatit 2 i Bilancit;

Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të Formatit 8 i Bilancit është i barabartë me pagesat e kryera për këtë llogari që janë të pasqyruara në evidencën e realizimit të shpenzimeve me thesarin si dhe është pasqyruar në ditarin e bankës (llog 435+llog 436).
 Tatimi mbi të ardhurat të Formatit 8 i Bilancit është i barabartë me pagesat e kryera për këtë llogari që janë të pasqyruara në evidencën e realizimit të shpenzimeve me thesarin si dhe është pasqyruar në ditarin e bankës (llog. 431).
 U kërkuan dhe u verifikuan borderotë e viti 2024. Rezultuan praktikë e plotë dokumentare dhe me nënshkrimin e personave përgjegjës.
 Për pasqyrën Formatit 8 janë zbatuar drejt Udhëzimi i MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022, kreu I, II dhe III; Aneksi I.

3.3 Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

Bashkia Përmet të ardhurat nga tarifatat dhe taksat vendore i vjel nëpërmjet UK Përmet tani UK Rajonale Gjirokastrë. Përjashtim bën vetëm NJA Frashër arkëtimi i tyre kryhet në zyrat e saj manualisht, pasi në territorin e saj nuk ka ujësjellës. Përjashtim bëjnë subjektet private (jo në çdo rast) dhe institucionet të cilat detyrimet për llogari të bashkisë Përmet i kryejnë nëpërmjet sistemit bankar.

1. Veprimet me bankën, u kërkuan këto Urdhër shpenzimi:

USH 75 date 29.01.2024	U Sh 902 date 21.10.2024
------------------------	--------------------------

USH 149 date 13.02.2024	USH 907 date 22.10.2024
USH 510 date 10.06.2024	USH 910 date 22.10.2024
USH 511 date 10.06.2024	USH 1015 date 19.11.2024
USH 597 date 09.07.2024	USH 1089 date 13.12.2024

Nga auditimi rezultoi se Urdhër Shpenzimet bashkëngjitur përmbanin praktikën e plotë dokumentare sipas kuadrit ligjor në fuqi: dokumenti autorizues, vërtetues dhe të kontabilitetit.

2. Veprimet me arkën Nga auditimi i dokumentacionit për veprimet me arkën rezultoi se:

- Arkëtimet kryhen në zyrën e taksave në NJA Frashër në Librat e arkës;
- kryhen akt rakordimet ditore midis arkëtares dhe specialistes së taksave;;
- Shuma ditore e arkëtuara në zyrën e Taksave të NJA derdhet totalisht në Bankë nga specialisti i taksave, duke mos lënë gjendje në arkë.
- Zyra e taksave përpilon ditarin dhe librin e pagesave;
- Akt rakordim mes zyrës së taksave të NJA Frashër me Sektorin e të Ardhurave në bashki;
- Akt rakordim mujor mes Sektorit të financës dhe Sektorit të Taksa e Tarifave vendore me degën e Thesarit.
- Akt rakordim mes Sektorit të të ardhurave dhe UKR Gjirokastrë-sha.

Gjithë dokumentacioni i mësipërm përmban nënshkrimin e personave përgjegjës të secilës procedurë.

Veprimet janë konform me Udhëzimin nr. 30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” KREU III paragrafi “Dokumentimi i vlerave monetare dhe atyre me vlerë” pika 61-72.

Nga auditimi i librit të arkës dhe ditarit të arkës, rezultoi se, të ardhurat nga arkëtimet e kryera janë derdhur totalisht në bankë dhe gjendja e arkës në fund të çdo muaji dhe në fund të vitit është zero lekë. Të gjitha të ardhurat e arkëtuara janë bërë derdhje në bankë në mënyrë periodike dhe arka rezulton me gjendje zero në fund të muajit. Gjithashtu është mbajtur ditari i arkës në formën klasike kontabël i cili rezulton i kuadruar. Përfshirja e shumës së të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël.

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e Thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumën për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor, rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës, i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

3.4 Procedura e inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Përmet.

Bashkia Përmet nëpërmjet Urdhrit të Titullarit nr. 386 datë 01.11.2024 dhe me nr. 2890 prot., datë 01.11.2024, është ngritur komisioni i inventarizimit fizik vlerësimit paraprak si më poshtë vijon:

Inventarizimi i Aktiveve Bashkia Përmet 2024							
Komisioni i inventarizimit fizik dhe vlerësimit paraprak				Komisioni i vlerësimit të aktiveve të cilësuar të dëmtuara Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuar të dëmtuara për asgjësim			
Emër	Mbiemër	Statusi	Pozicioni strukturë në	Emër	Mbiemër	Statusi	Pozicioni strukturë në
1.K	G	Kryetar	Pr.SFB	1.E	K	Kryetar	NZ
2.A	S	anëtar	ADSH/NJAP	2.E	M	anëtar	Dr. DZHE
3.A	M	-/-	P.SH/NJAF	3.Ze	Ja	-/-	Pr. SBNJ
4.M	S	-/-	P.Taks/NJAP	4.Fr	L	-/-	Kr.MZSH
5.Ja	M	-/-	P.Taks/NJAÇ	5.K	G	-/-	Sp.SF
6.		-/-		6.Gj	T	-/-	Sp.IT
7.		-/-		7. Nga 1 punonjës për çdo NJAdministrative		-/-	

Burimi: Bashkia Përmet

Nga Auditimi i praktikës dokumentare të inventarizimit **rezultton** se:

- Komisioni i inventarit fizik dhe ai i vlerësimit të aktiveve është i njëjtë, konform nenit 97 të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar;

- Komisioni i inventarizimit dhe i vlerësimit paraprak të aktiveve ka ndarë në dokumente të veçanta Relacionin për mbylljen e inventarizimit fizik të njësisë dhe Relacionin e vlerësimit paraprak të inventareve cilësuar si të dëmtuara, konform pikës 82 dhe 99 Kreu IV të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar;

-Komisioni i inventarizimit fizik dhe i vlerësimit paraprak të aktiveve nuk ka përpiluar proces verbalet për çdo njësi të strukturës e përfshirë në procesin e inventarizimit në kundërshtim me pikën 85/a të Udhëzimit nr. 30/2011, por ka hartuar Relacionin përmbledhës mbështetur mbi shënimet tek kartela kontabël e vënë në dispozicion nga zyra e financës. Relacioni përmbledhës ka informacionin si më poshtë vijon:

-Materialet e Repertorit: Lipivan, Borockë dhe Çarshovë, janë dorëzuar në RTSH/Tiranë, propozuar për shkarkim nga regjistri i inventarit të Bashkisë

	Nr	Vlera /lekë
Llog.214		1,108,600
Llog. 327		81,000
Llog. 218		276,965
Totali		1,466,565

-Materialet e klasës së internetit në shkollën Kosinë, janë vjedhur, propozuar për shkarkim nga regjistri i inventarit të Bashkisë:

	Nr	Vlera /lekë
Llog. 214		675,137
Totali		675,137

-Materialet e Repertorit Përmet që janë vjedhur (Procesverbali i datës 05.03.2021), propozuar për shkarkim nga regjistri i inventarit të Bashkisë:

	Nr	Vlera /lekë
Llog. 218		198,300
Totali		198,300

Totali:

	Nr	Vlera /lekë
Llog.214		1,108,600
Llog. 327		81,000
Llog. 218		276,965
Llog. 214		675,137
Llog. 218		198,300
Totali		2,340,002

- Me Urdhrin e Kryetarit nr. 33 datë 03.02.2025 është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve materiale dhe materialeve të cilësuar të dëmtuara (në tabelën më lart)

Ky komision është duke zhvilluar procedurën e vlerësimit të aktiveve të cilësuar të dëmtuara, jo vetëm të atyre të propozuara nga komisionet e dy viteve të fundit (2023 dhe 2024), por edhe të atyre më të hershme (nga viti 2011). Pra procedura e vlerësimit të aktiveve është në proces dhe brenda afatit të përcaktuar, deri në datën 30.04.2025.

Komisioni i vlerësimit të aktiveve të cilësuar të dëmtuara, ka një anëtar i cili rezulton në të dy komisionet, specialisti i financës duke cenuar kështu rregullshmërinë e procesit të inventarizimit në tërësinë e tij, pasi referuar pikës 84 të këtij udhëzimi ku citohet..” *Inventarizimi periodik i*

aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision”.dhe rrjedhimisht,i njëjti person (specialist i financës në rastin konkret), nuk mund dhe nuk duhet të jetë në 2 komisione të niveleve të ndryshme brenda vitit të të njëjtës procedurë.

▪ Vlerësimi i aktiveve bëhet sipas këtyre kriterëve:

a) kur është plotësuar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, afatit të skadencës, nëse ka, dhe nuk mund të riparohen;

b) kur riparimi është i pamundur si pasojë e konsumit dhe kur nuk mund të përshtaten për përdorim tje tër;

c) kur thyhen ose dëmtohen në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit;

d) kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm;

e) kur ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formën tjetër;

f) kur kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë;

g) kur janë dëmtuar e janë bërë të papërdorshme, si pasojë e fuqisë madhore (tërmet, përmytje, zjarr etj.) ose ndodhive të rastit;

h) kur si pasojë e ndryshimit të kërkesave teknike, kushteve të punës, misionit të njësisë, objektivave afatmesëm ose afatgjatë nuk janë gjetur mundësitë e përdorimit për qëllimin e caktuar ose për qëllime të tjera, ashtu siç janë ose edhe me përshtatje

- Në përfundim të procedurës së inventarizimit të njësisë, nuk është hartuar dhe miratuar Regjistri i aktiveve të bashkisë (për vitin 2023 pasi procedura për vitin 2024 është në proces). Nga SFB është hartuar vetëm regjistër elektronik i cili përfshin informacionin e plotë sipas kërkesave ligjore, mosveprime këto në kundërshtim me kreun II, Paragrafi III, pika 26,27,28 të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar;

4.Auditim mbi planifikimin, dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me VKB sipas viteve përkatëse bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

-Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH- së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE,u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, nga subjekti Bashkia Përmet referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve janë zhvilluar gjithsej 42 procedura prokurimi me fond limit 143,527 446,8 lekë pa TVSH, me vlerë kontrate 118,878,639.22 lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi

limit në shumën 24,289,908,5 lekë pa TVSH, ose 17 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Viti 2023					
Lloji i procedurës	Nr.	Fondi limit pa TVSH	Kontrata pa TVSH	Fondi total i kursyer pa TVSH	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit
Procedurë e hapur;	3	109,583,793	90,429,221	19,154,572	17.5 %
Procedurë e hapur e thjeshtuar;	5	19,847,066.6	17,898,437	1 948 629.6	10 %
Prokurim me vlerë të vogël	29	13,703,055.2	10,181,981.22	3 521 073.98	25.6 %
Prokurim me vlerë të vogël nën 100 mijë lekë	5	393,532	369,000	24 532	7 %
SHUMA	42	143,527,446,8	118,878,639.22	24,648,807.58	17 %

Burimi: Bashkia Përmet.

Për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, nga subjekti Bashkia Përmet referuar të dhënave të regjistrimit të prokurimeve janë zhvilluar gjithsej 44 procedura prokurimi me fond limit 284,800 418.9 lekë pa TVSH, me vlerë kontrate 245,032,655.07 lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 39,767,763.83 lekë pa TVSH, ose 14.3%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Lloji i procedurës	Nr.	Fondi limit pa TVSH	Kontrata pa TVSH	Fondi total i kursyer pa TVSH	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit
Procedurë e hapur;	5	243 747 134.7	211 529 418.9	32 217 715.86	13.2%
Procedurë e hapur e thjeshtuar;	6	25 777 849.17	20 869 299.58	4 908 549.59	19 %
Prokurim me vlerë të vogël	27	14 772 102	12 176 344.92	2 595 757.08	17.5%
Prokurim me vlerë të vogël nën 100 mijë lekë	6	503 333	457 591.67	45 741.33	9%
SHUMA	44	284,800,418.9	245,032,655.07	39,767,763.83	13.9%

Burimi: Bashkia Përmet.

Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura. Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSHsë, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, përzgjedhi për auditim: 5 procedura prokurimi me vlerë kontrate 118,902,664 lekë, ose **96 %** e totalit të fondit të kontratave të lidhura për periudhën objekt auditimi 01.01.2023-31.12.2023 si më poshtë:

Nr	Objekti	Fondi limit	Oferta fituese	Diferenca ne leke pa TVSH	Operatori fitues
1	Blerje karburant për Bashkinë Përmet dhe institucionet në varësi për vitin 2023	14,020,000	11,742,334	2,277,666	K. Shpk
2	Rehabilitimi i Digës së Rezervuarit Pacomit, Bashkia Përmet	39,822,000	38,695,735	1,126,265	2. Sh.p.k
3	Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara	9,318,871	7,926,814	1,392,057	A. Sh.p.k
4	Rikonstruksion i Pallatit të Sportit, Qytet Përmet	55,741,793	39,991,152	15,750,641	L. V Sh.p.k
5	Blerje ushqimesh për kopshtin/cerdhen /koviktin	5,403,770	4,921,420	482,350	G - 1987

Burimi: Bashkia Përmet.

Për vitin 2024 u përzgjedhën 5 procedura prokurimi me vlerë kontrate 228,572,433 lekë, ose **93 %** e totalit të fondit të kontratave të lidhura për periudhën objekt auditimi 01.01.2024-31.12.2024 si më poshtë:

Nr	Objekti	Fondi limit	Oferta fituese	Diferenca ne leke pa TVSH	Operatori fitues
1	Blerje karburant për Bashkinë Përmet dhe institucionet në varësi për vitin 2024	13,422,500	11,154,481	2,268,019	O sh.p.k
2	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Meleq Gosnishti" Përmet	103,642,065	98,407,650	5,234,415	Z. sh.p.k
3	Ndërtim i Kanalit Ujitës Bual, Përmet	36,249,312	34,837,848	1,411,464	Boe E. dhe M
4	Rikonstruksion i Rrugës Qilarisht	65,627,871	43,159,116	22,468,755	K. sh.p.k
5	Punime shtesë për sistemime të brendshme dhe të jashtme në objektin Pallati i Sportit Përmet	9,630,685	6,442,421	3,188,264	H. sh.p.k

Burimi: Bashkia Përmet.

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Regjistri i realizimit të prokurimeve të periudhës 01/01/2023 – 31/12/2023 dhe 01/01/2024-31/12/2024;
- 2- Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut;
- 3- DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;
- 4- Sistemi elektronik i APP, sipas kodit të marrë nga APP si Auditues;
- 5- Dosjet fizike të OE/BOE shpallur fitues;

Nga auditimi me zgjedhje i procedurave të prokurimit, rezultoi si vijon:

1. Prokurimi me objekt: Rehabilitimi i Digës së Rezervuarit Pacomit, Bashkia Përmet

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rehabilitimi i Digës së Rezervuarit Pacomit, Bashkia Përmet		
1. Urdhër Prokurimi 243 datë 16.08.2023	3. Njësia e Prokurimit Urdhër nr. 253 datë 30.08.2023 P.M G.I B.M	4. Komisioni VO Urdhër nr. 254 datë 30.08.2023 D.D F.H B.I
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur-punë		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 39,822,000	6. Oferta fituese (pa TVSH) 38,695,735	7. Diferenca me fondin limit 1,126,265
8. Data e hapjes së tenderit 18.09.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10. Operatorë Ekonomik pjesëmarrës 1. Oe A.C Shpk 2. Boe A. Shpk dhe 6d - P Shpk 3. Oe B. Shpk 4. Oe C. Shpk 5. Oe F Shpk 6. Oe H. Shpk 7. Oe K.K Shpk 8. Oe R. 9. Oe RR.G Shpk 10. Boe T. Shpk Dhe C. Dhe 6d - Plan Shpk 11. 2. Sh.p.k (Fituesi) Të Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata nr.2814prot		
14. Lidhja e kontratës datë 20.10.2023	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 6,434,882	

I. Fondi limit: Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 39,822,000 lekë pa TVSH

-Për vitin 2023 vlera e financimit është 30,947,802 lekë pa TVSH.

- Për vitin 2024 vlera e financimit është 8,874,197, lekë pa TVSH.

Me urdhër nr. 243 prot., datë 16.08.2023 është mbajtur proces verbali për ngritjen e komisionit për llogaritjen e vlerës limit, komision i cili është i përbërë nga z. P.M , z. G.I, z. B.M. Sa i përket preventivit të punimeve i cili është hartuar në bazë të një kontrate dhurimi nga, kontratë me nr.666 prot., datë 01.03.2022 ndërmjet subjektit Bej-74 dhe si përfitues Bashkia Përmet. Preventivi është hartuar në bazë Manualit të çmimeve miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015, i ndryshuar. Nga verifikimi zërave të preventivit konstatohet se, për zërin 3.106/a “Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, prani uji ~ 2m kategoria IV, me shk ne mjet” nga preventivuesi është llogaritur në vlerën 361 lekë për m³ ndërsa në manual llogaritet 314 për m³ pra 47 lekë për m³ më shumë x 4250 m³ bazur në preventiv =199,750 lekë më shumë. Këto veprime janë në kundërshtim me Manualit të çmimeve miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015, i ndryshuar.

II. Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit: Me urdhër nr. 253 datë 30.08.2023 është ngritur Njësia Prokurimit publik e përbërë nga zj. P.M Kryetar, G.I Anëtar, dhe z. B.M.

-Në lidhje me kriterin 2.3.3 është kërkuar nga Operatori Ekonomik ofertues që duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 35 (tridhjetë e pesë) punonjës të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

-Referuar zërave të punimeve, numri prej 35 punonjësish është kriter i pa argumentuar, nuk ka një analizë për përcaktimin e fuqisë punëtore, në lidhje me orët e punës për çdo zë punimi sipas manualit në fuqi, me volumet e punës sipas preventivit dhe me afatin e punimeve sipas grafikut të punimeve. Përa i përket pjesës ku shprehen për periudhën kohore që duhet të jenë në listapagesat për 5 muajt e fundit është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar. Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: zj.P.M, z.G.I, z.B.M.

III.Vlerësimi i Ofertave: Me shkresën nr. 2777 prot., datë 17.10.2023, është hartuar Raporti Përmbledhës drejtuar për dijeni titullarit të AK. Në vijim, është finalizuar procedura me lidhjen e kontratës nr. 2814, datë 20.10.2023.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1.2. sh.p.k me Nipt K.....M me vlerë oferte 38,695,735 pa TVSH.

2.A.C sh.p.k me nipt K.....F me vlerë oferte 39,256,225 lekë pa TVSH.

3.BOE A. sh.p.k me Nipt M.....L dhe 6 SHPK me Nipt L.....H me vlerë oferte 26,877,010 lekë pa TVSH.

4.B. sh.p.k me Nipt J.....V me vlerë oferte 39,380,150 lekë pa TVSH.

5.C. sh.p.k me Nipt K.....Mme vlerë oferte 32,654,112 lekë pa TVSH.

6.F me Nipt K.....C Pa vlerë të ofertës.

7.H. sh.p.k me Nipt J...B me vlerë oderte 39,223,950 pa TVSH.

8.K.Ksh.p.k me Nipt K..... Pa vlerë të ofertës.

9.R.SHPK me Nipt J,.....E Pa vlerë të ofertës.

10.RR.G sh.p.k me Nipt K.....H Pa vlerë të ofertës.

11.BOE T. shpk me Nipt K....L dhe C. SHPK me Nipt J.....K dhe 6.SHPK sh.p.k me Nipt L.....H me vlerë oferte 24 408 815 lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm për mosplotësim kriteresh:

-A.Csh.p.k me nipt K.....F me vlerë oferte 39,256,225 lekë pa TVSH.

-BOE A. sh.p.k me Nipt M.....L dhe 6D -Plan sh.p.k me Nipt L.....H me vlerë oferte 26,877,010 lekë pa TVSH.

-B. sh.p.k me Nipt J.....V me vlerë oferte 39,380,150 lekë pa TVSH.

-OE C. sh.p.k me Nipt K.....Mme vlerë oferte 32,654,112 lekë pa TVSH.

-OE F me Nipt K.....C Pa vlerë të ofertës.

-OE K.K sh.p.k me Nipt K..... Pa vlerë të ofertës.

-OE R.SHPK me Nipt J,.....E Pa vlerë të ofertës.

-OE RR.G sh.p.k me Nipt K.....H Pa vlerë të ofertës.

-BOE T. sh.p.k me Nipt K....L dhe C. SHPK me Nipt J.....Kdhe 6 SHPKme Nipt L.....H me vlerë oferte 24,408,815 lekë pa TVSH.

Për arsyet e mëposhtme:

1.Operatori Ekonomik A.C sh.p.k me Nipt K.....F konkretisht për arsyet e mëposhtme:

Nuk përmbush pikën 2.3.1 për përvojë të suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme për pikën 2.3.1 a ose b. Kontratat e paraqitura janë të ndryshme nga natyra e punimeve të kërkuara për këtë objekt dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen as si kontrata të ngjashme pasi nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në natyrë, kompleksitet dhe metodologji. Natyra e objekteve të paraqitura nga OE nuk është e ngjashme pasi produkti është i ndryshëm. Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga ky si kandidat ofertues.

Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.3.5 të DST-ve Ing.Gjeoteknik Zj. F.M nuk figuron në Liçensën profesionale të Shoqërisë siç dhe ka deklaruar OE mbështetës K. sh.p.k në formularin e e vetëdeklarimit.

Në shtojcën 8 të formularit të vetëdeklarimit shkronja C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” në tabelën e mjeteve dhe paisjeve në pronësi ose qera ka paqartësi në raport me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit në pikën 2.3.11 dhe vetëdeklarimit si më poshtë: Janë deklaruar nga OE A.C sh.p.k paisjet në pronësi: -Kamion vetëshkarkues me targa TR....K dhe AB....KV por pa përcaktuar kapacitetin mbajtës të kërkuar 10-20 ton. Po kështu është deklaruar Kamionçinë me targa AA...SN por pa përcaktuar kapacitetin mbajtës të kërkuar 2-5 ton.

2.Bashkimi i Operatorëve Ekonomik A. sh.p.k me Nipt M.....L dhe 6. SHPK sh.p.k me Nipt L.....H Konkretisht për arsyet e mëposhtme:

Në përmbushje të pikës 2.2.3 të DST-ve mungon deklarata për pagimin e të gjitha detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022 për të dy operatorët ekonomikë pjesë e bashkimit.

Nuk përmbush pikën 2.3.1 për përvojë të suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme për pikën 2.3.1 a ose b. Kontratat e paraqitura janë të ndryshme nga natyra e punimeve të kërkuara për këtë objekt dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen as si kontrata të ngjashme pasi nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në natyrë, kompleksitet dhe metodologji. Natyra e objekteve të paraqitura nga OE nuk është e ngjashme pasi produkti është i ndryshëm. Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga ky BOE si kandidat ofertues.

Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.2.2 Bilancet e viteve 2020, 2021, 2022. ë OE 6.SHPK sh.p.k nuk është janë të shoqëruara me Akt-Ekspertizën përkatëse po kështu bilanci i vitit 2022 është vetëm me firmë nga drejtuesi i njësisë ekonomike S.K.

Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.3.9 të DST-ve pas verifikimit online Çertifikata për sistemimin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015; Çertifikata për sistemimin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 dhe Çertifikata për sistemimin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001:2018 të paraqitura në SPE për OE 6.SHPK sh.p.k nuk janë të vlefshme.

Çertifikatat ISO të kërkuara në pikën 2.3.9 të OE A. shpk nuk kanë në fushën e tyre të çertifikimit objektin e prokurimit.

Në shtojcën 8 të formularit të vetëdeklarimit shkronja C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” në tabelën e mjeteve dhe paisjeve në pronësi ose qera ka paqartësi në raport me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit në pikën 2.3.11 dhe vetëdeklarimit si më poshtë: Janë deklaruar paisjet me qera të OE 6D- P sh.p.k pjesë BOE: -Kamion me targa AA....MB; AA...PU por pa përcaktuar kapacitetin mbajtës të kërkuar 10-20 ton. Po kështu është deklaruar kamionçinë me faturë tatimore shitje nr.38391322 pa kapacitet mbajtës.

OE 6.SHPK sh.p.k pjesë e këtij BOE është subjekt mbështetës në të njëjtën procedurë edhe tek një BOE tjetër në shkelje të nenit 90 pika 7 paragrafi 2. ë VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

3.Operatori Ekonomik B. sh.p.k me Nipt J.....V konkretisht për arsyet e mëposhtme:

OE nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3. Nuk përmbush pikën 2.3.1 për përvojë të suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme për pikën 2.3.1 a ose b. Kontrata e paraqitur është e ndryshme nga natyra e punimeve të kërkuara për këtë objekt dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet as si kontratë e ngjashme pasi nuk përmbush karakteristikat e kontratës në natyrë, kompleksitet dhe metodologji. Natyra e objekteve të paraqitura nga OE nuk është e ngjashme pasi produkti është i ndryshëm. Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga ky si kandidat ofertues. Nuk përmbush pikën 2.3.2. ë DST-ve pasi sipas liçensës profesionale NZ.3362/13 datë 29.07.2020 të këtij OE nuk ka kategorinë e kërkuar NP-6A.

Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.3.4 dhe 2.3.5 nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit 1 (një) inxhinier gjeodet; 1 (një) Ing.Ndërtimi; 1 (një) Ing. Gjeoteknik.

Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.3.6 nga 3 (tre) Hekurkthyes ka deklaruar 2 (dy) dhe nga 5 (pesë) Karpentier ka deklaruar 2 (dy). 11 (njëmbëdhjetë) punëtorët e kërkuar në formularin e vetëdeklarimit janë pa emra.

Çertifikatat ISO të kërkuara në pikën 2.3.9 nuk kanë në fushën e tyre të çertifikimit objektin e prokurimit.Në shtojcën 8 të formularit të vetëdeklarimit shkronja C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” në tabelën e mjeteve dhe paisjeve në pronësi ose qera në raport me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit në pikën 2.3.11 dhe vetëdeklarimit si më poshtë: Ky OE nuk ka deklaruar Eskavator me krah 1(një) copë; Matrapik 1 (një) copë; Kompresor 1 (një) copë; Autobetoniere nga 2 (dy) copë të kërkuara është deklaruar vetëm 1 (një) copë me targa AF..... Kokore ka deklaruar vetëm 29 copë nga 35 copë të kërkuara.

4.Operatori Ekonomik C. sh.p.k me Nipt K.....M konkretisht për arsyet e mëposhtme:

Nuk përmbush pikën 2.3.1 për përvojë të suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme për pikën 2.3.1 a ose b. Kontrata e paraqitur është e ndryshme nga natyra e punimeve të kërkuara për këtë objekt dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet as si kontratë e ngjashme pasi nuk përmbush karakteristikat e kontratës në natyrë, kompleksitet dhe metodologji. Natyra e objekteve të paraqitura nga OE nuk është e ngjashme pasi produkti është i ndryshëm. Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga ky si kandidat ofertues. Në përmbushje të pikës 2.3.4 Ing.Hidroteknik z. DH.N i deklaruar në formularin e vetëdeklarimit nuk figuron i siguruar në listëpagesën e muajit qershor. Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.3.6 11 (njëmbëdhjetë) punëtorët e kërkuar në formularin e vetëdeklarimit janë pa emra.

5.Operatori Ekonomik F. sh.p.k me Nipt K.....C pa ofertë konkretisht për arsyet e mëposhtme:

Ky OE nuk plotëson asnjë prej kërkesave për kualifikim të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në DST, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e tyre dhe as ofertë ekonomike dhe rrjedhimisht skualifikohet nga procedura objekt prokurimi.

6.Operatori K.K. sh.p.k me Nipt K..... pa ofertë Konkretisht për arsyet e mëposhtme:

OE nuk ka paraqitur në SPE Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 për përmbushjen e pikave 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7, 2.3.8, 2.3.11 të DST-ve.

OE nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3.

Në përmbushje të pikës 2.2.3 të DST-ve mungon deklarata për pagimin e të gjitha detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022. Nuk përmbush pikën 2.3.1 për përvojë të suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme për pikën 2.3.1 a ose b. Kontratat e paraqitura janë të ndryshme nga natyra e punimeve të kërkuara për këtë objekt dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen as si kontrata të ngjashme pasi nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në natyrë, kompleksitet dhe metodologji. Natyra e objekteve të paraqitura nga OE nuk është e ngjashme pasi produkti është i ndryshëm. Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitura nga ky si kandidat ofertues. Çertifikatat ISO të kërkuara në pikën 2.3.9 nuk kanë në fushën e tyre të çertifikimit objektin e prokurimit. Ky OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në SPE për përmbushjen e pikës 2.3.10 dhe 2.3.12. ë DST-ve.

7.Operatori R.SHPK me Nipt J,.....E pa ofertë konkretisht për arsyet e mëposhtme:

Ky OE nuk plotëson asnjë prej kërkesave për kualifikim të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në DST, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e tyre dhe as ofertë ekonomike dhe rrjedhimisht Skualifikohet nga procedura objekt prokurimi.

8.Operatori Ekonomik RR.G sh.p.k me Nipt K.....H pa ofertë konkretisht për arsyet e mëposhtme:

Ky OE nuk plotëson asnjë prej kërkesave për kualifikim të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në DST, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e tyre dhe as ofertë ekonomike dhe rrjedhimisht skualifikohet nga procedura objekt prokurimi.

9. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik T. sh.p.k me Nipt K....L dhe C. SHPK me Nipt J.....K dhe 6 SHPK me Nipt L.....H konkretisht për arsyet e mëposhtme:

Gjatë verifikimit të preventivit ka gabime në llogaritje. Totali i zërave të preventivit të paraqitur nuk rakordon me shumën totale të ofertuar. Diferenca midis ofertës dhe llogaritjeve që dalin nga preventivi i paraqitur në SPE është në vlerën 3,447,115 pa TVSH dhe 4,136,538 me TVSH çka ndikon në vlerën totale të ofertës. Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.2.2 Bilanci i Vitit 2020 i OE C. SHPK nuk është i shoqëruar me Akt Ekspertizën përkatëse.

Nuk janë paraqitur në SPE bilancet 2020, 2021, 2022. ë OE 6.SHPK pjesë e BOE në përmbushje të pikës 2.2.2. Në përmbushje të pikës 2.2.3 të DST-ve mungon deklarata për pagimin e të gjitha detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022 nga të tre OE pjesë e BOE.

Nuk përmbush pikën 2.3.1 për përvojë të suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme për pikën 2.3.1 a ose b. Kontratat e paraqitura nga të tre OE pjesë e Bashkimit të Operatorëve janë të ndryshme nga natyra e punimeve të kërkuara për këtë objekt dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen si kontrata të ngjashme pasi nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në natyrë, kompleksitet dhe metodologji. Natyra e objekteve të paraqitura nga OE nuk është e ngjashme pasi produkti është i ndryshëm. Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitura nga ky si kandidat ofertues. OE T. shpk nuk përmbush pikën 2.3.2. ë DST-ve pasi sipas liçensës profesionale të tij NZ.4283/7 datë 31.05.2023 nuk ka kategoritë e kërkuara NP-6A dhe NP-12A.

OE C. SHPK nuk përmbush pikën 2.3.2. ë DST-ve pasi sipas liçensës profesionale të tij NZ.2944/20 datë 07.10.2019 nuk ka kategoritë e kërkuara NP-5A dhe NP-6A.

Në përmbushje të pikës 2.3.5 Inxh. Mjedisi Zj.M.Gj. i deklaruar nga OE C. SHPK nuk figuron në liçensën profesionale të shoqërisë NZ.2944/20.

Në përmbushje të pikës 2.3.5 Inxh. Gjeoteknik z.E.A i deklaruar nga OE 6.SHPK sh.p.k nuk figuron në liçensën profesionale të shoqërisë NZ.7741/5.

Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.3.9 të DST-ve pas verifikimit online Çertifikata për sistemimin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015; Çertifikata për sistemimin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 dhe Çertifikata për sistemimin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001:2018 të paraqitura në SPE nga OE 6.SHPK nuk janë të vlefshme.

Në shtojcën 8 të formularit të vetëdeklarimit shkronja C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” në tabelën e mjeteve dhe paisjeve në pronësi ose qera ka paqartësi në raport me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit në pikën 2.3.11 dhe vetëdeklarimit si më poshtë: Janë deklaruar pajisjet në pronësi të OE C. SHPK pjesë BOE: -Kamion me targa AA....B; AB.....EY por pa përcaktuar kapacitetin mbajtës të kërkuar 10-20 ton. Po kështu OE T. sh.p.k ka deklaruar Autovinq me targa AB....DN pa kapacitetin mbajtës. OE 6.SHPK sh.p.k pjesë e këtij BOE është subjekt mbështetës

në të njëjtën procedurë edhe tek një BOE tjetër në shkelje të nenit 90 pika 7 paragrafi 2. ë VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht, nga OE shpallur fitues konstatohet se:

Nuk plotësohet pika 2.3.3 ku thuhet se listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi

Grupi i auditimit referuar legjilacionit në fuqi, konkretisht formatit që kërkohet ka konstatuar se: Në DST, lidhur me punësimin e stafit mbështetës, me profesionin “Hidroizolues”. Konkretisht nga verifikimi i dokumentacionit “Shtojca 8”, të plotësuar nga OE 2. sh.p.k pasi ky OE, rezulton se ka deklaruar, me profesionin “Murator” punonjësit “A.P” dhe “B.V”. Nga verifikimi i dokumentacionit “listëpagesa” mbi punonjësin “A.P” dhe “B.V”, konstatohet se ai figuron i punësuar me kodin e profesionit 9312.02, ndërkohë duhet të ishte me kod profesioni 7124. Sqarojmë se bazuar në përcaktimet e bëra në VKM nr.514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve” (LKP), të rishikuar, punonjësit e regjistruar në listëpagesë me kodin 9312.02, klasifikuar si “Punëtor Krahu”, ndërkohë për prokurimin përkatës duhen punonjës me kod profesioni 7124 “Hidroizolues”, i cili kryen sikurse e kërkon profesioni. Për punonjësin G.K është deklaruar me profesionin “Karpentier”, nga verifikimi i listpagesës rezulton me kod profesioni 9312.02 kod i cili e klasifikon si “Punëtor Krahu”, në një kohë që duhej klasifikuar me kod profesioni 715.02 si “Karpentier”.

Për punonjësin RV është deklaruar me profesionin “Manovrator”, nga verifikimi i listpagesës rezulton me kod profesioni 3119.15 kod i cili e klasifikon si “Teknik Ndërtimi”, në një kohë që duhej klasifikuar me kod profesioni 8111.02 si “Manovrator”.

Për punonjësin I.D është deklaruar me profesionin Hidraulik, nga verifikimi i listpagesës rezulton me kod profesioni 8111.02 kod i cili e klasifikon si “Makinist hapës kanalesh/Eskavatorist”, në një kohë që duhej klasifikuar me kod profesioni 7126.03 si “Hidraulik”.

Sqarojmë se bazuar në Udhëzimin nr.23, datë 09.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar, për plotësimin e rubrikave të deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë mbajnë parasysh sa më poshtë respektimin e pikave 1-12, ndër të cilat është edhe pika 11. Në rubrikën 11 “Detyra, funksioni, profesioni apo puna që ka kryer punonjësi” – shënohet detyra apo profesioni që punonjësi kryen në tatimpaguesin përkatës. Detyra apo profesioni zgjidhen nga lista kombëtare e profesioneve.

Sa më sipër rezulton se KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80. Parimet e procesit të përzgjedhjes, pika1, “Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura; neni 92 pika 3, “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”. Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon D.D , F.H , B.I .

2. Prokurimi me objekt: Rikonstruksion i Pallatit të Sportit, Qytet Përmet

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksion i Pallatit të Sportit, Qytet Përmet	
1. Urdhër Prokurimi nr.350 datë 01.11.2023	4. KVO nr.362 datë 14.11.2023

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur -Punë	3. Njësia e Prokurimit nr.361 datë 14.11.2023 P.M G.I K.I	F.H D.D A.P
5. Fondi Limit (pa TVSH) 55,741,793	6. Oferta fituese (pa TVSH) 39,991,152 L. VII Sh.p.k	7. Diferenca me fondin limit 15,750,641
8. Data e hapjes së tenderit 04.12.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomik Pjesmarrës 1. Boe A. Shpk Dhe A.C Shpk 2. Oe A.2 Shpk 3. Oe A. Shpk 4. Oe B. Shpk 5. Oe B. Shpk 6. Oe C. Shpk 7. Boe C. Dhe T. Shpk 8. Boe E.P Shpk dhe E. Shpk M dhe V. Shpk 9. Oe E. Ç. Person Fizik 10. Boe H.E Shpk dhe O.B.K Shpk dhe A. N. Shpk 11. Boe H. Shpk dhe Z. Sh.p.k 12. Oe I. 13. Oe P. G Shpk 14.Oe L. V Shpk (Fitues) Të Kualifikuar 5 Oe
11. Ankimime AK	12.Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata nr.137 prot		
14. Lidhja e kontratës datë 15.01.2024	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 46,588,882	

I.Fondi limit: Me urdhër nr. 350 prot., datë 01.11.2023 është mbajtur proces verbali për ngritjen e komisionit për llogaritjen e vlerës limit, komision i cili është i përbërë nga z, P.M , z, G.I,zj K.I. Preventivi i punimeve është hartuar nga shoqëria Architecture & Design, referuar Manualit të çmimeve miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015, i ndryshuar.

II.Mbi Përcaktimin e Kriteve të Kualifikimit:Me urdhër nr. 361 prot., datë 14.11.2023 është ngritur Njësia Prokurimit publik e përbërë nga zj. P.M Kryetar, G.I Anëtar, dhe zj. K.I. Në lidhje me kriterin 2.3.3 është kërkuar nga Operatori Ekonomik ofertues që duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 40 (dyzet e pesë) punonjës të siguruar për Gusht 2023-Tetor 2023. Referuar zërave të punimeve, numri prej 40 punonjësish është kriter i pa argumentuar, nuk ka një analizë për përcaktimin e fuqisë punëtore, në lidhje me orët e punës për çdo zë punimi sipas manualit në fuqi, me volumet e punës sipas preventivit dhe me afatin e punimeve sipas grafikut të punimeve. Përa i përket pjesës ku shprehen për periudhën kohore që duhet të jenë në listapagesat për 5 muajt e fundit është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

Në kriterin **2.3.10** është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Në procesverbalin përkatës për argumentimin e kriteve të vendosura nuk argumentohet veprimtaria e mjeteve me analizë teknike, si dhe për cilin qëllim do të përdoret në zbatimin e kontratës, por thjeshtë është argumentuar që secili mjet duhet për një (zë) punimesh të caktuar .

Përsa më sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar.

III. Vlerësimi i Ofertave: Është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave me urdhër të titullarit nr.362 prot., datë 14.11.2023. Me shkresën nr. 25 prot., datë 05.01.2024, është hartuar Raporti Përmbledhës drejtuar për dijeni titullarit të AK. Në vijim, është finalizuar procedura me lidhjen e kontratës nr. 137, datë 15.01.2024.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 14 (katërbëdhjetë) ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE A. sh.p.k me Nipt M.....H dhe A.C sh.p.k me Nipt K.....F me vlerë oferte 42,003,557 lekë pa TVSH.

2. A.2 sh.p.k me Nipt K.....C me vlerë oferte 44,409,965 lekë pa TVSH.

A. sh.p.k me Nipt J.....O me vlerë oferte 47,055,060 lekë pa TVSH.

3. B. sh.p.k me Nipt J.....R me vlerë oferte 47,272,464 lekë pa TVSH.

4. B. sh.p.k me Nipt J.....V me vlerë oferte 42,000,000 lekë pa TVSH.

5. C. sh.p.k me Nipt J....E me vlerë 46,104,698 lekë pa TVSH.

6. BOE C. SHPK me Nipt J.....K dhe T. sh.p.k me Nipt K....L me vlerë oferte 45,555,555 lekë pa t.vs.h.

7. BOE E.P sh.p.k me Nipt EJ...U dhe E. sh.p.k me Nipt J.....O dhe 8.V. me Nipt K.....P me Vlerë oferte 44,548,297 lekë pa TVSH.

9. E.C person fizik me Nipt M.....I pa vlerë të ofertës.

10. BOE H.E sh.p.k me Nipt M.....J dhe O.B. Konstruksion sh.p.k me Nipt K.....A dhe A. sh.p.k me Nipt K...O me vlerë oferte 46,468,235 lekë pa TVSH.

11. BOE H. sh.p.k me Nipt J....O dhe Z. sh.p.k me Nipt L....O me vlerë 49,645,402 lekë pa TVSH.

12. I. me Nipt J..... me vlerë oferte 40,150,901 lekë pa TVSH.

13. L. VII sh.p.k me nipt K..... me vlerë oferte 39,991,152 lekë pa TVSH. (OE Fitues)

14. P. sh.p.k me Nipt L....L me vlerë oferte 47,885,999 lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE A. sh.p.k me Nipt M.....H dhe A.C sh.p.k me Nipt K.....F është skualifikuar për arsyet e mëposhtme: Ka gabime në vlerën e ofruar pa TVSH. Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.2.1 për xhiron vjetore për vitet financiare (2020,2021,2022) OE A. sh.p.k pjesë e BOE-së e ka më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi.

Mjetet/pajisjet/makineritë e nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate të përcaktuara në dokumentat e tenderit në pikën 2.3.10 të vetëdeklaruar në shtojcën 8 nga OE A. sh.p.k pjesë e BOE-së si (matrapik; vibrator; zmerilatrice; Saldatrice/Motosaldatrice; Çekiç pneumatic hidraulik) janë pa nr.fature dhe datë. OE A.C ka deklaruar kamion me targa TR...G me kapacitet 3.54 ton dhe jo kamionçinë sic është kërkuar në DST.

2. OE A.2 sh.p.k me Nipt K.....C është skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

Në preventivin ofertues të paraqitur në SPE nga OE ka mospërputhje me preventivin e AK pasi zëri A-1.1 ka nr. analize 2.426/1 dhe nga OE është paraqitur me nr.2.426 që sipas manualit të ndërtimit i përket zërit (Prishje mur tulle pa pastrim); Në zërin nr.C-1.16 është shënuar nr. analize 240.000 kur nga AK është kërkuar me nr. analize 480/2; zëri D-1.21 i paraqitur nga OE ka nr. e analizës An.V.1.14 kur nga AK është kërkuar nr. analize An.V.3.36; Zëri D-1.22 i paraqitur nga OE ka nr. analize An.V.1.15 kur nga AK është kërkuar me nr. analize An.V.3.37.

Ky OE nuk ka ngarkuar në SPE deklaratën (nga Administratori i shoqërisë) për Drejtuesin Teknik të punimeve në këtë objekt që duhet të jetë i përfshirë në liçensën e shoqërisë.

Ky OE nuk ka ngarkuar në SPE deklaratën që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë.

3. OE B. sh.p.k me Nipt J.....R është skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

OE nuk ka paraqitur preventivin e ofertës sipas shtojcës 2 Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit.

OE nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3.

Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.2.2 bilanci i vitit 2022 është i pa konfirmuar nga Autoritetet përkatëse dega e Tatim-Taksave.

OE nuk ka paraqitur në SPE Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 për përmbushjen e pikave 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.6/1, 2.3.7, 2.3.8, 2.3.10 të DST-ve.

Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.3.1/a puna e ngjashme që ka paraqitur ky OE është një kontratë e realizuar si BOE ku sipas formularit të vlerësimit ky OE mbulon 66.84% të punimeve pra 21,757,417 lekë pa TVSH pra me pak se vlera që kërkohet nga AK në pikën 2.3.1/a të DST-ve si dhe mungon në SPE dokumentacioni në përputhje me pikën 2.3.1 (pika 1.3)

Nuk ka paraqitur në SPE grafikun e punimeve të kërkuar në pikën 2.3.11.

4.OE C. shpk me Nipt J...E është skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

Ka gabime aritmetike në ofertë midis vlerës pa TVSH të preventivit dhe asaj të ofruar në Shtojcën 1 formulari i ofertës në vlerën 1,374,667 lekë.

Mjetet/pajisjet/makineritë e nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate të përcaktuara në dokumentat e tenderit në pikën 2.3.10 të vetëdeklaruar në shtojcën 8 nga OE C. sh.p.k 1 (një) Saldatrice/Motosaldatrice nga 3 (tre) copë të kërkuara nga AK.

6.BOE C. SHPK me Nipt J.....K dhe T. sh.p.k me Nipt K...L është skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

Ka mospërputhje në vlerën me t.v sh midis shtojcës nr. 1 Formular Oferte me shtojcën nr.2 Lista e Çmimeve sipas zërave të preventivit. Në lidhje me këtë pikë duke parë formularin e ofertës (shtojca 1) dhe listën e çmimeve sipas zërave të preventivit (shtojca 2) të paraqitur nga BOE në SPE ky BOE nuk i është referuar preventivit të hartuar nga AK. Gjatë llogaritjes së preventivit zëri pajisjet është pa TVSH. Në shtojcën nr.1 ky OE vlerës totale pa TVSH i ka shtuar përsëri TVSH. Marrëveshjes së bashkëpunimit ku përcaktohet përqindja që marrin përsipër OE nuk i është bashkëlidhur preventivi me ndarjen e përqindjes së punimeve për secilin OE pjesë e BOE-së.

OE C. sh.p.k. pjesë e BOE-së nuk ka paraqitur në SPE formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Bilanci i vitit 2020 i C. SHPK nuk ka akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar edhe pse është në kushtet e nenit 41 gërma “c” të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009.

Nuk janë deklaruar në formularin e vetëdeklarimit pajisjet si: Çekiç pneumatik hidraulik copë 1; Fadromë me goma copë 1; Zmerilatridge copë 2; Matrapik copë 2; Skeleri min 500 m2; fikëse zjarri, komplet ndihma e shpejtë dhe tabela paralajmeruese; Saldatrice/Motosaldatrice të deklaruar nga T. janë pa sasi; Vibrator deklaruar nga T. është pa sasi; Depozitë uji deklaruar nga T. është pa sasi; kokore pa sasi.

OE pjesë e BOE-së nuk kanë ngarkuar në SPE deklaratën (nga Administratori i shoqërisë) për Drejtuesin Teknik të punimeve në këtë objekt që duhet të jetë i përfshirë në liçnsën e shoqërisë.

Mungon në SPE deklaratat për mjetet që janë të pa angazhuara në kontrata të tjera.

7.BOE E.P sh.p.k me Nipt EJ...U dhe E. sh.p.k me Nipt J.....O dhe V. me Nipt K.....P Konkretisht për arsyet e mëposhtme:

Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.2.1 për xhiron vjetore për vitet financiare (2020,2021,2022)

OE E. sh.p.k pjesë e BOE-së e ka më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi. Bilanci i vitit 2022. ë E.P sh.p.k nuk ka akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar edhe pse është në kushtet e nenit 41 gërma “c” të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009.

Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.3.1/a puna e ngjashme që ka paraqitur OE V. sh.p.k pjesë e BOE-së është kontrata me objekt “Rehabilitim i Sallës Farie Hoti dhe ambienteve të shërbimit të Klubit Sportiv Tirana” e realizuar si BOE ku sipas formularit të vlerësimit ky OE mbulon 43.86% të punimeve por në SPE mungon kontrata e bashkëpunimit e lidhur tek noteri dokumentacion i kërkuar në përputhje me pikën 2.3.1(pika 1.3)

Çertifikatat ISO të kërkuara në pikën 2.3.9 të OE V. shpk pjesë e BOE-së nuk kanë në fushën e tyre të certifikimit objektin e prokurimit edhe pse ky OE bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit ka marr përsipër punime ndërtimore.

OE E. L sh.p.k nuk ka kategoritë e liçencave NS-12 dhe NS-14 edhe pse në ndarjen e % së punimeve në preventiv ka marr përsipër punime që i mbulojnë këto lloje liçensash.

8.OE Eduart Çela person fizik me Nipt M03806202I konkretisht për arsyet e mëposhtme:

Ky OE nuk plotëson asnjë prej kërkesave për kualifikim të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në DST, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e tyre dhe as ofertë ekonomike dhe rrjedhimisht Skualifikohet nga procedura objekt prokurimi.

9.BO E sh.p.k me Nipt M.....J dhe O.B.Konstruksion sh.p.k me Nipt K.....Adhe A. sh.p.k me Nipt K...O konkretisht për arsyet e mëposhtme:

Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.2.1 për xhiron vjetore për vitet financiare (2021,2022) OE H.E shpk pjesë e BOE-së e ka më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi.

Bilanci i vitit 2021 i A. sh.p.k nuk ka akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar edhe pse është në kushtet e nenit 41 gërma “c” të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009.

Punët e ngjashme të paraqitura nga OE H.E sh.p.k referuar përqindjes që ky OE ka marr përsipër në punët e ngjashme që ka realizuar për përmbushjen e pikës 2.3.1/b nuk janë në vlerën e kërkuar prej 4,414,750 lekë pa TVSH sipas përqindjes prej 3.96 % si dhe ka mangësi në dokumentacionin e kërkuar ku tek objekti: “Riparim pjesor i çatisë së godinës së administratës dhe lysterje e ambienteve të zyrave brenda godinës në Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë” mungon akti i kolaudimit.

Në preventivin ofertues të paraqitur në SPE nga BOE ka mospërputhje me preventivin e AK pasi zëri C-1.26 ka nr.analize 2.a-93 dhe nga BOE është paraqitur me nr.2.a-96; zëri nr.D-1.13 është shënuar nr. analize 240.000 kur nga AK është kërkuar me nr. analize 480/2; zëri D-1.21 i paraqitur nga BOE ka nr. e analizës 2.535/e kur nga AK është kërkuar nr.analize 2.535/g; Zëri E-7 i paraqitur nga BOE ka ndryshime në specifika ku kapaciteti në ftohje/ngrohje është shënuar 2.2/3.2kë nga 2.2/2.4 kë që është kërkuar nga AK si dhe nga BOE është shënuar vaj.nom =510 m' ndërsa nga AK është kërkuar me specifikimin vaj.nom=450 m'. Në zërat e preventivit me nr. E-20 dhe E-21 BOE nuk ka shënuar karakteristikat teknike të kërkuara nga AK.

10.BO E H. sh.p.k me Nipt J....O dhe Z. sh.p.k me Nipt L.....O

Konkretisht për arsyet e mëposhtme:

Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.3.1/a puna e ngjashme që ka paraqitur OE Z. sh.p.k pjesë e BOE-së është kontrata me objekt “Ndërtimi i një Kompleksi Agroturistik me ambiente argëtuese dhe çlodhëse” ku nuk ka paraqitur në SPE certifikatën e marrjes në dorëzim në përputhje me pikën 2.3.1 (1.2/b).

Disa nga mjetet/pajisjet/makineritë e nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate të përcaktuara në dokumentat e tenderit në pikën 2.3.10 janë vetëdeklaruar në shtojcën 8 nga të dy OE pjesë e BOE-së pa sasi, nr.fature dhe datë. OE H. sh.p.k ka deklaruar kamionçinë me targa AA....SA por pa përcaktuar kapacitetin sikurse është kërkuar në DST. Nga 2 (dy) Kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 ton të kërkuar është deklaruar vetëm 1 (një) sipas kërkesave në DST me targa AA...DU.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht, nga OE shpallur fitues konstatohet se:

-Nga OE L. VII sh.p.k në formularin e vetëdeklarimit shtojca 8 në deklaratën për mjete/pajisje/makneri nuk ka përcaktuar 2 copë smelilatrice.

-Për punonjës in Albert Zyberaj i punësuar si Mekanik pranë shoqërisë L. VII sh.p.k, në çertifikatën e kualifikimit përcaktohet se, ky punonjës ka përfunduar me sukses kursin profesional *për autoservis*. Po ti referohemi argumetimit nga Njësia e Prokurimit, përcaktohet se ky pozicion pune kërkohet për kategoritë N.S - 2 A impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre dhe N.S - 12 A impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit. Këto punime kërkojnë një tjetër kualifikim nga çfarë është paraqitur nga OE fitues. Gjithashtu nga verifikimi i listëpagesës konstatohet është mirëpërcaktuar kodi i profecionit 7231.10 “Mekanik për kamionë”.

- Për punonjës in A.K është deklaruar si Kartpentier, ndërsa në kualifikimin e paraqitur rezulton specialist ndërtimit.

-Për punonjës in A.B është deklaruar si “Kartpentier”, ndërsa në kualifikimin e paraqitur rezulton specialist ndërtimit

-Për punonjës in F.R është deklaruar si “Suvatues”, ndërsa në kualifikimin e paraqitur rezulton specialist ndërtimit.

-Për punonjës in P.K është deklaruar si “Suvatues”, ndërsa në kualifikimin e paraqitur rezulton specialist ndërtimit.

-Për punonjës in F.H është deklaruar si “Suvatues”, ndërsa në kualifikimin e paraqitur rezulton specialist ndërtimit.

Sa më sipër rezulton se KVO ka vepruar në kundërshtim kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80. Parimet e procesit të përzgjedhjes, pika 1, “Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura,; neni 92 pika 3. “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.

3. Prokurimi me objekt: Blerje karburant për Bashkinë Përmet dhe institucionet në varësi për vitin 2023.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Blerje karburant për Bashkinë Përmet dhe institucionet në varësi për vitin 2023		
1. Urdhër Prokurimi nr.07 datë 05.01.2023	3.Njësia e Prokurimit Urdhër Nr.07/1 datë 12.01.2023	4. Komisioni VO Urdhër Nr.22 datë 12.01.2023
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur- mallra	P.M B.I A.T	B.K M.K Th.N
5. Fondi Limit (pa TVSH) 11,742,334	6. Oferta fituese (pa TVSH) 11,742,334 lekë Normë fitimi 17 lekë/litër	7. Diferenca me fondin limit 0
8. Data e hapjes së tenderit 31.01.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit + Buxheti i Bashkisë Përmet	10. Operatorët Ekonomik pjesmarrës 1. O. 2.K. (Fituesi) Të Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK	12.Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata nr. 600 prot		
14. Lidhja e kontratës datë 20.02.2023	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 14 090 801	

I.Me VKB nr. 83 prot., datë 15.11.2022 është miratuar sasia e karburantit që do të shpenzohet për Bashkinë Përmet dhe institucionet në varësi, ku ka vendosur shpërndarjen si më poshtë:

-Sasia e harxhimit të karburantit për automjetin e administratës, Policisë Bashkiake, automjetet e NJA etj, të jetë 15000 litra në vit.

-Sasia e harxhimit të karburantit për automjetet e e Ndërmarrjes së Pastrim Gjelbërimit të jetë 16000 në vit.

- Sasia e harxhimit të karburantit për automjetet e MZSH, të jetë 4000 litra në vit.

- Sasia e harxhimit të karburantit për lëvizjen e punonjësve të shërbimit pyjor të jetë 2300 litra në vit.

- Sasia e harxhimit të karburantit për mjetet e bordit të kullimit të jetë 12,000 litra në vit.

- Sasia e harxhimit të karburantit për mjetet e punës për Rrugët Rruale të jetë 18,000 litra në vit.

- Sasia e harxhimit të naftës për kaldajën e kopshtit nr.2. të jetë 2800 litra për sezonin 1 janar -15 mars 2023 dhe 15 nëntor 2023-31 dhjetor 2023.

Me Urdhërin e prokurimit nr. 07/1 datë 10.01.2024, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Përmet, zj. A.H , është zhvilluar procedura e prokurimit me objekt “Blerje Karburanti për Bashkinë Përmet dhe institucionet në varësi, për vitin 2023 me fondin limit në vlerën prej 11,742,334 lekësh pa TVSH.

II.Përcaktimi i kriterëve teknike dhe fondit limit: Me procesverbalin pa nr, të datës 11.01.2023, me objekt “Për përllogaritjen dhe argumentimin e fondit limit për procedurën me objekt: Blerje Karburanti për Bashkinë Përmet dhe institucionet në varësi”, Njësia e Prokurimit me përbërje: zj. P.M , z.B.I , z. A.T , ka hartuar dhe argumentuar fondin limit për procedurën e sipërpemëndur. Në lidhje me sasinë e përllogaritur vec dokumentacionit të paraqitur, nuk ka një analizë të detajuar e cila duhet të ketë të përcaktuar kërkesat e paraqitura nga grupet e punës në terren, kërkesat nga shoferët që kanë në ngarkim mjetet, analizën mbi aktivitetin e punës së vitit të kaluar, parashikimin e volumeve të punës të vitit pasardhës bazuar në programin vjetor programeve mujore të miratuara, numrin e mjeteve si dhe verifikimi i gjendjes teknike mjeteve. Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 34, pika 3 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 12, pika 4, Neni 7, Neni 76, pika 2, VKM nr. 285 datë 19.05.2022, neni 74, pika 3. Për sa më sipër mban përgjegjësi, zj. P.M, z.B.I, z. A.T.

III. Vlerësimi i ofertave: Me urdhër nr. 22 prot., datë 12.01.2023 është krijuar komisioni i vlerësimit të ofertave. Me shkresën nr. 571 prot., datë 17.02.2023 është hartuar Raporti Përmbledhës miratuar nga Titullari i AK, më pas është lidhur kontrata me nr. 600 prot., datë 20.02.2023 ndërmjet Bashkisë Përmet dhe OE K. sh.p.k.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 (dy) ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.K. sh.p.k me Nipt J.....P me vlerë oferte 11,742,334 lekë pa TVSH.

2.O.sh.p.k me Nipt J.....I me vlerë oferte 12,005,700 lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

-Operatori Ekonomik Olsi sh.p.k. me Nipt J63423463I konkretisht për arsyet e mëposhtme:

-Vlera e ofertuar nga ky operator ekonomik është më e lartë se fondi limit i përllogaritur për këtë objekt prokurimi i pasqyruar në DST në pikën 2.10/1 të njoftimit të kontratës.

-Sasia mbi të cilin është llogaritur fondi limit nga ana e këtij OE është më e vogël se sasia e pritshme e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

4. Prokurimi me objekt: “Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin ne Bashkine Permet per vitin 2023”

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 12/1 datë 23.01.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. P.M , 2. K.C , 3. E.R ,	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr.33 datë 23.01.2023 1. B.K Kryetar, 2. M.T , 3 K.M ,
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: e hapur e thjeshtuar mallra.		
5. Fondi Limit 5,367,380 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese: “OE G sh.p.k me ofertë ,4,921,420 lekë pa TVSH.	7. Diferenca me fondin limit: 445,960 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 03.02.2023	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 0 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

L.Mbi Përcaktimin i kriterëve teknike dhe fondi Limit:

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Bashkia Përmet , regjistrat e kopështit dhe çerdhes, regjistra këto të pa protokolluara u konstatua se, në Bashkinë Përmet trajtohen me ushqim 1 (një) kopësht, 1 (një) çerdhe dhe konviktit i qytetit. Nga verifikimi i regjistrave konstatohet se, numri i fëmijëve për çerdhen rezulton të jetë 31 fëmijë dhe për kopështin 58 fëmijë. Përsa i përket nxënësve të konviktit me VKB nr. 92 datë 15.11.2022 Këshilli Bashkiak ka vendosur të miratojë përfituesit e kuotës ë plotë ushqimore për 4 (katër) nxënësit e arsimit parauniversitar të gjimnazit publik “Sami frashëri” Përmet të cilët janë vendosur në konviktin e qytetit. Me urdhër nr.12 është ngritur komisioni i përllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike si dhe grafikut të lëvrimit të procedurës së prokurimit “Blerje ushqime për kopshtin me drekë, çerdhen në Bashkinë Përmet. Në procesverbalin e datës 20.01.2023 është përcaktuar se është bërë testimi i tregut në tre subjekte që tregëtojnë produkte jo shtazore, fruta perime dhe produkte shtazore. Është mbajtur procesverbali i datës 23.01.2023 për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim i hartuar nga zj. P.M, zj. K.Ç dhe z. E.R. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në hartimin e kërkesës për ushqime dorëzuar njësisë së prokurimit, rezulton se, përgjegjësja e kopshteve nuk i është referuar Urdhërit të MSHMS, kjo nga fakti se janë 8 produkte të listës që MSHMS ka përcaktuar në Urdhër të papërfshira në listën e ushqimeve, dhe 4 produkte janë shtuar, për kopshtin me drekë është hartuar menuja javore për cdo ditë dhe për 4 vakte. Nga komunikimi verbal me Përgjegjësen e kopshteve, na u sqarua se menuja javore dhe përzgjedhja e produkteve deri në vitin 2023, janë hartuar mbështetur në përvojën shumëvjeçare të aktivitetit të kopshteve me drekë si dhe nga konsultimet me prindërit e fëmijëve që frekuentojnë kopshtin me drekë. Kjo është bërë për të qenë më pranë nevojave dhe dëshirave të fëmijëve.

Përsa i përket çerdhes, në hartimin e kërkesës për ushqime dorëzuar komisionit për përllogaritjen e fondit limit, rezultoi se përgjegjësja e çerdhes nuk i është referuar urdhërit të MSHMS, kjo vërtetuar nga fakti se janë 16 produkte të listës që MSHMS ka përcaktuar në Urdhër dhe që janë të papërfshira në listën e ushqimeve që fëmijët duhet të konsumojnë. Nga kryqëzimi i informacionit, llogaritjes së kuotave ditore sipas urdhërit të Ministrisë dhe kërkesës që përgjegjësi i çerdhes i është drejtuar komisionit për përllogaritjen e fondit limit ku rezultoi diferencë në sasin e përdorur në masën 519.75 litër/kg/kokërr kjo sasi është e planifikuar në mospërputhje me numrin mesatar të fëmijëve dhe urdhrin nr.457, datë 24.01.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç. Në hartimin e kërkesës për ushqime dorëzuar për përllogaritjen e fondit limit rezulton se përgjegjësi i konviktit i ka përfshirë të gjitha produktet që përmban lista e udhëzimit përkatëse, pavaresisht se në kërkesë janë përfshirë edhe produkte të tjera, norma ditore nuk tejkalohet, sidoqoftë nuk dokumentohet mënyra se si ka

përcaktuar normat ditore. Këto veprime janë në kundërshtim me urdhrin nr. 457, datë 24.01.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç. Vkm Nr. 511, Datë 27.7.2022 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa në Vendimin Nr. 666, Datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për Kuotat Financiare të Ushqimit në Mensa e Konvikte Dhe Përcaktimin e Kritereve për Përfitim të Bursave e të Pagesave për Nxënësit e Arsimit Parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike”, të Ndryshuar.

II. Vlerësimi i ofertave: Me urdhër nr. 33 prot., datë 23.01.2023 është krijuar komisioni i vlerësimit të ofertave me përbërje znj. B.K Kryetar, znj M.T anëtar, K.M anëtar. Me datë 03.02.2023 është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës. Me datë 03.02.2023 është mbajtur procesverbali i vlerësimit. Me shkresën nr. 505 prot., datë 13.02.2023 është hartuar Raporti Përmbledhës miratuar nga Titullari i AK.

Në këtë procedurë ka marrë pjesë 1 (një) ofertues si mëposhtë me këtë vlerë përkatëse të ofruar:

1.G. sh.p.k me Nipt L.....D me vlerë oferte 4,921,420 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht, nga OE shpallur fitues konstatohet se:

1.Nuk plotësohet kriteri 2.3.1 ku është kërkuar që për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Nga auditimi konstatohet se, OE fitues ka paraqitur vetëm faturat tatimore nga përvoja e mëparshme e realizuar në Bashkinë Përmet, por nuk ka paraqitur vërtetim të lëshuar nga ky Autoritet Kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës sipas përcaktimeve në kriterin e mësipërm.

2.Nuk plotësohet kriteri 2.3.5 ku kërkohet nga Operatori ekonomik që duhet të paraqesë vetëdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU-së ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

-Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se, OE fitues nuk ka paraqitur kontrollin e fundit ushtruar nga AKU ku të provoj se subjekti ushtron aktivitetin konform kërkesave ligjore, **kriter ky thelbësor i cili i shërben Autoritetit Kontraktor për të siguruar cilësinë e ushqimeve, që do të prokurohen.**

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është, në kundërshtim me nenin 82, pika 2. e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohet me përgjegjësi, znj, B.K Kryetar, Znj.M.T , znj. K.M , III.Zbatimi i kontratës: Nga auditimi i zbatimit të kontratës konstatohet se, është lidhur kontrata me nr.584 prot., datë 20.02.2023 ndërmjet Bashkisë Përmet dhe OE G. sh.p.k.

- Me urdhër nr. 11 prot, datë 10.01.2023, të titullarit të autoritetit kontraktor, është ngritur Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të Aktiveve, i përbërë nga zj. K.G, z. A.T, z. A.J -Ky urdhër ka pësuar ndryshime me urdhërin 11/1 datë 13.03.2023 është ngritur Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të Aktiveve, i përbërë nga z. K.G, z. S.K, z. A.J.

-Nga auditimi konstatohet se, në pikën 2. ë këtij urdhëri përcaktohet se, komisioni të zbatojë të gjitha dizpozitat ligjore e nënligjore dhe rregullat për menaxhimin e aktiveve në fuqi, për mallin e dorëzuar nga subjektet që rezultojnë fitues nga procedurat e prokurimit me vlerë të vogël dhe të marrë në dorëzim. Referuar pikës 2. ë këtij urdhëri theksojmë se është ngritur në referencë të procedurave me vlerë të vogël.

-Urdhëri NA për ngritjen e Komisionit të marrjes në dorëzim të aktiveve, nuk ka përcaktuar magazinierin e institucionit si pjesë e komisionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, neni 43.

-Është ngritur urdhëri nr.87 datë 28.02.2023 për ndjekjen de ecurinë e zbatimit të kontratës i përbërë nga z. E.R, zj.M.T, zj. M.SH.

-Nga auditimi konstatohet se, plani i zbatimit të kontratës është jashtë afatit nga momenti i nënshkrimit të kontratës në kundërshtim me pikën 3 të nenit 124 të LPP.

-Referuar nenit 6 pika 6.1 të kontratës nr.584 prot., datë 20.02.2023 ku thuhet se, mallrat do të dorëzohen në magazinat e çerdhes, kopështit dhe konviktit sipas një grafiku lëvrimi, grafik i cili përcaktohet në dokumentat e tenderit ku përcaktohet se lëvrimi do të jetë periodik, i përditshëm sipas kërkesave të institucioneve objekt furnizimi. Malli do të lëvrohet çdo ditë të javës nga e Hëna në të Premte. Sasia e mallit që do të lëvrohet, do të kërkohe nga Autoriteti Kontraktor çdo ditë, në bazë të përlllogaritjeve ditore, duke iu referuar frekuentimit ditor, menuse ushqimore të çerdhes kopshtit dhe konviktit, sipas normativave të miratuara vlera ditore e shprehur në vlerë është 222.3 lekë. Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga përgjegjësi i konviktit Përmet, grupi i auditimit ka përlllogaritur frekuentimin e nxënësve për periudhën Janar- Qershor – Shtator-Dhjetor frekuentimi i nxënësve sipas përlllogaritjeve të cilat gjenden në tabelën e mëposhtme sipas frekuentimit në situacionet mujore:

Viti	Nr. i rregjistruar	FEMIJE TE REGJISTRUAR												
		Prezenca faktike												
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Totali
2023	4	65	100	113	88	105	42	0	0	64	107	100	88	872

Burimi:Bashkia Përmet

Referuar frekuentimit në total të nxënësve të konviktit, për periudhën Janar- Qershor – Shtator-Dhjetor 2023, rezultoi se, kanë frekuentuar konviktin në total (872 frekuentime x 222.3 lekë sipas vlerës ditore përcaktuar në Vkm) = 193,584 lekë, kjo vlerë përputhet me stitacionet mujore të rakorduara ndërmjet konviktit dhe specialistet së financës.

- Nga njësia shpenzuese (cerdhja) nuk është vënë në dispozicion një menu ditore ose javore e cila e bën procesin më transparent në shpërndarjen e ushqimit, sipas urdhërit përkatës për kopshtet dhe çerdhet. Këto veprime janë në kundërshtim me urdhrin nr. 457, datë 24.01.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç.

- Nga auditimi u konstatua se, nga ana e komisionit të ngritur me Urdhër nr. 11, datë 10.01.2023 dhe urdhër 11/1 datë 13.03.2023 “Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit”, nuk konstatohen gjurmë dokumentare/auditimi lidhur me përshkrimin e detajuar të mallit që merret në dorëzim si dhe verifikimin që i është kryer atij përpara marrjes në dorëzim, të tilla si:

Nuk janë paraqitur Proces Verbalet me të dhënat treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtojca 5) lidhur me:

Pranimin e perimeve dhe zarzavateve, pranimin e frutave, nuk ka evidentuar nëse mallrat e furnizuara janë të cilësisë së parë, nëse ambalazhi i tyre është në përputhje me kërkesat e prokurimit, nëse furnizimi është në përputhje me treguesit cilësorë sipas standardit shtetëror të miratuar. Pranimin e bulmetrave për furnizimin me djathë nuk është mbajtur Proces verbali ku të

evidentojë certifikatën e cilësisë për çdo furnizim parti prodhimi, për furnizimin me qumësht nuk ka evidentuar certifikatën e analizës, për furnizimin me gjalpë të freskët nuk ka evidentuar ambalazhin e paketimit të produktit, etiketa e produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto/ neto, dhe origjinën e prodhimit, Për furnizimin me vezë nuk është përcaktuar nëse furnizimi është në përputhje me rregullat e Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët. -Sa i përket nenit 1 të kontratës “Objekti i Kontratës” pika 1.2 kërkohet për mallrat që do të dorëzohen duhet të jenë sipas sasisë në dokumentet e tenderit dhe specifikimeve teknike. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga Bashkia Përmet konstatohet se, janë paraqitur për disa ushqime raporte të provës të testuara nga laborator privat për produktet fasule, kripë, vaj luledjelli, sheqer, tërshërë, vaj ulliri i virgjër, oriz, miell misri, dhe mish viçi. Në rezultatet e raportit të provës në lidhje me produktin ushqimor oriz në treguesit fiziko-kimik nuk pasqyrohen të dhënat mbi aciditetin për këtë produkt, në një kohë që në specifikimet teknike në seksionin për treguesit fiziko-kimik përrcaktohet aciditeti në rezultatin 0.081%. në raportin e provës për produktin kripë nuk janë përcaktuar të gjithë treguesit sipas treguesit “Fiziko-kimike. Për produktin ushqimor mish viçi nuk specifikohen treguesit shqisorë sipas specifikimeve teknike si: Aciditeti i shprehur në pH: 5.2 deri 6.4. Reaksioni për hidrogjenin sulfuror (H₂S): Negativ. Reaksioni Kreis: Negativ. Përsa i përket pjesës tjetër të produkteve ushqimore nuk paraqitet dukumentacion sikurse përcaktohet në nenin 1 “Objekti i Kontratës” ku mallrat duhet të jenë sipas specifikimeve teknike.

Situata trajtuar si më lart tregon veprime në kundërshtim me nenin 1 të kontratës “Objekti i kontratës” pika 1.2 ku është kërkuar që për mallrat që do të dorëzohen duhet të jenë sipas sasisë në dokumentet e tenderit dhe specifikimeve teknike.

-Nuk është zbatuar neni 6 i kontratës pika 6.1 ku përcaktohet se mallrat do të dorëzohen nga shitësi në cerdhe, konvikt dhe kopshtit me drekë sispas një grafiku lëvrimi dhe transporti i tyre do të përballohet nga vetë shitësi me mjete të përshtatshme që plotësojnë kushtet higjeno-sanitare.

-Nga auditimi konstatohet se, bashkëlidhur dokumentacionit nuk gjendet fleta e shoqërimit e cila dorëzohet nga furnitori ku përcaktohen minimalisht të dhënat e mjetit me të cilin po transportohen ushqimet, nëse i plotëson kushtet higjeno-sanitare, ose transportohen me mjetin frigoriferik i cili përcaktohet në dokumentat e tenderit.

- Në pikën 6.3 të nenit 6 specifikohet se, mallrat do të dorëzohen nga administratori i firmës ose nga një përfaqësues i firmës autoizuar me shkrim shoqëruar me raport analizën për cdo produkt. Nga të dhënat e vëna në dispozicion konstatohet se, jo cdo produkt është shoqëruar me raport analizën përkatëse.

-Në strukturën e Bashkisë Përmet, nuk është planifikuar apo aplikuar ekzistenca e strukturave monitoruese për kontratat, por është mjaftuar vetëm me vendosjen e emrave të përgjegjësve të kopështiti/konviktit/çerdhes që do të ndjekin ecurinë e kontratës. Gjatë auditimit nuk u konstatua hartimi i raportit në përfundim të kontratës, ku sipas VKM nr. 285/2021, është parashikuar që personi përgjegjës për prokurimin pranë autoritetit kontraktor merr informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton APP-së. Po kështu, në përfundim të kontratës, përgatitet një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti, një kopje e këtij raporti i dërgohet edhe APP-së.

-Vlera e shpenzuar sipas njësive shpenzuese paraqitet si më poshtë:

-Për kopshtin është shpenzuar vlera 1,894,288 lekë.

-Për çerdhen është shpenzuar vlera 1,266,782 lekë

-Për konviktin është shpenzuar vlera 227,264 lekë.

-Nga auditimi rezultoi se kontrata është realizuar në masën 68.8 % ku nga vlera e kontratës 4,921,420 lekë pa TVSH është likuiduar vlera totale prej 3,389,508 lekë. Të dhënat mbi likuidimet, faturimet, fletë hyrja- fletë dalja, vlerat përkatëse dhe urdhër shpenzimet gjenden të pasqyruara në aneksin nr.P.5 në kapitullin Anekse.

-Për mangësit dhe veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi rast pas rasti:

1- znj.A.H, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor.

2 -z.E.R, në cilësinë e përgjegjësit të konviktit, pjesë e grupit të punës për monitorimin e kontratës.

3-znj.M.T, në cilësinë e përgjegjëses së kopështit, pjesë e grupit të punës për monitorimin e kontratës dhe anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

4-znj.M.SH, në cilësinë e përgjegjëses së çerdhes, pjesë e grupit të punës për monitorimin e kontratës.

5-znj.K.G, në cilësinë e anetërit të komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve.

6- z. A.T, në cilësinë e anetërit të komisionit dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve

7- z. A.J, në cilësinë e anetërit të komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve

8-z.S.K, në cilësinë e anetërit të komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve.

9. znj. B.K, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

10. znj.K.M, në cilësinë e anetares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

5.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 310 datë 04.10.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. P.M, 2. G.I, 3. J.S.	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr.311 datë 04.10.2023 1. A.P Kryetar, 2. A.B, 3 D.M,
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur -punë		
5. Fondi Limit 9,318,871 (pa TVSH)	6. Oferta fituese: “OE A.” shpk me ofertë, 7,926,814 lekë pa TVSH.	7. Diferenca me fondin limit: 1,392,057 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 12.10.2023,	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit + Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b) Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 3 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

I.Fondi limit: Me urdhër nr.270 datë 07.09.2023 është mbajtur proces verbali për ngritjen e komisionit për llogaritjen e vlerësimit, komisioni i cili është i përbërë nga z, P.M , zj, G.I , z J.S . Sa i përket preventivit të punimeve i cili është hartuar nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Përmet. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 9,318,871 lekë pa TVSH.

Për vitin 2023 vlera e financimit është 5,964,077 lekë pa TVSH.

Për vitin 2024 vlera e financimit është 3,354,794 lekë pa TVSH.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 9,318,871 lekë pa TVSH.

Për vitin 2023 vlera e financimit është 5,964,077 lekë pa TVSH.

Për vitin 2024 vlera e financimit është 3,354,794 lekë pa TVSH.

II.Mbi Përcaktimin E Kriteve Të Kualifikimit:

Me urdhër nr. 441 prot., datë 04.12.2024 është ngritur Njësia Prokurimit publik e përbërë nga zj. P.M Kryetar, zj. G.I Anëtar, dhe z. J.S.

Me shkresën nr. 2690 prot., datë 10.10.2023 është mbajtur procesverbal për argumentimin e kriteve.

Në kriterin 2.3.3 është kërkuar nga Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 10 (dhjetë) punonjës të siguruar, për 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me:

-Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për muajin e kërkuar;

-Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Lidhur me argumentimin e këtyre punonjësve nga NJP është argumentuar si më poshtë:

Argumentimi: Staf i teknik i kualifikuar:

1 (një) Elektricitist (16,17,18,19,20,21,22, 39)

1 (një) Hidraulik (23,24,25, 26, 27)

1 (një) Pllakashtrues (28, 29, 40)

1 (një) Karpentier (6)

1 (një) Hekurkthyes (41)

1 (një) Bojaxhi (14)

2 (dy) Suvaxhi (5, 13, 31, 36, 38)

1 (një) Muratorë (3, 4, 12, 30)

1 (një) Hidroizolues (32, 33, 34)

1 (një) Shofer (7)

Referuar zërave të punimeve, numri prej 10 punonjësish është kriter i pa argumentuar, nuk ka një analizë për përcaktimin e fuqisë punëtore, në lidhje me orët e punës për çdo zë punimi sipas manualit në fuqi, me volumet e punës sipas preventivit dhe me afatin e punimeve sipas grafikut të punimeve. Përa i përket pjesës ku shprehen për periudhën kohore që duhet të jenë në listapagesat për 5 muajt e fundit është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme. Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit znj, P.M , z. G.I , z. J.S .

III. Vlerësimi i Ofertave: Është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave me urdhër të titullarit nr. 311 datë 04.10.2023. Me shkresën nr. 3032 prot., datë 13.11.2023, është hartuar Raporti Përmbledhës drejtuar për dijeni titullarit të AK. Në vijim, është finalizuar procedura me lidhjen e kontratës nr. 3122 datë 21.11.2023.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 5 (Pesë) ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE “M. ” sh.p.k me Nipt J.....V dhe L sh.p.k me Nipt K.....H me vlerë oferte 8,966,644 lekë pa TVSH.

2. BOE 2. sh.p.k me Nipt L.....J dhe E. sh.p.k me Nipt K.....P me vlerë 9,275, 914 lekë pa TVSH.

3. A. sh.p.k me Nipt M.....H me vlerë 7,309,554 lekë pa TVSH.

4. A. sh.p.k me Nipt J.....O me vlerë 7,926,814 lekë pa TVSH.

5. I. me nipt J..... me vlerë 8,784,938 lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

-Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “M.” sh.p.k me Nipt J.....V dhe L sh.p.k me Nipt K.....H me vlerë të ofertës 8,966,644 lekë pa TVSH.

-Sigurimi i ofertës nuk është prerë duke ju referuar pikës 3.2. ë DST-ve (njoftimi i kontratës) ku periudha e vleshmërisë duhet të jetë 150 ditë dhe jo 90 ditë siç e ka prerë ky operator ekonomik. Bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit ku është bërë ndarja e përqindjes së punimeve dhe Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të deklaruar nga të dy OE pjesë e BOE, nga 10 (dhjetë) punonjës mesatarisht të kërkuar OE M. shpk që mbulon % më të madhe të punimeve ka deklaruar vetëm 2 (dy) punëtor 1 (një) karpentier dhe 1 (një) suvaxhi. OE L sh.p.k referuar formularit të vetëdeklarimit në lidhje me stafin teknik të kërkuar 1 (një) pllakashtrues z. A.B. figuron i siguruar vetëm 6 ditë në muajin shtator; 1 (një) hekurkthyes z. P.F figuron i siguruar vetëm 6 ditë në muajin shtator dhe 1 (një) Bojaxhi z. P.B nuk figuron i siguruar në muajin shtator. Në shtojcën 9 të formularit të vetëdeklarimit shkronja C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” në tabelën e mjeteve dhe paisjeve në pronësi ose qera në raport me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit në pikën 2.3.7 dhe vetëdeklarimit asnjë nga OE pjesë e BOE-së nuk ka deklaruar *Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 2 - 5 ton (copë 1)* po kështu *Betoniere e kërkuar* është deklaruar por pa përcaktuar kapacitetin mbajtës 0.25m³.

-Operatori Ekonomik A. sh.p.k me Nipt M.....H me vlerë të ofertës 7,309,554 lekë pa TVSH. Oferta e këtij OE është anomalisht e ulët. Në punën e ngjashme të realizuar me sektorin privat nuk ka paraqitur situacionin përfundimtar të punimeve. Në shtojcën 9 të formularit të vetëdeklarimit shkronja C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” në tabelën e mjeteve dhe paisjeve në pronësi ose qera në raport me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit në pikën 2.3.7 dhe vetëdeklarimit OE nuk ka deklaruar *Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 2 - 5 ton (copë 1) por Kamionçinë* po kështu *Betoniere 0.25m³; Vibrator; dhe Vinç* janë deklaruar vetëm me faturë pa nr. dhe datë fature. Nga llogaritja e ofertës anomalisht më të ulët rezultoi se, oferta anomalisht më të ulët llogaritet në vlerën 7,363,172 lekë.

Nga verifikimi rezultoi se, se Oe në formularin e vetëdeklarimit ka deklaruar *Betoniere 0.25m³*, për mjetet *vinç , Vibrator* janë deklaruar pa të dhënat e kërkuara.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht, nga OE shpallur fitues konstatohet se:

1. Nuk plotësohet kriteri 2.3.5 ku për punonjësit e kërkuar operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në formularin e vetëdeklarimit tabelën sipas të dhënave të mëposhtme:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i dëshmisë/certifikatës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
-----	---------------------------	------------	--	--	--

Nga verifikimi i dokumentacionin të paraqitur në SPE dhe fizikisht konstatohet se, OE fitues nuk paraqitur punonjësit në formën e kërkuar si më lart.

2. Nga verifikimi i listëpagesave konstatohet se, punonjësi M.B deklaruar me Profesionion “Hidroizolues” rezulton me kodin e punësimit 2133.02 ku sipas VKM nr.514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve” (LKP), të rishikuar, kjo kategori i përket profesionit “Agronom”.

- Për punonjësin E.K deklaruar me Profesionion “Hekurkthyes” rezulton me kodin e punësimit 8322.01 ku sipas VKM nr.514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve” (LKP), të rishikuar, kjo kategori i përket profesionit “Shofer”

- Punonjësit e kontraktuar në bazë të kontratës së datës 01.04.2023 z, E.L, z,G. L. z. A.A z.V.C.j, z. Sh.K, z. M. B, V. C, z, B. T konstatohet se figurojnë të siguruar vetëm 9-10 ditë në muajin shtator.

Sa më sipër rezulton se KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80. Parimet e procesit të përzgjedhjes, pika1, “Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura; neni 92 pika 3, “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohet me përgjegjësi KVO me përbërje; znj.A.P Kryetar, z. A.B, z. D.M

6. Prokurimi me objekt: “Rikonstrukcion i rrugës Qilarisht”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i rrugës Qilarisht”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 441 datë 04.12.2024	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. P.M 2. M.K 3. F.H	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 433 datë 04.12.2024 1. D.D Kryetar 2. L.B 3 D.M
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur -punë		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 65,627,871 lekë	6. Oferta fituese: “OE K. shpk me ofertë , 43,159 116 lekë pa TVSH.	7. Diferenca me fondin limit: 22,468,755 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 23.12.2024	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 10 OE b) Skualifikuar 6 OE, c) Kualifikuar 4 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

I.Fondi limit:Me urdhër nr. 243 datë 16.08.2023 është mbajtur proces verbali për ngritjen e komisionit për llogaritjen e vlerës limit, komisioni i cili është i përbërë nga z, P.M , zj, M.K ,z F.H . Sa i përket preventivit të punimeve i cili është hartuar në bazë të një kontrate dhurimi nga, kontratë me nr. 2743 prot.,datë 13.10.2023 ndërmjet subjektit G.P sh.p.k dhe si përfitues Bashkia Përmet. Nga grupi i auditimit u testuan disa prej zërave të preventivit me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së çmimeve për njësi në preventiv me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit miratuar me VKM. 216, datë 13.4.2023 Për Krijimin Dhe Funkcionimin e Sistemit Të Integruar Për informatizimin e Manualit të Çmimeve për zërat e Punimeve në Ndërtim. Nga verifikimi u konstatua se çmimet për njësi përputhen me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit.

II.Mbi Përcaktimin E Kriterëve Të Kualifikimit:Me urdhër nr. 441 prot., datë 04.12.2024 është ngritur Njësia Prokurimit publik e përbërë nga zj. P.M Kryetar, zj.M.K Anëtar, dhe zj. F.H .

-Në lidhje me kriterin **2.3.7** është kërkuar që Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar muajin e fundit dhe të figurojë në listëpagesat e subjektit, punonjësit specialistë të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) Teknik Topograf
- 1 (një) Punëtor asfalti

- 1 (një) Elektriçist
- 1 (një) Hidraulik
- **2 (dy) Murator/suvatues**
- 2 (dy) Betonues
- 1 (një) Pllakashtrues
- 1 (një) Hekurkthyes
- 1 (një) Saldator
- 2 (dy) Karpentier

Referuar kërkesës për 2 (dy) murator/suvatues në procesverbalin me nr.3226 prot., datë 05.12.2024 për argumentimin e kriterëve të veçanta NJP është shprehur se, prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Kërkesa për 2 (dy) murator/suvatues është kriter i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

-Në kriterin **2.3.10** është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës.

Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri dhe lloji i mjeteve që kërkohet, në përputhje me punën që do të kryejnë, volumin dhe grafikun e punimeve. Nuk argumentohet me analizë teknike, si dhe për cilin qëllim do të përdoret në zbatimin e kontratës.

Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar. Sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi NJP: P.M , M.K , F.H .

III. Vlerësimi i Ofertave:

Është ngritur komisioni i vlerësimit të ifertave me urdhër të titullarit nr. 433 datë 04.12.2024. Me shkresën nr. 254 prot.,datë 28.01.2025, është hartuar Raporti Përmbledhës drejtuar për dijeni titullarit të AK. Në vijim, është finalizuar procedura me lidhjen e kontratës nr. 138/1 datë 20.01.2025.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 11 (njëmbëdhjetë) ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. A. sh.p.k me Nipt M.....L me vlerë oferte 48,893,115 lekë pa TVSH.
2. A. sh.p.k me Nipt J.....O me vlerë oferte 50,696,713,64 lekë pa TVSH.
3. B. sh.p.k me Nipt J.....V me vlerë 52,793,307 lekë pa TVSH.
4. C. SHPK me Nipt J.....K me vlerë oferte 47,238,667,52 lekë pa TVSH.
5. C. R. sh.p.k me Nipt K...V me vlerë 50,338,953 pa TVSH.
6. BOE F sh.p.k me Nipt K.....C dhe D.sh.p.k me Nipt K.....J dhe 7. T. sh.p.k me Nipt K.....G me vlerë 49,293,142 lekë pa TVSH.
8. H.94 sh.p.k me Nipt J....O me vlerë 51,884,849 lekë pa TVSH.
9. I. me Nipt J..... me vlerë oferte 48,748,738 lekë pa TVSH.
10. K. sh.p.k me Nipt J.....D me vlerë oferte 43,159,116 lekë pa TVSH. **(OE fitues)**
11. R.SHPK me Nipt J,.....E Pa vlerë oferte.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar 6 (gjashtë) OE për mosplotësim kriteresh dhe janë kualifikuar 4 (OE), Operatorin Ekonomik K. sh.p.k me Nipt J.....D me vlerë totale 43,159,116 lekë pa TVSH është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

-Grupi i auditimit bëri llogaritjet për të parë nëse ofertat e konsideruara të vlefshme janë anomalisht të ulta duke aplikuar formulën e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik, në rast se janë të vlefshme 3 ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatres së ofertave të vlefshme. Oferta e kualifikuara janë konkretisht B. sh.p.k, H.94 sh.p.k, K. sh.p.k, C. sh.p.k. përcaktimi sipas formulës i **(PR=85% MO) rezultoi në vlerën 42,112,447,97 lekë pa TVSH.**

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht, nga OE shpallur fitues konstatohet se:

Nuk plotësohet kriteri **2.3.12** ku është kërkuar nga Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzojnë analizën teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim.

-Nga verifikimi i preventivit u konstatua se, se për zërin e punimeve 3.211 *“Shtresë më cakëll mbeturinë kave t+20 cm, përhapur e ngjeshur me manineri”*

-Për zërin e punimeve 3.224/1 *“Shtresë asfaltbetoni me granil guri kave, 3 cm, me makineri”* llogaritja në preventiv për emërtimin transport auto është llogaritur 15 op ndërsa në manual llogaritet 1.38 op.

-Për zërin e punimeve 3.935 *“F.v Tabelë rrethi Ndalim e vogël me D=40”* llogaritja në preventiv për emërtimin të ndryshme 2% është llogaritur si njësi në lekë për sasinë 7,400 ndërsa në manual llogaritet për njësin lekë sasia 5,150 .

-Për mjetin e marrë me qira me targë, AA...XZ çertifikata për transport mallrash është e specifikuar për llogari të vet dhe jo për te tretë.

Sa më sipër rezulton se KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 *“Për Prokurimin Publik”*, neni 80. Parimet e procesit të përzgjedhjes, pika 1, *“Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:*

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;, neni 92 pika 3. “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.

7. Prokurimi me objekt: “Ndërtimi i kanalit ujitës Bual”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim i kanalit ujitës Bual”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 277 datë 20.08.2024	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. P.M , 2. M.K , 3. B.M,	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr.278 datë 20.08.2024 1. D.D Kryetar, 2. K.M , 3 Y.D .
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur - punë		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 36,249,312 lekë	6. Oferta fituese: “OE E. sh.p.k me ofertë, 34,837,848 lekë pa TVSH.	7. Diferenca me fondin limit: 1,411,464 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 06.09.2024	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 6 OE b) Skualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

I.Fondi limit

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 36,249,312 lekë pa TVSH i detajuar si më poshtë:
Financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2024 do të jetë në vlerën 14,565,044 lekë pa TVSH dhe për vitin 2025 do të jetë në vlerën 21,684,268 lekë pa TVSH. Me urdhër nr. 270 datë 16.08.2024 është mbajtur proces verbal për ngritjen e komisionit për llogaritjen e vlerës limit, komision i cili është i përbërë nga z. P.M , zj. M.K , z B.M. Sa i përket preventivit të punimeve i cili është hartuar në bazë të një kontrate dhurimi nga, kontratë me nr.1163 prot.,datë 02.05.2024 ndërmjet subjektit Paskal Londo s dhe si përfitues Bashkia Përmet. Nga grupi i auditimit u testuan disa prej zërave të preventivit me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së çmimeve për njësi në preventiv me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit miratuar me VKM. 216, datë 13.4.2023 “Për Krijimin Dhe Funksionimin e Sistemit Të Integruar Për informatizimin e Manualit të Çmimeve për zërat e Punimeve në Ndërtim”. Nga verifikimi u konstatua se çmimet për njësi përputhen me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit.

II.Mbi Përcaktimin E Kriteve Të Kualifikimit:1. Në kriterin 2.3.4 është kërkuar që Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- Inxhinier Ndërtimi profili Infrastrukturë Transport
- Inxhinier Ndërtimi
- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Marksheder
- Inxhinier Hidroteknik
- Inxhinier Gjeolog
- Inxhinier Mjedisi
- Inxhinier Elektrik

Këto kritere janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet (Inxhinieri i Mjedisit).

2. Në kriterin 2.3.2 është kërkuar licensa profesionale NP-12/A “Punime të inxhinierisë së mjedisit”. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

III.Vlerësimi i Ofertave:

Është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave me urdhër të titullarit nr. 278 datë 20.08.2024. Me shkresën nr. 2532 prot.,datë 02.10.2024, është hartuar Raporti Përmbledhës drejtuar për dijeni titullarit të AK. Në vijim, është finalizuar procedura me lidhjen e kontratës nr. 2625 datë 10.10.2024.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 6 (gjashtë) ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE A. sh.p.k me Nipt L....A dhe C. sh.p.k me Nipt J....E dhe I. sh.p.k me Nipt J.....D me vlerë oferte 28,518,601 lekë pa TVSH.
2. BOE E. sh.p.k me Nipt J....O dhe M. sh.p.k. me Nipt K.....G me vlerë oferte 34,837,848 lekë pa TVSH.
3. OE H. sh.p.k me Nipt J....O me vlerë 28,597,579 lekë pa TVSH.
4. OE K. sh.p.k me Nipt J.....D me vlerë 35,597,560 lekë pa TVSH.
5. BOE N. 1934 sh.p.k me Nipt J.....S dhe G. sh.p.k me Nipt K.....A dhe L. sh.p.k me Nipt J.....L me vlerë 27,148,681 lekë pa TVSH.
6. BOE V. sh.p.k me Nipt L.....E dhe A. sh.p.k me Nipt J.....O me vlerë 27,218,297 lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit e mësipërm janë skualifikuar 4 OE/BOE, siaps KVO-së nga shqyrtimi i këtyre ofertave në SPE si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave ka konkluduar se, operatorët ekonomik të skualifikuar nuk kanë paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura duke i skualifikuar si oferta.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1.BOE A. sh.p.k me Nipt L.....A dhe C. sh.p.k me Nipt J....E dhe I. sh.p.k me Nipt J....D konkretisht për arsyet e mëposhtme:

Xhiro vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 e paraqitur nga OE A. sh.p.k pjesë e BOE-së për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar është më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

-Nga verifikimi në SPE xhiro e subjektit A. është më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

OE I. sh.p.k pjesë e BOE-së nuk përmbush pikën 2.3.1 në lidhje me punët e ngjashme të deklaruara. Ing. i ndërtimit i deklaruar nga OE I. sh.p.k është profil Rugë-Ura. Pra asnjë prej OE pjesë e BOE-së nuk ka deklaruar në formular vetëdeklarimi Ing.Ndërtimi profil Infrastrukturë-Transport

OE I. sh.p.k pjesë e BOE-së nuk ka paraqitur Deklaratë nga Administratori që Makineritë e deklaruara në formular vetëdeklarimi nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera.

OE C. sh.p.k nuk ka paraqitur Çertifikatën për menaxhimin e Sigurisë së Qarkullimit Rrugor ISO 39001-2012 (e vlefshme) ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

OE A. shpk referuar preventivit të ndarjes së punimeve ka marr përsipër punime kur në formularin e vetëdeklarimit Shtojca 8 deklaron se nuk disponon Ing.Gjeolog, Teknik Ndërtimi, Teknik Topograf:

OE A. sh.p.k referuar preventivit të ndarjes së punimeve ka marrë përsipër punime kur në formularin e vetëdeklarimit Shtojca 8 deklaron se nuk disponon Vibrator Betoni.

OE I. sh.p.k referuar preventivit të ndarjes së punimeve ka marr përsipër punime kur në formularin e vetëdeklarimit Shtojca 8 deklaron se nuk disponon Ing.Hidroteknik dhe Ing.Gjeolog.

Nisur nga akt marrëveshja e bashkëpunimit paraprake pika 7 ku OE G. sh.p.k ka marr përsipër 53.34% dhe N. 1934 sh.p.k ka marr përsipër 33.04% të të gjithë zërave të punimeve këto pika duhet të plotësoheshin nga të dy. (Referuar dhe Vendimit të KPP-së nr.1129/2022)

2.BOE V. sh.p.k me Nipt L.....E dhe A. sh.p.k me Nipt J.....O konkretisht për arsyet e mëposhtme:

Xhiro vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 e paraqitur nga OE V. sh.p.k pjesë e BOE-së për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar është më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

-Nga verifikimi në SPE OE V. në vërtetimin e xhiros së paraqitur rezulton se xhiro është më e vogël se vlera e kontratës që prokurohet.

Asnjë nga OE pjesë e BOE-së nuk ka paraqitur Deklaratë nga Administratori që makineritë e deklaruara në formular vetëdeklarimi nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera.

OE V. shpk referuar preventivit të ndarjes së punimeve ka marr përsipër punime kur në formularin e vetëdeklarimit Shtojca 8 deklaron se nuk disponon Ing.Ndërtimi Transport, Ing.Hidroteknik dhe Ing.Gjeolog.

-Nga verifikimi në SPE rezultoi se OE V. nuk disponon Ing.Ndërtimi Transport, Ing.Hidroteknik dhe Ing.Gjeolog.

OE A. shpk referuar preventivit të ndarjes së punimeve ka marr përsipër punime kur në formularin e vetëdeklarimit Shtojca 8 deklaroi se nuk disponon Vibrator Betoni, Betoniere, Kamion me vinç, dhe motosaldatriçe/elektrosaldatriçe.

3.Operatori Ekonomik H. sh.p.k me Nipt J....O konkretisht për arsyet e mëposhtme:

Nuk përmbush pikën 2.2.2 pasi nuk ka paraqitur bilancet e viteve 2021, 2022, 2023 të konfirmuara pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

Nga verifikimi në sistem rezultoi se, bilancet sipas viteve të kërkuara nuk janë të konfirmuara nga autoriteti përkatës.

Nuk përmbush pikën 2.3.3 ku kërkohet që OE të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt. Ky OE ka deklaruar si drejtues Teknik z.A.H i deklaruar në formular vetëdeklarimi si Ing. Hidroteknik. Përgjegjësi Teknik i kantierit i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” kreu I pika 2.1 ku përcaktohet se: “Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

Në formularin e vetëdeklarimit nuk ka deklaruar Betoniere copë 3. Po kështu mjeti fadromë me goma e paraqitur në formularin e vetëdeklarimit është pa targa vetëm me deklaratë doganore nr.R 742 datë 20.08.2012 kjo jo në përputhje me ligjin 8378 datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” neni 58, 99 dhe 113 si dhe VKM-në nr.153 datë 07.04.2000 VKM Nr.153 datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” neni 201, 244 dhe 282.Nuk përmbush pikën 2.3.11 pasi nuk ka paraqitur grafikun e punimeve sipas DST-ve. Nga verifikimi në SPE OE H. nuk ka paraqitur Deklaratë për drejtuesin Teknik.

4.BOE N. 1934 sh.p.k me Nipt J.....S dhe G. sh.p.k me NiptK.....A dhe L. sh.p.k me Nipt J.....L konkretisht për arsyet e mëposhtme:

Oferta e paraqitur nga ky BOE është anomalisht e ulët referuar nenit 93 pika 5 të LPP-së i ndryshuar dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 82 pika 4. OE G. sh.p.k referuar preventivit të ndarjes së punimeve ka marr përsipër punime betonimi kur në formularin e vetëdeklarimit Shtojca 8 deklaroi se nuk disponon betonues. OE G. sh.p.k referuar preventivit të ndarjes së punimeve ka marr përsipër punime kur në formularin e vetëdeklarimit Shtojca 8 deklaroi se nuk disponon Ing.Hidroteknik. OE N. 1934 sh.p.k referuar preventivit të ndarjes së punimeve ka marr përsipër punime kur në formularin e vetëdeklarimit Shtojca 8 deklaroi se nuk disponon Teknik Topograf dhe Betonues.

Nga llogaritja për ofertën anomalisht më të ulët rezultoi se BOE N. 1934 sh.p.k me Nipt J.....S dhe G. sh.p.k kanë paraqitur ofertë anomalisht më të ulët.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

1.Në kriterin 2.3.2 është kërkuar që OE duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit sipas kategorive:

NP-1 A (Punime gërmimi në tokë)

NP- 4 A (Rruge , autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale)

NP- 5 A (Punime nëntokësore,ura e vepra arti)

NP- 7 B (Ujësjellësa,gazsjellësa,vajsjellësa,vepra kullimi e vaditje)

NP-11 A (Ndërtime për N/stacionet,kabinat e transformatorëve, linjat e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

NP-12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

Për punimet speciale të ndërtimit sipas kategorive:

NS- 1A (Punime prishje ndertimore)

NS-4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)

NS-18 A (Punime topogjeodezike)

Nga auditimi konstatohet se, pas verifikimit të dokumentacionit të dorzuar nga OE E. sh.p.k pranë AK Bashkia Përmet, rezultoi se, nuk plotësohet kriteri i sipërpërmendur, sepse liçensa e paraqitur nga ky OE nuk ka të përcaktuara kategoritë përkatëse të kërkuara si në kriter, konkretisht mungon:

- Kategoria NP- 5 A me emërtim (Punime nëntokësore,ura e vepra arti)

-Kategoria NP-11 A me emërtim (Ndërtime për N/stacionet,kabinat e transformatorëve, linjat e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

- Kategoria NP-12 A me emërtim (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

- NS-18 A me emërtim (Punime topogjeodezike)

-Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80. Parimet e procesit të përzgjedhjes, pika1, “Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura,; neni 92 pika 3, “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO me përbërje; znj.D.D Kryetar, znj.K.M, z.Y.D.

8. Prokurimi me objekt: “Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare “Meleq Gosnishti” Përmet”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare “Meleq Gosnishti” Përmet”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 204 datë 13.06.2024	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. P.M , 2. M.K , 3. F.H ,	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr.204/1 datë 13.06.2024 1. A.M Kryetar, 2. D.D , 3 A.P ,
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur -punë		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 103,642,065 lekë	6. Oferta fituese: “OE Z. sh.p.k me ofertë , 98,407,650 lekë pa t.vs.h.	7. Diferenca me fondin limit: 5,234,415 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 09.07.2024,	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit + Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

I.Fondi Limit:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës është 103,642,065,51 lekë pa TVSH i detajuar si më poshtë:

- Financimi nga buxheti i Shtetit për vitin 2024 do të jetë në vlerën: 31,666,666 lekë pa TVSH dhe për vitin 2025 në vlerën 55,503,620 lekë pa TVSH.

- Financimi nga të ardhurat e Bashkisë për vitin 2025 do të jetë në vlerën: 16,471,778 lekë pa TVSH.

Me urdhër nr. 270 datë 16.08.2024 është mbajtur proces verbali për ngritjen e komisionit për llogaritjen e vlerësimit, komisioni i cili është i përbërë nga z. P.M , zj. M.K , z F.H .

Sa i përket preventivit të punimeve është hartuar dhe vlerësuar sipas manualeve të VKM nr .216 datë 13.04.2023, hartuar nga shoqëria “R. sh.p.k”.

Nga grupi i auditimit u testuan disa prej zërave të preventivit me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së çmimeve për njësi në preventiv me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit miratuar me VKM. 216, datë 13.4.2023 “*Për Krijimin Dhe Funksionimin e Sistemit Të Integruar Për informatizimin e Manualit të Çmimeve për zërat e Punimeve në Ndërtim*”. Nga verifikimi u konstatua se çmimet për njësi përputhen me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit.

II.Mbi Përcaktimin E Kriereve Të Kualifikimit:Me urdhër nr. 204 prot., datë 13.06.2024 është ngritur Njësia Prokurimit publik e përbërë nga zj. P.M Kryetar, zj.M.K Anëtar, dhe zj. F.H.

1.Nga auditimi në lidhje me kriteret e vendosura konstatohet se, në kriterin 2.3.3/a është kërkuar që OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licensën e shoqërisë si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi (Drejtimi Strukturist/Konstruktor) 1 (një)
- Arkitekt 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Telekomunikacioni/IT/Elektronik 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder 1 (një)
- **Inxhinier Mjedisi** 1 (një)

2. Në lidhje me kriterin ku kërkohet 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisi” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “*Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisi*” lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

- Këto kriterë janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet konkretisht Inxhinier Mjedisi..

3. Në lidhje me kriterin ku është kërkuar 1 (një) punonjës që të jetë i pajisur me çertifikatë si Ekspert Zjarrfikës, për dhenien asistencës teknike në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të ligjit nr. 152/2015 “*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*”.

-Ekspert zjarrfikës kërkohet në rastet kur duhet të bëhet ekspertizë apo një projekt për mbrojtjen nga zjarri, referuar pikës 29 në nenin 3 të Ligjit nr. 152/2015 Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, pra ky kriter është i tepërt.

4. Në lidhje me kriterin ku është kërkuar që OE të ketë një nga drejtuesit teknik të jetë i pajisur me “Certifikatë e Audituesit Energjistik” në ndërtesa, lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë në përputhje me VKM Nr. 407 datë 19.06.2019.

-Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

Në kriterin **2.3.5** është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës.

Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet veprimtaria e mjeteve me analizë teknike, si dhe për cilin qëllim do të përdoret në zbatimin e kontratës, por thjeshtë është argumentuar që secili mjet duhet për një (zë)/(orë) punimesh të caktuar .

5.Në kriterin **2.3.7** është kërkuar që Operatori/ët ekonomikë ofertues për materialet e kërkuara në këtë procedurë prokurimi cilëson se :

Në rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të paraqesi autorizim prodhuesi, ose distributori të autorizuar ose marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit **ose** midis ofertuesit -distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: Adresë, telefon, e-mail, ëbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

6.Në kriterin **2.3.8** Operatori/ët ekonomik përsa i përket pllakave të gurit për shtrimin e sheshit të shkollës, në përputhje me kushtet teknike dhe preventivin përkatës, në rast se nuk e disponon në pronësi duhet të paraqesë:

Kontratën e furnizimit

Çertifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ose deklarata e konformitetit në përputhje me standartin EN 1926 ose ekuivalente (përcaktimit të rezistencës në shtypje përsa i përket pllakave të gurit).

7.Në kriterin **2.3.9** është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë noteriale me një laborator testimi tëbetonit, hekurit dhe pllakave të gurit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2019 ose ekuivalent, SSH EN 12350-2:2019 ose ekuivalent, SSH EN 12504-2:2012 ose ekuivalent, SSH EN ISO 6892 – 1:2019 ose ekuivalent, SSH EN 1341:2012, SSH EN 1926:2006, SSH EN 1342:2012.

1.Përsa me sipër duhet të paraqitet:

2.Kontratë shërbimi me laboratorin testues përkatës

3.Çertifikata e akreditimit të laboratorit testues përkatës

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomikë pikat e kriterit 2.3.9 duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt-marrëveshje).

- Kërkesa për dokumentacionin e mësipërm në rastin kur OE disponon kontratë furnizimi me distributorin e autorizuar, i adresohet palëve të treta dhe jo OE që merr pjesë në garë, pasi në asnjë rast një distributor i autorizuar nuk ka detyrim që një të furnizuarit t'i vendosi në dispozicion dokumentacionin e tij ligjor që lidhet me prodhuesin e materialeve, përveç çertifikatë analize të cilësisë së materialit, faturë tatimore. Theksojmë se AK nuk është i detyruar, nuk duhet të kërkojnë: “certifikata të prodhuesit, të cilët mund të mos jenë konkurrentë në procedurën e prokurimit, apo për dokumente që i’u përkasin operatorëve ekonomikë që nuk janë palë në procedurën e prokurimit”.Sa më sipër, konstatohet se kriteret e veçanta të kualifikimit nuk janë në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 4, shkronjat “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 39, shkronjën “b”, paragrafi 2 në pikën 2 në nenin 78 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. *Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Njësia Prokurimit me përbërje: znj. P.M, znj.M.K, z.F.H.*

III.Vlerësimi i Ofertave: -Është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave me urdhër të titullarit nr. 204/1 datë 13.06.2024. Me shkresën nr. 1944/1 prot.,datë 19.08.2024, është hartuar Raporti Përmbledhës drejtuar për dijeni titullarit të AK.,Në vijim,është finalizuar procedura me lidhjen e kontratës nr. 2625 datë 10.10.2024.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 (dy) ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.V.K sh.p.k me Nipt K.....E me vlerë 101,566,756, lekë pa t.vsh.

2.Z. sh.p.k me Nipt L.....O me Vlerë oferte 98,407,650,48 lekë pa TVSH.(OE Fitues)

-Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori Ekonomik V.K sh.p.k me Nipt K26330202E me vlerë të ofertës 101,566,756 lekë pa TVSH. Konkretisht për arsyet e mëposhtme:

-Ky OE nuk ka ngarkuar në SPE sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3.

-Bilanci i vitit 2021 dhe 2022 është pa shkresën konfirmuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

-Puna e ngjashme e paraqitur për përmbushjen e pikës 2.3.1/a me objekt “Ndërtim i objektit hotel në lagjen Uji i Ftohtë Vlorë” ka si porosites V.K sh.p.k dhe si zbatues V.K shpk dhe mban datë lidhje 29.08.2017 pra më shumë se pesë vite nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

-Në licensën profesionale të shoqërisë është kërkuar kategoria N.P-3D kurse liçensa me nr. NZ.4064/12 e këtij OE ka kategorinë N.P-3B.

-Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.3.3/a Arkitekti i deklaruar z. R.V dhe Inxh. Elektronik z. SH.B nuk figurojnë si drejtues teknik në liçensën profesionale të shoqërisë. Përsa i përket Inxhinierit Elektronik nuk ka deklaruar që të jetë i pajisur me: Certifikatë CISCO CCNA (Cisco Certified Netëork Associate) ose ekuivalent (për Ndërlidhjen e pajisjeve të rrjetit Kompjuterik dhe Telekomunikacionit), e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të liçensuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

-Ky OE nuk ka ngarkuar në SPE deklaratën (nga Administratori i shoqërisë) për Drejtuesin Teknik të punimeve dhe deklaratën nga vet drejtuesi teknik për këtë objekt.

-Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.3.3/b në formularin e vetëdeklarimit nuk ka deklaruar: Teknik të mesëm elektrik; Teknik të mesëm topograf /gjeodet / gjeometër; Hekurpunues; Termoizolues; Specialist për veshje fasade; Përgatitës të konstruksioneve metalike; Marangoz/Mobilier; Murator /suvatues nga (5 persona) të kërkuar janë deklaruar (2 persona); Pllakashtrues nga (5 persona) të kërkuar janë deklaruar (3 persona); Hidroizolues nga (3 persona) të kërkuar janë deklaruar (2 persona); Specialist gipsi nga (3 persona) të kërkuar janë deklaruar (1 person); Specialist për sisteme ngrohje-ftohje nga (3 persona) të kërkuar janë deklaruar (2 persona);

-Ky OE nuk ka plotësuar dhe ngarkuar në SPE tabelën me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/certifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore.

-Ky OE nuk ka deklaruar 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

-Ky OE nuk ka deklaruar 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet certifikata e trajnimit e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

-Ky OE nuk ka deklaruar 2 (dy) “Përgatitës të konstruksioneve metalike”; 3 (tre) “Specialistë Veshje Fasade” dhe 2 (dy) “Karpentiere” që të disponojnë certifikatë trajnimi “Për punime në lartësi”, sipas V.K.M nr.312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

-Ky OE nuk ka deklaruar 1 (një) punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e kaldajave me avull dhe ujë të nxehtë sipas "Rregullores se sigurimit teknik të kaldajave

të avullit dhe ujit të nxehtë" dhe ligjit Nr. 32/2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion".

-Ky OE nuk ka deklaruar 1 (një) punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e rezervuareve të gazit (GLN ose LPG) mbi tokë dhe nëntokë sipas vendimit Nr. 1062, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet dhe bashkësitë nën presion" dhe ligjit Nr. 32/2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion".

-Për përmbushjen e pikës 2.3.5 ky OE nuk ka deklaruar: Autovinç me kapacitet ngritës mbi 5 ton; Vidiator; Trapan; Nivelues me lazer; Aparat lidhje për fibër optike; Frezë për rrafshim/hapje kanalesh në mur; Pompë presioni për testimin e tubave nën presion; Pajisje/Makineri për bashkimin e tubave PPR; Pajisje/Makineri për bashkimin e tubave PEX; Nga (3 copë) Matrapik të kërkuar është deklaruar vetëm (1 copë)

-Ky OE nuk ka paraqitur në SPE asnjë dokument për përmbushjen e pikave 2.3.7; 2.3.8; 2.3.9 dhe 2.3.10 të kërkuara në DST.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

1.Nga verifikimi i listëpagesës së paraqitur nga OE Z. konstatohet se, për (2) dy punonjësit e deklaruar në formularin e vetëdeklarimit z.P.Ç me profesion "Automakinist" dhe z. S.A me profesion "Eskavatorist", nuk figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.:

2.Nuk plotësohet pika 2.3.4 ku thuhet se listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Grupi i auditimit referuar legjilacionit në fuqi, konkretisht formatit që kërkohet ka konstatuar se: Në DST, lidhur me punësimin e stafit mbështetës, me profesionin "Përgatitës i Konstruksioneve Metalike,". Konkretisht nga verifikimi i dokumentacionit "Shtojca 8", të plotësuar nga OE Z. sh.p.k pasi ky OE, rezulton se ka deklaruar, me profesionin "Përgatitës i Konstruksioneve Metalike" punonjës in "K.Sh" Nga verifikimi i dokumentacionit "listëpagesa" mbi punonjës in K. Sh." konstatohet se ai figuron i punësuar me kodin e profesionit 7412.11, ndërkohë duhet të ishte me kod profesioni 7214. Sqarojmë se bazuar në përcaktimet e bëra në VKM nr.514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve" (LKP), të rishikuar, punonjës in e regjistruar në listëpagesë me kodin 7412.11, klasifikuar si "Elektro-mekanik, ndërkohë për prokurimin përkatës duhen punonjës me kod profesioni 7214 "Përgatitës i Konstruksioneve Metalike," i cili kryen sikurse e kërkon profesioni. Sqarojmë se bazuar në Udhëzimin nr.23, datë 09.12.2014 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", i ndryshuar, për plotësimin e rubrikave të deklaratës "Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi", tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë mbajnë parasysh sa më poshtë respektimin e pikave 1-12, ndër të cilat është edhe pika 11. Në rubrikën 11 "Detyra, funksioni, profesioni apo puna që ka kryer punonjës in" – shënohet detyra apo profesioni që punonjës in kryen në tatimpaguesin përkatës. Detyra apo profesioni zgjidhen nga lista kombëtare e profesioneve.

Sa më sipër rezulton se KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80. Parimet e procesit të përzgjedhjes, pika1, "Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura,; neni 92 pika 3, "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe

specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.

9. Prokurimi me objekt: “Blerje karburant për Bashkinë Përmet dhe institucionet në varësi për vitin 2024”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburant per Bashkinë Përmet dhe institucionet në varësi për vitin 2024		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 12 datë 10.01.2024	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. P.M , 2. F.L , 3. Z.J ,	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr.13 datë 11.01.2024 1. M.K Kryetar, 2. A.T , 3 Th.N ,
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur -		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 11,154,181 lekë	6. Oferta fituese: “OE O. me ofertë , 11,154,481 lekë pa TVSH.	7. Diferenca me fondin limit: 0
8. Data e hapjes së tenderit: 29.01.2024	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

I.Me VKB nr. 76 prot., datë 30.10.2023 është miratuar sasia e karburantit që do të shpenzohet për Bashkinë Përmet dhe institucionet në varësi, ku ka vendosur shpërndarjen si më poshtë:

-Sasia e harxhimit të karburantit për automjetin e administratës, Policisë Bashkiake, automjetet e NJA etj, të jetë 15000 litra në vit.

-Sasia e harxhimit të karburantit për automjetet e Ndërmarrjes së Pastrim Gjellbërimit të jetë 23000 litra në vit.

- Sasia e harxhimit të karburantit për automjetet e MZSH, të jetë 3600 litra në vit.

- Sasia e harxhimit të karburantit për lëvizjen e punonjësve të shërbimit pyjor të jetë 2300 litra në vit.

- Sasia e harxhimit të karburantit për mjetet e bordit të kullimit të jetë 12000 litra në vit.

- Sasia e harxhimit të karburantit për mjetet e punës për Rrugët Rruale të jetë 18000 litra në vit.

- Sasia e harxhimit të naftës për kaldajën e kopshtit nr.2. ë jetë 2800 litra për sezonin 1 janar -15 mars 2024 dhe 15 nëntor 2024-31 dhjetor 2024.

Me Urdhërin e prokurimit nr. 08 datë 08.01.2024, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Përmet, zj. A.H , është zhvilluar procedura e prokurimit me objekt “Blerje Karburanti për Bashkinë Përmet dhe institucionet në varësi, për vitin 2024) me fondin limit në vlerën prej 11,154,181lekësh pa TVSH.

II.Përcaktimi i kriterëve teknike dhe fondit limit:-Me procesverbalin pa nr, të datës 11.01.2023, me objekt “Për përlllogaritjen dhe argumentimin e fondit limit për procedurën me objekt: Blerje Karburanti për Bashkinë Përmet dhe institucionet në varësi”, Njësia e Prokurimit me përbërje: zj. P.M, z.F.L, z. Z.J, ka hartuar dhe argumentuar fondin limit për procedurën e sipërpemëndur.

I.Në lidhje me sasinë e përlllogaritur vec dokumentacionit të paraqitur, nuk ka një analizë të detajuar e cila duhet të ketë të përcaktuar kërkesat e paraqitura nga grupet e punës në terren, kërkesat nga shoferët që kanë në ngarkim mjetet, analizën mbi aktivitetin e punës së vitit të kaluar, parashikimin e volumeve të punës të vitit pasardhës bazuar në programin vjetor programeve mujore të miratuara, numrin e mjeteve si dhe verifikimi i gjendjes teknike mjeteve.

-Në kriteret për kapacitetet teknik nuk është vendosur si kriter dorëzimi nga OE i protokollmatjeve/verifikimi metrologjik për saktësinë e sasisë së hedhjes së karburantit për

instrumentat matës (pistoletat e shpërndarjes së karburantit) detyrim ligjor për subjektet që përdorin instrumente matës me qëllim mbrojtjen e interesave të AK në sasinë e karburantit në furnizimin pranë stacionit të shitjes.

Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 34, pika 3 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 12, pika 4, Neni 7, Neni 76, pika 2, VKM nr. 285 datë 19.05.2022, neni 74, pika 3. ,e përcaktimet e bëra në pikat 2, 3, , gërma “c” në pikën 6 në nenin 40, nenin 44, dhe pikën 2 në nenin 78 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;Për sa më sipër mban përgjegjësi, zj. P.M, z.F.L, z. Z.J.

III.Vlerësimi i Ofertave:. Është ngritur komisioni i vlerësimit të Ofertave me urdhër të titullarit nr. 13 prot., datë 11.01.2024. Me shkresën nr. 303/1 prot.,datë 02.02.2024, është hartuar Raporti Përmbledhës drejtuar për dijeni titullarit të AK.,Në vijim,është finalizuar procedura me lidhjen e kontratës nr. 367 prot., datë 05.02.2025.

Në, në këtë procedurë ka marrë pjesë 1 (një) ofertues i mëposhtëm me këtë vlerë përkatëse të ofruar: O. sh.p.k me Nipt J.....I me vlerë 11,154,481 lekë pa t.vsh me normë fitimi të shprehur në lekë 6 (gjashtë) lekë/litër.

10. Prokurimi me objekt: “Punime shtesë për sistemime të brendshme dhe të jashtme në objektin Pallati i Sportit Përmet”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Punime shtesë për sistemime të brendshme dhe të jashtme në objektin Pallati i Sportit Përmet”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 465 datë 23.12.2024	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. P.M , 2. M.K , 3. B. ,	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr.466 datë 23.12.2024 1. L.B Kryetar, 2. A.P , 3 K.L ,
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur -punë		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 9,630,685 lekë	6. Oferta fituese: “OE H. sh.p.k me ofertë , 6 442 421 lekë pa TVSH.	7. Diferenca me fondin limit: 3,188,264 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 06.01.2025	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit + Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 7 OE b) Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 5 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

I.Fondi Limit:Me urdhër nr. 419 datë 15.11.2024 është mbajtur proces verbali për ngritjen e komisionit për llogaritjen e vlerës limit, komisioni i cili është i përbërë nga z, P.M , zj, M.K , z B. . Sa i përket preventivit të punimeve është hartuar dhe vlerësuar sipas manualeve të VKM nr .216 datë 13.04.2023, hartuar nga subjekti “E. sh.p.k”.

Me VKB nr. 93 prot., datë 14.11.2024, konfirmuar me shkresën 929/1 prot., datë 15.11.2024 është miratuar në buxhet e zëri shtesë për sistemime të brendshme dhe të jashtme në objektin pallati i sportit Përmet, gjithashtu është mbajtur relacioni për projekt vendim.

Nga të dhënat e vendosura në dizpozicion nga Bashkia Përmet, preventivat e paraqitur për objektin e prokurimit “Rikonstruksion i e pallatit të sportit” dhe objektit “Punime shtesë të pallatit të sportit” rezultoi se preventivat me zërat përkatës për secilin objekt janë të ndryshëm.

II.Mbi Përcaktimin E Kriereve Të Kualifikimit:Me urdhër nr. 465 prot., datë 23.12.2024 është ngritur Njësia Prokurimit publik e përbërë nga zj. P.M , zj.G.I Anëtar, dhe z. J.S .

Me shkresën nr. 3415 prot., datë 23.12.2024 është mbajtur procesverbal për argumentimin e kriereve.

1.Në lidhje me kriterin 2.3.6 ku është kërkuar numri dhe lloji i makinerive,paisjeve në pronësi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Nr.	Lloji i Makinerive	Njesia	Sasia	Statusi
1	Vinc me kosh	Copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Matrapik	Copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Karroca dore	Copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Motosaldatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Betoniere	Copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Depozite uji 1000 l	Copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Vibrator betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Gjenerator minimumi 100 kva	Copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Doreza per punetore	Copë	5	Në pronësi ose me qera
10	Kokore mbrojtëse për kokën	Copë	8	Në pronësi ose me qera
11	Jeleke fosforeshente per punetoret	Copë	8	Në pronësi ose me qera
12	Fikese zjarri	Copë	2	Në pronësi ose me qera
13	Kuti e ndihmes se shpejte	Copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Prozhektor per ndricim	Copë	1	Në pronësi ose me qera

Nësia e Prokurimit në proces verbalin nr.3415 prot., datë 23.12.2024 për argumentimin e kriterëve, nuk ka argumentuar teknikisht “Pajisjet dhe mjetet” e mësipërme se pse janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.Në kriterin **2.3.7** nga NjP është kërkuar që OE të disponojë certifikatën për sistemimin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO zërave të mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Njësia Prokurimit me përbërje;znj,P.M , Znj.M.K , z.B.
III.Vlerësimi i Ofertave: Është ngritur komisioni i vlerësimit të Ofertave me urdhër të titullarit nr. 466 prot., datë 23.12.2024. Me shkresën nr. 48/1 prot.,datë 24.01.2025, është hartuar Raporti Përmbledhës drejtuar për dijeni titullarit të AK. Në vijim, është finalizuar procedura me lidhjen e kontratës nr. 642 datë 05.03.2025.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1.A. sh.p.k me Nipt M.....H me vlerë 6,766,147 lekë pa TVSH.
- 2.E. sh.p.k me Nipt K.....P me vlerë 7,305,934 lekë pa TVSH.
- 3.H. sh.p.k me Nipt J....O me vlerë 6,442,421 lekë pa TVSH.(OE Fitues)
- 4.L. VII sh.p.k me Nipt K..... me vlerë 9,030,095 lekë pa TVSH.
- 5.N. 1934 sh.p.k me Nipt J.....S me vlerë 7,139,905 lekë pa TVSH.
- 6.S. sh.p.k Nipt K.....Ë me vlera 9,445,160 lekë pa TVSH.
- 7.T. sh.p.k me Nipt K....L vlerë 7,345,593 lekë pa TVSH.

2.Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1.A. sh.p.k me Nipt M.....H me vlerë 6,766,147 lekë pa TVSH. për arsyet e mëposhtme:

Ky OE ka bërë llogaritje gabim në preventiv pasi vlerën 587,000 lekë (punime të brendshme) e ka shtuar dy herë dhe të punimet për sistemimet e jashtme. Referuar preventivit të ofertuar pra shtojcës 2. ë DST-ve gabimi në total shkon në vlerën 616,350 lekë duke ndikuar dhe në vlerën totale pa TVSH. Kjo bie ndesh me VKM-në 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar neni 82 pika 3 ku thuhet: “Ofertat me gabime aritmetike refuzohen,

kur: shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar”.

Ky OE nuk përmbush pikën 2.3.1 a) të DST-ve për përvojën e ngjashme të realizuar në sektorin privat me objekt: "Shtesë anësore 1 kat dhe objekt ndihmës 1 kat, në objektin egzistues 1 kat, kaponon industrial me adresë Katun i Ri, Tiranë" pasi dhe nga dokumentacioni i kërkuar në DST nuk është paraqitur *dhe një dokumenti tjetër që provon realizimin me sukses të punës.*

2. "S." sh.p.k me Nipt K.....Ë vlera 9,445,160 lekë pa TVSH. Për arsyet e mëposhtme:

Ky OE ka bërë llogaritje gabim në preventiv pasi vlerën 713,000 lekë (punime të brendshme) e ka shtuar dy herë dhe të punimet për sistemimet e jashtme. Referuar preventivit të ofertuar pra shtojcës 2. ë DST-ve gabimi në total shkon në vlerën 748,650 lekë duke ndikuar dhe në vlerën totale pa TVSH. Kjo bie ndesh me VKM-në 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar neni 82 pika 3 ku thuhet: *"Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur: shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar”.*

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

1. Nuk plotësohet kriteri 2.3.6 numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qira pika c) ku specifikohet se: Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, OE fitues nuk ka paraqitur dokumentacionin ku të provojë se disponon mjetin "Motosaldatrice" sikurse është kërkuar në kriterin 2.3.6.

2. Nga auditimi konstatohet se, nga OE H. nuk janë paraqitur foto për pajisjet teknike që ka deklaruar sikurse është përcaktuar në pikën c) të kriterit 2.3.6 .

Sa më sipër rezulton se KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80. Parimet e procesit të përzgjedhjes, pika 1, "Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura; neni 92 pika 3, "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.

-Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi KVO, z.L.B, zj.A.P, zj.K.L.

-Gjithashtu të gjitha proceset e parashikuara në nenin 21 pika 5 të LPP zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi zj. A.H. Kryetare e Bashkisë Përmet.

4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.

Në zbatim të pikës 4.4 të Programit të Auditimit, në Bashkinë Përmet, nga grupi i auditimit të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve të përfunduara dhe të mara në dorëzim nga Bashkia

Përmet për periudhën e auditimit 2023 -2024 për **6 (gjashtë)** investime në shumën **107,792,761 lekë**. Nga kjo analizë, u arsyetua që si objekte me risk në realizimin e punimeve, të cilat janë kërkuar për t'u audituar, janë përzgjedhur në bazë të vlerës së kontratës, llojit të punimeve të ndërtimit, zërave të punimeve të ndërtimit me risk të madh në zbatimin e veprave, të rishikimit të projekteve të zbatimit si dhe të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve për objektet e paraqitura në **Tabelën 1**, si vijon:

Tabela 1: Regjistri i kontratave për punë publike të përfunduara dhe të marra në dorzim nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Përmet, për periudhën e auditimit 2023 - 2024.

Nr.	Objekti i Prokurimit	Kodet CPV	Fondi Limit pa TVSH	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit te procedures se prokurimit	Operatori Ekonomik i shpallur fitues
VITI 2023						
1	Rehabilitimi i Kanalit Ujitës Piskove, Permet	Pompa centrifugale, Punime për ujitje	11.751.046	9,824,568	12/12/2022	“S. R” SHPK
2	Rikonstruksion me ndryshim funksioni nga Ish-Cerdhe ne Qender Rinore, Qytet Permet	Punime ndërtimi, Punime veshje, Punime hidraulike	10.844.730	8,940,050	04/01/2023	“A.” SHPK
3	Sistemim Asfaltim rruga Spital-Varreza	Punë ndërtimi	39.376.666,	31,719,823	30/11/2022	“H. 94” SHPK
4	Termoizolimi dhe permiresimi i sistemit te ngrohjes i Konviktit Permet	Pajisje ngrohje dhe ventilimi, Punime ndërtimi, Punime ngrohje, Punime hidroizolimi	11.507.560,	10,685,771	17/10/2022	“E.” SHPK
VITI 2024						
1	Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara	Punë ndërtimi, Punime ndërtimi për shtëpi	9.318.871	7,926,814	23/10/2023	“A.” SHPK
2	Rehabilitimi i digës së Rezervuarit Pacomit, Bashkia Përmet	Rezervuarë, Punime ndërtimi, Punime për ujitje	39.822.000	38,695,735	18/09/2023	“2.” SHPK

Burimi: Bashkia Përmet.

Mbështetur sa më sipër, për auditimin e zbatimit të punimeve të kontratave për punë publike, për periudhën e auditimit 01.01.2023 – 31.12.2024, u audituan **4 (katër)** investime në shumën totale **109,111,076.4 lekë me TVSH ose 84.35 %** të shumës totale të kontratave për punë publike **129,351,349.2 lekë**.

Në përfundim të auditimit të zbatimit të kontratave për punë publike, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, dhe shqyrtimit të observacioneve të subjektit të audituar Bashkia Përmet, **po pasqyrojmë në mënyrë të detajuar problematikat e konstatuara**, si vijon:

I. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për objektin: **“Rehabilitimi i digës së rezervuarit Pacomit, Bashkia Përmet”**, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rehabilitimi i digës së rezervuarit Pacomit, Bashkia Përmet” .		
14.Lidhja e kontratës nr. 2814 prot., datë 20.10.2023 OE “2.” SHPK	15.Vlera e kontratës VI e prev ofertues 46,434,882 lekë me TVSH. VI. Prev të ripunuar 46,433,982 lekë me TVSH.	16.Likuiduar: -Sit. Nr. 1 në vlerën 16,168,080 lekë me TVSH -Sit. Nr. 2 në vlerën 20,969,238 lekë me TVSH -Sit. Nr. 3 në vlerën 5,874,744 lekë me TVSH -Sit. Nr. 4 në vlerën 3,653,573 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar Sit. përfundimtar në vlerën 46,433,982 lekë me TVSH	18.Afati i kontratës. Fillimi punimeve: 27.10.2023 Përfundimi punimeve: 05.06.2024	19. Zgjatja e kontratës Afati 8 muaj. Shtyrje afati nuk ka.

20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “M.” SHPK	Licenca MK.1811/10	Kontratë me nr. 2862 prot., datë 26.10.2023
21. Kolaudatori i punimeve OE “P. 2019” SHPK	Licenca Nr: MK. 3492/1665	Kontratë nr. 1833 prot., datë 19.07.2024
22.Akt Kolaudimi. Akti i Kolaudit është kryer me sipas aktit me nr. 1833/1 prot., datë 29.07.2024 dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “2.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve OE “M.” SHPK dhe kolaudatori i punimeve shoqëria OE “P. 2019” SHPK .	23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 27.09.2024 është hartuar certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve nga OE “2.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve OE “M.” SHPK, kolaudatori i punimeve shoqëria “P. 2019” SHPK, si dhe nga Komisioni i ngritur nga Kryetari i Bashkisë Përmet , përkatësisht nga M.K, A.J , J.P, si dhe Kryetari i Bashkisë Znj. A.H.	

rezultoi me problematikat, si vijon:

Përshkrimi i Situatës:

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi;

1. Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 2814 prot., datë 20.10.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Përmet, përfaqësuar nga Kryetari Znj. A.H dhe shoqërisë “2.” SHPK me NIPT K.....M dhe, Lic. Nr. NZ3455/15 përfaqësuar nga Administratori z. A.S me vlerë të kontratës 46,434,882 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 8 (tetë) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Shtresë stabilizanti t=10 cm; Struktura të holla monolite betoni C 16/20 (betone kthesat)], **me pasojë dëm ekonomik** në buxhetin e Bashkisë Përmet, në vlerën **405,500 lekë pa TVSH**, si dhe zë pune i realizuar jo në përputhje me specifikimet teknike dhe normat dhe kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, në shumën **696,800 lekë pa TVSH**, vlerë e cila përfaqëson përdorim të fondeve publike pa **Efience dhe Efektivitet**, argumentuar sipas tabelës.

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferencanë +	
							Vol.	Vlera
	I.3 Punime betoni dhe betonarmeje							-
Zëri 20 (3.212/b)	Shtresë stabilizanti t=10 cm	m ³	400	680	680	Realizuar 50 %	-	136,000
	I.7 Punime të rehabilitimit kanalit vaditës pjesa nga pas (bjefi i poshtëm l=1120 ml)							-
Zëri 35 (An)	FV Tub metalik Ø 300 mm për kalimet në rrugë kanali vaditës	ml	5,200	134	134	134 ml tub çeliku i vjetër	-	696,800
	I.8 Punime për rrugë aksesi për te diga							-
Zëri 37 (3.243/1)	Struktura të holla monolite betoni C 16/20 (betone kthesat)	m ³	11,000	50	50	25.5	24.5	269,500

Nga ana e zbatuesi i punimeve shoqëria “2.” SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
- **Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998** “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, **ku përcaktohet se:** “Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane... ”.

- *Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...”*

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqëria “**M.**” SHPK, e përfaqësuar nga Administratori z. T.S, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- *Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”*.

- *UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”*.

Nga ana e kolaudatorit të punimeve shoqërisë, “P. 2019” SHPK e përfaqësuar nga Drejtuesi Ligjor z. S.T, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

- *Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se: “Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuar janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”*.

- *Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:*

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.

b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.

Konstatim. Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, rezulton se, paraprakisht, përpara zbatimit të kontratës së sipërcituar, nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Përmet është miratuar Vendimi me nr. 2830/1, datë 26.10.2023, për miratimin e Deklaratës për kryerje punimesh.

-Në gjykimin e grupit të auditimit nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Përmet, për projektin e zbatimit për objektin “Rehabilitimi i digës së rezervuarit Pacomit, Bashkia Përmet” **nuk duhej që të lëshohej Deklaratë për kryerje punimesh nr. 2830/1, datë 26.10.2023, por në zbatimin të VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, Neni 19, pika 1,**

germa “O” theksohet se: “Për basene ujore artificiale me kapacitet mbi 10,000 m3 i kërkohet Këshillit Kombëtar të Territorit, në bazë të nenit 28 të Ligjit (KKT-së) pajisja me Leje Ndërtimi Sa më sipër, sjellim në vëmendje të Drejtorisë së Urbanistikës si dhe Titullari i Bashkisë **Znj. A.H.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. T.S, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

2. Z. S.T, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

II. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për objektin: “Sistemim asfaltimi i rrugës Spital - Varreza”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Sistemim asfaltimi i rrugës Spital - Varreza”.		
14.Lidhja e kontratës nr. 79 prot., datë 09.01.2023 OE “H. 94” SHPK	15.Vlera e kontratës VI e prev ofertues 38,063,788 lekë me TVSH. VI. Prev të ripunuar 38,063,752 lekë me TVSH.	16.Likuiduar: -Sit. Nr. 1 në vlerën 10,000,000 lekë me TVSH -Sit. Nr. 2 në vlerën 13,626,000 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar Sit. përfundimtar në vlerën 14,437,752 lekë me TVSH	18.Afati i kontratës. Fillimi punimeve: 24.02.2023 Përfundimi punimeve: 25.08.2023	19. Zgjatja e kontratës Afati 6 muaj. Shtyrje afati nuk ka.
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “M. ” SHPK	Licenca MK.1811/10	Kontratë me nr. 687 prot., datë 28.02.2023
21. Kolaudatori i punimeve OE “S. Consulting” SHPK	Licenca Nr: MK. 4201	Kontratë nr. 2433 prot., datë 18.09.2023
22.Akt Kolaudimi. Akti i Kolaudimit është kryer me sipas aktit me datë 03.10.2023 dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “H. 94” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve OE “M. ” SHPK dhe kolaudatori i punimeve shoqëria OE “S. C.” SHPK .	23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 06.10.2023 është hartuar certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve nga OE “H. 94” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve OE “M.” SHPK, kolaudatori i punimeve shoqëria “S. C.” SHPK, si dhe nga Komisioni i ngritur nga Kryetari i Bashkisë Përmet , si dhe Kryetari i Bashkisë Znj. A.H .	

rezultoi me problematikat, si vijon:

Përshkrimi i Situatës:

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi;

1. Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 79 prot., datë 09.01.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Përmet, përfaqësuar nga Kryetari Znj. A.H dhe shoqërisë “H. 94” SHPK me NIPT J...O dhe, Lic. Nr. NZ. 1246/12 përfaqësuar nga Administratori z. A.H me vlerë të kontratës 38,063,788 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 6 (gjasthtë) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Trotuar, me 6 cm, me pllaka], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Përmet , në vlerën **327,951 lekë pa TVSH**, argumentuar si vijon:

Zëri 4 (An/3.620) Shtresë pllaka trotuari betoni h=6 cm.

Situacioni përfundimtar pasqyron 2,956 m² pllaka betoni me çmim 1,306 lekë. Libreza e masave pasqyron 2,956 m² pllaka betoni në mënyrë analitike. Nga auditimi i zbatimit të këtij zëri pune, u konstatuan problematikat si vijon:

-Së pari: Nga auditimi i punimeve në objekt rezulton se, paketa e trotuarit është realizuar me 4 shtresa dhe konkretisht: [Pllaka trotuari betoni me t= 6 cm; ; Rërë 3 cm; Shtresë me cakëll 15 cm]. Ndërkohë që, po t'i referohemi VKM Nr. 629, date 15.07.201 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” mbi analizën për zërin konkret me nr. Analize 3.620 është parashikuar që brenda çmimit të realizohej edhe **shtresa e betonit**. Pra, si rrjedhojë kjo shtresë betoni në trotuar, nuk mund të merret në konsideratë, aq më tepër që në projekt-preventivin e projektit të zbatimit është parashikuar një shtresë betoni poshtë pllakave t=10 cm, sipas zërit të punës “5(2.262)”. Rezultoni punë e kryer për sipërfaqen 2,956 m² pllaka me çmim **1,238 lekë** dhe jo 2,956 m² pllaka me çmim **1,306 lekë**.

Sa më sipër, diferenca në çmim prej **68 lekë** është libëruar dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve, në vlerën **201,008 lekë pa TVSH** [2,956 m² x 68 lekë].

-Së dyti: Në sipërfaqen totale të trotuarit nuk janë zbritur sipërfaqet që zënë pemët në sisinë prej 120 pemë me sipërfaqe 97.20 m² [0.81 m² (0.9 m x 0.9 m) x 120 pemë].

Sa më sipër, diferenca në sipërfaqe prej 97.20 m² është libëruar dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve, në vlerën **126,943 lekë pa TVSH** [97.20 m² x 1,306 lekë].

Nga ana e zbatuesi i punimeve shoqëria “**H. 94**” SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas: - **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se: “. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...”.

- **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqëria “M.” SHPK, e përfaqësuar nga Administratori z. T.S, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “.. Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të

vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, **nuk** rezulton të jetë pjesë e saj apo **të jetë kryer një oponencë teknike**, në lidhje me projektin e zbatimit për objektin: “Sistemim asfaltimi i rrugës Spital - Varreza”.

Për sa më sipër, referuar pikës **4 të VKM Nr.1055**, datë 22.12.2010, kërkesa për oponencë teknike bëhet nga investitori (Bashkia Përmet), çka nënkupton edhe përgjegjësinë e këtij të fundit në rast mosveprimi.

Si konkluzion, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponente teknike përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit.

Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, **neni 6, germa (a)**, ku theksohet: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: [a] ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventivuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik”, **Neni 6.**].

-Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar,

-VKM Nr.1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, **ngarkohet me përgjegjësi: Ish-Titullari i Bashkisë Përmet Znj. A.H .**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **Znj. A.H**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Përmet.

2. **Z. T.S**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

(III. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për objektin: “Termoizolimi dhe përmirësimi i sistemit të ngrohjes i konviktit Përmet”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Termoizolimi dhe përmirësimi i sistemit të ngrohjes i konviktit Përmet”.		
14.Lidhja e kontratës nr. 4027 prot., datë 28.12.2022 BOE “E. & C.” SHPK	15.Vlera e kontratës VI e prev ofertues 12,564,245 lekë me TVSH. VI. Prev të ripunuar 38,063,752 lekë me TVSH.	16.Likuiduar: -Sit. Nr. 1 në vlerën 6,006,166 lekë me TVSH -Sit. Nr. 2 në vlerën 6,558,000 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar Investimi përfundoi në vlerën 12,564,166 lekë me TVSH	18.Afati i kontratës. Fillimi punimeve: 09.02.2023 Përfundimi punimeve: 06.04.2023	19. Zgjatja e kontratës Afati 60 ditë. Shtyrje afati nuk ka.
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “M.” SHPK	Licenca Nr: MK. 1811/9	Kontratë nr. 46 prot., datë 05.01.2023
21. Kolaudatori i punimeve “F S” SHPK	Licenca Nr: MK. 3429	Kontratë nr. 1112 prot., datë 11.04.2023
22.Akt Kolaudimi.	23.Akt i marrjes në dorëzim:	

Akti i Kolaudimit është kryer me sipas aktit me nr. 1112/1 prot., datë 13.04.2023 dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve BOE “E. & C” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve OE “M.” SHPK dhe kolaudatori i punimeve “F S” SHPK.	Me nr. 1600/1 prot., datë 27.06.2023 është hartuar certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve nga OE “E. & C.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve OE “M.” SHPK, kolaudatori i punimeve shoqëria “F S” SHPK, si dhe nga Komisioni i ngritur nga Kryetari i Bashkisë Përmet me përbërje M.K , A.J , Dh.P, si dhe Kryetari i Bashkisë Znj. A.H.
---	--

rezultoi me problematikat, si vijon:

Përshkrimi i Situatës:

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi;

1. Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 4027 prot., datë 28.12.2022. ë lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Përmet, përfaqësuar nga Kryetari Znj. A.H dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “E.” SHPK me NIPT J.....Odhe, Lic. Nr. NZ. 3374/7 përfaqësuar nga Administratori z. H.M dhe OE C. SHPK me NIPT J.....S dhe, Lic. Nr. NZ. 0005/24 me përfaqësues ligjor z. F.C me vlerë të kontratës 12,564,245 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 60 (gjashtëdhjetë) ditë, nga nënshkrimi i kontratës nga data e lidhjes së kontratës me mbikëqyrësin e punimeve, kjo sipas afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit dhe të pranuar nga operatori ekonomik në tender, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5 cm + rrjetë + suva; F.V Dyer d/alumini plastike me dopio xham; FV Fikse zjarri me Co2, destinacioni për mbrojtje e pajisjeve elektrike nga zjarri, kapaciteti 6 kg;], **me pasojë dëm ekonomik** në buxhetin e Bashkisë Përmet , në vlerën **664,487 lekë pa TVSH**, argumentuar sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferencanë +	
							Vol.	Vlera
II. Punime, termoizolimi, suvatimi, shtresash								-
Zëri 1 (An.)	Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5 cm + rrjetë + suva	m ²	2,500	851	851	851 m2 realizuar me çmim 1,799 lekë dhe jo me çmim 2,500 lekë	-	596,551
Zëri 13 (2.395/1.)	F.V Dyer d/alumini plastike me dopio xham	m ²	15,000	7.3	7.3	7.3 m2, realizuar me çmim 10,543 lekë dhe jo me çmim 15,000 lekë	-	32,536
V. Punime për MNZ								-
Zëri 2 (An.)	FV Fikse zjarri me Co2, destinacioni për mbrojtje e pajisjeve elektrike nga zjarri, kapaciteti 6 kg	copë	1,400	2	2	1	1	14,000
VII. Pajisje për ngrohje								-
Zëri 3 (An.)	FV Termometër (0-120o)	copë	800	2	2	-	2	1,600
Zëri 4 (An.)	FV Manometër	copë	800	2	2	-	2	1,600
Zëri 5 (An.)	FV Presostat sigurie	copë	1,200	1	1	-	1	1,200
Zëri 6 (An.)	FV Flusostat	copë	9,000	1	1	-	1	9,000
Zëri 10 (An.)	FV Enë zgjerimi me diafragmë për linjat e terminaleve ngrohës: Volumi 50 lit, Diametri 407 mm, lartësia 530 mm.	copë	8,000	2	2	1	1	8,000

Nga ana e zbatuesi i punimeve BOE E. SHPK & C. SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se: “ ... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...”.

- **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqëria “M.” SHPK , e përfaqësuar nga Administratori z. T.S, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Librezat e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezat hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.

Nga ana e kolaudatorit të punimeve shoqërisë, “F S” SHPK e përfaqësuar nga Drejtuesi Ligjor Z. S.B, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

- **Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, **Kreu III, neni 12**, ku përcaktohet se: “Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit teknik ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuar janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”

- **Udhëzimin nr. 3** datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.

b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, **nuk** rezulton të jetë pjesë e saj apo të jetë kryer një **Oponencë Teknike**, në lidhje me projektin e zbatimit për objektin: “Termoizolimi dhe përmirësimi i sistemit të ngrohjes i konviktit Përmet”.

Mungesa e oponencës teknike, në rastin konkret, rezulton në kundërshtim me pikën 1 të VKM Nr.1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.

Miratimi i projektit të zbatimit, nga ish Kryetari i Bashkisë Përmet, në mungesë të oponencës teknike, është në kundërshtim me pikën 3 të VKM Nr.1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, sipas të cilës: “Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponencës teknike...”.

Si konkluzion, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponente teknike përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit.

Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me:

- **Ligjin Nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, **neni 6, germa (a)**, ku theksohet: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha:

a) ndërtimet publike;

b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventivuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë;

c) objektet me akses publik”, **Neni 6**.

- **Ligjin Nr. 120/2020** “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, **ngarkohet me përgjegjësi: Ish-Titullari i Bashkisë Përmet Znj. A.H.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **Znj. A.H.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Përmet.

2. **Z. T.S.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

3. **Z. S.B.**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

IV. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për objektin: “Rehabilitimi i kanalit ujitës Piskovë”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rehabilitimi i kanalit ujitës Piskovë”.		
14.Lidhja e kontratës nr. 107 prot., datë 11.01.2023 OE “S.” SHPK	15.Vlera e kontratës VI e prev ofertues 11,439,482.70 lekë me TVSH. VI. Prev të ripunuar 46,433,982 lekë me TVSH.	16.Likuiduar: -Sit. Nr. 1 në vlerën 4,856,298.72 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar Sit. përfundimtar në vlerën 6,254,024.78 lekë me TVSH	18.Afati i kontratës. Fillimi punimeve: 05.05.2023 Përfundimi punimeve: 28.07.2023	19. Zgjatja e kontratës Afati 3 (tre) muaj. Shtyrje afati nuk ka.

20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “P. 2019 ” SHPK	Licenca MK.3492/1	Kontratë me nr. 196 prot., datë 18.01.2023
21. Kolaudatori i punimeve OE “2&P S” SHPK	Licenca Nr: MK. 4190	Kontratë nr. 2337 prot., datë 07.09.2023
22.Akt Kolaudimi. Akti i Kolaudit është kryer me sipas aktit me nr. 2407 prot., datë 14.09.2023 dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “S.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve OE “P. 2019” SHPK dhe, kolaudatori i punimeve shoqëria OE “2&P H S” SHPK .	23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 02.10.2023 është hartuar certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe, është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve nga OE “S.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve OE “P. 2019” SHPK , kolaudatori i punimeve shoqëria “2D&P HSA S” SHPK, si dhe nga Komisioni i ngritur nga Kryetari i Bashkisë Përmet , përkatësisht nga M.C , B.I , J.P , si dhe Kryetari i Bashkisë Znj. A.H.	

rezultoi me problematikat, si vijon:

Përshkrimi i Situatës:

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi:

1. Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 107 prot., datë 11.01.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Përmet, përfaqësuar nga Kryetari Znj. A.H dhe shoqërisë “S.” SHPK me NIPT K.....S dhe, Lic. Nr. NZ. 8082 përfaqësuar nga Administratori znj. A.B me vlerë të kontratës 11,439,482.70 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 3 (tre) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Nënshtresë zhavorri; F.V Tuba çeliku Ø>200 të pa izoluar për ujësjellësa të jashtëm (tubi i thithjes 1-25 m); F.V Valvula moskthimi çeliku me fllanxha, Pn deri 25 bar, Ø250 (Valvula e thithjes); F.V Valvula moskthimi çeliku me fllanxha, Pn deri 25 bar, Ø 200 mm; F.V Saraçineska gize me fllanxha, Pn deri 16 bar, Ø>200; Shkallë metalike me hekur dhe profile (për të zbritur tek vepra e marrjes); Hekur betoni (për bazamentin e tij); Rrethim me kollona b/a + rrjetë teli (paneli + kabina + pompa)], **me pasojë dëm ekonomik** në buxhetin e Bashkisë Përmet , në vlerën **1,241,795 lekë pa TVSH**, pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferencanë +	
							Vol.	Vlera
A. KANALE DHE VEPRAT E TIJ								
Zëri 5 (2.258)	Nënshtresë zhavorri.	m ³	1,150	431.3	431.3	-	431.3	495,995
D. Vepra e marrjes.								
Zëri 1 (4.6)	F.V Tuba çeliku Ø>200 të pa izoluar për ujësjellësa të jashtëm (tubi i thithjes 1-25 m).	Ton	215,000	0.8	0.8	-	0.8	172,000
Zëri 3 (4.128/6)	F.V Valvula moskthimi çeliku me fllanxha, Pn deri 25 bar, Ø250 (Valvula e thithjes).	copë	150,000	1	1	-	1	150,000
Zëri 4 (4.128/6)	F.V Valvula moskthimi çeliku me fllanxha, Pn deri 25 bar, Ø 200 mm	copë	130,000	1	1	-	1	130,000
Zëri 5 (4.123/7)	F.V Saraçineska gize me fllanxha, Pn deri 16 bar, Ø>200	copë	85,000	1	1	-	1	85,000
Zëri 6 (4.4)	Shkallë metalike me hekur dhe profile (për të zbritur tek vepra e marrjes)	Ton	22,000	0.4	0.4	-	0.4	8,800
Zëri 7 (2.166)	Hekur betoni (për bazamentin e tij)	Ton	100,000	0.5	0.5	-	0.5	50,000
Zëri 8 (3.837)	Rrethim me kollona b/a + rrjetë teli (paneli + kabina + pompa)	m ²	1,500	100	100	-	100	150,000

Nga ana e zbatuesi i punimeve shoqëria “S.” SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se: “ ... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...”.

- **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqëria “**P. 2019**” SHPK, e përfaqësuar nga Administratori z. S.T, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Librezat e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.

Nga ana e kolaudatorit të punimeve shoqërisë “2D & P HSA S” SHPK e përfaqësuar nga Drejtuesi Ligjor z. H.LL, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale (për zërat vizual) të bëra në:

- **Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, **Kreu III, neni 12**, ku përcaktohet se: “Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuar janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”

- **Udhëzimin nr. 3** datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.

b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, **nuk** rezulton të jetë pjesë e saj apo të jetë kryer një oponentë teknike, në lidhje me projektin e zbatimit për objektin: “**Rehabilitimi i kanalit ujitës Piskovë**”.

Mungesa e oponentës teknike, në rastin konkret, rezulton në kundërshtim me **pikën 1 të VKM Nr.1055**, datë 22.12.2010 “*Për vendosjen e oponentës teknike për projektet e veprave të ndërtimit*”.

Miratimi i projektit të zbatimit, nga ana e Këshillit Teknik të Bashkisë Përmet, në mungesë të oponentë teknike, është në kundërshtim me **pikën 3 të VKM Nr.1055**, datë 22.12.2010 “*Për vendosjen e oponentës teknike për projektet e veprave të ndërtimit*”, sipas të cilës: “*Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponentës teknike...*”.

Për sa më sipër, referuar pikës **4 të VKM Nr.1055**, datë 22.12.2010, kërkesa për oponentë teknike bëhet nga investitori (Bashkia Përmet), çka nënkupton edhe përgjegjësinë e këtij të fundit në rast mosveprimi.

Si konkluzion, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponente teknike përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit.

Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me:

1. Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, **neni 6, germa (a)**, ku theksohet: “Oponenta teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha:

a) ndërtimet publike;

b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventivuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë;

c) objektet me akses publik”, **Neni 6**.

2. Ligjin Nr. 120/2020 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, të ndryshuar,

3. VKM Nr.1055, datë 22.12.2010 “*Për vendosjen e oponentës teknike për projektet e veprave të ndërtimit*”, **ngarkohet me përgjegjësi: Ish-Titullari i Bashkisë Përmet Znj. A.H** .

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj. A.H, në cilësinë e Ish-Kryetarit të Bashkisë Përmet.

2. Z. S.T, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

3. Z. H.LL, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e kontratave për punë publike:

Nga auditimi i 4 (katër) kontratave për punë publike për periudhën e auditimit në vlerën totale 109,111,076.4 lekë me TVSH, u konstatuan problematikat si vijon:

► *Në 4 (katër) raste, rezultuan zëra pune të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën 2,639,733 lekë pa TVSH, në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, si dhe Kontratat përkatëse të zbatimit, respektivisht:*

- Vlera 664,487 lekë pa TVSH, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën me nr. 4027 prot., datë 28.12.2022 me objekt:

“Termoizolimi dhe përmirësimi i sistemit të ngrohjes i konviktit Përmet” me sipërmarrës BOE “E.” SHPK ” SHPK & C.SHPK.

- Vlera 1,241,795 lekë pa TVSH, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën me nr. 107 prot., datë 11.01.2023 me objekt: “Rehabilitimi i kanalit ujitës Piskovë” me sipërmarrës OE “S.” SHPK.

- Vlera 405,500 lekë pa TVSH, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën me nr. 2814 prot., datë 20.10.2023 me objekt: “Rehabilitimi i digës së rezervuarit Pacomit, Bashkia Përmet” me sipërmarrës OE “2.” SHPK.

- Vlera 327,951 lekë pa TVSH, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën me nr. 79 prot., datë 09.01.2023 me objekt: “Sistemim asfaltimi i rrugës Spital - Varreza” me sipërmarrës OE “H. 94” SHPK.

► Në 3(tre) raste, nga auditimi i zbatimit të kontratave për punë publike për objektet përkatësisht:
- “Sistemim asfaltim të rrugës Ura e Luznisë - kryqëzimi i rrugës së fshatit Lishan me fshatin Hotesht, Faza I” me nr. 815 prot., datë 24.02.2023, fituar nga shoqëria “C.” SHPK me vlerë të kontratës 36,445,518 lekë me TVSH,

- “Sistemim asfaltimi i rrugës Spital - Varreza” me nr. 79 prot., datë 09.01.2023, fituar nga shoqëria “H. 94” SHPK me vlerë të kontratës 38,063,788 lekë me TVSH,

- “Termoizolimi dhe përmirësimi i sistemit të ngrohjes i konviktit Përmet” me nr. 79 prot., datë 09.01.2023, fituar nga BOE “E.” SHPK & C. SHPK me vlerë të kontratës 12,564,245 lekë me TVSH,

*- “Rehabilitimi i kanalit ujitës Piskovë” me nr. 107 prot., datë 11.01.2023, fituar nga OE “S.” SHPK me vlerë të kontratës 11,439,482.70 lekë me TVSH, u konstatua se: Nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Përmet nuk është kryer **Oponencë Teknike**, veprim ky në mospërputhje me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998”, me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 52, me VKM Nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”.*

5.Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.

5.1 Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

5.2. Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.

Në zbatim të pikës 5 “Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM-ve”, të programit të auditimit nr.323/1 Prot., datë 10.03.2025, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Listat e pasurive të paluajtshme të transferuara sipas VKM- ve përkatëse;
- Lista e pasurive të paluajtshme të regjistruara në kadastrë;
- Inventari i fondit pyjor;
- Kontratat e lidhura për dhënien me qira të fondit pyjor;

Të përgjithshme:

Bashkia Përmet ka miratuar strukturën organizative për vitin 2024 me Vendimin nr. 21, datë 16.01.2024, e cila është rishikuar me Vendimin nr. 345/1, datë 02.10.2024. Administrimi i pasurive kryhet nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësi dhe Turizëm (DZHEBT), ku Specialistët e Aseteve mbikëqyrin dokumentimin, inventarizimin dhe ruajtjen e aktiveve.

Në përputhje me detyrimet ligjore, Bashkia Përmet duhet të ketë një regjistër të saktësuar të pronave, tokave dhe pasurive natyrore, të fituara përmes akteve ligjore, shpronësimeve dhe shkrirjes së ish-komunave. Për të pasqyruar saktë vlerën e tyre në pasqyrat financiare, është e nevojshme kryerja e inventarizimit, vlerësimi fizik e monetar, si dhe krijimi i regjistrit kontabël me të dhëna analitike mbi asetet.

5.1 Mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të aseteve në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se:

a. Sipas VKM-ve përkatëse, janë transferuar gjithsej **3,250 pasuri**, të cilat përfshijnë ndërtesa, pyje, kullota, toka dhe terrene, nga të cilat **3,015 pasuri** janë në pronësi dhe **235 pasuri** në përdorim, të ndara si më poshtë:

- **Bashkia Përmet** – Me VKM nr. 1032, datë 08.10.2009, janë transferuar **415 pasuri** (400 në pronësi, 15 në përdorim).
- **Njësia Administrative Qendër Piskovë (ish-Komuna Piskovë)** – Me VKM nr. 738, datë 16.10.2012, janë transferuar **470 pasuri** (454 në pronësi, 16 në përdorim).
- **Njësia Administrative Petran (ish-Komuna Petran)** – Me VKM nr. 806, datë 06.10.2010, janë transferuar **1,090 pasuri** (1,042 në pronësi, 48 në përdorim).
- **Njësia Administrative Frashër (ish-Komuna Frashër)**
 - Me VKM nr. 240, datë 25.04.2007, janë transferuar **156 pasuri** (pa përcaktim të qartë të pronësisë/përdorimit).
 - Me VKM nr. 264, datë 12.05.2021, janë shtuar **8 pasuri**.
 - Me VKM nr. 525, datë 29.07.2022, janë shtuar **3 pasuri**.
- **Njësia Administrative Çarshovë (ish-Komuna Çarshovë)** – Me VKM nr. 70, datë 20.02.2011, janë transferuar **1,108 pasuri** (952 në pronësi, 156 në përdorim).

Bazuar në të dhënat e siguruara nga subjekti, tabela e mëposhtme përmbledh numrin e pronave sipas listës së inventarit dhe VKM-ve përkatëse për Bashkinë Përmet dhe Njësitë e saj Administrative, si dhe numrin total të pasurive të regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me titull pronësie.

Tabela përmbledhëse sipas VKM-ve për pasuritë e regjistruara në ASHK

Nr.		VKM / Shkresa		Në pronësi Në numër	Në përdorim Në numër	Nga këto regjistruar
		Numër	Datë			
1	Bashkia Përmet	1032	08.10.2009	400	15	20
2	NJA. Piskovë	738	16.10.2012	454	16	0
3	NJA. Petran	806	06.10.2010	1042	48	1
4	NJA Çarshovë	70	20.02.2011	952	156	10
5	NJA Frashër	240	25.04.2007	156		8
4	NJA Frashër	264	12.05.2021	8	-	0
5	NJA Frashër	525	29.07.2022	3	-	0
	TOTAL			3015	235	39

Burimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësi, Turizëm

Përpunoi: Grupi i auditimit

Aplikime për certifikatë pronësie në DR ASHK për vitin 2024

Nr i aplikimit	Dt. Aplikimit	Nr. pasurise	Volum	Faqe	ZK	Certifikate pronesie
362	05.03.2024	350	5	83	1292	JO
362	05.03.2024	349	5	68	1292	JO

677	23.04.2024	8/20	27	57	2917	JO
845	23.05.2024	6/103	21	73	2917	JO

Pasuri të tjera të kaluara në pronësi të Bashkisë Përmet

-Me shkresën nr.1731 prot., datë 20.10.2016, Prefektura Gjirokastrë me procesverbal dorëzimi ka transferuar pronat e paluajtshme shtetërore dhe aktivet e tjera të Sektorit PMNZSH-së.

-Me shkresën nr.448/5 prot., datë 01.07.2016, Bordi Rajonal i Kullimit Fier i ka transferuar Bashkisë Përmet Asetet e Paluajtshme të Bordeve dhe Mjetet e Pajisjet.

- Me VKM nr.915, datë 11.11.2015, Bashkisë Përmet i janë transferuar, nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, asetet e luajtshme e të paluajtshme të Rrjetit të Rrugeve Rurale . Marrja në dorëzim e aseteve të paluajtshme të pajisjeve është bërë me procesverbal datë 15.03.2016 .

- Ka në administrim 22 apartamente të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) dhe të dorëzuara bashkisë. Në përputhje me Vendimin Nr. 898, datë 18.11.2020 “Për Rregullat, Kushtet, Kriteret e Procedurat e Privatizimit të Banesave dhe të Objekteve të kthyer në Fond Banese të Paprivatizuara”, VKB nr. 36, datë 02.06.2021, “Për miratimin e privatizimit të banesave sociale me nr pasurie 83/3 dhe 93/3”, si dhe VKB nr. 36 datë 30.05.2022, “Për miratimin e privatizimit të banesave sociale në qytetin Përmet si dhe vlerën e privatizimit të tyre në favor të përfituesëve”, Bashkia duhet të lidhë kontratat e shitjes me rezervë me subjektet përfituese për apartamentet si më poshtë vijon:

Nr	Apartamentet	Kontrata	Çertifikuar	Përfituesi
Pasuria pallat me nr. 83/3, Qyteti Përmet				
1	ZK 2917, 28/55+1-15, Vol 14, Fq 220	Po	Po	VH
2	ZK 2917, 28/55+1-9, Vol 14, Fq 214	Po	Po	VM
3	ZK 2917, 28/55+1-4, Vol 14, Fq 209	Po	Po	ID
4	ZK 2917, 28/55+1-1, Vol 14, Fq 206	Po	Po	BD
5	ZK 2917, 28/55+1-2, Vol 14, Fq 207	Po	Po	ADH
6	ZK 2917, 28/55+1-3, Vol 14, Fq 208	Jo	Jo	YR
7	ZK 2917, 28/55+1-6, Vol 14, Fq 211	Po	Po	LC
8	ZK 2917, 28/55+1-8, Vol 14, Fq 213	Jo	Jo	YR
9	ZK 2917, 28/55+1-10, Vol 14, Fq 215	Po	Po	PS
Pasuria pallat me nr. 93/3, Lagja e re , Qyteti Përmet				
1	ZK 2917, 25/80+1-6, Vol 15, Fq 184	Po	Po	AD
2	ZK 2917, 25/80+1-3, Vol 15, Fq 181	Jo	Jo	SHC
3	ZK 2917, 25/80+1-1, Vol 15, Fq 179	Po	Po	AN
4	ZK 2917, 25/80+1-8, Vol 15, Fq 186	Po	Po	FD
5	ZK 2917, 25/80+2-3, Vol 15, Fq 191	Po	Po	THK
6	ZK 2917, 25/80+2-4, Vol 15, Fq 192	Po	Po	KH
7	ZK 2917, 25/80+2-5, Vol 15, Fq 193	Jo	Jo	SGJ
8	ZK 2917, 25/80+2-6, Vol 15, Fq 194	Po	Po	HM
9	ZK 2917, 25/80+2-8, Vol 15, Fq 196	Po	Po	IC
10	ZK 2917, 25/80+2-7, Vol 15, Fq 195	Po	Po	BD
11	ZK 2917, 25/80+2-9, Vol 15, Fq 197	Po	Po	LB
12	ZK 2917, 25/80+2-10, Vol 15, Fq 198	Po	PO	KB
13	ZK 2917, 25/80+1-10, Vol 15, Fq 180	Po	PO	NC

Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se bashkia Përmet nuk ka pajisur me çertifikatë pasuritë me nr. 28/55+1-8, nr. 28/55+1-3, nr. 25/80+1-3, nr. 25/80+2-5. Çertifikimi i apartamenteve është i domosdoshëm me qëllim lidhjen e kontratës së shitjes me rezervë me subjektet përfituese nga privatizimi, në përputhje me Vendimin Nr. 898, datë 18.11.2020 “Për Rregullat, Kushtet, Kriteret e Procedurat e Privatizimit të Banesave dhe të Objekteve të kthyer në Fond Banese të Paprivatizuara”, Kreu V – Lidhja e Kontratës, si dhe si dhe VKB nr 36, datë 30.05.2022 “Për miratimin e privatizimit të banesave sociale në Qytetin Përmet si dhe vlerën e privatizimit të tyre në favor të përfituesëve”.

b. Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Përmet dhe Njësite Administrative Qendër Piskovë, Petran, Frashër dhe Çarshovë, nuk është ndërmarrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të këtyre pronave. Nuk janë kryer evidentimet përkatëse në terren, çka ka penguar hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik, si dhe dorëzimin e tyre pranë ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Këto mangësi bien në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, ku përcaktohet se:

"Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji."

Inventarët e pronave të paluajtshme të miratuara me VKM-të përkatëse për Bashkinë Përmet dhe Njësitë e saj Administrative nuk pasqyrojnë gjendjen reale të këtyre pasurive. Kjo vjen si pasojë e mungesës së rakordimit me Drejtorinë Vendore të ASHK mbi statusin juridik dhe ndryshimet e mundshme për shkak të legalizimeve, privatizimeve, kthimeve/kompensimeve apo vendimeve gjyqësore.

Në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, 2, gërm a, b, si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 26-30, nuk janë ngritur grupe pune apo marrë masa konkrete për inventarizimin e pasurive të paluajtshme sipas VKM-ve. Gjithashtu, në buxhetin e vitit 2024 është parashikuar një fond prej 200,000 lekësh, i dedikuar për aplikimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të transferuara sipas VKM-ve. Nga ky fond, Bashkia Përmet ka përdorur vetëm 40,000 lekë, duke aplikuar pranë DR ASHK për regjistrimin e vetëm 4 pasurive, nga të cilat rezulton se nuk është çertifikuar asnjë pasuri.

Konkluzion

- Në total, me VKM-të përkatëse janë transferuar 3,250 pasuri në Bashkinë Përmet, nga të cilat 3,015 janë në pronësi dhe 235 në përdorim. Vetëm 39 pasuri janë të pajisura me çertifikatë pronësie, ndërsa 2,976 mbeten të paregjistruara. Gjatë vitit 2024, janë aplikuar vetëm 4 pasuri për regjistrim në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, nga të cilat nuk është çertifikuar asnjë pasuri.

Bashkia Përmet nuk ka ndërmarrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të këtyre pronave dhe nuk ka kryer veprimet e nevojshme ligjore për regjistrimin e pasurive të transferuara. Gjithashtu, nuk është siguruar pajisja e tyre me çertifikatë pronësie, duke vepruar në kundërshtim me: Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV, neni 37, pika 1, 2, germa a, b, Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI, “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i i ndryshuar, pikat 26-30.

- Bashkia Përmet administron 22 apartamente të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) dhe të dorëzuara bashkisë, për të cilat bashkia duhet të lidhë kontratat e shitjes me rezervë me subjektet përfituese për apartamentet e miratuara për privatizim.

Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se bashkia Përmet nuk ka pajisur me çertifikatë pronësie pasuritë me nr. 28/55+1-8, nr. 28/55+1-3, nr. 25/80+1-3, nr. 25/80+2-5. Çertifikimi i apartamenteve është i domosdoshëm me qëllim lidhjen e kontratës së shitjes me rezervë me subjektet përfituese nga privatizimi. Kto veprime dhe mos veprime janë në mospërputhje me Vendimin Nr. 898, datë 18.11.2020 “Për Rregullat, Kushtet, Kriteret e Procedurat e Privatizimit

të Banesave dhe të Objekteve të kthyer në Fond Banese të Paprivatizuara”, Kreu V – Lidhja e Kontratës, si dhe VKB nr 36, datë 30.05.2022 “Për miratimin e privatizimit të banesave sociale në Qytetin Përmet si dhe vlerën e privatizimit të tyre në favor të përfituesëve”.

- **Bazuar VKM-në 398, datë 13.05.2020** “Për disa ndryshime në vendimin nr.433 datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave, për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave, bashkive”, këto janë sipërfaqet pyjore dhe kullimore në pronësi të Bashkisë Përmet:

- Sipërfaqe totale: **18 433 ha**
- Pyje: **10771 ha**
- Kullota: **733 ha**
- Sipërfaqe boshe:**15 ha**
- Sipërfaqe djerr: **20 ha**
- Sipërfaqe in produktive:**110 ha**
- Sipërfaqe shkëmbore: **482 ha**

5.2 Mbi procedurat e dhënies me qira dhe likuidimin e kontratave të lidhura.

Dhënia e aseteve të bashkisë me qira realizohet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840;
- Ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar;
- VKM nr. 559, datë 29.7.2022 “ Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”.

Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, në total janë aktive **52** kontrata (27 prej tyre janë kontrata të reja të lidhura gjatë vitit 2024 për kullota verore dhe dimërore, me afat kontrate 5-mujor) për dhënien me qira të aseteve, që administrohen nga Bashkia Përmet, konkretisht si më poshtë:

- **34** kontrata për dhënien me qira të pyjeve dhe kullotave;
- **17** kontrata për dhënien me qira të tokave bujqësore;
- **1** kontratë për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve shtetërore.

Për sa i përket aseteve të cilat janë dhënë me qira, referuar kontratave të sipërpërmendura, Bashkia Përmet nuk posedon titull pronësie për këto pasuri. Kjo problematikë është trajtuar më gjerësisht në nënpikën nr. 5.1 të programit të auditimit, i cili ka objekt “Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të aseteve në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”

a. Kontrata për dhënien me qira të pyjeve dhe kullotave.

Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, Bashkia Përmet ka lidhur **27** kontrata të reja për dhënien me qira të pyjeve dhe kullotave, si dhe ka aktive **7** kontrata ekzistuese.

Për vitin 2024 kanë qenë aktive **34 kontrata qiraje**, me një vlerë totale kontraktuale prej 3,044,197 lekë. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, konstatohet se gjatë vitit 2024 është shlyer një shumë totale prej 1,472,887 lekësh.

Diferenca prej 1,572,310 lekë përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Përmet.

Analiza e detajuar mbi subjektet që kanë nënshkruar kontrata qiraje për pyjet dhe kullotat me Bashkinë Përmet, si dhe statusi i likuidimit të detyrimeve për këto kontrata gjatë vitit 2024, pasqyrohet në tabelat e mëposhtme:

Kontratat ekzistuese nga fondi pyjor kullor

Nr	Emërtesa	Afati i Kontratës	Data e pagesës	Detyrimi	Paguar
1	Kontratë qeraje për dhënie me qera të sipërfaqes pyjore kullorore A.SH	29.09.2022-25.06.2031		160000	
2	Kontratë qeraje për dhënie me qera të sipërfaqes pyjore kullorore A. Sh.a, Çarshovë	29.09.2022-19.05.2031		160000	
3	Kontratë qeraje SITE 1216 V. ALBANIA SH.A , Petran	04.07.2018-16.04.2024	04.01.2024	143437	143437
4	Kontratë qeraje për dhënie me qera të sipërfaqes pyjore V.ALBANIA SH.A, Çarshovë	23.11.2020-05.08.2029	04.01.2024	198050	198050
5	Kontratë qeraje (Çarshova Neë-1296) O.	03.10.2018-02.10.2027		216000	
6	Kontratë qeraje (Përmeti-1080) TD KQ -40/18 O.	22.06.2018-16.04.2024		300000	
7	K. shpk	04.10.2018-05.10.2024	-	736310	-
	Shuma Totale			1,913,797	341,487

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësi dhe Turizëm

b. Kontrata për dhënie me qira të tokave bujqësore.

Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, Bashkia Përmet kanë qënë aktive 17 kontrata me një vlerë totale kontraktuale prej **271,343** lekë. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, konstatohet se gjatë vitit 2024 është shlyer një shumë totale prej 201,976 lekësh.

Diferenca prej 69,367 lekë përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Përmet.

Analiza e detajuar mbi subjektet që kanë nënshkruar kontrata qiraje për pyjet dhe kullotat me Bashkinë Përmet, si dhe statusi i likuidimit të detyrimeve për këto kontrata gjatë vitit 2024, pasqyrohet në tabelat e mëposhtme:

Toka bujqësore me qera

Nr	Emertesa	Afati i Kontratës	Data e pagesës	Detyrimi	Paguar
1	Kontratë qeraje për pasuri të patundshme Shoqëria "GG Sh.p.k"	07.11.2018-07.11.2053		48360	
2	Kontratë për dhënie me qera të tokës bujqësore të pandarë, AD	12.04.2022 – Afat 99 vjeçar		11607	
3	Kontratë qeraje e tokës bujqësore, të pandarë R.M	03.09.2021 – Afat 99 vjeçar	12.09.2024	31756	31756
4	Kontratë qeraje e tokës bujqësore, të pandarë KM	03.09.2021 – Afat 99 vjeçar	12.09.2024	69836	69836
5	XH.K	Mars 2010-Afat 40 vjet	Viti 2024	700	700
6	IC	Shtator 2010-afat 40vjet	Viti 2023-2024	900	0
7	OTH	Shtator 2010-afat 40vjet	Viti 2023-2024	1300	0
8	PJ	Shkurt 2011-afat 40 vjet	Viti 2024	750	750
9	FI	Prill 2011	Viti 2024	4000	4000
10	XHK	Prill 2011	Viti 2024	450	450
11	JDH	Prill 2012	Viti 2024	230	230
12	EK	Prill 2012	Viti 2024	320	320
13	OTH	Prill 2013	Viti 2023-2024	7200	0
14	N.DH	Prill 2013	Viti 2024	4800	4800
15	Kontratë qeraje për pasuri të patundshme LK	18.07.2018 Afat 99-vjet	23.09.2024	80822	80822
16	Kontratë qeraje për pasuri të patundshme LK	18.07.2018 Afat 35-vjet	23.09.2024	3412	3412
17	Kontratë qeraje për pasuri të patundshme të llojit kullotë E.I	03.05.2019-02.05.2028	31.07.2023 Parapagim 3 vite	4900	4900
	Shuma Totale			271343	201976

c. Kontrata për dhënie me qira të ndërtesave/objekteve shtetërore

Për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, Bashkia Përmet ka aktive 1 kontratë ekzistuese, me një vlerë totale kontraktuale prej 520,200 lekë. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, konstatohet se gjatë vitit 2024 është shlyer i gjithë detyrimi kontraktual i cili buron nga kontrata e qirasë.

Analiza e detajuar mbi subjektet që kanë nënshkruar kontrata qiraje për pyjet dhe kullotat me Bashkinë Përmet, si dhe statusi i likuidimit të detyrimeve për këto kontrata gjatë vitit 2024, pasqyrohet në tabelat e mëposhtme:

Ndërmarje shtetërore

Nr	Emërtesa	Afati i Kontratës	Data e pagesës	Detyrimi	Paguar
1	Enfiteozë "A." Sh.p.k	16.07.2019- 15.07.2039	13.02.2024 (Kësti I) 22.07.2024 (Kësti II)	260100 260100	520200
Shuma Totale				520200	520200

Kontratat e privatizimit për apartamentet në administrim për të cilat janë lidhur kontratat e shitjes me rezervë:

Bashkia Përmet ka në administrim **22 apartamente**, të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) dhe të dorëzuara bashkisë. Sipas Vendimit nr. 898, datë 18.11.2020, "*Për Rregullat, Kushtet, Kriteret e Procedurat e Privatizimit të Banesave dhe të Objekteve të kthyer në Fond Banese të Paprivatizuara*", Bashkia ka detyrimin të lidhë kontratat e shitjes me rezervë me subjektet përfituese. Nga kontrolli rezulton se janë lidhur kontratat përkatëse me **18 subjekte përfituese**, ndërsa **4 kontrata ende nuk janë lidhur**.

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion rezulton se totali i detyrimeve deri më datë 31.12.2024 për kontrata e lidhura është në shumën 343,261 lekë. Kjo shumë prej **343,261 lekësh** përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Përmet.

Analiza e detajuar mbi subjektet që kanë nënshkruar kontratat e shitjes me rezervë për privatizimin e apartamenteve me Bashkinë Përmet, si dhe statusi i likuidimit të detyrimeve për këto kontrata deri në fund të vitit 2024, pasqyrohet në kapitullin Anekse mbi asetet.

- Burimet Natyrore

Gjatë vitit 2024, nga të dhënave të siguruara nga Regjistri i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, në territorin e Bashkisë Përmet ka ushtruar aktivitet një subjekt në fushën e burimeve natyrore.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit nuk disponon dokumentacionin përkatës për këtë subjekt, përfshirë raportin teknik, kontratat e qirasë, si dhe dokumentacion tjetër shoqëruar të nevojshëm. Më poshtë paraqitet subjekti në fjalë:

- Subjekti "E. MP" shpk disponon një HEC në Qarkun Gjirokastër, në Njësinë Administrative Çarshovë. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit në Bashkinë Përmet nuk disponon dokumentacionin përkatës për këtë subjekt, si raportin teknik, kontratën e qirasë dhe dokumente të tjera.

- Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, "*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*", i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, "*Për Fondin kullor*", pikat 3, 7, 9,10,11, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, "*Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor*", i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, "*Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullor*".

Konkluzion

- Nga verifikimi i pagesave të kryera nga subjektet qiramarrëse të tarifës së qirasë sipas kontratave të lidhura rezulton se në fund të vitit 2024 **janë debitorë 10 subjekte në vlerën 1,641,677 lekë** në

kundërshtim me nenin “Detyrimet e qiramarrësit” të Kontratës, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Përmet.

Nga titullari i institucionit nuk janë marrë masa për ngritjen e grupeve të punës mbi monitorimin e kontratave të qirave në lidhje me objektin dhe detyrimet e përdoruesit, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

- Nga verifikimi i pagesave të kësteve të 18 kontratave të shitjes me rezervë, të lidhura në kuadër të procesit të privatizimit, rezulton se **detyrimet e papaguara deri më datë 31.12.2024 për këto kontrata arrijnë shumën prej 343,261 lekësh**, shumë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Përmet, në kundërshtim me detyrimet kontraktuale të përcaktuara në kontratat përkatëse.

- Nga verifikimi i të dhënave të siguruara nga Regjistri i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, në territorin e Bashkisë Përmet ka ushtruar aktivitet një subjekt në fushën e burimeve natyrore. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit nuk disponon asnjë dokumentacion, përfshirë raportin teknik, kontrat qiraje, si dhe dokumentacion tjetër shoqërues të nevojshëm. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për Fondin kullor”, pikat 3, 7, 9,10,11, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

- **zj. A.H.**, me detyrë Kryetar në Bashkinë Përmet, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, referuar ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhmin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 8, 21, 22, Ligjit 139, datë 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Manualit MFK, Kapitulli II;
- **z. H.DH.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës, Planifikimit të Territorit, Gjellbërimit dhe Mirëmbajtjes, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 25 të Rregullores së Brendshme të bashkisë Përmet, sipas strukturës së miratuar me vendimin nr. 21, datë 16.01.2024, deri më datë 01.10.2024 (aktualisht larguar nga puna);
- **z. F. G.**, me detyrë Specialist i Aseteve, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 25 të Rregullores së Brendshme të bashkisë Përmet, deri më datë 31.07.2024 (aktualisht larguar nga puna)
- **z. Dh.P.**, me detyrë Specialist i Aseteve, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 25 të Rregullores së Brendshme të bashkisë Përmet;
- **z. A.J.**, me detyrë Punonjës i Shërbimeve/Liçensave, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 25 të Rregullores së Brendshme të bashkisë Përmet;

6. Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të Territorit.

6.1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit.

6.2. Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përlogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj;

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit me nr. 323/1 prot; datë 10.03.2025, i ndryshuar, me objekt: “Auditim mbi zbatimin e kërkesave të Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, prej datës 01.01.2023 deri më 31.12.2024, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Dokumentacioni në sistemin “E leje”;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e financës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë juridike;
- Dokumente të tjera nga arkiva, etj.

Bashkia Përmet ka miratuar **Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr.3, datë 10.06.2020, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësimi Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, infrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik, ndarja e territorit në zona dhe njësi. Kjo PPV është korrigjuar me Vendim nr. 3, datë 24.11.2021, të KKT-së, “Për miratimin e korrigjimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Përmet”.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.
2. Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik.
3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.
4. Dhënia e Çertifikatës së Përdorimit.

LEJET E NDËRTIMIT, ZHVILLIMIT DHE PËRDORIMIT PËR PERIUDHËN 01.01.2023 - 31.12.2024

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Përmet, rezulton se për afatin e auditimit **01.01.2023 deri në 31.12.2024**, ka pasur **191 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh** si: leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m², leje zhvillimi, deklarata për kryerje punimesh, çertifikata përdorimi, etj., të evidentuara në tabelën përmbledhëse në **Tabelën nr. 1** dhe në **Tabelën nr.2**

Tabela nr. 1: Aplikimet në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2023-31.12.2023

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Certifikatë përdorimi	4	4	0
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	47	34	13
Leje infrastrukture	4	4	0
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m ²	4	4	0
Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	6	3	3
Leje për ndryshim funksioni	4	4	0
Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	4	1	3
Leje zhvillimi	14	9	5
Njoftim për fillim punimesh	11	11	0
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m ²	7	4	3
Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	3	2	1
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	1	1	0
Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	1	1	0

Burimi: DUPT Bashkia Përmet

Përpunoi: Grupi i auditimit

Tabela nr. 2: Aplikimet në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2024-31.12.2024

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Certifikatë përdorimi	6	5	1
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	47	14	33
Leje infrastrukture	3	3	0
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m ²	1	0	1
Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	7	3	4
Leje për ndryshim funksioni	1	1	0
Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	1	1	0
Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	1	1	0
Leje zhvillimi	3	0	3
Njoftim për fillim punimesh	2	1	1
Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	1	1	0
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m ²	4	0	4
Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	1	1	0
Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	2	2	0
Leje ndërtimi për prishje ndërtimi ekzistues	1	1	0

Burimi: DUPT Bashkia Përmet

Përpunoi: Grupi i auditimit

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit (këtu e në vazhdim DUPT) e Bashkisë Përmet, si dhe në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e evidentuara në **Tabelën nr. 3**, bashkëlidhur këtij akt-konstatimi.

Tabela nr. 3 – Rastet e audituara

Nr.	Titulli i objektit	Zhvilluesi	Miratuar	Prevetivi
Leje ndërtimi				
1	Banesë një familjare në pronë të familjes X	A.X	21.07.2023	13,484,244
2	Ndërtim objekt dy kat me cati + një kat podrum (bujtinë)	S.B.	18.10.2024	21,087,764
3	Banesë individuale një kat + podrum dhe çati	VG	20.11.2023	4,547,793
4	Prishje dhe rindërtim objekti 2 kat me një kat nëntokë	A.N	29.03.2023	8,747,933
5	Rikonstruksion dhe shtesë 1 kat banim në godinë ekzistuese 2 kate	J.P	05.06.2023	6,761,127
Certifikata përdorimi				
6	Mbingritje 1 kat me çati në objekt ekzistues me funksion banimi	AK	03.04.2024	2,184,903

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në lidhje me auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikateve të përdorimit, vërehen parregullsitë si më poshtë:

➤ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikateve të përdorimit u konstatua se në **5 raste**, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Në **të gjitha rastet** janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu në **1 rast** u konstatua se leja e ndërtimit nuk respekton përcaktimet ligjore në lidhje me përmbajtjen e dokumentit të lejes. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 1145/2, datë 21.07.2023, për objektin: “Banesë një familjare në pronë të familjes X. ”, me adresë Petran, Përmet, me zhvillues A.X , me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 65 ditësh pune, veprime jo në përputhshmëri me nenin 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 2732/5, datë 18.10.2024, për objektin: “Ndërtim objekt dy kat me cati + një kat podrum (bujtinë)”, me adresë Bual, Përmet, me zhvillues Suela B. , me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 229 ditësh pune, veprime jo në përputhshmëri me nenin 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

- Leja e ndërtimit e miratuar nuk respekton përcaktimet ligjore në lidhje me përmbajtjen e dokumentit të lejes së ndërtimit, veprime jo në përputhshmëri me nenin 16 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, nënpika b). Nga auditimi u konstatua se në dokumentin e lejes së ndërtimit mungon shënimi i datës së miratimit të saj.

- Projekti ndërtimor dhe dokumentacioni shoqërues i tij nuk janë të plotë, pasi:

- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit hidroteknik, veprime këto në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar, pika 1, nënpika g);

- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për ekspertin privat zjarrfikës, veprime këto në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar, pika 1, nënpika g). Nga auditimi u konstatua se polica e sigurimit e ngarkuar në sistemin “e Leje” është jashtë afatit të vlefshmërisë, pasi periudha e sigurimit të saj përfundon më datë 15.08.2024, ndërkohë që leja e ndërtimit është aplikuar më datë 09.10.2023;

- Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për të gjithë hartuesit e projekteve që përbëjnë projektin ndërtimor, veprime këto në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar, pika 1, nënpika ë).

3. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 2540/1, datë 20.11.2023, për objektin: “Banesë individuale një kat + podrum dhe çati”, me adresë Qilarisht, Përmet, me zhvillues V.G , me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 41 ditësh pune, veprime jo në përputhshmëri me nenin 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

- Dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë, pasi:

- Mungon certifikata e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (këtu e në vazhdim QKB) për hartuesin e projektit arkitektonik, hartuesin e projektit konstruktiv dhe hartuesin e projektit të mbrojtjes kundër zjarrit, kjo jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, date 13.05.2015 "Për miratimin e Regullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

- Mungon kontrata e sipërmarjes ndërmjet zhvilluesit dhe subjektit ndërtues, kjo jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, date 13.05.2015 "Për miratimin e Regullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika b);

4. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 2846/2, datë 29.03.2023, për objektin: “Prishje dhe rindërtim objekti 2 kat me një kat nëntokë”, me adresë Bodar, Përmet, me zhvillues A.N , me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 119 ditësh pune, veprime jo në përputhshmëri me nenin 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

- Dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë, pasi:

- Mungon kontrata e sipërmarjes ndërmjet zhvilluesit dhe subjektit ndërtues, kjo jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika b);

- Mungon licenca për ushtrimin e aktivitetit e hartuesit të projektit të mbrojtjes kundër zjarrit, veprime këto në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*" të ndryshuar, pika 1, nënpika ë).

- Mungon çertifikata e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (këtu e në vazhdim QKB) për hartuesin e projektit arkitektonik, hartuesin e projektit konstruktiv, si dhe hartuesin e projektit të mbrojtjes kundër zjarrit, kjo jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

5. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 1103/1, datë 05.06.2023, për objektin: "Rikonstruksion dhe shtesë 1 kat banim në godinë ekzistuese 2 kate", me adresë Përmet, me zhvillues J.P, me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 39 ditësh pune, veprime jo në përputhshmëri me nenin 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*".

- Dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë, pasi:

- Mungon kontrata e sipërmarjes ndërmjet zhvilluesit dhe subjektit ndërtues, kjo jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika b);

- Mungon çertifikata e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (këtu e në vazhdim QKB) për hartuesin e projektit arkitektonik, hartuesin e projektit konstruktiv, si dhe hartuesin e projektit të mbrojtjes kundër zjarrit, kjo jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

6. Çertifikatë përdorimi miratuar me Vendim nr. 2319/1-5, datë 03.04.2024, për objektin: "*Mbingritje 1 kat me çati në objekt egzistues me funksion banimi*", me adresë Petran, Përmet, me subjekt zhvillues z. A.K, me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 138 ditësh pune, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*".

- Mungon polica e sigurimit të përgjegjesisë së ndërtuesit për dëmtime të objektit të përfunduar, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27/2. ë VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika i);

Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me:

- VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, neni 16, pika 1, nënpika b); neni 20; neni 15, pika 1, nënpika b) ë) g); neni 27; neni 27/2, pika 1, nënpika i;

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Zj. A.H.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Përmet (*për rastet 1 - 6*);

- **Z. G.I.**, në cilësinë e drejtorit të DUPT, aktualisht i larguar nga puna (*për rastet 1, 3 - 5*);

- **Zj. H.DH**, në cilësinë e drejtorit të DUPT aktualisht e larguar nga puna (për rastin 6);
- **Z. L.B**, në cilësinë e drejtorit të DUPT (për rastin 2);
- **Zj. M.K**, në cilësinë e nëpunësit pranë DUPT (për rastet 1 - 6);

-Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se Bashkia Përmet dhe DUPT, në **5 raste** nuk ka kërkuar/respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 6, DPZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më sipër cituar, rezultoi se:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 1145/2, datë 21.07.2023, për objektin: “Banesë një familjare në pronë të familjes X”, me adresë Petran, Përmet, me zhvillues A.X, me problematika si më poshtë vijon:

- Bashkia Përmet dhe DUPT nuk kanë kërkuar mendimi i asnjë prej autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, veprime jo në përpuethshmëri me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 6. DUPT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më sipër cituar, rezultoi se DUPT nuk ka kërkuar mendimin e asnjë prej këtyre autoriteteve, si dhe pa marrë mendim pozitiv nga DR ASHK, edhe pse në dispozitat regullatore shprehet qartësisht se informacioni që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronesisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën.

2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 2732/5, datë 18.10.2024, për objektin: “Ndërtim objekt dy kat me cati + një kat podrum (bujtinë)”, me adresë Bual, Përmet, me zhvillues S. B., me problematika si më poshtë vijon:

- Bashkia Përmet dhe DUPT nuk ka kërkuar mendimin e të gjithë autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, veprime jo në përpuethshmëri me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 6. DUPT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më sipër cituar, rezultoi se leja e ndërtimit është miratuar pa marrë mendim pozitiv nga DR ASHK, edhe pse në dispozitat regullatore shprehet qartësisht se informacioni që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronesisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën.

3. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 2540/1, datë 20.11.2023, për objektin: “Banesë individuale një kat + podrum dhe çati”, me adresë Qilarisht, Përmet, me zhvillues V.G, me problematika si më poshtë vijon:

- Bashkia Përmet dhe DUPT nuk kanë kërkuar mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, veprime jo në përpuethshmëri me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 6. DUPT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet

të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më sipër cituar, rezulton se DUPT, përveç OSHEE-së, nuk ka kërkuar mendimin e asnjë prej këtyre autoriteteve, edhe pse në dispozitat rregullatore shprehet qartësisht se informacioni që mundësojnë DR ASHK është i detyrueshëm.

4. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 2846/2, datë 29.03.2023, për objektin: “Prishje dhe rindërtim objekti 2 kat me një kat nëntokë”, me adresë Bodar, Përmet, me zhvillues A.N , me problematika si më poshtë vijon:

- Bashkia Përmet dhe DUPT nuk kanë kërkuar mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, veprime jo në përpuethshmëri me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 6. DUPT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më sipër cituar, rezulton se DUPT, përveç AEE-së, nuk ka kërkuar mendimin e asnjë prej këtyre autoriteteve, edhe pse në dispozitat rregullatore shprehet qartësisht se informacioni që mundëson DR ASHK është i detyrueshëm.

5. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 1103/1, datë 05.06.2023, për objektin: “Rikonstruksion dhe shtesë 1 kat banim në godinë ekzistuese 2 kate”, me adresë Përmet, me zhvillues J.P , me problematika si më poshtë vijon:

- Bashkia Përmet dhe DUPT nuk kanë kërkuar mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, veprime jo në përpuethshmëri me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 6. DUPT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më sipër cituar, rezulton se DUPT, nuk ka kërkuar mendimin e asnjë prej këtyre autoriteteve, edhe pse në dispozitat rregullatore shprehet qartësisht se informacioni që mundëson DR ASHK është i detyrueshëm.

Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me:

- VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 21;

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Zj. A.H**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Përmet (për rastet 1 - 6);
- **Z. G.I**, në cilësinë e drejtorit të DUPT, aktualisht i larguar nga puna (për rastet 1, 3 - 5);
- **Z. L.B**, në cilësinë e drejtorit të DUPT (për rastin 2);
- **Zj. M.K**, në cilësinë e nëpunësit pranë DUPT (për rastet 1 - 5);

➤ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në **2 raste**, objektet e miratuara nuk respektojnë kondicionet urbane, siç janë distancat nga kufiri i pronës dhe lartësinë e lejuar të matur në numër katesh. Në **1 rast**, parcelat të cilat janë vendosur në funksion të zhvillimit të objektit nuk kanë lidhje fizike me njëra-tjetrën. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 1145/2, datë 21.07.2023, për objektin: “Banesë një familjare në pronë të familjes X ”, me adresë Petran, Përmet, me zhvillues A.X , me problematika si më poshtë vijon:

- Objekti i miratuar nuk respekton kondicionet urbane, pasi:

- Nuk respekton lartësinë e matur në numër katesh. Referuar pasaportës së njësisë strukturore, lartësia maksimale e lejuar në numër katesh është 1 kat. Nga kontrolli i projektit ndërtimor për objektin që do zhvillihet, rezulton se çatia e shfrytëzueshme zë më shumë se 30% të sipërfaqes së katit funksional, duke u konsideruar kat shtesë, veprime jo në përputhshmëri me përcaktimet e pasaportës së njësisë strukturore PM_B_B2_64/5, si dhe nenit 20 të Planit të Përgjithshëm Vendor, miratuar me vendim të KKT, nr.3, datë 10.06.2020.

- Nuk respekton distancat urbane nga kufiri i pronës. Nga këqyrja e projektit ndërtimor dhe planit të vendosjes së miratuar, konstatohet se objekti i miratuar nuk respekton distancat urbane nga kufiri i pronës në fasadën jug-perëndimore të objektit, duke u pozicionur në kufij me kufirin e pronës, veprime jo në përputhshmëri me nenit 35 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1.

- Parcelat të cilat janë vendosur në funksion të zhvillimit të objektit nuk kanë lidhje fizike me njëra-tjetrën. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin “e-lejet” rezulton se katër pronat e përfshira në këtë zhvillim nuk janë të lidhura fizikisht mes tyre. Më konkretisht, parcelat me nr. pasurie 56/26 dhe 56/75, në ZK 2946, kufizohen nga pasuria 56/71, për të cilën nuk është përcaktuar pronësia. Në krah të kësaj pasurie ndodhet parcela me nr. pasurie 56/33. Pasuria me nr. 57/5 kufizohet nga pasuria me nr. 56/63, e cila gjithashtu nuk ka të përcaktuar pronësinë. Pala aplikuese dhe DUPT nuk kanë kërkuar informacion pranë DR ASHK për të verifikuar statusin juridik dhe pronësinë mbi këto pasuri, në përputhje me kërkesat ligjore.

- Së pari, marrja në konsideratë e parcelave të cilat nuk kanë lidhje fizike midis tyre nuk është në përputhje me neni 30 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika c);

- Së dyti, në respektim të nenit 14 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 2, zhvilluesi do të duhej të kishte ngarkuar marrëveshjen për servitut kalimi me poseduesit e pasurisë 56/71 dhe 56/63;

- Së treti, në funksion të pikës 3 të kësaj gjetjeje, duke mos marrë në konsideratë pasurinë 56/33 dhe 57/5, mbi të cilat faktikisht nuk zhvillohet objekti, Intenistet i miratuar konstatohet të jetë më i lartë se 0.5, nga sa përcaktuar sipas pasaportës së njësisë strukturore PM_B_B2_64/5.

2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 2846/2, datë 29.03.2023, për objektin: “Prishje dhe rindërtim objekti 2 kat me një kat nëntokë”, me adresë Bodar, Përmet, me zhvillues A.N , me problematika si më poshtë vijon:

- Objekti i miratuar nuk respekton distancat urbane nga kufiri i pronës në kufirin verior. Distanca që objekti do të duhej të respektonte nga kufiri i pronës është 3 metra, e përlllogaritur sipas rregullores së zhvillimit të territorit ($d = nr. k + 1m$), ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve. Distanca e miratuar është 1.5 m, kjo në kundërshtim me nenit 35 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar.

Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me, VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 14, neni 30, neni 35;

- Planin e Përgjithshëm Vendor, miratuar me Vendimin e KKT nr.3, datë 10.06.2020, neni 20, pika 4;

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit, të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Zj. A.H.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Përmet (*për rastet 1 - 2*);

- **Z. G.I.**, në cilësinë e drejtorit të DUPT, aktualisht i larguar nga puna (*për rastet 1 - 2*);

- **Zj. M.K**, në cilësinë e nëpunësit pranë DUPT (për rastet 1 - 2);

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 323/6 prot; datë 29.07.2025, është observuar nga funksionarët e Bashkisë Përmet dhe DUPT dhe zj. A.H, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Përmet, me anë të shkresës nr. 2397 prot; datë 25.07.2025, si më poshtë vijon:

1.1 Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin se parcelat në zhvillim nuk kanë lidhje fizike me njëra-tjetrën, për objektin: “Banesë një familjare në pronë të familjes X”, shprehen se: “Parcelat që do të zhvillohen bëjnë pjesë në sistemin bujqësor, si dhe në zbatim të pikës 4, Kreu II të Vendimit nr. 283, datë 01.04.2015, "Për përcaktimin e tipeve, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen...", i ndryshuar, për qëllim të llogaritjes së sipërfaqes së ndërtimit në intensitetin e ndërtimit, përfshihen ngastra ose bllok ngastrash edhe kur ndahen nga rrugë, kanale apo kufij të tjerë natyrorë”.

1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin tuaj, theksojmë se Vendimi nr. 283, datë 01.04.2015, "Për përcaktimin e tipeve, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen...", rregullon kriteret e ndërtimit që lidhen me ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokë bujqësore. Ndërkohë, objekti i miratuar nga ana juaj është një banesë njëfamiljare dhe, si i tillë, duhet të respektojë kriteret e përcaktuara në VKM nr. 408, datë 13.05.2015.

Për sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

2.1 Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin objekti i miratuar nuk respekton lartësinë e matur në numër katesh, për objektin: “Banesë një familjare në pronë të familjes X”, shprehen se: “Referuar nenit 20, pika 5, të Planit të Përgjithshëm Vendor, miratuar me vendim të KKT nr.3, datë 10.06.2022, në rastet kur lejohet çati e shfrytëzueshme ose atik, sipërfaqja e shfrytëzueshme nuk mund të jetë më shumë se 75% e sipërfaqes së katit, prandaj sipërfaqja e shfrytëzueshme del më e madhe se 30 %”.

2.2 Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin tuaj, theksojmë se referuar nenit 20, pika 4, të Planit të Përgjithshëm Vendor, miratuar me Vendimin e KKT nr.3, datë 10.06.2020, citohet: “Në rast se çatitë e shfrytëzueshme kanë më pak se 30% të sipërfaqes së katit funksionale, lartësia maksimale llogaritet në kuotën e ullukut, në të kundërt llogaritet në kulmin e çatisë duke e konsideruar kat”. Duke marrë në konsideratë kriterin e mësipërme dhe nga kontrolli i projektit arkitektonik, kostatohet se sipërfaqja e shfrytëzueshme e katit nën çati është më shumë se 30%.

Për sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

3.1 Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin se objekti i miratuar nuk respekton distancën minmale nga kufiri i pronës, për objektin: “Prishje dhe rindërtim objekti 2 kat me një kat nëntokë”, shprehen se: “Nga verifikimi i projektit arkitektonik, planimetria e objektit kati përdhe (bashkëlidhur), sqarojmë se fasada veriore nuk ka çarje të tipit dritare/derë, është kallkan. Si e tillë, në zbatim të nenit 35 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, distanca minimale midis ndërtimit dhe kufirit të pronës ruhet për faqet me dritare”.

3.2 Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin tuaj, theksojmë se në nenin 35 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, nuk parashikohet ndonjë përjashtim nga respektimi i distancës minmale nga kufiri i pronës në rastet kur njëra nga faqet e objektit është kallkan (pa çarje të tipit dritare/derë). Gjithashtu, në Planin e Përgjithshëm Vendor, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 3, datë 10.06.2020, në nenin 24 përcaktohet qartë se, për distancat nga kufiri i pronës, do të zbatohen normat minmale të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Për sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

Konkluzion i përgjithshëm mbi miratimin e lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit:

1. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe deklaratave paraprake, u konstatua se në **5 raste**, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Në **të gjitha rastet** janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuara në dispozitat ligjore dhe

nënligjore. Gjithashtu në **1 rast** u konstatua se leja e ndërtimit nuk respekton përcaktimet ligjore në lidhje me përmbajtjen e dokumentit të lejes së ndërtimit.

2. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në **5 raste** nuk është kërkuar ose respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Lejet e ndërtimit janë miratuar në heshtje, pa marrë mendim nga DV ASHK.

3. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në **2 raste**, objekti i miratuar nuk respekton kondicionet urbane, siç janë respektimi i numrit të kateve dhe distanca nga kufiri i pronës. Gjithashtu në **1 rast** u konstatua se parcelat të cilat janë vendosur në funksion të zhvillimit të objektit nuk kanë lidhje fizike me njëra-tjetrën.

7. Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV.

7.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

7.2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV: Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

7.3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

-Grupi i auditimit, për periudhën objekt auditimi 2023 –2024, kërkoi vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme siç janë dosjet e procedurave të mbajtura nga IMT, në të cilat duhet të përfshihen procesverbalet e konstatimit të mbajtura nga inspektorët, vendimet e gjobave, vendimet e pezullimit, vendimet e prishjeve dhe procesverbalet e ekzekutimit të këtyre prishjeve, kallëzimet penale, kërkesat drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv, informacioni periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT, planet vjetore dhe planet mujore të punës të miratuara nga k/inspektori.

Tabela nr. 1. Struktura e IMTV

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni strukturës	Lloji arsimit/dega	Data emërimit në detyrë	Aktualisht në punë apo larguar data
1	K.M	Inspektor IMT	Juridik	Prill 2022	Korrik të 2023
2	Dh.P	Inspektor IMT	Ekonomik	Gusht 2023	Dhjetor 2023
3	B.I	Inspektor IMT	Inxhinieri	Janar 2024	Aktualisht në punë

Burimi: Bashkia Përmet.

Në Bashkinë Përmet funksioni i kontrollit të territorit, nuk kryhet nga strukturë e mirëfilltë e IMTV-së por kryhet nga zyra e kontrollit dhe mbrojtjes së territorit në varësi të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Numri i punonjësve në zyrën e kontrollit, nuk është në përputhje me përcaktimet e kuadrit rregullator, pasi nga 3 punonjës minimalisht që duhet të ketë kjo strukturë, në fakt janë vetëm 1 punonjës, si dhe nga niveli drejtues i Bashkisë Përmet, nuk janë marrë masa për plotësimin e kësaj strukture dhe ushtrimin e funksionit të inspektimit në përputhje me përcaktimet në kuadrin rregullator të fushës. Referuar strukturës së IMTV-së konstatohet se, arsimimi i Inspektorit të IMTV Bashkia Përmet, aktualisht është në përputhje me ligjin 9780. Ndërsa arsimi i inspektorit Dh.P për periudhën Gusht-Dhjetor të vitit 2023 nuk është në përputhje të kërkesës së Nenit 11 të ligjit 9780 “Për Inspektimin Dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të ndryshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.

7.1. Auditim mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve me leje zhvillimi.

Lidhur me praktikat ligjore të mbajtura nga IMTV, paraqiten rastet specifike të praktikave të (Proces –verbal konstatimi), Vendim i dënimit me gjobë-vendim i prishjes së objektit) dhe arsyet e mospërputhjes, dhe konkretisht:

Në bazë të process-verbaleve të kundravajtjes, vendimeve të gjobave, vendimeve të prishjeve të objekteve të kundraligjshëm, të vëna në dispozicion nga IMTV Bashkia Përmet janë ilustruar si më poshtë:

Tabela nr.2 Pasqyra e vendimeve të marra

Nr.	Lloji i aktit	2023	2024
1	PV/Akte kontrolli	11	4
2	PV/Akte konstatimi	11	4
3	Vendime gjobe	1	-
4	Vendime pezullimi		1
8	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	1	

Burimi: Bashkia Përmet

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion në lidhje me praktikat e punës për vitet 2023 dhe 2024 rezulton se janë kryer inspektime dhe janë marrë masat si më poshtë:

Për vitin 2023:

-Është mbajtur procesverbal 03.02.2023 për subjektin V.M i cili është pajisur me lejen nr.3557/1 prot., datë 21.12.2022 për rrethim prone. Nga inspektimi i datës 03.02.2023 është konstatuar nga inspektorët e IMTV-së se ky subjekt po kryente punime jashtë lejes, dhe për këtë rast nuk është vendosur pezullimi i punimeve deri në pajisjen me lejen përkatëse.

- Është mbajtur procesverbal i datës 13.02.2023 ku është konstatuar se subjekti Fuat Jaupi ka bërë punime pa u pajisur me lejen përkatëse murë rrethues përpara banesës, për këtë rast nuk është vendosur nga inspektorët pezullimi i punimeve dhe të rikthehet trualli në gjenden fillestare.

- Është mbajtur procesverbal 07.04.2023 për subjektin V.M i cili po kryente punime sistemimi me shtresë betoni të sipërfaqes para objektit, për këtë rast nuk është vendosur pezullimi i punimeve deri në pajisjen e kategorisë përkatëse.

-Në procesverbalin e datës 08.04.2023 nga inspektimet në terren u konstatua se punimet e kryera nga subjekti Y.M janë brenda kushteve të lejes nr.807/1 prot., datë 17.03.2023 për riparim të rrethimit egzistues.

-Në procesverbalin e darës 18.05.2023, specifikohet se, në bazë të kërkesës së z. Z.J, për përcaktim kufiri, inspektorët e IMTV-së shprehen se u vendos ndarja e kufirit sipas certifikatës se pronësisë së z.Z.J, por në blloqet për vendimet përkatëse nuk pasqyrohet ky vendim.

-Është mbajtur procesverbal më datë 18.05.2023, ku referuar kërkesës nr.1191 prot., datë 18.05.2023 të zotit z. M.Q për qytetarin z.A.TH ky i fundit ka ndërtuar objekt pa leje jashtë sheshit të ndërtimit 2 metër gjatësi dhe 4 metër brenda sheshit të vet. Ng ana e inspektorëve të IMTV-së i është lënë afat z.A.TH të sjellë dokumentata e pronësisë të objektit ose kthimin në gjendjen fillestare të ndërtimit. Për këtë rast, edhe pse është lënë detyrë për prishjen e punimeve pa leje dhe/ose të dorëzimit të dokumentacionit, konstatohet se nuk administrohet dokumentacioni i dorëzuar nga palët, të cilat janë ngarkuar me detyrimin për të dorëzuar dokumentacionin përkatës.

-Është mbajtur procesverbali referuar ankesës së z.K.V nr.1181 prot., datë 13.04.2023 për ngushtim rruge, ndërtim pa leje jashtë pronës së vet, nga inspektorët është konstatuar se, z. K.Sh I cili ka vendosur një parapet shkallë në hyrje të shkallës 5 cm jashtë pronës dhe në hyrje të shkallës 15 cm jashtë pronës. Për këtë rast nuk është marrë vendim për pezullim të punimeve në ndërtim.

-Është mbajtur procesverbal lidhur me ankesën adminitruar nga IMTV Përmet me objekt verifikimin e kufinjëve ndërmjet firmës “R. ” i cili pretendohet sipas ankesës se ka dëmtime si pasojë e veprimterisë së tij, ku nga inspektorët referuar konstatimet sqarojnë se për këtë rast nuk ka dëme nga punimet e kryera nga firma.

-Gjatë kontrollit në terren bazuar në procesverbalin e mbajtur më datë 01.11.2023 nga inspektorët e IMTV se subjekti po kryente punime jashtë lejes së marrë. Me vndimin nr.2 prot., datë 01.11.2023 është vendosur masa dënimi me gjobë për kundravajtësin A. R sh.p.k.

-Në procesverbalin e datës 01.11.2023 nga IMTV është konstatuar se qytetari z. I.B. po kryente punime jashtë projektit, për këtë rast nuk është marrë vendim pezullimi.

-Është mbajtur procesverbal i datës 18.12.2023 ku gjatë kontrolli të ushtruar nga IMTV, ka konstatuar se personi SH.B në pronën e tij kishte ndërtuar pa lejen përkatëse një stallë me mur tulle betoni dhe me mbulesë llamarine. Për këtë rast IMTV ka dalë me vendim prishje me nr.1 prot., datë 18.12.2023.

Për vitin 2024:

-Është mbajtur procesverbal i datës 20.06.2024 subjektit A. sh.p.k ku rezultoi se, subjekti është i pajisur me leje ndërtimi nr.2058/6 prot., datë 23.05.2024, nga kontrolli i IMTV u konstatua se, nuk shtë bërë rethimi i objektit, nuk janë vendosur tabela treguese në objekt.

-Është mbajtur procesverbali i datës 09.08.2024 për verifikimin e ristaurimeve të Kishës Shën Mëri e pajisur me leje nr.1959 prot., datë 06.08.2024.

-Është mbajtur procesverbali i datës,21.08.2024, në lidhje me inspektimin e ushtruar në fshatin kreshovë nga IMTV u konstatua se, janë bërë punime rindërtimin e vakëfit i cili është prishur që në munizëm. Për këtë rast IMTV ka dalë me vendimin nr.2 prot., datë 21.08.2024 vendim për pezullimin e punimeve në ndërtim.

-Është mbajtur procesverbal i datës 30.08.2024 ku nga IMTV është konstatuar se, ku nga personi z. B.K është kryer ndërtimi i një solete betoni prej 13.7 m² dhe rrethimi i murit rrethues me tel, IMTV sqaron se personi përgjigjës nuk është gjendur në objekt gjatë kontrollit.

-Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra, veprim ky në kundërshtim me nenin 5, germa (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua se, inspektori nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe nenin 51 “Inspektimi” të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, pikës 2. ë VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”

7.2. Auditim mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV për subjektet të cilët kanë kryer kundravajtje administartive dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

Nga të dhënat e IMTV , vënë në dispozicion grupit të auditimit është konstatuar se: Për periudhën nën auditim 2023-2024, në total shuma e gjobave referuar procesverbaleve, rezulton në vlerën 100,000 lekë.

Është mbajtur procesverbali me nr. 2, datë 01.11.2023 dënimi me gjobë ndaj subjektit Albania Rafting sh.p.k për kundravajtjen Punime jashtë afatit të lejes, dënimi me gjobë në masën 100,000 lekë vlerë e cila është likuaduar.

A.R Sh.p.k	01.11.2023	Punime jashtë afatit të lejes	100,000
------------	------------	-------------------------------	---------

7.3. Auditim mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe Bashkëveprimi në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit.

Nga auditimi konstatohet se, bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i IMTV Bashkia Përmet rezulton se, puna e kryer nga IMTV është bazuar më shumë gjatë kontrolleve rutinë në territor dhe nuk ka evidencë shkresore të ndërveprimit me DPZHKT, veprim i cili duhet të ishte dhe të jetë i domosdoshëm për evidentimin në kohë të devijimeve të mundëshme të punimeve të ndërtimit për zhvilluesit, kjo duke marrë informacion për secilin subjekt zhvillues që në hapat e parë si: Akt-kontrollet në të gjitha fazat e ndërtimit të cilat janë si bazë e informacionit me të dhëna që nga projekti e deri në përfundim të objekteve, kryesisht atyre mbi 250 m². ë cilat kanë shtrirë dhe mund të vijnë aktivitetin e ndërtim në zona të përcaktuara me rëndësi kombëtare, të ndaluara ose të mbrojtura. Mos mbajtja në kontroll e territorit sipas përcaktimeve ligjore është dhe mund të jetë shkak për pasoja jo vetëm në mbrojtjen e territorit por bëhet shkak dhe për shmangien nga detyrimet që parashikohen për taksat e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja.

8. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

8.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

8.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

8.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit në RPA dërguar me shkresën nr. 360/9 prot., datë 06.06.2024, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 107 datë 05.06.2024, mbërritur në Bashkinë ovë dhe regjistruar me nr. 945/18 prot., date 07.06.2024, për përmirësimin e gjendjes është kërkuar marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht dhe rekomandimet e pa zbatuara si më poshtë vijon:

a. Masa për përmirësimin e Legjislacionit në fuqi nuk është lënë masë;

b. Masa Organizative janë lënë **28** nga të cilat janë pranuar **27** masa: **13** masa janë zbatuar, **8** masa janë në proces zbatimi, **6** masa janë pjesërisht zbatuar dhe **0** masë pa zbatuar;

c. Masa për shpërblim dëmi nuk është lënë;

d. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara janë lënë **4** masa dhe pranuar **4** masa, nga të cilat 2 masa janë të rikërkua rezultojnë: **2** masa janë zbatuar (1 e rikërkuar), **1** masë në proces zbatimi, **1** masë (e rikërkuar) pjesërisht zbatuar dhe **0** masa pa zbatuar;

e. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore/të ardhura të munguara, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, TNI, etj (të ardhura të munguara) në bashkinë Përmet janë lënë **6** masa në vlerën totale 51,106 mijë lekë, nga të cilat **2** masa janë zbatuar, **2** masa janë në proces zbatimi, **2** masa janë pjesërisht zbatuar dhe **0** masa janë pa zbatuar;

f. KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Përmet, fillimin e dhënies së masave disiplinore për 2 punonjës dhe për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkallën e shkeljes. Nga verifikimi rezultoi masa disiplinore e kategorisë **E** të rekomanduara për 2 punonjësit nuk është zbatuar; masa disiplinore e kategorisë **E1** është zbatuar.

➤ DREJTIMET E AUDITIMIT:

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, sipas përcaktimeve në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

- Në Bashkinë Përmet ka dalë Urdhri i kryetarit nr. 259 datë 01.08.2024, për hartimin e Plan veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në RPA me shkresën nr. 493/6 prot., datë 30.07.2024.

Në Bashkinë Përmet, nga kryetari i bashkisë është miratuar plani i veprimit me nr. 2102 prot., datë 19.08.2024 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në RPA”, në të cilin janë caktuar dhe personat përgjegjës për ndjekjen e çdo rekomandimi dhe afatet konkrete për zbatimin e tyre.

Bashkia Përmet ka hartuar dhe miratuar nga kryetari i bashkisë Planin e veprimit “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna në raportin përfundimtar të auditimit” dërguar me shkresën nr. 493/6 prot., datë 30.07.2024. “Plani i veprimit” është dërguar në KLSH me shkresën nr. 1932/1 prot., datë 20.08.2024 dhe rezultoi të jetë hartuar, miratuar dhe dërguar në KLSH brenda afatit 20 ditë, gjë që ka ndikuar edhe në angazhimin në afat të strukturave ngarkuar me përgjegjësi, në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” Bashkia Përmet ka kthyer përgjigje zyrtare në KLSH brenda afatit 20 ditë nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon “Planin e Veprimeve”, duke shprehur qëndrimin e saj për pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.

Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

- Nga ana e saj Bashkia Përmet iu përgjigj kërkesës së grupit të auditimit dërguar në rrugë elektronike për çdo rekomandim të lënë, duke bërë me dije statusin e zbatimit të tyre: Në zbatim të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 30 pika 2, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojë brenda afatit 6 muaj nga data e mbërritjes së RPA shkresërisht me objekt “Raportim mbi zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit”, dërguar me shkresën nr. 493/6 prot., datë 30.07.2024, mbërritur dhe regjistruar në Bashkinë Përmet me nr. 1932 prot., dt.31.07.2024. Nga verifikimi rezultoi se ky raportim është bërë me shkresën nr303/1 prot., datë 30.01.2025 brenda afatit 6 muaj.

Zbatuar

3. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, sipas përcaktimeve në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

- Bashkia Përmet ka raportuar në Këshillin Bashkiak lidhur me “Gjetjet dhe Rekomandimet e lëna në RPA të KLSH-së” përcjellë me shkresën nr. 493/6 prot., datë 30.07.2024 nëpërmjet shkresës me objekt “Raportim” datë 20.09.2024;

Zbatuar

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Përmet ka ngritur një sistem jo efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim konkretisht:

-Nuk janë hartuar planet vjetore të punës;

-Nuk ka raportime periodike nga menaxherët e strukturave brenda institucionit;

-Dosjet personale të punonjësve kanë disa mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, vlerësimet periodike të punonjësve dhe formularet e përshkrimeve të punës. Punësimi i 3 punonjësve në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara dhe pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi dhe 2 punonjës me profesion elektrikistë nuk janë të pajisur me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknike, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” i ndryshuar;

-Në Raportin dërguar pranë MFE-së mbi vlerësimin e aktiviteteve të kontrollit, në të nuk përfshihen të gjithë kapitujt/elementët e parashikuar në Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, Shtojca nr. 2.

-Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

-Nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të për proceset kryesore të punës. Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to

-Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, nuk realizohet nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm, pasi nuk është plotësuar NjAB konform legjislacionit në fuqi. Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të.

-Bashkia nuk i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar.

-Nuk ka plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.

-Nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm. *(Më hollësisht trajtuar në nënkapitullin 2.2.1-2.1.3, faqe 26-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Përmet, Sektori Juridik dhe i Burimeve Njerëzore, Koordinatorin e Riskut dhe Koordinatorin e MFK -së të merren masa për:

-Hartimin e planeve operacionale të konsoliduar të punës, me tregues performancë, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.

-Hartimin e procedurave të shkruara mbi rregullat e raportimit, i cili nuk duhet të jetë i fokusuar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performancë dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva.

-Dosjet e personelit të plotësohen me dokumentacion origjinal apo fotokopje të noterizuar, duke bërë dhe inventarizimin e tyre.

-Evidentimin e nevojave të stafit për trajnim, si dhe hartimin e planit vjetor për trajnimin e punonjësve, me qëllim ngritjen e nivelit profesionale të tyre.

-Hartimin e manualeve të shkruara të proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit, në mënyrë që të identifikojnë përgjegjësitë dhe të përcaktojnë linja të qarta raportimi për njësinë publike.

-Monitorim të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë dhe Sektori Juridik dhe i Burimeve njerëzore kanë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Kështu: me shkresën nr. 3155/1 prot., datë 21.11.2022 është hartuar Plani i trajnimeve për vitin 2023; me shkresën nr. 1425/1 prot., datë 31.05.2024 është kërkuar plotësimi i dosjes së punonjësit në pozicionin e elektrikistit D.L, ndërsa punonjëi tjetër elektrikist O.S nuk është pjesë e stafit të bashkisë; ***Pra Rekomandimi 1.1 është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.***

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i procedurave të rekrutimit të punonjësve që rregullojnë marrëdhëniet e punës me anë të shërbimit civil konstatohet që:

Përgjatë vitit 2023, janë rekrutuar 5 punonjës (nëpunës civil dhe punonjës me kontratë), pranë Bashkisë Përmet. Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, ka një plan vjetor rekrutimi me Vendimin nr. 37/1, datë 22.09.2023, të Kryetarit të Bashkisë.

Për sa më sipër, grupi i auditimit ka verifikuar respektimin e kuadrit ligjor nga ana e bashkisë për rekrutimin (punësimin) e punonjësve gjatë kësaj periudhe kohore, konkretisht:

1. Për punësimin e znj. M.K e punësuar me Vendimin nr. 131, datë 31.03.2023, “Urdhër për Emërim në Shërbimin Civil” të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Përgjegjës i Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit” nga verifikimi i dosjes së personelit konstatohet se, është dokumentuar procedura e konkurimit, e hapur për këtë pozicion pune.

2. Për punësimin e z. Dh.P, i punësuar me Aktin nr. 67, datë 09.02.2023, “Urdhër për Emërim Punonjësi” të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Specialist Asetesh”, nga verifikimi i dosjes së personelit konstatohet se, është dokumentuar procedura e konkurimit, e hapur për këtë pozicion pune.

3. Për punësimin e z. J.Xh, i punësuar me Aktin nr. 91, datë 28.02.2023, “Urdhër për Emërim Punonjësi” të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Punonjës Pyjesh” nga verifikimi i dosjes së personelit konstatohet se, nuk dokumentohet procedura e konkurimit, e hapur për këtë pozicion pune. Grupi i auditimit vlerëson se, punësimi i z. J.XH, pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

4. Për punësimin e z. E S, i punësuar me Aktin nr. 132, datë 31.03.2023, “Urdhër për Emërim Punonjësi” të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Punonjës Pyjesh” nga verifikimi i dosjes së personelit konstatohet se, nuk dokumentohet procedura e konkurimit, e hapur për këtë pozicion pune. Grupi i auditimit vlerëson se, punësimi i z. E.S, pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

5. Për punësimin e znj. J. P, e punësuar me Aktin nr. 299, datë 29.09.2023, “Urdhër Emërimi” të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Specialiste Bujqësie” nga verifikimi i dosjes së personelit konstatohet se, nuk dokumentohet procedura e konkurimit, e hapur për këtë pozicion pune. Grupi i auditimit vlerëson se, punësimi i znj. J. P, pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

Si konkluzion: Punësimi pranë Bashkisë Përmet i nëpunësve për të cilët nuk është zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi e hapur, përveçse bie ndesh me interesin publik, parimin e konkurrencës së lirë dhe barazisë përpara ligjit, ndër të tjera, përbën një risk të shtuar duke ndikuar negativisht në mbarëvajtjen e punës të institucionit.

Për sa më sipër, Bashkia Përmet ka vepruar në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 107, pika 2, ku përcaktohet që: “Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji”.

2.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet dhe Sektori Juridik dhe i Burimeve Njerëzore të marrin masa që, emërimet e punonjësve që i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Shërbimin Civil të kryhen nëpërmjet procedurës së konkurimit të parashikuar në dispozitën ligjore përkatëse, duke synuar mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë dhe Sektori Juridik dhe i Burimeve njerëzore kanë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Kështu: me shkresën nr. 3036 prot., datë 18.11.2024 është hartuar “shpallja për pozicione të lira pune” drejtuar Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe është vijuar me procedurat e rekrutimit sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; me shkresën nr. 406 prot., datë 08.11.2024 është miratuar Plani vjetor i pranimeve në shërbimin civil. ***Pra Rekomandimi 2.1 është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.***

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, nuk është krijuar dhe Njësia e Auditit të Brendshëm dhe nuk është kryer shërbimi i Auditimit të Brendshëm në kundërshtim me Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 10, pika 1.b, dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, pika 3. Në strukturën organizative të Bashkisë Përmet, miratuar me Vendimin nr. 13, datë 10.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë ka vetëm një pozicion Specialist i Auditit të Brendshëm dhe ky pozicion është vakant për mungesë të burimeve njerëzore. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.1-2.1.3, faqe 26-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet të marrë masa për organizim të shërbimit të auditimit të brendshëm në bashki, duke krijuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm brenda strukturës organizative të Bashkisë apo nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi me bashkitë kufitare për marrjen e këtij shërbimi.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë ka marrë masa në vijimësi për zbatimin e rekomandimit. Kështu: në strukturat organizative të miratuara për vitet 2023 dhe 2024 është miratuar pozicioni i audituesit të brendshëm, por vijon të jetë vakant; me shkresën nr. 464 prot., datë 08.02.2023 dhe atë nr. 3079 prot., datë 18.11.2024 është bërë shpallja për pozicionin vakant të auditit të brendshëm; në takimet e GMS mbi diskutimet e tavaneve buxhetore në PBA, në procesverbalin e datës 24.04.2024 nga Sektoret e Përgjithshme është ngritur si shqetësim mungesa e NJA dhe është propozuar që ky shërbim të mundësohet me kontraktim. ***Pra Rekomandimi 3.1 nuk është pranuar nga subjekti por është në proces zbatimi.***

4. Gjetje nga auditimi: Nga krahasimi i shpenzimeve të realizuara përgjatë vitit 2023 konstatohen diferenca me planifikimin fillestar sipas parashikimit të bërë në fillim të vitit nga institucioni konkretisht të realizuara në llogaritë shpenzime operative, transferime korrente të brendshme, transferime për buxhete familjare dhe individë dhe investime. Të gjitha diferencat e paraqitura në

Ilogaritë e mësipërme janë në tejkalim të parashikimit fillestar që rezulton në një parashikim jo të saktë të nevojave gjatë vitit buxhetor.

Nga këto diferenca të realizuara konstatohet një planifikim jo i saktë i nevojave të vitit të pritshëm buxhetor si pasojë e ndryshimit të niveleve të realizimit. Planifikimi kryhet në bazat e një përqindje të caktuar në rritje në krahasim me shpenzimin faktik të vitit të kaluar.

Për vitin 2023 totali i buxhetit është planifikuar në vlerën **788,037,772 lekë** dhe realizuar në vlerën **558,569,763 lekë** në masën **70.8%** ose **mosrelizim në vlerën 229,468,009 lekë** përbëhet nga të ardhurat e veta në vlerën 67,603,628 lekë + nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 185,907,360 lekë + nga tranferta e kushtëzuar specifike në vlerën 108,390,042 lekë + nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 107,843,214 lekë + nga transferta e kushtëzuar për investimet në vlerën 88,825,519 lekë.

-Artikulli 600 “Paga, Shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli” është planifikuar në vlerën 194,899,278 lekë dhe realizuar në vlerën 178,880,679 lekë ose në masën 91.78%;

-Artikulli 601 “Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” është planifikuar në vlerën 31,996,482 lekë dhe realizuar në vlerën 29,425,675 lekë ose në masën 91.97%;

-Artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” + Fondi Rezervë është planifikuar në vlerën 92,896,356 lekë dhe realizuar në vlerën 60,697,345 lekë ose në masën 65.34%;

-Artikulli 604 “Transferime korrente të brendshme” është planifikuar në vlerën 16,494,904 lekë dhe realizuar në vlerën 10,221,710 lekë ose në masën 61.97%;

-Artikulli 606 “Transferime për buxhete familjare dhe individë” është planifikuar në vlerën 101,412,095 lekë dhe realizuar në vlerën 100,075,069 lekë ose në masën 98.68%;

-Artikulli 230-231 “Investime” është planifikuar në vlerën 350,338,657 lekë dhe realizuar në vlerën 179,269,285 lekë ose në masën 51.17%;

-Artikulli 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është planifikuar në vlerën 0 lekë dhe realizuar në vlerën 4,628,442 lekë nga transferta e kushtëzuar. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 46. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.1-2.2.4, faqe 39-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera të Bashkisë Përmet, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigojohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Drejtoria e Financës e buxhetit janë marrë masat duke rritur bashkëpunimin me çdo sektor apo drejtori që në fushën e veprimtarisë së tyre kanë edhe Ilogaritjen dhe sigurimin e vjeljes së të ardhurave tatimore dhe jotatimore. Kështu në mbyllje të vitit 2024 diferenca mes planifikimit dhe realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve ka ardhur duke u zvogëluar, krahasuar me vitet paraardh paraardhëse. Pra **Rekomandimi 4.1 është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.**

5. Gjetje nga auditimi: Vlora e raportuar nga Bashkia Përmet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 626 prot., datë 28.02.2024, për detyrimet e prapambetura më datë 31.12.2023, është 30,119,149 lekë që kanë si burim financimi nga të ardhurat e veta, ndërsa nuk ka detyrime të prapambetura me burim financimi nga FZHR dhe Ministrinë e linjës.

Bashkia Përmet më datë 01.01.2023, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura në total **vlerën 45,482,122 lekë** me burim financimi nga të ardhurat e veta, ku në të përfshihen detyrime për vendime gjyqësore në vlerën 22,404,569 lekë + detyrime për investime në vlerën 20,730,657 lekë + detyrime për mallra dhe shërbime në vlerën 2,346,886 lekë.

Përgjatë vitit 2023 janë likuiduar detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore në **vlerën 2,526,162 lekë** me burim financimi nga të ardhurat e veta që i përkasin detyrimeve progresive të datës 31.12.2023.

Vlera e detyrimeve të trashëguara të papaguara më datë 31.12.2023, pa përfshirë detyrimet e krijuara gjatë vitit 2022, është në **vlerën 30,119,149 lekë** me burim financimi nga të ardhurat e veta, ku në të përfshihen detyrime për vendime gjyqësore në vlerën 12,376,606 lekë + detyrime për investime në vlerën 15,395,657 lekë + detyrime për mallra dhe shërbime në vlerën 2,346,886 lekë.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, pikat-162, Rubrika “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve”, nenin 52, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në nën-pikën 2.2.1-2.2.4, faqe 39-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet dhe Drejtorja e Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Drejtorja e Financës e buxhetit janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Kështu referuar raportit të monitorimit rezulton se raporti i realizimit të buxhetit ndaj planifikimit ka ardhur në rënie për çdo zë buxhetor, si dhe janë ulur ndjeshëm detyrimet e prapambetura me 25,270,073 lekë nga 30,119,149 lekë në total; vlera e mbetur prej 4,849,076 lekë përbëhet nga: 2,346,886 lekë si detyrim ndaj OSHEE tani FSHU për të cilën janë në proces gjyqësor sipas kërkesë padisë nr. 2545 datë 26.08.2022 pasi janë të paguara vërtetuar kjo nga mandat pagesat; vlera prej 2,200,102 lekë ‘Projektim i Qendrës së Qytetit’ nëpërmjet VKB nr. 121 datë 18.12.2024 është shuar si detyrim, pasi në mungesë të dokumentacionit ishte kontabilizuar gabimisht; vlera prej 302,088 lekë detyrim i kontabilizuar ndaj shtetasit B.C t pritet vendim i formës së prerë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pra ***Rekomandimi 5.1 është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.***

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i paketës fiskale të aplikuar nga Bashkia Përmet për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, të miratuar me VKB nr. 98, datë 05.12.2022, konstatohet se, në këtë dokument nuk janë përcaktuar afatet për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit privat dhe familjar. Afati i pagesës duhet të jetë pjesë integrale e paketës fiskale, pasi është një element i rëndësishëm i taksave dhe tarifave vendore dhe si i tillë duhet t’i nënshtrohet gjykimit të Këshillit Bashkiak. Përcaktimi i afatit të pagesës duhet të jetë i tillë që të garantojë mbledhjen e të ardhurave brenda një kohe të caktuar (kryesisht brenda 6-mujorit të parë

të vitit) me qëllim që me këto të ardhura të sigurohet financimi i shpenzimet të miratuara në planin vjetor të buxhetit. Nga Sektori i Tatim-Taksave shpjegohet se këto afate përcaktohen me daljen e njoftim vlerësimit tatimor, gjë që tregon se afati i përcaktimit të pagesës së detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore mbetet të përcaktohet nga ky sektor dhe jo nga Këshilli Bashkiak.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, neni 5, gërma “c”, ku përcaktohet që: “Përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatin e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”. (*Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.5, faqe 53-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet dhe Sektori i Tatim-Taksave, të marrin masa për përcaktimin në paketën fiskale, të afateve të pagimit për taksat dhe tarifatat vendore për taksapaguesit privat dhe familjar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga kryetari i Bashkisë dhe Sektori i Tatim taksave vendore janë marrë masat dhe me VKB nr.96 datë 27.11.2024 “Për miratimin e Paketës fiskale” për vitin 2025, është përcaktuar qartë afati i pagesës për taksat dhe tarifatat vendore për taksapaguesit privat dhe familjar.

Pra Rekomandimi 6.1 është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore është në vlerën 72,317 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 70,357 mijë lekë ose në masën 97.2% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 1,960 mijë lekë.

Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, konstatohet se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura të debitorëve. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32. (*Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.5, faqe 53-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandim: Sektori i Tatim Taksave të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifatat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Bashkia Përmet janë hartuar PBA 2024-2026 dhe Plani vjetor 2024 të cilat janë miratuar me VKB. Pra **Rekomandimi 7.1 (është i njëjtë me Rekomandimin 4.1) është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.**

7.2. Rekomandim: Sektori i Tatim Taksave të marrë masa që për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifat vendore të vitit buxhetor aktual.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Sektori i Tatim taksave vendore ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Kështu ka regjistruar veçmas të ardhurat nga taksa e tarifa vendore të prapambetura si dhe ka mbajtur informacion të plotë mbi subjektet debitore nga viti i krijimit të debisë dhe kamatvonesat për secilin rast. Pra **Rekomandimi 7.2 është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.**

8. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Sektori i Tatim Taksave të ardhurat nga Agjentët Tatimorë (Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë, ASHK Përmet në lidhje me taksën mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, Drejtoria Rajonale e Tatime Gjirokastrë në lidhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat personale dhe DSHTRR Gjirokastrë në lidhje me taksat vendore të qarkullimit për mjetet e përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Përmet dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Përmet duke kuadruar edhe me akt-rakordimin vjetor të datës 31.12.2023. Bashkia Përmet ka të dhëna vetëm për vlerën e arkëtuar nga këta agjentë, sipas vlerës së depozituar në thesar, por nuk ka bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimor dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre. Gjithashtu janë mbajtur në mënyrë pjesore akt-rakordime me agjentët tatimorë si SHRUKGJ dhe Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Gjirokastrë, ndërsa me DRSHTRR Gjirokastrë dhe Degën Doganore Tre Urat Përmet nuk janë mbajtur akt-rakordime për vitin 2023. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.5, faqe 53-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandim: Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Përmet të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Sektori i Tatim taksave vendore ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Kështu periodikisht iu është kërkuar agjentëve tatimorë rakordim, por nuk ka pasur asnjë përgjigje. Me anë të shkresave: Nr.2066 dhe 2067 datë 14.08.2024 është rikërkuar agjentëve tatimor- Drejorisë Rajonale të Tatimeve, Dega Doganore Tre Urat dhe DRSHTRR-së kërkesë për rakordim, por nuk ka pasur asnjë reagim. Drejtoria e Financës e buxhetit/Sektori i Taksa e tarifave vendore rakordon vetëm nëpërmjet Akt Rakordimit me Degën e Thesarit Përmet. Me Ujësjellës Kanalizimie Rajonal Gjirokastrë - Sha në rolin e agjentit tatimor për vjeljen e taksave dhe tarifave të popullatës nëpërmjet marrëveshjes nr. 316 prot., datë 31.01.2024 për Bashkinë Përmet dhe me nr. 469 prot., datë 07.02.2024 për UKR Gjirokastrë-Sha, si dhe kryhen rakordimet mujore dhe Akt rakordimi vjetor 2024 është mbajtur në 27.01.2025; me DRT Gjirokastrë kryhen aktrakordime mujore për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël. Pra **Rekomandimi 8.1 është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi**

Detyrimi vjetor që UKR Gjirokastrë duhet të vjelë për taksa e tarifa vendore/Bashkia Pë rmet						
Nr	Emërtimi	Bashkia	NJA Piskovë	NJA Petran	NJA Çarshovë	Totali
1	Taksë Toke		590,506	408,294	228,812	7,6121,222
2	Taksë Ndërtese	2,832,941	405,520	630,784	212,539	4,081,784

3	Taksë trualli		23,067	17,714	6,888	47,669
4	Tarifë Dru zjarri		365,400	400,500	68,400	834,300
5	Tarifë pastrimi	5,313,600	520,800	307,200		6,141,600
6	Tarifë ndriçimi	1,771,200	172,800	184,000	102,400	2,230,400
7	Tarifë Gjelbërimi	443,000				443,000
8	Tarifë ujitje			30,800	9,200	40,000
9	Të tjera			57,000	116,002	173,002
	Totali	10,360,741	2,078,093	2,036,292	744,241	15,219,367

8.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifave vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjykitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Përmet dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, kanë marrë masat për zbatimin e rekomandimit, konkretisht nëpërmjet shkresave nr. 2066 dhe 2067 prot., datë 14.08.2024 iu është kërkuar agjentëve tatimor: DRT Gjirokastër, DD Tre Urat dhe DRSHTRR Gjirokastër, kërkesë për rakordim. Deri në 31.12.2024 nga ana e tyre nuk ka asnjë përgjigje. Këto kërkesa kanë vijuar edhe për vitin 2025. Pra **Rekomandimi 8.2 (është i njëjtë me Rekomandimin 8.1) është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi**

9. Gjetje nga auditimi: Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për abonentët privatë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Përmet kryhet në programin Excel. Sektori i Tatim-Taksave kryhen regjistrim manual të të dhënave (*nuk disponon regjistra fizik*). Çdo informacion që grumbullohet nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Përmet i administrojnë në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Sektorit të Tatim Taksave për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të Sektorit të Tatim Taksave. Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7. (*Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.5, faqe 53-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandim: Nga Sektori i Tatim-Taksave të merren masa të menjëhershme për krijimin e regjistrit të taksave dhe tatimpaguesve vendore në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, me qëllimin ruajtjen dhe miradministrimin e të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Sektori i Taksa e tarifave vendore regjistrat e hartuar përditësohen me informacion të ri të verifikuar. Pra **Rekomandimi 9.1 është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.**

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Përmet si dhe duke u bazuar në procesverbalet e mbajtura mbi

verifikimin e statusit të subjekteve për vitin 2023, nga inspektorët e terrenit pranë Sektorit të Tatim-Taksave dhe punonjësve të Policisë Bashkiake dhe të dhënave në QKB konstatohet se:

-Në territorin e Bashkisë Përmet kanë ushtruar aktivitet 29 subjekte të cilat nuk janë të regjistruara në QKB;

-Në vitin 2023 kanë aplikuar për ç’regjistrim 12 subjekte nga të cilat 4 subjekte ushtrojnë aktivitet dhe 8 subjekte nuk ushtrojnë aktivitet. Gjithashtu nga këto subjekte vetëm 3 prej tyre janë të ç’regjistruara në QKB ndërsa 9 subjekte janë ende aktiv në QKB;

-Referuar procesverbaleve të inspektimit në terren 6 subjekte nuk ushtrojnë aktivitet, por janë aktivë në QKB;

-Në vitin 2023 kanë aplikuar 9 subjekte për pezullim të përkohshëm të aktivitetit nga të cilët 1 subjekt ushtron aktivitet dhe 8 subjekte nuk ushtrojnë aktivitet. Mos kryerja e inspektimeve në terren nga Sektori i Tatim Taksave, krijon risk për ushtrimin nga subjektet të aktivitetit, pa u pajisur me licensat përkatëse, duke krijuar të ardhura të munguara për institucionin. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, neni 22, nenet 48-49. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.5, faqe 53-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandim: Bashkia Përmet, Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa për përlogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore përkatëse për subjektet që ushtrojnë aktivitet pa u regjistruar në QKB si dhe për subjektet që kanë aplikuar për pezullim apo ç’regjistrim, por nga inspektimet në terren rezultojnë që ushtrojnë aktivitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Drejtoria e Financës e buxhetit/Sektori i Taksa e tarifave vendore janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Kështu nëpërmjet urdhrave të kryetarit janë ngritur komisionet e verifikimit në terren për verifikimin e gjithqë subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë. Janë mbajtur procesverbale për subjektet që kanë aplikuar për pezullim apo çregjistrim të aktivitetit në QKB. Nga kontrollet e ushtruara nuk ka rezultuar subjekte aktive të paregjistruara. Pra ***Rekomandimi 10.1 është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.***

11. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2023 në territorin e Bashkisë Përmet kanë ushtruar aktivitet katër subjekte në fushën e ndërtimit të cilat nuk janë të pajisur me Nipt Sekondar në zbatim të përcaktimeve të nenit 22 dhe neneve 48-49, të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, ku këto subjekte duhet të shlyejnë detyrimet për taksat dhe tarifave vendore ndaj institucionit referuar kontratave si më poshtë:

-Kontrata me nr. 3122 prot., datë 21.11.2023, me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara”, në vlerën 7,926,814 lekë me TVSH me afat të fillimit të punimeve më datë 21.11.2023, dhe me afat të përfundimit të punimeve më datë 21.03.2024, lidhur ndërmjet Bashkisë Përmet përfaqësuar nga znj. A.H Kryetar i Bashkisë dhe OE “A.” Shpk me Nipt J.....O përfaqësuar nga Administratori z. A. A.

-Kontrata me nr. 2814 prot., datë 20.10.2023, me objekt “Rehabilitimi i digës së rezervuarit Pacomit Bashkia Përmet”, në vlerën 38,695,735 lekë me TVSH me afat të fillimit të punimeve më datë 20.10.2023, dhe me afat të përfundimit të punimeve më datë 20.06.2024, lidhur ndërmjet Bashkisë Përmet përfaqësuar nga znj. A.H Kryetar i Bashkisë dhe OE “2.” Shpk me Nipt K.....M përfaqësuar nga Administratori z. A.S.

-Kontrata me nr. 107 prot., datë 11.01.2023, me objekt “Rehabilitim i kanalit ujitës Piskovë Përmet”, në vlerën 9,824,568.4 lekë me TVSH me afat të fillimit të punimeve më datë 11.01.2023, dhe me afat të përfundimit të punimeve më datë 11.04.2023, lidhur ndërmjet Bashkisë Përmet

përfaqësuar nga znj. A.H Kryetar i Bashkisë dhe OE “S.” Shpk me Nipt K.....S përfaqësuar nga Administratori znj. A. B.

-Kontrata me nr. 715 prot., datë 01.03.2023, me objekt “Ndriçim publik në kuadër të projektit “Bashki me energji inteligjente”, në vlerën 54,422,970 lekë me TVSH me afat të fillimit të punimeve më datë 01.03.2023, dhe me afat të përfundimit të punimeve më datë 01.09.2023, lidhur ndërmjet Bashkisë Përmet përfaqësuar nga znj. A.H Kryetar i Bashkisë dhe BOE “2.” Shpk me Nipt K.....M & “R.” Shpk Nipt J.....Q përfaqësuar nga Administratorët z. L.K dhe z. A.S. (*Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.5, faqe 53-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandim: Bashkia Përmet, Sektori Juridik dhe i Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Sektorin e Tatim-Taksave të marrë masa në vijimësi, për të gjithë subjektet që kanë lidhur kontratë investimesh me bashkinë, pajisjen e tyre me nipt sekondar dhe përlloraritjen e taksave dhe tarifave vendore deri në momentin e përfundimit të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Bashkia Përmet dhe Sektori i Taksa e Tarifave vendore janë marrë masat për zbatimin e rekomandimeve. Kështu nëpërmjet shkresës nr.26/1 datë 22.04.2024 Sektori Juridik ka bërë me dije Sektorin e Tatim taksave dhe me anë të shkresës nr.1189 prot., datë 07.05.2024 bashkëlidhur faturat, i kanë dërguar njoftim operatorëve ekonomik fitues. Nga katër subjekte tre prej tyre kanë paguar, respektivisht: **“2.” Shpk në datë 16.05.2024, “S.” Shpk në datë 17.05.2024 dhe “A.” Shpk në datë 12.11.2024.**

- Me anë të shkresave nr.2088 datë 19.08.2024 dhe nr.256 datë 28.01.2025 është njoftuar dhe rinjoftuar subjekti “R” Shpk për shlyerje detyrimesh. Pra **Rekomandimi 11.1 është pranuar nga subjekti dhe është pjesërisht zbatuar.**

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të liçencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatohet se përgjatë vitit 2023 në territorin e Bashkisë Përmet dhe njësisë administrative është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 4 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2023, gjithsej rezultojnë 3 subjekte të pajisura me autorizim me afat 1-5 vjeçar, këto subjekte e kanë paguar të plotë vlerën e autorizimit sipas rastit. Ndërkohë që për 1 subjekt (**“G.C” Shpk për të cilën nga DPTUSH ka përllogatur detyrimin në vlerën 1,000,000 lekë**) me aktivitet tregtimin e karburanteve që operojnë në territorin e Bashkisë Përmet të pa pajisur me autorizimin përkatës. Në lidhje me këtë situatë Kryetar i Bashkisë është drejtuar Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe për dijeni Subjektit “G.C” Shpk me shkresën nr. 3381 prot., datë 22.12.2023, duke bërë me dije se në territorin e Bashkisë Përmet ushtron aktivitet subjekti i sipërpërmendur ushtron aktivitet ndërkohë që nuk është i pajisur me liçencën/autorizimin përkatës. Deri më datë 10.05.2024, që i përket përfundimit të periudhës objekt auditimi në terren, nga Bashkia Përmet dhe ISHTI nuk janë masat e duhura për bllokimin e veprimtarisë të Subjektit “G.C” Shpk i cili ushtron aktivitet pa liçencën/autorizimin përkatës.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të 197 kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, germa “b”, dhe

pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, gërma “b” dhe pika 9 dhe 15. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.5, faqe 53-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandim: Bashkia Përmet, Sektori i Tatim-Taksave, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Urbanistikës dhe Shërbimeve në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa të menjëhershme për pezullimin e subjekteve, që ushtrojnë aktivitet për tregtimin karburanti pa u pajisur me autorizim/liçencë.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e buxhetit dhe financës ka marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Kështu: - me shkresën nr. 2127 prot., datë 22.08.2024 i është drejtuar ISHTI-it dhe për dijeni subjektit “G. (GKG)” Shpk, me objekt “Kërkesë për bashkëpunim institucional dhe marrjen e masave për bllokim të veprimtarisë”;

Subjekti “GKG” Shpk është paraqitur në Bashkinë Përmet për tu pajisur me licencë, sipas kërkesës së regjistruar nr. 2250 prot., datë 03.09.2024;

Me shkresën nr. 12323/1 prot., datë 09.09.2024 ISHTI i ka kthyer përgjigje Bashkisë Përmet, ku e vë në dijeni për inspektimin e bërë pranë subjektit;

Subjekti “GCG” Shpk ka kryer pagesa për 3 vjet aktivitet (2022,2023,2024) me faturën nr. 119 datë 03.10.2024, nr. 144 datë 26.11.2024 dhe nr. 149 datë 17.12.2024 shumën prej 600,000 lekë (3*200,000);

- Subjekti ”S.” Shpk rezulton jo aktiv. Referuar QKB-së subjekti ”S.” Shpk me nr NIPT K.....V ka filluar ushtrimin e aktivitetit në datë: 30/04/2018 me Numri i ceshtjes: CN-758329-04-18; është shtuar Adresa: "Gjirokastrë;; Përmet;; Lagjja Partizani, Zona Kadastrale 2917, Numer Pasurie 18/56, Vol 15, Fq 16. Subjekti ka kryer një pagesë e cila është arkëtuar në datë 24.09.2021 në vlerën 200 000 leke, (për një periudhë 1-vjecare) Subjekt ka qenë i pajisur me License për këtë periudhë me nr 1 datë 01.10.2021.

Referuar QKB-së në datë 04/07/2023 me Numrin e çështjes: CN-139268-06-23 është Hequr Adresa: "Gjirokastrë; PËRMET; Përmet; PËRMET; Lagjja Partizani, Zona Kadastrale 2917, Numër Pasurie 18/56, Vol 15, Fq 168. Subjekti nuk ushtron aktivitet që prej periudhës Qershor 2023. Me shkresën nr. 1190 prot. datë: 13.04.2022, Bashkia Përmet i është drejtuar subjektit “S.” shpk, dhe për dijeni Drejtorisë së Inspektimit të Naftës, Gazit & Nënprodukteve të tyre me objekt ‘njoftim për shlyerje detyrimesh dhe pajisje me license për ushtrim aktiviteti’. Drejtoria e Inspektimit të naftës dhe gazit dhe nënprodukteve të saj, Inspektoriati Qëndror Teknik i saj, me shkresën nr 3511/1 date 28.04.2022 me lëndë ‘kthim pergjigje’, shprehet se Subjekti “S.” do të inspektohet nga ana e tyre.

Po me shkresën nr. 3401 prot. datë: 08.11.2022 Bashkia Përmet i është drejtuar përsëri subjektit “S.” shpk me objekt njoftim për shlyerje detyrimesh. ***Pra Rekomandimi 12.1 (i njëjtë me Rekomandimin 25.1/2.1) është pranuar nga subjekti dhe është pjesërisht zbatuar***

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Përmet dhe njësisë të varësisë konstatohet se, janë kontabilizuar aktive në gjendjen e llogarisë 327 “Inventar i imët” vlera 17,345,395 lekë, llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” vlera 4,590,149 lekë, llogarisë 215 “Mjete transporti” në vlerën 10,363,360 lekë dhe llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 13,179,159 lekë të cilat nuk janë në gjendje pune (të dëmtuara ose të dala jashtë funksionit) të cilat konfirmohen sipas relacionit të datë 31.12.2023, i hartuar nga komisioni i inventarizimit të aktiveve të institucionit dhe në kushte të tilla këto aktive duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. Veprime këto në

kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1.pika 2.1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 69-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve në pasqyrat financiare të vitit 2024 të bëjë sistemimin e vlerës totale prej 45,478,063 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të aktiveve të dëmtuara që i përkasin llogarive 327 “Inventar i imët” në vlerën 17,345,395 lekë, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” në vlerën 4,590,149 lekë, 215 “Mjete transporti” në vlerën 10,363,360 lekë dhe 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 6,850,180 lekë, sistemi të kryhet referuar trajtimin kontabël në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

Deri më datë 31.03.2025

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Përmet çdo vit kryen inventarizimin fizik dhe vlerësimin praparak të aktiveve të saj. Për vitin 2023 është kryer nëpërmjet komisionit të ngritur në zbatim të Urdhrit të Kryetarit nr. 335 datë 19.10.2023; për vitin 2024 është me Urdhrin e kryetarit nr. 386 datë 01.11.2024; për vitin 2023 me mbylljen e fazës së parë nuk është vijuar me fazat vijuese: atë të vlerësimit të aktiveve të cilësuara të dëmtuara nga komisioni i vlerësimit dhe më pas me nxjerrjen jashtë përdorimit nëse është e nevojshme nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit. Me Urdhrin e Kryetarit nr. 33 datë 03.02.2025 është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të cilësuara të dëmtuara nga faza e parë e inventarizimit fizik të dy viteve 2023 dhe 2024 si dhe gjithë aktiveve nga viti 2011 e deri më sot. Nga informacioni i dhënë dhe komunikimi verbal me subjektin, rezulton se procesi i vlerësimit të aktiveve të cilësuara paraprakisht si "të dëmtuara" është në proces, duke mos i reflektuar deri në 31.03.2025 me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit të mbyllur ushtrimor 2024. ***Pra Rekomandimi 13.1 është pranuar nga Subjekti dhe në proces zbatimi.***

14. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 60,198,925 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 87,840,764 lekë me një rritje në vlerën 27,641,839 lekë. Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është përfshirë vlera 2,208,930 lekë e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore dhe për pasojë kjo llogari nuk paraqet situatën reale debitore. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Sektorit Juridik dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë së Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve. Në këtë llogari është përfshirë edhe vlera 26,492,937 lekë e pa analizuar në kontabilitet që i përket detyrimeve që vijnë nga Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Përmet. Gjithashtu në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërparti llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5, pika 7, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 69-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandim: Bashkia Përmet, Drejtoria e Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve dhe Sektori i Tatim Taksave të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i

plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me kunërparti llogarinë 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë”.

Deri më datë 31.03.2025

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës e buxhetit/Sektori i Financës mori masat dhe me mbylljen e pasqyrave financiare, u mbyll llogaria 475 duke kontabilizuar saktë të drejtat për arkëtim nga të tretë në llogarinë 468 ‘debitorë të ndryshëm’ me kundërparti llogarinë 470 ‘llogari në pritje- të ardhura për tu marrë’. Pra ***Rekomandimi 14.1 është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.***

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në vlerën 41,840,074 lekë veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Seksioni 3.1, pika 15, për arsye se kjo vlerë duhej të kontabilizohej në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Detyrimet e prapambetura duhet të rregjistrohen në debi të llogarinë 4342 “Operacione me shtetin” (të drejta) dhe në kredi të llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 467 “Kreditorë të tjerë”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 69-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve të marrë masat e nevojshme për mbylljen e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” e cila është llogari rregulluese dhe nuk është pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar. Detyrimet e prapambetura duhet të rregjistrohen në debi të llogarinë 4342 “Operacione me shtetin” (të drejta) dhe në kredi të llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Deri më datë 31.03.2025

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës e buxhetit/Sektori i Financës mori masat dhe me mbylljen e pasqyrave financiare mbylli llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe detyrimet e prapambetura u kontabilizuan në debi të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” dhe në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Pra ***Rekomandimi 15.1 është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.***

16. Gjetje nga auditimi: Në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në vlerën 18,336,713 lekë kosto historike është përfshirë vlera 7,182,172 lekë, 210 “Toka, troje, terrene” në vlerën 6,257,567 lekë kosto historike është përfshirë vlera 5,804,067 lekë, 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 646,811,957 lekë kosto historike është përfshirë vlera 472,818,049 lekë dhe 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 1,337,828,146 lekë kosto historike është përfshirë vlera 949,127,216 lekë të pa analizuara si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Këto vlera janë të trashëguara nga bilanci i ish-komunave Përmet (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 69-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës dhe buxhetit ka parashikuar në buxhetin vjetor 2025 fondin për vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale. Pra *Rekomandimi 16.1 është pranuar nga subjekti dhe pjesërisht zbatuar.*

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është mbivlerësuar në vlerën 20,017,100 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjiellës Kanalizime Përmet me Nipt J69228203I është 21,675,257 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër me Nipt M23329601L. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Përmet 1,658,157 lekë ose 7.65% ($7.65 * 21,675,257 / 100 = 1,658,157$ lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 216,752,570 lekë (në këtë regjistrim nuk është marrë në konsideratë ndryshimi i vlerës së kapitalit të Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Përmet ku nga vlera 216,752,570 lekë aktualisht vlera e kapitalet ka shkuar në vlerën 21,675,257). Veprime këto në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, pikat 27-30, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 69-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve, të marren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

Deri më datë 31.03.2025

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Përmet referuar Ekstraktit të QKB -së është aksionere me 7.65% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër” Sha me Nipt-M23329601L, ose me 7650 aksione me vlerë nominale 100 lekë/copa. Kjo vlerë është përcaktuar referuar Marrëveshjes “Për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjiellës Kanalizime [SKPUK]” mes 7 Bashkive të Qarkut Gjirokastër dhe MIE, me nr. Prot., 2298 datë 22.07.2022 për Bashkinë Përmet. Bashkia Përmet me anë të shkresës nr. 2071 prot., datë 14.08.2024 i është kërkuar për interpretim Sektorit juridik të AKUK referuar gjetjes së grupit të auditimit të KLSH-së në RPA-në e fundit. Nga ana e AKUK për këtë shkresë nuk është kthyer asnjë përgjigje; Me anë të shkresës nr. 87 prot., datë 13.01.2025 i është ridërguar shkresa për interpretim dhe përcaktim të saktë të vlerës së aksioneve që Bashkia Përmet ka në UKR Gjirokastër, drejtuar AKUK-së dhe Shoqërisë Rajonale “Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër” Sha. Me shkresën nr.109/1 datë 21.03.2025 UKR Gjirokastër ka kthyer përgjigje ku theksohet fakti se është në proces vlerësimi i kapitalit të secilës bashki dhe raportit ndaj kapitalit në total, pa anashkaluar 51% e MIE. Nga DFB i është kërkuar AUK situacioni përfundimtar i punimeve të kryera në Ujësjiellësin Përmet (pas vitit 2019), i cili në periudhën e transferimit të UKR dhe krijimit të UKR Gjirokastër ishte në proces, ende i papërfunduar. Me përfundimin e tij nga ana e autoritetit

kontraktor nuk ishte vënë në dijeni Bashkia Përmet. Me rrugë elektronike në datën 03.04.2025 është dërguar Situacioni dhe është regjistruar në Bashki me nr. 1134 prot., datë 03.04.2025. DFB në llog. 26 'pjesëmarrje në kapitalin e vet' të pasqyrave kontabël ka regjistruar vlerën e certifikuar të Shoqërisë audituese "H A" Shpk me eksperte kontabël H.M. të miratuar në prill të vitit 2019, në Raportin e së cilës vlerësohet se kapitali i Shoqërisë UK Përmet Sha është në vlerën 216,752,570 lekë dhe zotërohet në masë të plotë 100% nga aksioneri Bashkia Përmet.

Për sa më lart, nga ana e DFB nuk është reflektuar në llog. 26 të pasqyrave financiare të vitit 2024, vlerën e ndryshuar e situacionit dhe ajo e rekomanduar. ***Pra Rekomandimi 17.1 është pranuar nga subjekti dhe është pjesërisht zbatuar.***

18. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve konstatohet se, për vitin 2023 ka 1 kontratë në proces realizimi punimesh me objekt "SEMP Psikovë + kanal ujitës" për të cilën është likuiduar vlera 11,134,603 lekë, duke e nënvlerësuar këtë llogari në vlerën 11,134,603 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Aneksi 1, Klasa 23". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 69-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të merren masa për kontabilizimin e vlerës 11,134,603 lekë në llogarinë 231 "Për aktive afatgjata materiale" që i përket likuidimeve të situacioneve pjesore të kontratave të investimeve të cilat janë në proces zbatimi punimesh.

Deri më datë 31.03.2025

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Rezulton se kjo kontratë është shlyer tërësisht në vlerën e plotë prej 11,134,603 lekë. ***Pra Rekomandimi 18.1 është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.***

19. Gjetje nga auditimi: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, përmbledhsja e llogarive 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" paraqitet në vlerën 41,840,074 lekë, 42 "Detyrime ndaj personelit" në vlerën 13,165,611 lekë, 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" në vlerën 708,161 lekë, 435 "Sigurime shoqërore" në vlerën 3,850,421 lekë dhe 436 "Sigurime shëndetësore" në vlerën 524,052 lekë ku totali shkon në vlerën 60,088,319 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)" në vlerën 18,248,245 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Aneksi 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 69-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2025

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës e Buxhetit ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024, ka saktësuar vlerën e llog. 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)". ***Pra Rekomandimi 19.1 (i njëjtë me Rekomandimin 15.1) është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.***

20. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Përmet në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerë 17,032,871 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Përmet. Për 3 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Përmet janë ngurtësuar fonde në vlerën 1,528,145 lekë, për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Përmet, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 1,528,145 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 69-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet, Drejtoria e Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontrator për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Financës e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës kanë marrë masat për zbatimin e rekomandimit, duke patur nën monitorim përfundimin e periudhës së garancisë së çdo projekt investimi. Për vitin 2024 nuk rezulton periudhë garancie e përfunduar për asnjë investim. Pra **Rekomandimi 20.1 është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.**

21. Gjetje nga auditimi: Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 1,129,091,583 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 241,435,823 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 3,992,320 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”.

Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 1,871,675 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 105,624,379 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 2,703,510 lekë.

Kjo situatë ka ndodhur për arsye se diferenca që i përket llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” në vlerën 2,703,510 lekë (3,992,320 lekë- 1,288,810 lekë = 2,703,510 lekë) që i përket çeljes dhe mbylljes së kësaj llogarie nuk janë pasqyruar si çelje dhe mbyllje në llogarinë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” por janë kontabilizuar në llogarinë “Të tjera” pjesë e pasqyrës së Fondit të Kosoliduar. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e

qeverisjes së përgjithshme”, pika 17. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 69-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2025

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës e Buxhetit/Sektori i Financës ka marrë masat dhe me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024, ka sistemuar llogarinë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar”. Pra ***Rekomandimi 21.1 është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.***

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i borderove, listë prezencave ditore, listë pagesave për muajt janar, mars, qershor, tetor, nëntor të vitit 2023 konstatohet se, për 155 punonjës të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës nëpërmjet Kodit të Punës dhe kontratave individuale të punës nuk është përlllogaritur vjetërsia e punës, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 6, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 69-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve të merren masa për përlllogaritjen e vjetërsisë për punonjës që i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës dhe buxhetit me VKB nr. 17 datë 18.02.2025 “Për disa shtesa në VKB nr. 107 datë 18.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Përmet viti 2025”, ka miratuar shtesë fondi për pagesën e vjetërsisë së punonjësve me Kod pune. ***Pra Rekomandimi 22.1 është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.***

23. Gjetje nga auditimi: -Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Bashkisë Përmet dhe Njësi Administrative Qendër Piskovë, Petran, Frashër, Çarshovë, nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, ku përcaktohet që, “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

-Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, 215 “Mjete transporti” dhe 218 “Inventar ekonomik” konstatohet se nga Bashkia Përmet disponohet një regjistër kontabël në formatin Excel, jo sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, konkretisht në të nuk evidentohet datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia.

Për sa trajtuar më sipër nga Bashkia Përmet, nuk është përmbushur detyrimi ligjor për krijimin e një regjistri fizik në zbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

-Gjithashtu pronat e transferuara me VKM-të përkatëse të evidentuara në vijm të materialit që i përkasin llogarive 210, 211, 213 dhe 213 nuk janë të evidentuara në regjistratat në programin elektronik Excel.

-Asetet e transferuara në pronësi apo në përdorim të Bashkisë Përmet dhe Njësi Administrative nuk janë hartuar procesverbalet e marrjes në dorëzim.

-Me VKM-të përkatëse janë transferuar në total 3,250 pasuri si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat 3,015 pasuri në pronësi dhe 235 pasuri në përdorim, ku vetëm 38 pasuri prej tyre janë të pajisura me çertifikatë pronësie ndërsa 2,977 pasuri nuk janë të pajisura me titull pronësie. Përgjatë vitit 2023 vetëm 1 pasuri është pajisur me çertifikatë pronësie.

-Gjithashtu nga Bashkia Përmet nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV neni 37 pika 1, 2, gërma a, b, Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 90-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet të marrë masa që me grup pune, të cilët të jenë specialist të fushës, të hartojë regjistrin e plotë të aktiveve, jo vetëm për ato që janë të regjistruara në kontabilitet, por edhe për aktivet të cilat momentalisht, nuk janë të regjistruara në librat e kontabilitetit. Mbi bazën e evidentimit në regjistrin e aktiveve, të bëhet inventarizimi fizik i të gjitha pasurive në terren dhe për situatën e konstatuar të hartohet një raport i hollësishëm titullarit të institucionit.

23.2. Rekomandim: Bashkia Përmet të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara), sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë ka marrë masat dhe ka miratuar me Vendimin nr. 107 datë 18.12.2024, PBA dhe Buxhetin vjetor të bashkisë viti 2025, ku janë parashikuar fondi prej 4,000,000 lekë për zbatimin e rekomandimeve, ***Pra Rekomandimi 23.1 dhe Rekomandimi 23.2 janë pranuar nga subjekti dhe janë pjesërisht zbatuar.***

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për subjekte të pajisura me kontratat për shfrytëzimin e burimeve minerare dhe ato koncesionare sipas regjistratit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Qendrës Kombëtare të Biznesit, konstatohet se përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, në territorin e Bashkisë Përmet, kanë ushtruar aktivitet në fushën e burimeve minerare dy subjekte, për të cilat Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës Bashkia Përmet nuk administron dosje të këtij subjekti (raporti teknik, kontratë qiraje, etj..) konkretisht si më poshtë:

-Subjekti “C. F. F” ShPK me NIPT K.....I, i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1127/1, datë 08.01.2008, për shfrytëzimin e vendburimit Lipe për llojin e mineralit ranor pllakor dhe me sipërfaqen 0.306 km².

-Subjekti “E MP” ShPK me disponibilitet 1 HEC në Qarkun Gjirokastrë në Njësinë Administrative Çarshovë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për Fondin kullor”, pikat 3, 7, 9, 10, 11, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 90-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës t’i kërkojë informacion Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me qëllim evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullor të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Planifikimit të territorit dhe urbanistikës ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Rezulton se nga komunikimi zyrtar me MIE, gjithë sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullor që shfrytëzohen nga subjektet private janë hequr.. Pra **Rekomandimi 24.1 është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.**

25. Gjetje nga auditimi (i mëparshëm): Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 423/8 prot., datë 25.09.2023, ku janë lënë për zbatim 15 masa organizative, 2 masë për shpërblim dëmi në vlerën 495,347 lekë, 4 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimit e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efijencë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 30,531,158 lekë, 1 masë për arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën 42,219,480 lekë dhe 8 masa disiplinore.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 15 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 4 masa janë zbatuar plotësisht, 2 masa janë zbatuar pjesërisht, 3 masa janë në proces zbatimi dhe 6 masa janë të pa zbatuara.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 2 masa në vlerën 495,347 lekë të cila është janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 2 masa janë zbatuar plotësisht duke arkëtuar vlerën 495,347 lekë.

c. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimit e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efijencë dhe efektivitet të fondeve publike janë rekomanduar 4 masa në vlerën 30,531,158 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar pjesërisht, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 1 masë është e pa zbatuar.

d. Për arkëtimin e të ardhurave të munguara është rekomanduar 1 masë në vlerën 42,219,480 lekë e pranuar plotësisht e cila është e pa zbatuar.

e. Masa disiplinore janë rekomanduar 8 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 8 masa janë të pa zbatuara.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “c”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 95-112. ë Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1. Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju

rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A.1.1. Masa organizative të lëna në auditimin e mëparshëm.

Rekomandimet nr. 1.1, 1.2, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1, 7.1, 11.1, 11.2 dhe 12.1, që i përkasin kategorisë masa organizative të cilat nuk janë zbatuar, por në thelb janë të njëjtat problematika në formë dhe në përmbajtje me rekomandimet e dhëna nga KLSH mbi auditimin e ushtruar për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023. Në kushte të tilla këto rekomandime e kanë humbur efektin e tyre dhe nuk do të rikërkohet.

A.1.2. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave.

Rekomandimet nr. 1.1, dhe 3.1, që i përkasin kategorisë masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të cilat nuk janë zbatuar, por në thelb janë të njëjtat problematika në formë dhe në përmbajtje me rekomandimet e dhëna nga KLSH mbi auditimin e ushtruar për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023. Në kushte të tilla këto rekomandime e kanë humbur efektin e tyre dhe nuk do të rikërkohet përveç rekomandimeve nr. 2.1, dhe nr. 4.1:

2.1. Rekomandimi: Bashkia Përmet, Drejtoria e *Buxhetit, Financës dhe Tatim Taksave*, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve prej **2,000,000 lekë** nga **2 subjektet**, respektivisht:

- Vlera **1,000,000 lekë** nga subjekti "S" shpk",
- Vlera **1,000,000 lekë** nga subjekti "G.C" shpk.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e buxhetit dhe financës ka marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Kështu: - me shkresën nr. 2127 prot., datë 22.08.2024 i është drejtuar ISHT-it dhe për dijeni subjektit "G. (GKG)" Shpk, me objekt "Kërkesë për bashkëpunim institucional dhe marrjen e masave për bllokim të veprimtarisë";

Subjekti "GK" Shpk është paraqitur në Bashkinë Përmet për tu pasjitur me licencë, sipas kërkesës së regjistruar nr. 2250 prot., datë 03.09.2024;

Me shkresën nr. 12323/1 prot., datë 09.09.2024 ISHT i ka kthyer përgjigje Bashkisë Përmet, ku e vë në dijeni për inspektimin e bërë pranë subjektit;

Subjekti "G CG" Shpk ka kryer pagesa për 3 vjet aktivitet (2022,2023,2024) me faturën nr. 119 datë 03.10.2024, nr. 144 datë 26.11.2024 dhe nr. 149 datë 17.12.2024 shumën prej 600,000 lekë (3*200,000);

- Subjekti "S." Shpk nuk është aktiv;

Pra Rekomandimi 25.1/2.1 (i njëjtë me Rekomandimin 12.1) është pranuar nga subjekti dhe është pjesërisht zbatuar

4.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtës Territorit (IMT) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Përmet, të kërkojë në Gjykatë, shndërrimin e vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 "Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv" dhe neni 30 "Arkëtimi i shumave të detyrimeve" të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe arkëtimi i vlerës 150,000 lekë.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e inspektorit IMT-së në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, nëpërmjet shkresës nr. 1925 prot., datë 20.07.2023 është dërguar në Gjykatë kërkesa për kthimin e masave administrative (gjobave) në titull ekzekutiv. Pra ***Rekomandimi 25.1/4.1 është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar***

A.1.3. Masa për uljen e borxhit tatimor.

Rekomandim nr. 1.1, që i përket masa për uljen e borxhit tatimor i cili nuk është zbatuar, por në thelb është e njëjta problematikë në formë dhe në përmbajtje me rekomandimin e dhëna nga KLSH mbi auditimin e ushtruar për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023. Në kushte të tilla ky rekomandim e ka humbur efektin e tyre dhe nuk do të rikërkohej.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Përmet më datë 01.01.2023, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor të detyrimeve të prapambetura për 26 çështje nga vendimet gjyqësore në vlerën totale 22,404,569 lekë, ku në të përfshihen dëmshpërblime page për largim të punonjësve nga puna në vlerën 6,763,305 lekë + çështje të tjera të ndryshme gjyqësore në vlerën 15,641,264 lekë.

Përgjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime në vlerën 2,526,162 lekë nga humbja e proceseve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largim të punonjësve nga puna.

Gjithashtu gjatë vitit 2023 Bashkia Përmet për zbatimin e vendimeve gjyqësore ka shpenzuar vlerën totale prej 12,554,125 lekë, ku në të përfshihen dëmshpërblime page për largim të punonjësve nga puna në vlerën 6,798,275 lekë + çështje të tjera të ndryshme gjyqësore në vlerën 5,755,850 lekë. Në mbyllje më datë 31.12.2023, detyrimet nga vendimet gjyqësore janë në vlerën totale 12,376,606 lekë, ku në të përfshihen dëmshpërblime page për largim të punonjësve nga puna në vlerën 2,491,192 lekë + çështje të tjera të ndryshme gjyqësore në vlerën 9,885,414 lekë.

Vlera totale prej 12,554,125 lekë e shpenzuar për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, nga Bashkia Përmet për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largim të punonjësve nga puna dhe çështjeve të tjera të ndryshme gjyqësore *konsiderohet efekt negativ financiar*.

Nga auditimi konstatohet se, vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 60. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.1-2.2.4, faqe 39-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Kryetari i bashkisë janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Kështu situata e detyrimit financiar që Bashkia Përmet u ka punonjësve të larguar nga puna në periudhat e mëparshme, por zbardhur me vendim të formës së prerë deri në datën 31.12.2023 paraqitet si në tabelë:

Nr.	Emër Mbiemër	Detyrimi deri në 31.12.2023
1	AK	7,200
2	OS	240,184
3	SK	257,680
4	BI	351,188
5	SHM	246,168
6	GI	117,034
7	ST	149,120
8	SB	328,876
9	AGJ	390,141
10	VB	101,513
Totali		2,189,104
		Deri në 31.12.2024
		0

- Nga informacioni i detajuar për shtetasin B.C , ndaj të cilit deri në një Vendim të formës së prerë nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është debitore (deri sa të provohet pafajësia), rezulton se pas një kalvari të gjatë kërkesë padish dhe kundër padish, faza e fundit ka në fuqi Vendimin nr. 3854 datë 28.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me anë të të cilit i jepet e drejtë shtetasit B.C kundrejt të paditurit Byrosë Kombëtare të Sigurimeve [BKS], me një vlerë dëmshpërblimi: 894,276 lekë plus 5413 euro për shërbimin shëndetsor plus kamatvonesta mbi këto shuma duke filluar nga data 21.01.2016;

BKS ka ngritur padi kundër këtij vendimi nr. 4153 prot., datë 26.06.2019, me anë të së cilës kërkon prishjen e Vendimit nr. 3854 datë 28.05.2019 të GjRREGJ Tiranë;

Me anë të shresës nr. 301 prot., datë 30.01.2025 Bashkia Përmet i ka kërkuar informacion mbi ecurinë e çështjes në GJAJP Tiranë;

Me shkresën nr. 2281/1 prot., datë 04.02.2025 të GJAJP Tiranë është kthyer përgjigje se deri në datën 03.02.2025 kjo çështje nuk është planifikuar ende për gjykim.

Nga sa trajtuar më lart, rezulton se nuk ka asnjë analizë të dokumentuar mbi arsyet e largimit nga puna të punonjësve, që i kanë shkaktuar një dëm buxhetit të bashkisë prej 2,189,104 lekë për vitin 2023 dhe likuiduar në vitin 2024. Për vitin 2024 nuk ka Vendime gjyqësore të tjera të ardhura për ekzekutim dhe as informacion nëse ka ndonjë në proces. ***Pra Rekomandimi 1.1 është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.***

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë konstatohet se, në **tre raste** janë zhvilluar projekte artistike për të cilat nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, prashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8. Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e projekteve artistike është kryer sipas Vendimit nr. 99, datë 05.12.2022, të Këshillit Bashkiak, në artikullin 604 “Transferime korente të brendshme” në vlerën 1,000,000 lekë. Nga Bashkia Përmet për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, për 1 subjekt është likuiduar shuma 1,000,000 lekë. **Vlera 1,000,000 lekë përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 69-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve të evidentojë të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi dhe për

rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe buxhetit kanë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Kështu: Me shkresën nr. 1437 prot. datë 31.05.2024 është njoftuar shoqata “F.” për të marrë pjesë në takimin e organizuar në ambiente të bashkisë, “mbi ecurinë e projektit”; në datën 04.06.2024 është mbajtur procesi verbal i takimit të parashikuar; urdhri i Kryetarit nr. 123 datë 29.03.2024 dhe me nr. 910 prot., datë 29.03.2024 “për pagesë parafinancimi të projekteve fituese në Thirrjen e pestë dhe të gjashtë R.” subjekteve: Shoqata “F.” në shumën 1,250,000 lekë, Shoqata “V.E ” në shumën 1,000,000 lekë dhe Shoqata “Përmeti Futboll Klub 1930” në shumën 1,000,000 lekë; me Vendimin e Kryetarit nr. 123/1 datë 16.09.2024 dhe me nr. 910/1 prot., datë 16.09.2024 për ndërprerjen e kontratës së lidhur me Bashkisë Përmet dhe Shoqatës “F.” në kuadër të zbatimit të projektit RELOAD2; ***Pra Rekomandimi 2.1 është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.***

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se deri më datën 31.12.2022, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë abonentët familjarë, biznesi i madh, i vogël dhe institucionet në vlerën **39,396,779 lekë**. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, janë krijuar debitorë në vlerën **6,675,491 lekë**. Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2023, për abonentët familjarë, biznesi i madh, i vogël dhe institucionet janë në vlerën **46,072,270 lekë e cila përbën të ardhura të munguar për Buxhetin e Bashkisë Përmet** si më poshtë:

1. Vlera **12,038,566 lekë** për **1,515 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Përmet nga mos arkëtimi i taksës së tokës bujqësore;
2. Vlera **5,492,937 lekë** për **383 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin Bashkisë Përmet nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës;
3. Vlera **193,408 lekë** për **271 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Përmet nga mos arkëtimi i taksës së truallit;
4. Vlera **5,915,309 lekë** për **380 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Përmet nga mos arkëtimi i tarifave vendore të tjera + gjoba;
5. Vlera **17,444,367 lekë** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Përmet nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga biznesi i vogël;
6. Vlera **3,976,683 lekë** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Përmet nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga biznesi i madh;
7. Vlera **1,011,000 lekë** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Përmet nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga institucionet;

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta

vendore”. (Më hollësisht trajtuar në nënplikën 2.2.5, faqe 53-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Bashkia Përmet, Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore deri më datën 31.12.2023, në **vlerën totale 46,072,270 lekë**, e cila përbëhet nga:

-12,038,566 lekë detyrime për taksën e tokës bujqësore për 1,515 familje;

-5,492,937 lekë detyrime për taksën së ndërtesës për 383 familje;

-193,408 lekë detyrime për taksën së truallit për 271 familje;

-5,915,309 lekë detyrime për tarifa vendore të tjera + gjoba për 380 familje;

-17,444,367 lekë detyrime nga biznesi i vogël;

-3,976,683 lekë detyrime nga biznesi i madh;

-1,011,000 lekë detyrime nga institucionet;

a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim-Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektori i Tatim-Taksave të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. Sektori i Tatim-Taksave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Përmet, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Sektori i Taksave e Tarifave vendore ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit të lënë nga KLSH në RPA. Kështu situata e debitorëve paraqitet si në tabelën më poshtë. Pra **Rekomandimi 1.1 është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi**

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Urbanistikës dhe Shërbimeve në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Dega Përmet janë dërguar zyrtarisht me shkresë listat e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi. Nga auditimi konstatohet se deri më datë 31.12.2022, për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë detyrimi për këtë taksë është në vlerën **1,883,221 lekë**. Nga kjo vlerë për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, është arkëtuar vlera 419,469 lekë. Në total detyrimi për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë më datë 31.12.2023, është në **vlerën 1,480,494 lekë për 27 persona e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Përmet**. Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Përmet për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Dega Përmet ose ASHK-në Rajonale Gjirokastrë, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, pika “d”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014,

“Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5. (Më hollësisht trajtuar në nën pikën 2.2.5, faqe 53-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Bashkia Përmet, Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **1,480,494 lekë** ndaj **27 personave**.

Nga verifikimi rezultoi se: Sektori i Tatim taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të territorit dhe urbanistikës kanë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Pra **Rekomandimi 2.1 është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.**

Tabela përmbledhëse për **Rekomandimin 1.1** dhe **Rekomandimin 2.1**

Përshkrimi	Nr	Vlera e borxhit progresive deri më 31.12.2023	Nr	Arkëtuar nga detyrimi prapambet 2023	Nr	Vlera e borxhit progresive e vitit 2023 deri më 31.12.2024
Debitorë biznes i madh	12	3,976,683		110,838		3,865,845
Debitorë biznes i vogël	121	17,534,367		673,489		16,860,878
Nëntotali I	133	21,511,050		784,327		20,726,723
Institucione	6	921,000	0	0	6	921,000
Nëntotali II	6	921,000		0		921,000
Debitorë taksa e ndërtesës familje	4876	5,492,937		0	4876	5,492,937
Debitorët taksat familje (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim.)		6,108,717		0		6,108,717
Debitorët taksa e tokës bujqësore	2971	12,038,566		397,844		11,640,722
Debitorët taksa e ndikimit në infrast.	27	1,480,494	1	48,174		1,432,320
Debitorët nga qiratë		1,952,963		0		1,952,963
Debitorë nga hidrokarburet		1,600,000		0		1,600,000
Nëntotali III		28,673,677		446,018		28,227,659
Total Borxhi tatimor (I+II+III)		51,105,727		1,230,345		49,875,382

2.2. Rekomandim: Bashkia Përmet, Sektori i Tatim-Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Urbanistikës dhe Shërbimeve për personat të cilët nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje, t’i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Gjyrokastër vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Sektori i Tatim taksave vendore dhe Drejtorinë e Planifikimit të territorit, urbanistikës dhe shërbimeve për personat të cilët nuk kanë kryer pagesën e TNI për ndërtimet pa leje në vlerën 1,480,494 lekë ndaj 60 personave.

- Me anë të mandate pagesës me nr. reference 2024011 datë 19.01.2024 ka kryer pagesen pranë Raiffeisen Bank në vlerën 48,174 lekë;
- Me anë të shkresës nr. 278 datë 29.01.2025 janë nisur rinjofimet për subjektet debitorë për likuidimin e debisë në vlerën totale të mbetur prej 1,432,320 lekë.
- Nuk i është dërguar ASHK-së Rajonale lista e debitorëve të TNI-së për vendosje të sekuestros konservative. Pra **Rekomandimi 2.2 është pranuar nga subjekti dhe është pjesërisht zbatuar.**

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Përmet nuk ka lidhur kontrata të reja për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve. Janë aktive 12 kontrata për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve dhe për dhënien me qira të hapësirave/sipërfaqeve për vendosjen e antenave telefonike me vlerë kontrate 2,712,394 lekë.

Në total detyrimet progresive më datë 31.12.2023, për mos likuidimin e detyrimeve të përcaktuara në kontratën e qirasë janë në vlerën 2,808,417 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Përmet.

-Qiramarrësit me kontratë për antenat celulare në fond pyjor e kullësor rezultojnë të kenë një vlerë debitore prej 341,487 lekë.

-Qiramarrësit me kontratë për fond kullësor për nxjerrje inertesh rezultojnë të kenë një vlerë debitore prej 258,000 Lekë.

-Qiramarrësit me kontratë për HECE konstatohet të kenë një vlerë debitorë prej 2,208,930 lekë.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për subjektin “K.” Shpk detyrimi nuk është paguar. Me shkresën nr. 2832 prot., datë 24.10.2023, i është dërguar subjektit “K.” Shpk “Rinjofitim” referuar shkresës së tij nr. 97 prot., datë 07.10.2021, ku bën me dije se arsyet e mos pagesës së detyrimit të kësaj kontrate vijnë pasi që prej 15.11.2018, ky subjekt ka aplikuar në AZHT për tu pajisur me leje përfundimtare për të filluar aktivitetin të cilin nuk e ka nisur deri më sot.

-Nga titullari i institucionit nuk janë marrë masa për ngritjen e grupeve të punës mbi monitorimin e kontratave të qirave në lidhje me objektin dhe detyrimet e përdoruesit në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 90-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandim: Bashkia Përmet, Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e ndërtesave/objekteve në total në vlerën 2,808,417 lekë duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Bashkia Përmet dhe Sektori i Tatim taksave vendore janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Kështu:

- Subjekti ‘V. ka shlyer detyrimet e vitit 2023 për dy kontratat në datë 04.01.2024 në vlerën 341 487 lekë;

- Subjekti ‘R.’ sh.p.k ka shlyer detyrimet e vitit 2022 në datë 23.01.2024 në vlerën 129 000 lekë dhe detyrimin e vitit 2023 në datë 12.02.2024 në vlerën 129 000 lekë;

- Lidhur me Subjektin ‘K.’, është ndjekur ky komunikim zyrtar:

Është lidhur kontrata mes Bashkisë Përmet dhe Subjektit ‘K.’ nr. 2449 prot., datë 04.10.2018, ndryshuar me kontratën nr. 2946 prot., datë 20.11.2018, me afat 6 vjeçar;

Për vitin 2019 subjekti ka paguar kestin e parë, konform kërkesave të kontratës;

Me shkresën nr. 3653 prot., date 24.12.2020 i është kërkuar subjektit ‘K.’ pagesa vjetore 2020 e kështit të dytë në shumën 736,310 lekë;

Me shkresën nr. 3699 prot., date 30.12.2020 me objekt ‘rinjofitim -për shlyerje detyrimesh (vjetor 2020)’;

Me shkresën nr. 1093 prot., datë 21.04.2021 drejtuar Subjektit “K.” sh.p.k me objekt ‘njoftim me paralajmërim për prishje të njëanshme të kontratës’ për shlyerje të detyrimit vjetor 2020 në vlerën totale 748,753 [736,310 +12,443] lekë Brenda 10 ditësh;

Shkresa e dates 04.10.2021 e Sektorit të Aseteve për Drejtorinë Juridike me objekt ‘kërkesë për konfirmim të ndjekjes së procedurës gjyqësore’ ku kërkohet në mënyrë të qartë konfirmimi nëse ka filluar apo jo procedura gjyqësore për prishjen e kontratës me subjektin ‘K.’ shpk;

Shkresa nr. 2830 prot., date 24.10.2023 me objekt ‘Rinjofitim për pagesë të (4 kësteve) kësteve vjetore të kontratës, e pashoqëruar me faturën e detajuar të detyrimeve të deri asaj periudhe;

Shkresa nr. 113 prot., date 15.01.2025 me objekt "njoftim për mbarim të afatit të kontratës nr. 2449 prot., date 04.10.2018 ndryshuar me atë nr. 2946 prot., date 20.11.2018 dhe rinjoftim për përmbushjen e detyrimeve financiare të krijuara nga kjo kontratë". Bashkëlidhur fatura e detajuar e detyrimeve në vlerën totale prej 3,694,988 lekë;

Shkresa nr. 110 prot., date 22.01.2025 (e subjektit "K." shpk), i është kthyer përgjigje shkresës nr. 113 prot., date 15.01.2025 të Bashkisë Përmet, ku konfirmohet mos njohja e detyrimit pasi nuk është ndërtuar objekti, për mospajisje me lejen përkatëse të ndërtimit.

Shkresa nr. 113/2 prot., date 28.01.2025 me objekt "njoftim për ndërprerje të kontratës, vlera e detyrimit total të 5 vitete prej 3,694,987.65 lekë dhe ndjekja me rrugë ligjore për shlyerjen e detyrimit ndaj Bashkisë Përmet"; Deri në datën 09.05.2025 nga Zyra juridike e Bashkisë Përmet nuk është depozituar asnjë kërkesë padi në Gjykatë.

Pra nga vlera 2,808,417 lekë e debisë totale progresive të periudhës deri në 31.12.2023, është mundur të arkëtohen 470,487 lekë dhe mbeten për tu arkëtuar shuma progresive e prapambetur prej 2,337,930 lekë. ***Rekomandimi 3.1 është pranuar nga subjekti dhe është pjesërisht zbatuar.***

3.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e kontratave të qirasë.

Nga verifikimi rezultoi se: Me Urdhrin e kryetarit nr. 185 datë 09.06.2023 me nr. 1566 prot., datë 09.06.2023 është ngritur grupi i punës prej 9 anëtarësh për verifikimin e zbatimit të kontratave të dhënies me qira të tokave bujqësore.

Nr	Emër mbiemër	Statusi
1	F.H	Kryetar grupi
2	Dh.P	Anëtar
3	P.M	-//-
4	KTH	-//-
5	A.B	-//-
6	MS	
7	AZ	
8	KH	
9	PS	

Pra Rekomandimi 3.2 është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

3.3. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Urbanistikës dhe Shërbimeve të marrë masa që, të aplikojë pagesën e tarifave të kontratave të qirasë për dhënien e sipërfaqeje të fondit pyjor kullor nga momenti i lidhjes së kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton si në tabelë:

Kontrata të lidhura për dhënie me qira të kullotave viti 2023						
Nr	Sip total /ha	Sip në përdorim /ha	Kullota verore/krerë	Kullota dimërore /krerë	Detyrimi vjetor/në lekë	Statusi
31	4034	2072	5630	300	1,278,000	paguar
Kontrata të lidhura për dhënie me qira të kullotave viti 2024						
15	2114	1179	3413		764,200	paguar

Pra Rekomandimi 3.3 është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

E. MASA DISIPLINORE

Bazuar në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 57, 58 dhe 59, të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" i

ndryshuar me VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Përmet t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të kryej marrjen e masave disiplinore përkatëse në proporcion me shkallën e shkeljes, për 2 punonjës, respektivisht:

1. Znj. E.K., me status nëpunësi civil me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve në cilësinë e nëpunësit zbatues, nënshkruar i pasqyrave financiare.

2. Z. D.M., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave, për mangësitë e konstatuara në realizimin e planit të të ardhurave, zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, mos mbajtjen e regjistrave për abonentët familjarë, mos mbajtjen e akt rakordimeve me agjentit tatimor UK Sh.A Përmet.

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetare e Bashkisë Përmet nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit. Pra **Rekomandimi i Kategorisë E-“Masa Disiplinore” nuk është zbatuar nga subjekti.**

E.1. Për të gjithë punonjësit e tjerë, të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i të auditimit, lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Përmet, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Përmet nuk ka vlerësuar si të nevojshëm fillimin e procedurave disiplinore për punonjësit e atakuar në RPA. Pra **Rekomandimi i Kategorisë E1 është zbatuar.**

Konkluzion: Në përfundim të procesit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, rezultoi se nga **39** rekomandime të lëna në total, janë pranuar nga Subjekti Bashkia Përmet **38** rekomandime; janë verifikuar **39** rekomandimet nga të cilat: janë zbatuar **18** masa ose **46%** e tyre; 11 masa janë në proces zbatimi ku përfshihet edhe 1 masë e papranuar nga subjekti; 9 masa janë pjesërisht zbatuar si dhe 1 masë është e pa zbatuar; pra **9** masa mbeten për tu zbatuar nga subjekti Bashkia Përmet për periudhën në vijim nga të cilat 1 masë është e rikërkuar.

Grupi i auditimit duke analizuar Rekomandimet e pra nuara dhe të zbatuara nga Bashkia Përmet (njësitë përgjegjëse të saj) apo dhe ato në proces zbatimi, arriti në konkluzionin që:

- Për kategorinë “Masa Organizative”- Rekomandimet R2.1; R5.1; R 6.1; R7.2; R9.1; R10.1; R14.1; R15.1; R18.1; R19.1; R20.1; R21.1; R22.1; (janë zbatuar),

Rekomandimet R1.1; R3.1; R4.1; R7.1; R8.1; R8.2; R13.1; R24.1, (janë në proces zbatimi);

- Kategorinë “Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, TNI, etj (të ardhura të munguara)”- Rekomandimet R3.2; R3.3; (janë zbatuar),

Rekomandimet R1.1; R2.1; (janë në proces zbatimi);

- Kategorinë “Masa eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike” - Rekomandimet R 2.1; R25.1/4.1; –(janë zbatuar);
Rekomandimi R1.1 (është në process zbatimi);
- Masa Disiplinore /kategoria E1 (është zbatuar)
janë pranuar dhe zbatuar apo në proces zbatimi nga Bashkia Përmet, prandaj nuk mund të qëndrojnë për periudhën në vijim.

9.Të ndryshme të dala Gjatë auditimit.

-Gjatë auditimit nuk ka pasur çështje të tjera, veç çështjeve të programit të trajtuara më sipër.

IV.REKOMANDIME

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 10 (dhjetë) procedurave të prokurimit, të përzgjedhura për auditim u konstatua se:

Në 7 (shtatë) procedura prokurimi, për periudhën 01.01.2023 -31.12.2024, me vlerë totale të fondit limit 320,032,598 lekë pa TVSH dhe vlerë totale të kontratave 269,460,916 lekë pa TVSH, janë aplikuar kriteret e paargumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e objektit të kontratës çka ndikon drejtpërdrejt në konkurrencën midis B/OE pjesëmarrës në garë;

-Në 3 (tre) raste për vlerën e 28,300,285 lekë të fondit limit, Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar fondin limit. Konkretisht për 2 (dy) procedurat me objekt “*Blerje karburanti*” për vitet 2023-2024 dhe 1 (një) procedurë me objekt “*Blerje ushqimesh për kopshtin /konviktin/çerdhen*” për vitin 2023. Në lidhje me sasinë e përlllogarit të karburantit përveç dokumentacionit të paraqitur, nuk ka një analizë të detajuar e cila duhet të ketë të përcaktuar kërkesat e paraqitura nga grupet e punës në terren, kërkesat nga shoferët që kanë në ngarkim mjetet, analizën mbi aktivitetin e punës së vitit të kaluar, parashikimin e volumeve të punës të vitit pasardhës bazuar në programin vjetor programeve mujore të miratuara, numrin e mjeteve si dhe verifikimi i gjendjes teknike mjeteve. Në hartimin e kërkesës për ushqime dorëzuar për komisionit për llogaritjen e fondit limit u konstatua se, nuk dokumentohet mënyra se si janë përcaktuar normat ditore.

- Në 8 procedura, me vlerë totale të fondit limit 325,436,368 lekë pa TVSH dhe vlerë totale të kontratave 274,382,156 lekë pa TVSH, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Përmet.

-Në 1 (një) procedurë me fond limit 5,403,770 lekë dhe me vlerë kontrate 4,921,420 lekë pa TVSH, me objekt prokurimi “*Blerje ushqimesh për kopshtin /konviktin/çerdhen për vitin 2023*” është konstatuar mos zbatim i kushteve të kontratës me nr. 584 prot., datë 20.02.2023, gjithashtu, marrja në dorëzim e mallrave është kryer jo në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Nga auditimi u konstatua se, nuk paraqitet dukumentacion sikurse përcaktohet në nenin 1 “Objekti i Kontratës” ku mallrat duhet të jenë sipas specifikimeve teknike, në kundërshtim me nenin 1 të kontratës “Objekti i kontratës” pika 1.2 ku është kërkuar që për mallrat që do të dorëzohen duhet të jenë sipas sasisë në dokumentet e tenderit dhe specifikimeve teknike. Nuk janë paraqitur Proces Verbalet me të dhënat treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtojca 5) nuk ka evidentuar nëse mallrat e furnizuara

janë të cilësisë së parë, nëse ambalazhi i tyre është në përputhje me kërkesat e prokurimit, nëse furnizimi është në përputhje me treguesit cilësore sipas standardit shtetëror të miratuar. Nga auditimi u konstatua se, mungon fleta e shoqërimit e cila dorëzohet nga furnitori ku përcaktohen minimalisht të dhënat e mjetit me të cilin po transportohen ushqimet, nëse i plotëson kushtet higjieno-sanitare, ose transportohen me mjetin frigoriferik i cili përcaktohet në dokumentat e tenderit. Në pikën 6.3 të nenit 6 të kontratës me nr. 584 prot., datë 20.02.2023, specifikohet se, mallrat do të dorëzohen nga administratori i firmës ose nga një përfaqësues i firmës autoizuar me shkrim shoqëruar me raport analizën për çdo produkt, lidhur me këtë kërkesë u konstatua se, jo çdo produkt është shoqëruar me raport analizën përkatëse.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 2, me pikën 4 të nenit 39, nenin 78, nenin 107 i ndryshuar. Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b”, neni 98, pika 1/b neni 124, UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, neni 43. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 98-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet, të marrë masa që zyrtarët e përfshirë në procesin prokurues (Grupi për Hartimin e Fondit Limit, Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe Grupi i Monitorimit të Kontratës) të jenë specialistë të fushës, me qëllim që argumentimi i kriterëve të vendosura të jetë në përputhje me tipologjinë e procedurës së prokurimit, që gjatë vlerësimit të ofertave të sigurohet konkurrencë e drejtë dhe e paanshme, si dhe gjatë zbatimit të kontratës të garantohet plotësimi i Specifikimeve Teknike dhe kushteve të tjera.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në 3 (tre) raste, nga auditimi i zbatimit të kontratave për punë publike për objektet përkatësisht:

- “Sistemim asfaltimi i rrugës Spital - Varreza” me nr. 79 prot., datë 09.01.2023, fituar nga shoqëria “H. 94” SHPK me vlerë të kontratës 38,063,788 lekë me TVSH,

-“Termoizolimi dhe përmirësimi i sistemit të ngrohjes i konviktit Përmet” me nr. 79 prot., datë 09.01.2023, fituar nga BOE “E.” SHPK & C. SHPK me vlerë të kontratës 12,564,245 lekë me TVSH,

-“Rehabilitimi i kanalit ujitës Piskovë” me nr. 107 prot., datë 11.01.2023, fituar nga OE “S.” SHPK me vlerë të kontratës 11,439,482.70 lekë me TVSH, u konstatua se: Nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Përmet nuk është kryer Oponencë Teknike, veprim ky në mospërputhje me **pikën 1 të nenit 6** të ligjit nr. **8402**, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me **Ligjin Nr. 120/2020** “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998”, me **Ligjin nr. 107/2014** “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, **neni 52**, me **VKM Nr. 610, datë 22.9.2022** “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 135-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë masa që të pajiset me **Oponencë Teknike** çdo projekt zbatimi, për t’u siguruar mbi hartimin e studimeve të projekteve të zbatimit, në përputhje me detyrën e projektimit, me dokumentet e planifikimit të kontrollit dhe zhvillimit të territorit, me rregullat teknike të ndërtimit, kushtet teknike të projektimit dhe standardet në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, u konstatua se në 5 (pesë) raste ka mangësi në dokumentacionin shoqërues. Në të gjitha rastet janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu, në 1 (një) rast u konstatua se, dokumenti i lejes së ndërtimit nuk respekton përcaktimet ligjore në lidhje me përmbajtjen e tij. Mangësitë dhe shkeljet e konstatuara janë evidentuar për objektet: -Leje ndërtimi “Banesë një familjare në pronë të familjes X”, miratuar me Vendim nr. 1145/2, datë 21.07.2023, me zhvillues A.X ; -Leje ndërtimi “Ndërtim objekt dy kat me cati + një kat podrum (bujtinë)”, miratuar me Vendim nr. 2732/5, datë 18.10.2024, me zhvillues S. B. ; -Leje ndërtimi “Banesë individuale një kat + Bodrum dhe çati”, miratuar me Vendim nr. 2540/1, datë 20.11.2023, me zhvillues V.G ; Leje ndërtimi “Prishje dhe rindërtim objekti 2 kat me një kat nëntokë”, miratuar me Vendim nr. 2846/2, datë 29.03.2023, me zhvillues A.N ; -Leje ndërtimi “Rikonstruksion dhe shtesë 1 kat banim në godinë ekzistuese 2 kate”, miratuar me Vendim nr. 1103/1, datë 05.06.2023, me zhvillues J.P ; - Çertifikatë përdorimi “Mbingritje 1 kat me çati në objekt ekzistues me funksion banimi”, miratuar me Vendim nr. 2319/1-5, datë 03.04.2024, me zhvillues A.K; Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 16, pika 1, nënpika b); neni 20; neni 15, pika 1, nënpika b) ë) g); neni 27; neni 27/2, pika 1, nënpika i. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 155-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit të shqyrtojë dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, të mos miratojë leje ndërtimi apo çertifikata përdorimi në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm ligjor, si dhe të sigurojë plotësimin e saktë dhe të plotë të dokumentit të lejes së ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 5 (pesë) raste u konstatua se, Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Teritorit, Bashkia Përmet nuk ka respektuar detyrimin ligjor për të marrë mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Rezultoni se lejet e ndërtimit për 5 objektet:

-Leje ndërtimi “Banesë një familjare në pronë të familjes X”, miratuar me Vendim nr. 1145/2, datë 21.07.2023, me zhvillues A.X,

-Leje ndërtimi “Ndërtim objekt dy kat me cati + një kat Bodrum (bujtinë)”, miratuar me Vendim nr. 2732/5, datë 18.10.2024, me zhvillues S. B.

-Leje ndërtimi “Banesë individuale një kat + Bodrum dhe çati”, miratuar me Vendim nr. 2540/1, datë 20.11.2023, me zhvillues V.G.

-Leje ndërtimi “Prishje dhe rindërtim objekti 2 kat me një kat nëntokë”, miratuar me Vendim nr. 2846/2, datë 29.03.2023, me zhvillues A.N.

-Leje ndërtimi “Rikonstruksion dhe shtesë 1 kat banim në godinë ekzistuese 2 kate”, miratuar me Vendim nr. 1103/1, datë 05.06.2023, me zhvillues J.P.

janë miratuar në heshtje, pa marrë mendim pozitiv nga DR ASHK. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 21, pika 6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 155-163 të Raportit përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit të Teritorit, Bashkia Përmet, të merren të gjitha masat për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t’u pajisur me leje

ndërtimi, mendimin e Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në mënyrë të dokumentuar.

Menjëherë dhe në vijimës

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se, në 2 (dy) raste, nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë, lartësia maksimale e lejuar, e matur me numër katesh, si dhe distanca urbane nga kufiri i pronës. Në (1) një rast është konstatuar se, parcelat e përfshira në funksion të zhvillimit të të njëjtit objekt ndërtimi, nuk kanë lidhje fizike ndërmjet tyre. Këto parcela kufizohen me pasuri të tjera që ndodhen ndërmjet tyre dhe për rrjedhojë, nuk përbëjnë një njësi të pandërprerë territoriale (truall të përbashkët) në funksion të zhvillimit. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet: - Leje ndërtimi “Banesë një familjare në pronë të familjes X”, miratuar me Vendim nr. 1145/2, datë 21.07.2023, me zhvillues A.X; -Leje ndërtimi “Prishje dhe rindërtim objekti 2 kat me një kat nëntokë”, miratuar me Vendim nr. 2846/2, datë 29.03.2023, me zhvillues A.N . Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 14, neni 30, neni 35, Planin e Përgjithshëm Vendor, miratuar me Vendimin e KKT nr.3, datë 10.06.2020, neni 20, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 155-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit të marrë masa që, përpara miratimit të lejes së ndërtimit, të sigurojë respektimin e kushteve ligjore dhe urbane për zhvillim, konkretisht:

- Të verifikojë përputhshmërinë e aplikimit me kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe të miratojë vetëm ato aplikime që i respektojnë këto kondicione, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- Të pranojë për shqyrtim vetëm ato aplikime në të cilat objekti/et zhvillohen mbi parcela që kanë lidhje fizike midis tyre; ose, kur parcelat nuk kanë lidhje fizike, të jetë siguruar dokumentacion që vërteton marrëveshje të ligjshme për akses në pronë përmes parcelave ndërmjetëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Bashkisë Përmet i janë transferuar me VKM-të përkatëse 3,250 pasuri, nga të cilat 3,015 janë në pronësi dhe 235 në përdorim. Nga këto pasuri, rezultoi se vetëm 39 janë të pajisura me certifikatë pronësie, ndërsa 2,976 mbeten të paregjistruara. Gjatë vitit 2024, është aplikuar për regjistrim në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës vetëm për 4 pasuri, nga të cilat nuk është certifikuar asnjëra. Bashkia Përmet nuk ka ndërmarrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike dhe juridike të këtyre pronave dhe nuk ka kryer veprimet e nevojshme ligjore për regjistrimin e pasurive të transferuara me qëllim pajisjen e tyre me certifikatë pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me: Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV, neni 37, pika 1, 2, germa a, b, Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI, “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5.1, faqe 148-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin e gjendjes faktike dhe juridike të pasurive të transferuara sipas VKM-ve, si dhe për të bërë të mundur rakordimin me Drejtorinë Vendore të ASHK, me qëllim përditësimin e inventarit

të pasurive në përputhje me gjendjen reale dhe pajisjen e tyre me çertifikata pronësie, duke reflektuar ndryshimet nga legalizime, privatizime, kthime/kompensime apo vendime gjyqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Përmet ka në administrim 22 apartamente të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) dhe të dorëzuara në pronësi të saj, për të cilat ka detyrimin të lidhë kontratat e shitjes me rezervë me subjektet përfituese, në zbatim të vendimeve përkatëse të privatizimit. Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se Bashkia Përmet nuk i ka pajisur me çertifikatë pronësie apartamentet me nr. 28/55+1-8, nr. 28/55+1-3, nr. 25/80+1-3 dhe nr. 25/80+2-5, ndodhur në Zonë Kadastrale 2917. Pajisja me çertifikatë pronësie është e domosdoshme për lidhjen e kontratave të shitjes me rezervë me subjektet përfituese nga privatizimi. Këto veprime janë në kundërshtim me Vendimin Nr. 898, datë 18.11.2020 “Për Rregullat, Kushtet, Kriteret e Procedurat e Privatizimit të Banesave dhe të Objekteve të kthyer në Fond Banese të Paprivatizuara”, Kreu V – Lidhja e Kontratës, si dhe si dhe VKB nr.36, datë 30.05.2022 “Për miratimin e privatizimit të banesave sociale në Qytetin Përmet si dhe vlerën e privatizimit të tyre në favor të përfituesëve”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5.1, faqe 148-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë masa të menjëhershme për pajisjen me çertifikatë pronësie apartamentet e miratuara për privatizim me nr. 28/55+1-8, nr. 28/55+1-3, nr. 25/80+1-3, nr. 25/80+2-5, me qëllim finalizimin e procesit të privatizimit, duke siguruar lidhjen e kontratës së shitjes me rezervë me subjektet përfituese në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e siguruar nga Regjistri i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, konstatohet se gjatë periudhës 01.01.2024, deri më 31.12.2024, në territorin e Bashkisë Përmet ka ushtruar aktivitet në fushën e burimeve natyrore subjekti “E. MP” sh.p.k i cili disponon një HEC në Qarkun Gjirokastrë, në Njësinë Administrative Çarshovë. Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit nuk disponon dokumentacionin përkatës, përfshirë raportin teknik, kontratat e qirasë, si dhe dokumentacion tjetër shoqëruar të nevojshëm.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për Fondin kullor”, pikat 3, 7, 9,10,11, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5.1, faqe 148-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1.Rekomandimi: Bashkia Përmet t’i drejtohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim evidentimin dhe verifikimin e sipërfaqes së shfrytëzuar nga subjekti privat, në mënyrë që kjo sipërfaqe të zbritet nga fondi pyjor dhe kullor. Në rastet kur nuk realizohet zbritja e kësaj sipërfaqeje nga fondi pyjor dhe kullor, Bashkia të kërkojë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ndërprerjen e përkohshme të veprimtarisë së subjektit privat përkatës, deri në përmbushjen e detyrimit ligjor për zbritjen nga fondi pyjor të sipërfaqes së shfrytëzuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme përgjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2024, u konstatua se, në Bashkinë

Përmet funksioni i kontrollit të territorit, kryhet nga zyra e kontrollit dhe mbrojtjes së territorit në varësi të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe nuk është krijuar Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, në varësi direkte nga organi ekzekutiv i Bashkisë. Sa i përket numrit të punonjësve në zyrën e kontrollit u konstatua se nuk është në përputhje me përcaktimet e kuadrit rregullator, pasi nga 3 punonjës minimalisht që duhet të ketë kjo strukturë, ka vetëm 1 punonjës Kryeinspektori i zyrës së kontrollit nuk ka miratuar asnjë akt-kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, sipas fazave të punimeve, gjithashtu nuk ka përgatitur informacionin periodik 3–muajor për IKMT për masat e marra, gjatë ushtrimit të detyrave. Programi vjetor i punës për zyrën e kontrollit nuk është miratuar nga organi ekzekutiv i Bashkisë. Nga auditimi ka rezultuar se, ndërmjet zyrës së kontrollit dhe drejtorisë së urbanistikës, ka munguar bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 3, nenin 4, nenin 5, nenin 11, pikat 5, 6, 7, 8 në nenin 12, nenin 13, në Ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar; Nenin 1, në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve 159 të ndërtimit”, i ndryshuar; Pikat 1, 2, dhe 4 në nenin 51 në Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Nenin 5, pikën 1 në nenin 9, pikën 3 të nenit 24, shkronjat “a” dhe “c” në pikën 1, pikat 2, 3 dhe 4 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 31, pikat 4 dhe 5 në nenin 48 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Nenin 11 të Ligjit nr.10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Pikën 1 germa b/ii, pikën 2, shkronjën “b”, pikat 4 dhe 6 në VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 163-166, të Raportit Përfundimtar të Auditimi)

9.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masat e nevojshme për: Krijimin dhe funksionimin e strukturës së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit në nivel inspektorati dhe jo si zyrë kontrolli.

-Mbajtjen e akt-kontrolleve për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit.

-Rritjen e bashkëpunimit me Drejtorinë e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, për shkëmbimin e informacionit midis tyre.

-Përgatitjen e planeve vjetore dhe mujore të punës dhe informacionin periodik tre muajor ndaj Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) mbi aktivitetin e saj, procedurat e mbajtura gjatë kësaj kohe dhe vendimet e marra.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së IMTV, konstatohet se, në të gjitha rastet, edhe pse është lënë detyrë për prishjen e punimeve pa leje dhe/ose të dorëzimit të dokumentacionit, konstatohet se nuk administrohet dokumentacioni i dorëzuar si dhe nga zyra e kontrollit nuk është kryer inspektim për verifikimin e plotësisht të detyrave të lëna, pra të prishjes së punimeve të ndërtimeve pa leje. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 3, germa “a”, nenin 4, 5, nenin 11, pika 5, 6, 7 dhe 8 si dhe nenin 12 dhe 13, të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar”.(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 163-166, të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

10.1.Rekomandimi: Nga struktura e kontrollit dhe mbrojtjes së territorit Bashkia Përmet, të kryehen inspektive për verifikimin e plotësimin të detyrave të lëna bazuar në akt konstatimet e mbajtura, në lidhje me punimet për ndërtimet pa leje.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Mbi plotësinë dhe saktësinë e informacionit të llogarive kontabël për vitin 2024 në pasqyrat financiare të vitit 2024, sipas sipas UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën epërgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, u konstatua si më poshtë vijon:

- Shuma e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” është nënvlerësuar me 5,724,449 lekë, pasi informacioni i ardhur në Sektorin e financës për borxhin tatimor dhe numrin e tatimpaguesve që janë debitorë ndaj Bashkisë Përmet, nuk ka qenë i plotë dhe si pasojë vlera 5,724,449 lekë nuk rezulton e kontabilizuar ²⁴;

- Nga analiza e llog.218 “Inventar ekonomik” rezulton se kategoria “Pajisje kompjuterike” nuk është ndarë si nënkategori më vete [llog. 2186], duke mos pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj.

- Vlera e amortizimit në llog. 209 & 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM” është në vlerën 64,881,828 lekë. Nga auditimi rezulton se amortizimi nuk është llogaritur për çdo aktiv, por në grup, duke mos patur kështu informacion mbi aktivet që e kanë vlerën e mbetur të papërfillshme ose zero dhe si rrjedhojë as të paturin nën kontroll të nevojës për rivlerësimin e atyre që janë në gjendje pune;

- Llogaritë e klasës 20 “AAJM”/llog. 202 “Studime e projekte” paraqitet në shumën 20,194,217 lekë ku përfshihen 15 projekte. U konstatua se nga ana e DFB nuk janë marrë masat që për projektet e hershme kryesisht të atyre të vitit 2015 në shumën 4,212,174 lekë, të sigurohet informacioni i nevojshëm dokumentar, për të kaluar vlerën e tyre në llogaritë përkatëse të klasës 21 AAM: llog.212 dhe llog.213. tek investimi respektiv.

- Nga analiza e llog.218 “Inventar ekonomik” rezulton se kategoria “Pajisje kompjuterike” nuk është ndarë si nënkategori më vete [llog. 2186], duke mos pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj, për të saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit.

- Në llog. 210, llog.211, llog. 212 dhe llog.213 nuk janë përfshirë gjithë asetet e transferuara me VKM për Bashkinë Përmet, pasi procedurat për pajisjen e tyre me titull pronësie janë të papërfunduara nga ASHK dhe nuk është bërë rivlerësimi i tyre. U konstatua se këto asete janë të pa kontabilizuara;

- Llog. 26 “pjesëmarrje në kapitalin e vet” paraqitet në vlerën 216,752,570 lekë.

Bashkia Përmet referuar Ekstraktit të QKB -së është aksionere me 7.65% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë Rajonale “Ujësjetllës Kanalizime Gjyrokastër” Sh.a me Nipt- M.....L, ose me 7650 aksione me vlerë nominale 100 lekë/copa. Kjo vlerë është përcaktuar referuar Marrëveshjes “Për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjetllës Kanalizime [SKPUK]” mes 7 Bashkive të Qarkut Gjyrokastër dhe MIE;

Situacioni përfundimtar i punimeve të kryera në Ujësjetllësin Përmet (pas vitit 2019), i cili në periudhën e transferimit të kapitalit të UK Përmet–sha dhe krijimit të UKR Gjyrokastër-sha ishte në proces, ende i papërfunduar është në vlerën totale 583,299,150.92 lekë;

DFB në llog. 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet" të pasqyrave kontabël, ka regjistruar vlerën e

²⁴ Trajtuar gjerësisht në nënpikën 2.6 të programit “burimi i krijimit të të ardhurave”

certifikuar të Shoqërisë audituese "H A" sh.p.k me ekspertë kontabël H.M të miratuar në prill të vitit 2019, në Raportin e së cilës vlerësohet se kapitali i Shoqërisë UK Përmet -sha është në vlerën 216,752,570 lekë dhe zotërohet në masë të plotë 100% nga aksioneri Bashkia Përmet;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 80-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e buxhetit të marrë masa që deri në mbyllje të vitit ushtrimor 2025:

- Të sistemohet llog. 468 “*Debitorë të ndryshëm*” për vlerën 5,724,449 lekë që përbën vlerën e detyrimit progresiv nga të ardhurat vendore e cila nuk rezulton e kontabilizuar nga DFB;

- Për nëntë projektet e hershme të periudhës deri në vitin 2015 në vlerën totale 7,302,172 lekë që përfshihen në llog.202 “*Studime e projekte*”, të sigurohet informacioni i nevojshëm dokumentar, për të kaluar vlerën e tyre në llogaritë përkatëse të klasës 21 “AAM”: llog.212 apo llog.213 sipas rastit tek investimi respektiv;

- Në llog. 218 “*Inventari ekonomik*” të klasifikojë veçmas llog.2186 “*Pajisje kompjuterike*” në regjistrin e aktiveve të njësisë dhe pasqyrat financiare, sipas nomenklaturës së llogarive;

- Me mbylljen e procedurave të pajisjes me titull pronësie të aseteve të transferuara me VKM, të parashikohet në PBA fond për rivlerësimin e tyre, me qëllim kontabilizimin në llogaritë respektive të klasës 21 “AAM”;

- Të llogarisë amortizimin sipas normës përkatëse për çdo aktiv, për të patur në çdo kohë informacion të saktë mbi aktivet që e kanë vlerën e mbetur të papërfillshme ose zero, të cilat nga rivlerësimi do rezultojnë në gjendje pune;

- Me mbylljen e llogaritjeve të kapitalit të ish UK Përmet pjesëmarrës në UK Rajonale Gjirokastër, të saktësohet dhe vlera e llog. 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*”

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2025

12. Gjetje nga auditimi: - Nga analiza e llog. 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*”, rezulton se për 30 projekte “investime” apo “mallra e shërbime” është ngurtësuar vlera e garancisë prej 19,872,610 lekë, nga të cilat: janë në proces gjyqësor dy OE për vlerën totale 3,967,642 lekë dhe për katër OE në vlerën totale 1,528,145 lekë ka kaluar afati sipas kontratës. Nga ana e DFB nuk janë marrë masa për zhbllokimin e kësaj llogarie, pasi Drejtoria e Urbanistikës nuk ka vijuar me procedurat për përmbjlljen dokumentare të investimit dhe marrjen në dorëzim të tyre, duke patur parasysh dhe faktin që janë projekte të hershme (2016, 2019 dhe dy janë 2021), këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30/2011 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*” i ndryshuar, pika 34, pika 35/a,b; Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, nënkapitulli 2, seksioni 2.2, pika 6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 80-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Në Bashkinë Përmet, GMS, Drejtoria e Urbanistikës dhe Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Zyrën Juridike të marrin masa konkrete për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara konform kuadrit ligjor përkatës dhe për zhbllokimin e llogarisë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” veçanërisht për 4 projekt investimet e hershme në vlerën totale prej 1,528,145 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: mbi procedurën e inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Përmet, u konstatua si më poshtë vijon:

- Në përfundim të procedurës së inventarizimit të aktiveve të njësisë, në Bashkinë Përmet nuk është hartuar nga Nëpunësi Zbatues dhe miratuar nga Nëpunësi Autorizues Regjistri i unifikuar i

aktiveve të Bashkisë. Nga DFB, është hartuar vetëm regjistri elektronik i cili përfshin informacionin e plotë sipas kërkesave ligjore, mosveprime këto në kundërshtim me kreun II, Paragrafi III, pika 26,27,28 dhe Paragrafi IV pika 81 të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar;

- Nuk është miratuar “Rregullore për menaxhimin e aktiveve” dhe Strategjia për mbrojtjen dhe menaxhimin e aktiveve, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Manualit MFK; Udhëzimit nr. 30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6 “Përgjegjësia e titullarit të njësisë publike”, Kreu II pika 17-25;

- Komisioni i inventarizimit fizik dhe i vlerësimit paraprak të aktiveve nuk ka përpiluar procesverbalet për çdo njësi të strukturës e përfshirë në procesin e inventarizimit, në kundërshtim me pikën 85/a të Udhëzimit nr. 30/2011, por ka hartuar vetëm Relacionin përmbledhës mbështetur mbi shënimet tek kartela kontabël e vënë në dispozicion nga zyra e financës.

13.1.Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues dhe Drejtorja e Financës dhe buxhetit të marrin masa për të ndjekur rigorozisht hapat e procedurës së inventarizimit të aktiveve të dokumentuar me informacion të plotë dhe përzgjedhje të anëtarëve të komisioneve , sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi;

- Komisionet e inventarizimit të plotësojnë praktikën me dokumentacionin e plotë në formë dhe në përmbajtje, konform kuadrit ligjor në fuqi për procedurën e inventarizimit të aktiveve kryesisht përpilimin e procesverbaleve në çdo fazë të saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e strukturës përgjegjëse për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, u konstatua se informacioni tatimor përpunohet në paketën “Microsoft Office 2013” programi “Excel”, në mungesë të një sistemi IT bashkëkohor vetëm për të ardhurat vendore. Mungesa e këtij sistemi sjell vështirësi në administrimin e informacionit tatimor për subjektet tatimpaguese, klasifikimin sipas kategorisë së detyrimit, interesat, regjistrimin e gjobave dhe pagesat, etj; në mos përmbushje të kërkesave të Ligjit nr. 10296 /2010, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin financiar dhe Kontrollin” neni 22; Manuali i MFK, Kap. III, Paragrafi 3.2 dhe, 3.3 pika”. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2,6 faqe 54-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë dhe Sektori i taksave e tarifave në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe buxhetit, të marrin masat për implementimin e programeve kompjuterikesi pjesë e rëndësishme infrastrukurore, për mirëadministrimin dhe mos kompromentimin e informacionit tatimor, si dhe për të maksimizuar vjeljen e taksave;

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për vitin 2024, u konstatua se:

- Taksë e ndërtesës është parashikuar në shumën 9,880 mijë lekë dhe është vjelë 7,418 mijë lekë ose në masën 75% të saj, por vlera e saj ka ardhur në rënie prej (-) 1,833 mijë lekë më pak se në vitin 2023 ose me (-) 19%;

- Taksë table është parashikuar në vlerën 300 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 301 mijë lekë ose në masën 100%, krahasuar me vitin 2023 rezulton në rënie në vlerën prej (-)79 mijë lekë ose (-) 28%;

- Të ardhura nga tarifa e pastrimit për vitin 2023 janë planifikuar 13,220 mijë lekë dhe janë realizuar 14,284 mijë lekë ose në masën 108%, krahasuar me vitin 2023 ka një rënie të realizimit të të ardhurave prej (-) 519 mijë lekë ose me (-) 3.5%;
- Të ardhura nga tarifa e ndriçimit janë planifikuar 4,550 mijë lekë dhe janë realizuar 4,037 mijë lekë ose 89%, krahasuar me vitin 2023 ka një rënie prej (-) 322 mijë lekë ose me (-) 7.4%;
- Tarifë e gjelbërimit për vitin 2024 është planifikuar 1,970 mijë lekë dhe realizuar 1,955 mijë lekë ose në masën 99%, krahasuar me vitin 2023 ka rënie me (-) 155 mijë lekë ose me (-) 6%;
- Tarifë për lëndët drusore për vitin 2024 është planifikuar 810 mijë lekë dhe realizuar 589 mijë lekë ose në masën 73%, krahasuar me vitin 2023 ka rënie me (-) 23 mijë lekë ose (-) 3.8%;
- Tarifë kullotë bagëti për vitin 2024 është planifikuar 1,230 mijë lekë dhe realizuar 1130 mijë lekë ose në masën 92%, krahasuar me vitin 2023 ka rënie me (-) 148 mijë lekë ose (-) 11.6%;
- Tarifë parkimi për vitin 2024 është planifikuar 250 mijë lekë dhe realizuar 60 mijë lekë ose 24%, krahasuar me vitin 2023 ka rritje me 7 mijë lekë ose me 11.7%.

Mungesa e një analize të mirëfilltë nga ana e GMS për të ardhurat e (mos) realizuara në vitin 2023, ka sjellë mungesën e planifikimit të tyre ose planifikimin në vlera jo reale të pastuduara mbi të ardhurat e realizuara ndaj pritshmërisë.

- Nga auditimi rezulton se deri në 31.12.2024 rakordimet me DPSHTRR, ASHK Vendore, DPD dhe DPT, nuk janë kryer sipas formateve të miratuara nga MF, këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 9920/2008 datë “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 9632/2006 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, UMF nr. 26 datë 04.09.2008 dhe UMF nr. 12 datë 04.04.2017 etj, “Për Taksat Kombëtare”. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2,6 faqe 54-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria Ekonomike dhe STT të analizojnë me vëmendje të shtuar shkaqet që kanë sjellë mosrealizimin e të ardhurave nga taksat e tarifave përkatëse sipas parashikimit vjetor, si dhe të marrin masa për hartimin e planeve strategjike e vjetor jo vetëm për rritjen e të ardhurave nga arkëtimi i detyrimit vjetor të tatimpaguesve, por edhe për minimizimin e vlerës së debisë progresive.

Menjëherë

15.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet, GMS në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe buxhetit, Drejtorinë Ekonomike dhe Sektorin e të Ardhurave nga taksa e tarifa vendore, dhe gjithë strukturat që sigurojnë të ardhura nga aktiviteti i tyre të marrin masa:

- Për planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e planifikimit të të ardhurave dhe jo atij faktik;
- Për të kryer rakordim periodik mujor dhe vjetor me agjentët tatimor DRSHTRR Gjirokastër, DRT Gjirokastër, DPD/Dogana “Tre urat” Përmet dhe ASHK Vendore Gjirokastër, sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Përmet nga taksat që mblidhen nga këta agjentë.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe analiza e informacioneve mbi aktivitetin dhe taksat e kategorisë biznes, u konstatua se në Bashkinë Përmet rezultojnë 11 subjekte të cilat ushtrojnë më shumë se një aktivitet në territorin e biznesit të tyre me të njëjtin Nipt, por që

paguajnë detyrime ndaj Bashkisë vetëm për një aktivitet të deklaruar. Këto veprime janë kundërshtim me kuadrin ligjor/nënligjor për taksat dhe tarifatat në Republikën e Shqipërisë ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe ligjin nr. 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” i ndryshuar. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2,6 faqe 54-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1.Rekomandimi: Drejtoria ekonomike dhe e të ardhurave vendore dhe Njësitë Administrative, dhe gjithë strukturat e Bashkisë që nga funksioni i tyre sigurojnë të ardhura për buxhetin e Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe buxhetit dhe Zyrën Juridike të marrin masa për të riverifikuar në terren çdo subjekt që ushtron aktualisht aktivitet në territorin e Bashkisë Përmet, duke:

- identifikuar subjektet që ushtrojnë më shumë se një aktivitet të pa deklaruar,
- të rillogarisin vlerën e saktë të detyrimeve vjetore të pa paguara të këtyre subjekteve, referuar kuadrin ligjor dhe vlerës së përcaktuar në VKB që ka miratuar “paketën fiskale të vitit ushtrimor 2025”.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Mbi planifikimin dhe realizimin e treguesve buxhetorë për vitin 2024, u konstatua se, në buxhetin vjetor të vitit 2024 nuk është planifikuar Fond kontigjence, në kundërshtim me ligjin nr. 9936/2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 5 ku përcaktohet se këto fonde [FR] dhe [FK] llogariten deri në masën 3% të buxhetit pa transfertat e kushtëzuara; Niveli i planifikimit buxhetor vjen në rritje nga viti 2023 në vitin 2024 me një diferencë prej 4,103 mijë lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 34-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1.Rekomandimi: Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës dhe buxhetit, të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të planifikohen në buxhet Fondi i kontigjencës; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta mbi arsyet e realizimit dhe mosrealizimit të buxhetit në total dhe për çdo zë buxhetor, sipas programeve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i likuiditeteve dhe informacionit të pasqyruar në tabelën “detyrime të prapambetura”, nëpjesën narrative të materialit rezulton se, kanë lindur detyrime të reja gjatë vitit 2024 në shumën 13,956,508 lekë, krahas vlerës së trashëguar nga viti 2023 në shumën totale progresive 30,119,149 lekë për “investime” dhe “mallra e shërbime”. Gjatë vitit 2024 janë paguar 41,426,683 lekë duke e mbyllur vitin 2024 me një vlerë të detyrimit progresiv të hershëm prej 2,648,974 lekë.

Rezultoi se vlera e detyrimeve të prapambetura sipas bilancit përputhet me atë të raportuar në MFE. Në gjykimin e grupit të auditimit planifikimi i fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në programin përkatës 04960, do të rezultonte me një menaxhim më me efektivitet të fondeve për çdo program të buxhetuar, në rast se nuk do të ishin reduktuar numri i programeve buxhetore nga MFE nëpërmjet Udhëzimeve përkatëse të përgatitjes së PBA-ve nga Njësitë e Vetëqeverisjes vendore.

- Bashkia Përmet ka detyrime të mbartura nga viti 2024 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2025 për “shërbime” në shumën 2,346,886 lekë;

- Ka detyrime për Vendime gjyqësore dëshmshpërblim, në shumën 302,088 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7 datë 25.05.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore” shtojca 1, Udhëzimi MF nr. 6 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026”, UMF nr. 6 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026”, VKM nr. 50 datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” i ndryshuar, Udhëzimi nr. 5 datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 34-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik me Koordinatorin e riskut dhe Drejtoria e Financës dhe buxhetit, të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrit të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjes së detyrimeve të reja dhe monitorimit të zbatimit të kontratave për investime/shërbime/mallra apo vendimeve gjyqësore; për të paguar detyrimet sipas planit të miratuar dhe raportuar në MFE për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në vlerën 2,648,974 lekë deri në fund të vitit 2025; për likuidimin e faturave për mallra/shërbime/investime duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi për likuidimin e tyre në afat dhe sipas radhës; si dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim parandalimin e lindjes së detyrimeve të prapambetura në periudhat e ardhme;

- Drejtoria e Financës dhe buxhetit të bëjë planifikim sa më real të fondeve të çdo programi në PBA dhe Planin vjetor buxhetor, si për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi për likuidimin e tyre brenda afatit të përcaktuar dhe sipas radhës, por dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit ushtrimor.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Bashkia Përmet për zbatimin e rekomandimeve të KLSH përcjellë në RPA me shkresën e saj nr. 493/6 prot., datë 30.07.2024, rezultoi se: nga Bashkia Përmet është bërë raportimi në KLSH për miratimin e Planit të veprimit brenda afatit 20 ditor; është bërë raportimi mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor; është bërë raportimi në Këshillin Bashkiak mbi gjetjet dhe rekomandimet e KLSH-së përcjellë në RPA; konstatohet se, është një masë e konsiderueshme e tyre (përfshirë edhe ato të rikërkua), për të cilat në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e atyre rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht dhe të pa zbatuara.

a. Masa Organizative janë lënë 27 masa që janë pranuar 26 masa nga subjekti, nga të cilat: 13 masa janë zbatuar, 8 masa janë në proces zbatimi, 0 masa pa zbatuar;

b. Masa për eliminimin e efekteve negative në përdorimin me 3E të fondeve publike/administrimit e të ardhurave të munguara janë lënë 4 masa që janë pranuar nga subjekti, nga të cilat: 2 masa janë zbatuar, 1 masë në proces zbatimi, 1 masë është pjesërisht zbatuar, 0 masa pa zbatuar;

c. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, TNI, etj (të ardhura të munguara) janë lënë 6 masa në vlerën totale 51,106 mijë lekë që janë pranuar nga subjekti nga të cilat: 2 masa janë zbatuar, 2 masa janë në proces zbatimi, 0 masa pa zbatuar dhe 2 masa pjesërisht zbatuar;

d. Masa disiplinore, janë lënë 2 masa, nga të cilat masa E1 është zbatuar dhe masa E për 2 punonjës është e pazbatuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 167-196 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

A. Masa Organizative

11.1. Rekomandim: Bashkia Përmet, Sektori Juridik dhe i Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Sektorin e Tatim-Taksave të marrë masa në vijimësi, për të gjithë subjektet që kanë lidhur kontratë investimesh me bashkinë, pajisjen e tyre me nipt sekondar dhe përlllogaritjen e taksave dhe tarifave vendore deri në momentin e përfundimit të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve, të marrin masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

Me përfundimin e vlerësimit të kapitalit nga "UKR Gjirokastër" Sha

23.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet të marrë masa që me grup pune, të cilët të jenë specialist të fushës, të hartojë regjistrin e plotë të aktiveve, jo vetëm për ato që janë të regjistruara në kontabilitet, por edhe për aktivet të cilat momentalisht, nuk janë të regjistruara në librat e kontabilitetit. Mbi bazën e evidentimit në regjistrin e aktiveve, të bëhet inventarizimi fizik i të gjitha pasurive në terren dhe për situatën e konstatuar të hartohet një raport i hollësishëm titullarit të institucionit.

23.2. Rekomandim: Bashkia Përmet të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara), sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. Masa për Eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara.

25.1/2.1. Rekomandimi (e njëjtë me 12.1 Rekomandim / MO) Bashkia Përmet, Drejtoria e Buxhetit, Financës dhe Tatim Taksave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve prej 2,000,000 lekë nga 2 subjektet, respektivisht:

- Vlera 1,000,000 lekë nga subjekti “S.” shpk”,
- Vlera 1,000,000 lekë nga subjekti "G.C" shpk.

Menjëherë

C. Masa për Uljen e borxhit tatimor për rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara)

2.2. Rekomandim: Bashkia Përmet, Sektori i Tatim-Taksave në bashkëpunim me Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Urbanistikës dhe Shërbimeve për personat të cilët nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtime pa leje, t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Gjyrokastër vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1. Rekomandim: Bashkia Përmet, Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e ndërtesave/objekteve në total në vlerën 2,808,417 lekë duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat.

Menjëherë

C. Masa Disiplinore

E. Bazuar në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 57, 58 dhe 59, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar me VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Përmet t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të kryej marrjen e masave disiplinore përkatëse në proporcion me shkallën e shkeljes, për 2 punonjës, respektivisht:

1. Znj. E.K, me status nëpunësi civil me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve në cilësinë e nëpunësit zbatues, nënshkrues i pasqyrave financiare.

2. Z. D.M, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave, për mangësitë e konstatuara në realizimin e planit të të ardhurave, zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, mos mbajtjen e regjistrave për abonentët familjarë, mos mbajtjen e akt rakordimeve me agjentit tatimor UK Sh.A Përmet.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Bashkia Përmet nuk ka hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për implementimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm sipas komponentëve të MFK. Për periudhën objekt auditimi rezultoi se: nuk ka krijuar një strukturë efektive konform kuadrit ligjor, nuk ka përditësuar formularët e përshkrimit të punës për pozicionet me Kod Pune si dhe nuk bëhet shpallja e tyre në AKPA; nuk ka planifikuar dhe zhvilluar programe trajnimi për stafin, përfshirjen e gjithë stafit në trajnimet e zhvilluara nga ASPA me qëllim njohjen nga ana e tij me Ligjin dhe Manualin e MFK; nuk ka miratuar regjistrin e unifikuar dhe strategjinë e riskut, gjurmët standarde të auditimit, rregullore të menaxhimit të aktiveve; nuk ka takime të dokumentuara të GMS, plane dhe raporte vjetore mbi problematikat e hasura dhe zgjidhjen që iu është dhënë gjatë veprimtarisë së njësisë publike, duke zbehur rolin e tij për arritjen e objektivave të njësisë publike; nuk ka hartuar dhe miratuar Listën (hartën)/manualin e proceseve të punës; mosimplementim të sistemeve dhe programeve IT të avancuara veçanërisht në procesin e vjeljes së të ardhurave vendore dhe mirëmbajtjen e atyre ekzistuese për të minimizuar riskun e komprometimit të të dhënave që këto sisteme ruajnë dhe administrojnë; plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacion të përditësuar. Mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; Manualin MFK miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr. 54 datë 15.07.2010 i ndryshuar me atë nr. 108 datë 17.11.2016. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 1, faqe 15-32. ë Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për përmirësimin e komponentëve të MFK dhe veçanërisht për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë, nëpërmjet: rritjes dhe forcimit të aktivitetit GMS, të Kordinatorit të MFK dhe Kordinatorit të riskut; plotësimit të kuadrit rregullator me krijimin e një strukture efektive, miratimin e proceseve të punës, rregullores për menaxhimin e aktiveve dhe të gjurmëve të auditimit, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; forcimit dhe standardizimit në implementimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT të avancuara, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe monitorimit në Bashki.

Menjëherë dhe në vijimësi

20.2.Rekomandimi: GMS, Kordinatori i MFK si dhe Kordinatori i riskut, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor të tij për aktivitetet dhe çështjet që duhet të analizojnë dhe grafikun e takimeve që do realizojnë, për hartimin e raporteve vjetore, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësisë publike në tërësi, për të arritur objektivat institucionale në shërbim të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

20.3.Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa për të hartuar plane dhe programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit dhe specialistit IT, si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë; të kontribuojë në krijimin e një strukture organizative sa më efektive, plotësimin me personel të saj duke zbatuar procedurat ligjore të punësimit, përditësimin e formularëve të përshkrimit të punës për pozicionet me Kod pune dhe dosjeve të personelit me dokumentacion të përditësuar, për të rritur efektivitetin e shërbimeve dhe funksioneve që bashkisë i atribuon ligji në dobi të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi aktivitetin e NJAB u konstatua se, Bashkia Përmet e ushtron aktivitetin e saj në mungesë të NJAB, pasi NJAB e miratuar është me vende vakante. Deri në 31.12.2024 nga ana e saj nuk është mundur të plotësohen vendet vakante në strukturën e NJAB si dhe nuk ka arritur të realizojë bashkëpunim me NJVQV të tjera për të siguruar ofrimin e shërbimit të auditit të brendshëm të tyre nëpërmjet Akt marrëveshjeve, mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar me atë nr. 2 datë 02.02.2023; Manualin e AB miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr. 100 datë 25.10.2016.i ndryshuar me atë nr. 4 datë 10.01.2020; VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kriterëve për themelimin e njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik" të ndryshuar me VKM nr.353, datë 05.11.2016 etj; (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 1, faqe 32-34 të Raportit përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për plotësimin e strukturës me auditues të brendshëm, ose të sigurimit të ofrimit të këtij shërbimi nëpërmjet akt marrëveshjeve me Bashkitë fqinje.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur

në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, **nga Titullari i Njësisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,639,733 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me nr. 4027 prot., datë 28.12.2022. ë lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Përmet, përfaqësuar nga Kryetari Znj. A.H dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “E.” SHPK me NIPT J.....O dhe, Lic. Nr. NZ..... përfaqësuar nga Administratori z. H.M dhe OE C. SHPK me NIPT J.....S dhe, Lic. Nr. NZ. ...me përfaqësues ligjor z. F.C me vlerë të kontratës 12,564,245 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 60 (gjashtëdhjetë) ditë, nga nënshkrimi i kontratës nga data e lidhjes së kontratës me mbikëqyrësin e punimeve, kjo sipas afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit dhe të pranuar nga operatori ekonomik në tender, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5 cm + rrjetë + suva; F.V Dyer d/alumini plastike me dopio xham; FV Fikse zjarri me Co2, destinacioni për mbrojtje e pajisjeve elektrike nga zjarri, kapaciteti 6 kg;], **me pasojë dëm ekonomik** në buxhetin e Bashkisë Përmet , në vlerën **664,487 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me **Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 135-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Përmet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **664,487 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga BOE “E.” SHPK & C. SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 4027 prot., datë 28.12.2022 me objekt “Termoizolimi dhe përmirësimi i sistemit të ngrohjes i konviktit Përmet”.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 107 prot., datë 11.01.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Përmet, përfaqësuar nga Kryetari Znj. A.H dhe shoqërisë “S.” SHPK me NIPT K.....S dhe, Lic. Nr. NZ. 8082 përfaqësuar nga Administratori Znj. A.B me vlerë të kontratës 11,439,482.70 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 3 (tre) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Nënshtresë zhavorri; F.V Tuba çeliku Ø>200 të pa izoluar për ujësjellësa të jashtëm (tubi i thithjes l-25 m); F.V Valvula moskthimi çeliku me fllanxha, Pn deri 25 bar, Ø250 (Valvula e thithjes); F.V Valvula moskthimi çeliku me fllanxha, Pn deri 25 bar, Ø 200 mm; F.V Saraçineska gize me fllanxha, Pn deri 16 bar, Ø>200; Shkallë metalike me hekur dhe profile (për të zbritur tek vepra e marrjes); Hekur betoni (për bazamentin e tij); Rrethim me kollona b/a + rrjetë teli (paneli + kabina + pompa)], **me pasojë dëm ekonomik** në buxhetin e Bashkisë Përmet , në vlerën **1,241,795 lekë pa TVSH**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me **Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 135-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Përmet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **1,241,795 lekë** përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “S.” SHPK, për punime të pa kryera, parashikuar në kontratën me nr. 107 prot., datë 11.01.2023 me objekt “Rehabilitimi i kanalit ujitës Piskovë”, Bashkia Përmet.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me nr. 2814 prot., datë 20.10.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Përmet, përfaqësuar nga Kryetari Znj. A.H dhe shoqërisë “2.” SHPK me NIPT K.....M dhe, Lic. Nr. NZ....përfaqësuar nga Administratori z. A.S me vlerë të kontratës 46,434,882 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 8 (tetë) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Shtresë stabilizanti t=10 cm; Struktura të holla monolite betoni C 16/20 (betone kthesat)], **me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Përmet , në vlerën 405,500 lekë pa TVSH.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 135-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Përmet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **405,500 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “2.” SHPK, për punime të pa kryera, parashikuar në kontratën me nr. 2814 prot., datë 20.10.2023 me objekt: “Rehabilitimi i digës së rezervuarit Pacomit, Bashkia Përmet”.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 79 prot., datë 09.01.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Përmet, përfaqësuar nga Kryetari Znj. A.H dhe shoqërisë “H. 94” SHPK me NIPT J.....O dhe, Lic. Nr. NZ..... përfaqësuar nga Administratori z. A.H me vlerë të kontratës 38,063,788 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 6 (gjashtë) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Trotuar, me 6 cm, me pllaka], **me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Përmet, në vlerën 327,951 lekë pa T.V.SH.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 135-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Përmet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **327,951 lekë pa T.V.SH** përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “H. 94” SHPK , për punime të pa kryera, parashikuar në kontratën me nr. 79 prot., datë 09.01.2023 me objekt: “Sistemim asfaltimi i rrugës Spital - Varreza”.

Menjëherë

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet nga taksat dhe tarifat vendore, u konstatua se deri në datën 31.12.2024, borxhi tatimor progresiv është në vlerën totale 97,956,740 lekë, nga e cila vlera totale progresive e debisë (e kontabilizuar) është 92,232,291 lekë dhe përbëhet si më poshtë vijon:

- Detyrime nga kategoria “biznes”, në vlerën 24,682,418 lekë për 133 debitorë (pa kamatë);
- Detyrime nga kategoria “institucione” në vlerën 1,519,500 lekë për 6 debitorë;
- Kamata e llogaritur nga vlera e debisë është 4,248,982 lekë
- Detyrime nga TNI, në vlerën 1,432,320 lekë për 60 debitorë;
- Detyrime nga taksa e tarifa vendore debitorë familjarë dhe biznes nga ish komunat (deri në 31.12.2015), në vlerën 33,616,134 lekë për një numër të pacaktuar debitorësh;
- Detyrime nga “UK Përmet”–sha në vlerën 26,492,937 lekë për arkëtime të periudhës 2017-2019 të pa derdhura në buxhetin e Bashkisë Përmet;
- Detyrime të gjobave të vendosura nga IMT në vlerën 240,000 lekë;
- Debitorë *pa shpresë arkëtimi* janë 191 subjekte në vlerën e debisë 13,805,893 lekë;

Në Bashkinë Përmet gjatë vitit 2024 nga Drejtoria e Financës, buxhetit dhe treg nuk është shtruar për diskutim në takimet e GMS, mosarkëtimi i shumës progresive debitorë të periudhës deri në 31.12.2024 prej 92,232,291 lekë në total, veçanërisht për 191 debitorët problematik në shumën 13,805,893 lekë si dhe analizës së shumës 33,616,134 lekë e taksave të hershme nga ish komunat. Si rrjedhojë në mungesë të një analize të mirëfilltë, deri tani nuk ka një plan masash konkret për arkëtimin e tyre. Mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920/2008 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6, faqe 54-80 të Raportit përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria Financës dhe e buxhetit, Sektori i të Ardhurave vendore në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të marrin masat për verifikimin e listës së debitorëve të trashëguar nga ish komunat për saktësimin e numrit dhe të debitorëve si dhe arkëtimin e vlerës debitorë 33,616,134 lekë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë periudhës nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, rezulton se janë aktive gjithsej 52 kontrata për dhënien me qira të aseteve në administrim të Bashkisë Përmet. Referuar këtyre kontratave, konstatohet se Bashkia Përmet nuk disponon titull pronësie për pasuritë e dhëna me qira, gjë që cenon sigurinë juridike të administrimit dhe dhënies në përdorim të aseteve publike.

Gjithashtu, Bashkia Përmet ka në administrim 22 apartamente të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave, të cilat i janë dorëzuar për qëllime privatizimi. Sipas vendimeve përkatëse, Bashkia ka detyrimin të lidhë kontrata shitjeje me rezervë me subjektet përfituese nga privatizimi. Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se janë lidhur kontrata me 18 prej këtyre subjekteve, ndërsa 4 kontrata mbeten ende të pakonkluduara.

Në lidhje me detyrimet financiare, deri më datë 31.12.2024 rezultoi se:

- Vlera e detyrimeve të papaguara nga kontratat e qirasë është 1,641,667 lekë;

-Vlera e detyrimeve të papaguara nga kështet e kontratave të shitjes me rezervë është 343,261 lekë. Për sa më sipër konstatohet se nga titullari i institucionit nuk janë marrë masa për ngritjen e grupeve të punës që të ndjekin dhe monitorojnë kontratat e qirasë dhe kontratat e shitjeve me rezervë, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve nga përdoruesit. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, si dhe me detyrimet kontraktuale të përcaktuara në kontratat përkatëse të privatizimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5.2, faqe 148-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për monitorimin dhe ndjekjen e kontratave të qirasë, me qëllim zbatimin e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara në shumën totale prej **1,641,667 lekë**, që rrjedhin nga dhënia me qira e asetëve publike, si dhe të merren masat për ndjekjen e pagesave të kësteve të kontratave të shitjes nga procesi i privatizimit, në shumën totale prej **343,261 lekë**.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve nga taksat dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Përmet me efekt të ardhura të munguara, u konstatua se, deri në datën 31.12.2023, borxhi tatimor ka qenë 51,105,727 lekë për 17,584 debitorë. Vlera debitore e krijuar gjatë vitit 2024 ka qenë 9,976,242 lekë. Në total detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në mënyrë progresive deri në datën 31.12.2024, janë 97,956,740 lekë. Grupi i auditimit ka vlerësuar se detyrimi i papaguar (progresiv) deri në datën 31.12.2024 për disa nga taksat dhe tarifave vendore kryesore të cilat njihen si detyrime nga strukturat përkatëse të vjeljes së tyre, por për mos dërgim të informacionit në Sektorin e Financës është **5,724,449 lekë** e pa kontabilizuar dhe përbëhet si më poshtë:

- Detyrime nga taksa familjare (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim) në vlerën totale është në shumën 27,346,796 lekë, nga e cilat vlera 26,792,937 lekë është vlerë debitore (e kontabilizuar) dhe vlera 853,859 lekë është detyrim i me efekt në të ardhura të munguara i pa kontabilizuar;
- Detyrime nga kontratat e qirave, në vlerën 3,270,590 lekë për 9 debitorë;
- Detyrime nga subjektet që tregëtojnë hidrokarbure, në vlerën 1,600,000 lekë për 2 debitorë;
- Në Bashkinë Përmet nuk janë zhvilluar takime të GMS, ku të trajtohen problematikat për moskontabilizimin dhe pa/mundësinë e vjeljes së detyrimeve të debitorëve dhe si rrjedhojë në mungesë të një analize të mirëfilltë, deri tani nuk ka një plan masash konkrete për arkëtimin dhe kontabilizimin e tyre.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3. dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 54-80 të Raportit përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria Financës dhe e buxhetit, Sektori i të Ardhurave vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e shumës debitore progresive 97,956,740 lekë për 210 debitorë dhe veçanërisht për arkëtimin e debisë prej 13,805,893 lekë të 191 debitorëve problematik të kategorisë “biznes”.

- Drejtoria Financës dhe e buxhetit të kontabilizojë vlerën totale të borxhit tatimor prej 5,724,449 lekë që përfaqëson: diferencën e borxhit tatimor nga taksat familjare në vlerën 853,859 lekë; vlerën 3,270,590 lekë për 9 debitorë nga kontratat e qirasë dhe vlerën 1,600,000 lekë për 2 debitorë nga subjektet që tregëtojnë hidrokarbure.

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike dhe e të Ardhurave, të hartojë një plan masash periodik dhe vjetor për të siguruar vjeljen e taksave dhe tarifave vendore brenda afateve të miratuar me VKB si për familjarët dhe për biznesin, me qëllim parandalimin e krijimit të debitorëve të rinj;

Menjëherë dhe në vijimësi

E.MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me nr. 2814 prot., datë 20.10.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Përmet, përfaqësuar nga Kryetari Znj. A.H dhe shoqërisë “2.” SHPK me NIPT K.....M dhe, Lic. Nr. NZ.... përfaqësuar nga Administratori z. A.S me vlerë të kontratës 46,434,882 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 8 (tetë) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera jo në përputhje me specifikimet teknike dhe normat dhe kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, në shumën **696,800 lekë pa TVSH, vlerë e cila përfaqëson përdorim të fondeve publike pa Eficence dhe Efektivitet.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 135-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Përmet, të marrë masa për të ngritur një grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe, kolaudatorin e punimeve, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, bazuar nga fakti i auditimit në terren ku rezultuan se Tubi metalik Ø 300 mm për kalimet në rrugë kanali vaditës, nuk provohet me dokumentacionin përkatës justifikues/provues se është sipas specifikimeve teknike.

Dalja e përgjegjësave, realizimi i zërit të punimeve sipas PZ dhe ST në shumën **696,800 lekë**, të konfirmohet zyrtarisht nga palët, Autoriteti Kontraktor Bashkia Përmet, Mbikëqyrësi dhe Kolaudatori i punimeve, si dhe nga Sipërmarrësi i punimeve, brenda periudhë 6-mujore të realizimit të rekomandimeve të KLSH-së. Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, Auditit të brendshëm të Bashkisë Përmet, i lihet detyrë të gjegjë referencën e çmimit për tubin e çelikut ekzistues dhe, diferenca do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve.

Deri me datë 30 Dhjetor 2025

F. MASA DISIPLINORE

1. Për punonjësit në marrëdhënie pune

Mbështetur në Nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Përmet, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

a. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, gërma “c” e nenit 58, për 19 punonjës, si më poshtë:

1. Znj. P.M, në cilësinë e Njesisë së Prokurimit, për mangësitë e konstatuara në hartimin e Kriteve të kualifikimit në mënyrë të përsëritur;

2. Znj. M.K, në cilësinë e nëpunësit pranë Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit të miratuara;

-Në cilësinë e Njesisë së Prokurimit, për mangësitë e konstatuara në hartimin e Kriteve të kualifikimit në mënyrë të përsëritur; për veprime në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar.

3. Z.F.H, në cilësinë e Njesisë së Prokurimit, për mangësitë e konstatuara në hartimin e Kriteve të kualifikimit në mënyrë të përsëritur; për veprime në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar.

4. Z. B.M, në cilësinë e Njesisë së Prokurimit, për mangësitë e konstatuara në hartimin e Kriteve të kualifikimit në mënyrë të përsëritur; për veprime në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar.

5. Znj. B.K, në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat e kualifikimit të operatorëve ekonomik për procedurën me objekt “Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023” për veprime në kundërshtim me Sa më sipër rezulton se KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80.

6. Znj. M.T, në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat e kualifikimit të operatorëve ekonomik për “Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023” për veprime në kundërshtim me Sa më sipër rezulton se KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80.

7. Znj. K.M, në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat me objekt “Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023” dhe “Punime shtesë për sistemime të brendshme dhe të jashtme në objektin Pallati i Sportit Përmet”. Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80.

8. Znj. D.D, në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat e kualifikimit të operatorëve ekonomik në mënyrë të përsëritur; Për veprime në kundërshtim me Sa më sipër

rezulton se KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80.

9. Znj. K.G, në cilësinë e anëtarit të komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, për mangësitë në marrjen në dorëzim të mallit për procedurën me objekt “*Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023*” UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

10. Z. A.T, në cilësinë e anëtarit të komisionit dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, për mangësitë në marrjen në dorëzim të mallit për procedurën me objekt “*Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023*” Për veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

11. Z. A.J, në cilësinë e anëtarit të komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, për mangësitë në marrjen në dorëzim të mallit për procedurën me objekt “*Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023*” Për veprime në kundërshtim UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

12. Z. S.K, në cilësinë e anëtarit të komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, për mangësitë në marrjen në dorëzim të mallit për procedurën me objekt “*Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023*” Për veprime në kundërshtim UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

13. Z. E.R, në cilësinë e përgjegjës të konviktit, pjesë e grupit të punës për monitorimin e kontratës, për mangësitë në monitorimin e kontratës në procedurën me objekt “*Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023*” Për veprime në kundërshtim me Vkm Nr. 511, Datë 27.7.2022 “*Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa në Vendimin Nr. 666, Datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për Kuotat Financiare të Ushqimit në Mensa e Konvikte Dhe Përcaktimin e Kriteve për Përfitim dhe Bursave të Pagesave për Nxënësit e Arsimit Parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike*”, të Ndryshuar.

14. Znj. M.SH, në cilësinë e përgjegjëses së çerdhes, pjesë e grupit të punës për monitorimin e kontratës, për mangësitë në monitorimin e kontratës në procedurën me objekt “*Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023*” Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80.

15. Z. L.B, Në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit miratuara;

-Në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat e kualifikimit të operatorëve ekonomik në 2 raste . Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80.

16. Z. B.I, në cilësinë e inspektorit të IMTV për mangësitë e konstatuara për subjektet të cilët kanë kryer kundravajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e marra. në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 3, nenin 4, nenin 5, nenin 11, pikat 5, 6, 7, 8 në nenin 12, nenin 13, në Ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, i ndryshuar; Nenin 1, në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve 159 të ndërtimit*”, i ndryshuar; Pikat 1, 2, dhe 4 në nenin 51 në Ligjin nr. 107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar; Nenin 5, pikën 1 në nenin 9, pikën 3 të nenit 24, shkronjat “a” dhe “c” në pikën 1, pikat 2, 3 dhe 4 në nenin

25, pikat 1 dhe 2 në nenin 31, pikat 4 dhe 5 në nenin 48 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Nenin 11 të Ligjit nr.10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Pikën 1 germa b/ii, pikën 2, shkronjën “b”, pikat 4 dhe 6 në VKM nr. 894, datë 04.11.2015

17. Z. Dh.P., në cilësinë e inspektorit të IMTV për mangësitë e konstatuara për subjektet të cilët kanë kryer kundravajtje administartive dhe procedura e ndjekur për vendimet e marra.

Për veprime në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 3, nenin 4, nenin 5, nenin 11, pikat 5, 6, 7, 8 në nenin 12, nenin 13, në Ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar; Nenin 1, në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve 159 të ndërtimit”, i ndryshuar; Pikat 1, 2, dhe 4 në nenin 51 në Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Nenin 5, pikën 1 në nenin 9, pikën 3 të nenit 24, shkronjat “a” dhe “c” në pikën 1, pikat 2, 3 dhe 4 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 31, pikat 4 dhe 5 në nenin 48 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Nenin 11 të Ligjit nr.10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Pikën 1 germa b/ii, pikën 2, shkronjën “b”, pikat 4 dhe 6 në VKM nr. 894, datë 04.11.2015.

18. Znj. A.P., në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat me objekt: “Rikonstruksion i Pallatit të Sportit, Qytet Përmet” “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara” dhe “Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare Meleq Gosnishti Përmet” Për veprime në kundërshtim me me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80.

19. Znj. E.K., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së financës, buxhetit dhe treg deri në 31.12.2024 në cilësinë dhe të NZ, për mospërbushje plotësisht të detyrave të caktuara në ligjin nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin” neni 11, neni 12 pika 2/d,dh,f,g,gj dhe pika 3/1; Udhëzimit nr. 30 /2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar lidhur me:

- Për mos hartimin e një plani masash për verifikimin e numrit të debitorëve dhe të vlerës së borxhittatimor progresiv, kryesisht të atyre të trashëguar nga ish komunat me qëllim kontabilizimin dhe pasqyrimin në vlerë të saktë të tij në pasqyrat financiare, si dhe për arkëtimin në masë të kënaqshme të detyrimit vjetor nga taksat e tarifave vendore;

- Për mos evidentimin e mungesës dokumentare në procedurën e inventarizimit të aktiveve, të mos llogaritjes së amortizimit për çdo aktiv dhe mos miratimit e regjistrimit vjetor të aktiveve në përfundim të çdo procedure të inventarizimit vjetor.

F2. Për punonjësit e larguar:

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore, sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre:

1. Zj. H.DH., në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të çertifikatave të përdorimit të miratuara, aktualisht i larguar nga puna.

2. Z. G.I., në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, aktualisht i larguar nga puna.

-Në cilësinë e Njësisë së Prokurimit, për mangësitë e konstatuara në hartimin e Kriteve të kualifikimit në mënyrë të përsëritur.

F3. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TËSHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit pjesë e shërbimit civil, për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Përmet, Sektori i Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT

